



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RADIO TELEVISIONIT
SHQIPTAR”, TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË
NË
“DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RADIO TELEVISIONIT
SHQIPTAR”, TIRANË

Tiranë, dhjetor 2024

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinion i auditimit.....	22
II.HYRJA.....	25
1. Objekti i auditimit.....	26
2. Qëllimi i auditimit.....	26
3. Identifikimi i çështjes.....	26
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	26
5. Përgjegjësit e audituesve.....	27
6. Kriteret e vlerësimit.....	27
7. Standartet e auditimit.....	28
8. Metodot e auditimit.....	28
9. Dokumentimi i auditimit.....	28
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	28
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	28
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	29
2.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme.....	29-45
2.2. Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese, Bordit të Administrimit e Këshillit Drejtues, përputhshmëria ligjore e vendim-marrjeve të tyre.....	45-48
2.3. Mbi planifikimin, hartimin dhe realizimin e planit vjetor financiar dhe të biznesit të RTSH dhe njësive përbërëse, si dhe raportimi i tyre.....	48-57
2.4. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	57-87
2.5. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	87-116
2.6. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.....	116-220
2.7. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime,etj).....	218-221
2.8. Mbi administrimin mbi bazueshmërinë ligjore të administrimit të pronës, lidhjes së kontratave për reklama, rregullshmërinë e dhënies me qira të godinave e kullave metalike, të transmetuesve, studiove dhe pajisjeve teknike etj.....	220-229
2.9. Mbi auditimin e projekteve artistike dhe filmimeve	229-266
2.10.Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit	266-274
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	274

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

RTSH është person juridik publik, jo me qëllim fitimi, me seli në Tiranë, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në bazë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, rregulla të mjaftueshme për garantimin e funksionimit normal të RTSH përcaktohen në Statutin e saj, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Për vitin 2022 RTSH ka zhvilluar 17 emisione, janë angazhuar 56 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 15,187,939 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 14,754,400 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 29,942,339 lekë. Për 6-mujorin e parë të vitit 2023 RTSH ka zhvilluar 10 emisione janë angazhuar 35 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 12,961,997 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 12,780,660 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 25,742,657 lekë. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 38, datë 01.07.2004, “Për miratimin e sistemit tarifor të shërbimeve që ofron RTSH”, në pikën 1 është përcaktuar: Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti.</p> <p>Me vendim të këshillit drejtues nr. 85, datë 21.12.2007, është vendosur shfuqizimi i paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti”.</p> <p>Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimin e paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhet me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH”.</p>	Pika 2.5, fq 89-121	E lartë	<p>-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 27,535,060 lekë nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>-Këshill Drejtues brenda kompetencave ligjore, statusore dhe rregullatore të tij, të analizojë mënyrën e pagesës/shpërblimit të punonjësve të angazhuar në projekte artistike dhe filmike në RTSH, dhe të merret vendimi përkatës me argument shterues për të shmangur keq interpretimet e zbatimit të vendimarrjeve të mëparshme nga drejtoria në lidhje me këtë çështje.</p>

	<p>Referuar sa më sipër në RTSH për 27 emisione me angazhim 91 punonjës, është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës.</p> <p>Duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH.</p> <p>Vlera 27,535,060 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike.</p> <p>Veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Nenet 12, 21, 76, 77, 78, 80,81 dhe 115, Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Nenet 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 19, 20 dhe 52.</p>			
2	<p>Me urdhër nr. 218 prot, datë 17.01.2023 të E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm është urdhëruar prokurimi me mjete elektronike me fond limit 22,231,737 lekë me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, procedurë e hapur-mallra, me mjete elektronike.</p> <p>Në vitin 2020, RTSH ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: Furnizim-vendosje, pajisje dhe programeve për shtimin e arkivës për nevoja te RTSH, për vlerën 32,154,035 lekë. Kontrata me operatorin ekonomik “S. T. A.”shpk, është lidhur Nr. 35/16 prot., më datë 01.07.2020 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga Th. G., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “S. T. A.”shpk</p>	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 13,860,000 lekë nga B. M., me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë

	<p>përfaqësuar nga administrator K. P., për vlerën 32,154,035 lekë.</p> <p>-RTSH nuk ka kryer një vlerësim kosto-përfitim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për ruajtjen e të dhënave video. Aktualisht, RTSH ka në pronësi dhe përdorim: Sistemin Storeasy; Sistemin Mam me Storage (hapësirë ruajtjeje e të dhënave) Isilon dhe Backup Veam+ LTO9; Sistemin QSAN. Këto sisteme janë prokuruar për të njëjtin qëllim, ruajtjen dhe arkivimin e videove të RTSH.</p> <p>RTSH nuk ka justifikuar nevojën e një investimi sistem+Storage, pasi ka pasur në pronësi edhe sistemin MAM me Storage Isilon dhe Kasetat LTO9.</p> <p>RTSH duke pasur një sistem ka prokura edhe një tjetër, pa kërkuar shtesë të kapacitetit të sistemit ekzistues, kur duhet të shpenzonte vetëm për shtim të kapaciteteve të sistemit ekzistues dhe jo për sistem dhe storage.</p> <p>Referuar sa më sipër vlera 13,860,000 lekë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga B. M., me detyrë ish-Drejtores e Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit dhe E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19</p>			<p>së Teknologjisë dhe Informacionit dhe E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar</p>
3	<p>Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “T” shpk, me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH në vlerën 13,860,000 lekë, viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve,</p>	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	

	<p>nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, duke mos garantuar vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “T” ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Grupi i auditimit i kërkoi RTSH që kontraktori duke qenë brenda afatit të kontratës të paraqesë në RTSH: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, dokumentacion të cilin nuk u paraqit.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe neni 690, Deklaratën mbi përbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “T” Shpk, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5, neni 122, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.</p>			<p>Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përrjashtuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.</p>
4	<p>Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “F. E.” Shpk, me objekt: “Blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH”, për vlerën prej 15,409,437 lekë viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, duke mos garantuar saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të</p>	<p>Pika 2.6, fq 121- 223</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përrjashtuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “F. E.” Shpk nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato</p>

	<p>konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “F. E.” Shpk ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruarra.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476 659, 698 dhe neni 690, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “F. E.”Shpk, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5, neni 122, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.</p>			<p>të prokuruarra, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 15,409,437 lekë nga Shoqëria “F. E.”Shpk.</p>
5	<p>Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “S. T. A.” shpk, me objekt: Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent, në vlerën 3,097,546 lekë, viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, çertifikatat e garancisë për mallrat, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “S. T. A.” ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi</p>	<p>Pika 2.6, fq 121-223</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “S. T. A.” shpk nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në</p>

	<p>dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruarat.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, neni 659, 698 dhe neni 690, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “S. T. A.”Shpk, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5, neni 122, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.</p>			<p>rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 3,097,546 lekë nga Shoqëria “S. T. A.”Shpk.</p>
6	<p>Me vendim nr. 25, datë 01.12.2022, Bordi i administrimit ka vendosur të jap pëlqimin mbi preventivin për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61” i këngës në RTSH përkundrejt vlerës financiare 47,323,800 lekë.</p> <p>Në këtë preventiv është vendosur dhe vlera 300,000 lekë për drejtorin artistik të festivalit. Drejtori artistik i emëruar me urdhër nr. 32, datë 2.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm E. J., ka vendosur të marrë 300,000 lekë si drejtues artistik i festivalit, edhe pse është zv/titullari i RTSH. Vlerë të cilën nuk është miratuar nga këshilli drejtues me vendim nr. 32, datë 07.12.2022.</p> <p>Preventivi është i pa argumentuar për të gjitha zërat e tij, si në ana sasiore po ashtu dhe për çmimet e vendosura për çdo zë, çmime të cilat nuk janë në librin tarifor të miratuar me vendim të Këshilli Drejtues nr. 38, datë 01.07.2004. Nuk ka procedurë të përcaktimit të çmimeve për asnjë zë të preventivit, si është bërë përzgjedhja e personave dhe e subjekteve tregtare. Nuk ka të ardhura të planifikuara nga biletat, reklamat, sponsorizimet, nuk ka situacion të shpenzimeve sa ka kushtuar “Festivali 61 i këngës”, nuk ka situacion të të ardhurave etj.</p> <p>Për këtë festival RTSH, ka shpenzuar për punonjësit e saj, mbi pagesën</p>	Pika 2.9, fq 235-282	E lartë	<p>Nga këshilli drejtues të rishqyrtohet vlera 3,153,001 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e punonjësve të RTSH për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022, mbi pagesën mujore të tyre në vlerën 3,153,001 lekë, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e RTSH. RTSH nuk duhet të miratonte këtë fond që në planin e biznesit të vitit 2022, pasi menaxhimi nuk ka përcaktuar qartë domosdoshmërinë e planifikimin e këtij fondi dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike etj. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëmin ekonomik.</p> <p>Brenda datës 31.03.2024</p>

	<p>mujore të tyre, vlerën 3,153,001 lekë. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimin e paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhen me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH”. Referuar sa më sipër në RTSH për projektin artistik “Festivali i 61 i këngës”, është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës, duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH.</p> <p>Vlera 3,153,001 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77, 78, 80, 81 dhe 115, Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17.</p>			
7	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>Blerje Shërbimi për Platformën OTT</i>, viti 2020 marrëveshje kuadër me një OE rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm një OE i cili është bashkimi i operatorëve ekonomikë “A. T. & M. N” me vlerë të ofertës 84,858,280 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës i procedurës i administruar në RTSH me nr. 30/8 prot., datë 05.08.2020 ka shpallur fitues këtë bashkim operatorësh. Në përfundim të procedurës është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit nr. 30/10 prot., datë 17.08.2020 me vlerë të kontratës 101,829,936 lekë me TVSH për 24 muaj shërbim, ose 4,242,914 lekë pa TVSH në muaj. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në</p>	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 6,834,738 lekë nga B M N & A. T., për shërbime të likuiduara por të porealizuara si dhe për penaltete të pa aplikuar për dorëzimin me vonesë të shërbimeve në kontratën me objekt “Blerje Shërbimi për Platformën OTT” të lidhur sipas aktit me nr. 30/10 prot., datë 17.10.2020.

	<p>SPE rezulton se OE A. T., nuk plotëson kriterin në lidhje me punët e ngjashme për vlerën përkatëse sipas përqindjes së marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Konkretisht, sipas kontratës së bashkëpunimit OE M. N., ka marrë përsipër të kryejë 75 % të vlerës së kontratës (ose 63,835,200 lekë pa TVSH¹) dhe OE A. T., ka marrë përsipër të kryejë 25 % të vlerës së kontratës (ose 21,278,400 lekë pa TVSH²). Nga të dhënat e ngarkuara në SPE rezulton se BOE në tërësi nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme, pasi konkretisht OE A. T., nuk ka dëshmuar për një kontratë për punë të ngjashme në masën prej 40 % të vlerës takuese, ose shumë prej 8,511,360 lekë pa TVSH (21,278,400 lekë pa TVSH x 0.4) por si dëshmi ka sjellë një kontratë të lidhur mes RTSH dhe B. A.,³ & E. F., me nr. 183/5 prot., datë 24.11.2017. Në fakt kjo kontratë, sikundër është përmendur edhe në auditimin e mëparshëm, nuk ka diktuar qartë se cilat kanë qenë punët konkrete të marra përsipër nga secili prej tyre, kjo pasi të dyja palët kanë marrë përsipër furnizimin dhe i vetmi OE i cili ka pretenduar për marrjen përsipër të plotësimin të të gjitha kërkesave specifike të kërkuara në procedurën e tenderit për stafin dhe dokumentacione fakti ka qenë OE E. F..</p> <p>. Pra, në një situatë të tillë pjesa e furnizimit është marrë përsipër nga të dy OE dhe pjesa e stafit dhe kërkesave për dokumentacion është marrë përsipër nga ana e OE E. F. dhe nuk ka një dëshmi të qartë të punës së kryer. Por pavarësisht kësaj rezulton se vlera totale e kontratës së paraqitur si dëshmi është në masën 7,777,900 lekë pa TVSH nga 8,511,360 lekë pa TVSH që duhet të ishte, pra 733,460 lekë pa TVSH më pak. Për sa më sipër ky BOE nuk duhet të ishte shpallur fitues i procedurës së prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë</p>			
--	---	--	--	--

¹ Referuar vlerës së fondit limit prej 85,113,600 lekë pa TVSH.

² Referuar vlerës së fondit limit prej 85,113,600 lekë pa TVSH.

³ Aktualisht ADVAN TECH

	<p>20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 germa c, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 3, neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1, 2 dhe 3 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.</p>			
8	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike</i>, viti 2022, rezulton se sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me OE fitues V. A., me afat të zbatimit të kontratës 12 muaj. Me urdhër nr. 320/1 prot., datë 31.05.2022 të ish Titullarit z. E. J., është ngritur Grupi i Punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës me përbërje të grupit z. S. M., z. O. H. dhe z. S. B.. Referuar dokumentacionit të pagesave konstatohet se janë përfituar tepër shumat për pagesat respektive si më poshtë:</p> <p>Për periudhën e faturimit 11.05.2022 – 31.05.2022, rezulton se është përfituar tepër vlera prej 4,640 lekë pa TVSH, prej mos paraqitjes së ditëve të sakta në të cilat ka nisur shërbimi;</p> <p>Për periudhën e faturimit 01.06.2022 – 30.06.2022, rezulton se është përfituar tepër vlera prej 38,000 lekë pa TVSH, prej përfshirjes në faturën tatimore të shërbimit në pikat Stadiumi “Arena Kombëtare” dhe “Elbasan Arena”, pika në të cilat, sipas procesverbalit të datës 05.07.2022 ky shërbim nuk është ofruar;</p> <p>Për muajin tetor 2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH, kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.11.2022 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000</p>	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	<p>Nga ana e Titullarit të AK të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 299,941 lekë ndaj OE V. A., për shërbime të likuiduara por të parealizuara si dhe për penaltete të pa aplikuar për dorëzimin me vonesë të shërbimeve në kontratën me objekt “<i>Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike</i>” të lidhur sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022.</p>

	<p>lekë pa TVSH; Për muajin nëntor/2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.12.2022 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000 lekë pa TVSH;</p> <p>Për muajin dhjetor/2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.01.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000 lekë pa TVSH;</p> <p>Për muajin janar/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.02.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000 lekë pa TVSH;</p> <p>Për muajin shkurt/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.03.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000 lekë pa TVSH;</p> <p>Për muajin mars/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.04.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000 lekë pa TVSH;</p> <p>Për muajin prill/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.05.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë</p>			
--	---	--	--	--

<p>rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000 lekë pa TVSH;</p> <p>Për muajin maj/2023 është faturuar shuma prej 239,879 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 19.05.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 225,754 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 14,125 lekë me TVSH, ose 11,771 lekë pa TVSH;</p> <p>Për periudhën maj 2022 – maj 2023 rezulton se nga ana e ofruesit të shërbimit për pikën e emërtuar si “<i>Pallati i Sportit Goga Baket</i>” nuk është ofruar internet i llojit Dark Fiber me çmim 23,000 lekë pa TVSH por është ofruar me transmetim oIP, me një çmim prej 15,000 lekë. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 96,000 lekë pa TVSH [12 muaj x (23,000 – 15,000)];</p> <p>Nga verifikimi i pagesave mujore konstatohet se në pikat “<i>Pallati i Brigadave</i>”, “<i>Stadiumi Shijak</i>”, dhe “<i>Hotel Tirana</i>” nuk është ofruar shërbim për të gjithë afatin e kontratës, për 12 muaj AK Radio Televizioni Shqiptar nuk ka marrë shërbimi për të cilin OE V. A., është kontraktuar sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 me vlerë 8,512,992 lekë me TVSH. Për sa më sipër nga ana e grupit të monitorimit të kontratës, zyrës së fiancës si dhe Titullari nuk janë marrë masat e nevojshme për aplikimin e penaliteteve për mos realizim të kontratës përmes aplikimit të penaliteteve. Kjo shumë e paaplikuar rezulton të jetë në masën prej 44,530 lekë pa TVSH;</p> <p>Si përfundim, rezulton se janë përfituar vlera financiare tepër nga ana e OE V. A., për shërbime të pakryera dhe penalitete të pa aplikuara, në total në shumën prej 299,941 lekë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të arkëtohet ndaj OE.</p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën e shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 17.10.2020, Udhëzimin</p>			
---	--	--	--

	nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.			
9	<p>Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me Fibër Optike”, viti 2023, rezulton se me shkresën nr. 54/5 prot., datë 30.01.2023 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike me argumentimin e fondit limit me përbërje të grupit znj. B. M., z. M. M. dhe znj. K. B.. Përcaktimi i vlerës së fondit limit është bërë në bazë të ofertave të kërkuara ndaj OE V. A., O. A., A., A. S. C., D., T. dhe T..</p> <p>Pas marrjes së ofertave, sipas shkresës me nr. 54/24 prot., datë 01.03.2023 është bërë përcaktimi i vlerës së fondit limit si një mesatare e ofertave të marra duke bërë përcaktuar shumën prej 37,265,708.33 lekë pa TVSH. Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në momentin e nxjerrjes së Urdhrit me nr. 54/5 prot., datë 30.01.2023 për përgatitjen e specifikimeve teknike me argumentimin e fondit limit, RTSH ka patur në proces një kontratë të lidhur me OE V. A., me të njëjtin objekt prokurimi e konkretisht “Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”. Në këtë procedurë është konstatuar se operatori ekonomik i shpallur fitues ka rezultuar me një ofertë fituese e cila ka një ulje në vlerë prej 4,292,040 lekë pa TVSH nga fondi limit, ose në masën prej 37.7 %. Pra, procedura e mëparshme ka rezultuar e suksesshme me çmime shumë më të ulëta nga ato të parashikuara nga AK në procedurën e mëparshme. Për rrjedhojë, në këtë rast AK nuk duhet të ishte referuar mesatareve të marra nga ofertat e operatorëve ekonomikë V. A., A., A. S. C., A. T. U., O. A., por të merrte në konsideratë edhe çmimet e kontratës së parë. Nga përllogaritjet rezulton se nëse vlera e fondit do të ishte përllogaritur me vlerën e kontratës së vitit 2022, do të ishte në masën 17,861,930 lekë pa TVSH, ose</p>	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	Nga ana e RTSH të merren masat e nevojshme për një vlerësim objektiv të mundësive që ofron kuadri ligjor e rregullator i prokurimit publik në përcaktimin e vlerës së fondit limit, duke përzgjedhur mes tyre variantin më të përshtatshëm i cili siguron përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

<p>19,403,778 lekë pa TVSH më pak nga vlera prej 37,265,708 lekë pa TVSH që ka parashikuar AK për vitin 2023. Gjithashtu, konstatohet se as ulja e realizuar nga ana e operatori ekonomik fitues O. A., nuk e ka korrigjuar një efekt të tillë i cili ka bërë që AK të lidh një kontratë për ofrim shërbimi me vlerë 1,139,296 lekë pa TVSH më tepër mbi vlerë e duhur të fondit limit⁴, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin 162/2020 <i>Për Prokurimin Publik</i> neni 34 <i>Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit</i>, pika 3, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “<i>Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik</i>”, neni 12 <i>Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës</i>, pika 4, neni 13 <i>Studimi paraprak i tregut</i>, pika 2, neni 76 <i>Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit</i>, pika 1 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.</p>			
--	--	--	--

⁴ Nëse vlera e fondit limit do të ishte sipas çmimeve të kontratës së mëparshme.

10	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>Blerje Shërbimi për Platformën OTT</i>, viti 2020 marrëveshje kuadër me një OE rezulton se ky investim ka parashikuar krijimin e një aplikacioni <i>RTSH Tani</i> të aksesueshëm në të gjitha platformat si Android, iOS dhe pajisjet Smart TV përmes të cilit të mund të shihen kanalet TV dhe Radio të RTSH. Procedura është iniciuar me shkresën e administruar në Njësinë Teknike me nr. 436 prot., datë 21.06.2019 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH me nr. 1912 prot., datë 21.06.2019 është bërë kërkesë nga ana e Drejtorit të NJT për zhvillimin e mëtejshëm të platformës OTT. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është hartuar një relacion sqarues mbi leverdinë e investimit, pra nuk ka një studim fizibiliteti mbi përfitimet që i sjell ky investim RTSH. Aktualisht shërbimi nuk është më funksional pasi kontrata me vlerë 101,829,936 lekë me TVSH ka përfunduar në shtator të vitit 2021 dhe RTSH nuk ka asnjë akses në këtë aplikacion. Për rrjedhojë nga sa më sipër rezulton se nuk ka asnjë indikator vlerësues të dobishmërisë së investimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “<i>Për prokurimin publik</i>”, i ndryshuar, neni 1, “<i>Objekti dhe qëllimi</i>” si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.</p>	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet për çdo investim të parashikuar për tu kryer nga institucioni në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, një studim i qartë fizibiliteti me indikatorë konkretë e të matshëm, kjo më qëllim vlerësimin real të impaktit të investimeve dhe shmangien kështu të praktikave të kryerjes së investimeve të panevojshme dhe përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve.</p>
11	<p>Efekt financiar negativ në vlerën 49.472.938.4 lekë për procedurën e prokurimit “Blerje video wall,televizor, dhe pajisje ndriçimi për studiot e RTSH-së”. Me datë 22.10.2021 është lidhur kontrata me nr. 53/16 prot.,ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga z. M. L., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe bashkimit të operatorëve ekonomike I. S. C., në vlerën 58,200,000 lekë me TVSh, me datë fillimi nënshkrimit e saj dhe me afat 60 ditë. Me datë 20.12.2021 Autoriteti Kontraktor RTSH i përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm z. E. J. dhe bashkimi i operatorëve I. përfaqësuar nga z. E. A., kanë</p>	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	<p>Strukturat aktuale në RTSH ,drejtori dhe bordi drejtues të marrin në vlerësim dhe të analizojnë shkaqet dhe arsyet që kanë sjellë pasojat financiare në vlerën 49,472,938.4 lekë ,duke</p>

	<p>nëshkruar amendimin e kontratës me nr. 4546/6 prot, për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e kontratës me nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021, me arsyen se mallrat objekt i kontratës janë bllokuar në port nga situata e Covid 19. Neni 4 i amendimit të kontratës “Klauzolë shtesë” përcakton se: “Nëse me mbarimin e afatit të kontratës siç përcaktohet në nenin 4 të këtij amendimi nuk janë dorëzuar të gjitha mallrat sipas zërave objekt të kontratës nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021, në ambientet e RTSH-së, brenda orarit zyrtar të punës (ora 16:00), Autoriteti Kontraktor RTSH ka të drejtën për ta deklaruar kontratën të zgjidhur menjëherë” Operatori ekonomik I., (pasi ka pranuar zgjidhjen e kontratës në rast mosdorëzimi të mallrave brenda afateve të përcaktuara në amendimin e kontratës), duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për mospranim të mallrave jashtë afateve të kontratës, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë-padinë objekt gjykimi.</p> <p>Me vendimin 2508 datë 04.10.2022 Gjykata administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka vendosur:</p> <p>Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, Detyrimin e palës së paditur që të përmbushë detyrimin kontraktor ndaj paditësve në shumën 48,500,000 mijë lekë, Rrëzimin e kërimit për dhënie vendimi me ekzekutim të përkohshëm dhe Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga shërbimi përbarimor gjyqësor.</p> <p>Vlera 48,500,000 lekë sipas vendimit gjyqësor nr.2508 datë 04.10.2022.</p> <p>Vlera 972,938.4 lekë për vënien e sekuestros ekzekutive ,tarifa e shërbimit përbarimor.</p> <p>Deri ne këtë faze të auditimit ,faza projekt raportit vlera 49,472,938.4 lekë do të konsiderohet si veprim me efekt financiar negativ.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 2,3.</p> <p>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për</p>			<p>nxjerrë përgjegjësinë ligjore dhe administrative të të gjitha strukturave drejtuese dhe zbatuese ,referuar gjetjeve të grupit të auditimit.</p> <p>Vlera 48,500,000 lekë sipas vendimit gjyqësor nr.2508 datë 04.10.2022</p> <p>Vlera 972,938.4 lekë për vënien e sekuestros ekzekutive ,tarifa e shërbimit përbarimor.</p>
--	--	--	--	--

	menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale, neni 8 ,neni 2			
12	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë Ekonomike, rezulton se nga ana e RTSH në vijimësi përgjatë periudhës 2020 deri 30.06.2023 janë favorizuar padrejtësisht qiramarrësit përmes mos arkëtimeve të shumave respektive të cilat arrijnë në total vlerën prej 73,878,523 lekë si dhe duke mos marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për aplikimin e penalteteve për vonesa në arkëtimin e shumave në vlerën totale prej 1,802,711 lekë. Kjo situatë paraqitet e tillë deri me datë 30.06.2023. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratat respektive të qirave.</p>	Pika 2.8, fq 226-235	E lartë	<p>Nga ana e Titullarit të RTSH të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës prej 73,878,523 lekë si këste mujore të papaguara nga ana e subjekteve qiramarrës si dhe shuma prej 1,802,711 lekë si penaltitet i pa aplikuar ndaj 23 subjekteve sipas tabelës nr. 4, për mos respektim të kushteve kontraktuale prej përdorimit të aseteve të RTSH, në kundërshtim me kontratat respektive.</p> <p>-Nga ana e Titullarit të RTSH, të merren masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për të ndaluar përdorimin e aseteve nga ana e këtyre subjekteve deri në kryerjen e pagesave.</p> <p>-Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për të mos lidhur kontrata të reja qiraje apo për të mos rinovuar ato ekzistuese me subjektet debitorë si më sipër me qëllim arkëtimin e shumave dhe përdorimin e tyre më pas për interesa të institucionit.</p> <p>-Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për të mos lidhur kontrata të reja qiraje apo për të mos rinovuar ato ekzistuese me subjektet debitorë si më sipër me qëllim arkëtimin e shumave dhe përdorimin e tyre më pas për interesa të institucionit.</p>
13	Për blerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, ndërmjet ndërmjet RTSH dhe operatorit/e shoqërisë “R. & S. Os. G.”, është lidhur marrëveshja kuadër me 54/18 prot., datë	Pika 2.6, fq 121-223	E lartë	-Nga Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa për të rinegociuar me Kompaninë “R. & S. Os. G.”, Austri, Marrëveshjen Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, për të bërë

	<p>26.02.2021 për vlerën 7,329,968 euro me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj.</p> <p>Për periudhën 01.03.2021 deri 30.06.2023 është likuiduar për vlerën 6,007,626 euro.</p> <p>Dokumentacioni i likuidimit: Urdhër transfertat, fatura elektronike, raport SLA të kryera për çdo muaj drejtuar drejtuesit të njësisë teknike të RTSH, i firmosur nga grupet e punës/komisionet e ngritura me urdhër të drejtorit të përgjithshëm për vlerësimin e disponueshmërisë së rrjetit DVB-T2, në mënyrë të njëanshme pa firmosur nga "R. & S. Os. G.", Shkresat muaj për muaj drejtuar drejtorit të përgjithshëm nga drejtori i njësisë teknike, për dërgimin e raporteve/procesverbaleve për shpërblim të kompanisë "R. & S. Os. G.". Pagesat janë bërë/kryer :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pa mbajtur akt-kolaudim ndërmjet palëve. -Raportet mbi SLA e kryera, janë të përgjithshme jo të detajuar, ashtu siç është përcaktuar në specifikimet teknike. - Raportet nuk janë sipas aneksit nr. 4 "Formati i raportit periodik për stacionet e RTSH".Veprime në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, Nenin 21, Neni 5, pika 3, Neni 6, pika 4, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", Neni 419, 420, Neni 659, 698 dhe Neni 690. 			<p>amendimet përkatëse me qëllim që kopjet në anglisht të akt kolaudimeve/procesverbalet e pranimit/akt pranimeve në zbatim të kontratës të jenë të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët, referuar: Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14/1; Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private", Kreu VII "Detyrimet dhe kontratat", Neni 45 "Liria e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm"; Rregullores (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit European dhe të Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore", Neni 11, pika 1,2,3</p> <p>-Marrja në dorëzim i shërbimeve të kryera nga Kompania "R. & S. Os. G.", Austri të bëhet konform specifikimeve teknike të përcaktuar në kontratë me akt kolaudime/procesverbale të pranimit/akt pranime të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët.</p>
14	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për periudhën objekt auditimi, RTSH nuk ka krijuar dhe përditësuar një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri duhet të ishte mbajtur në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar. Regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshin: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e</p>	Pika 2.8, fq 226-235	E lartë	<p>Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për krijimin dhe përditësimin e regjistrit kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Ky regjistër të mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar i cili në vartësi të llojit duhet të përfshij: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e</p>

	<p>shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>Nga RTSH nuk është kryer inventari fizik i aktiveve afatgjata materiale. Inventari kontabël i aktiveve afat gjata materiale nuk është i detajuar toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj. Referuar sa më sipër, grupi i auditimit nuk ka mundur të auditojë administrimin e pronës. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si ndryshuar si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.</p>			<p>akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për kryerjen e inventarit fizik të aktiveve afatgjata materiale si dhe për detajimin e inventarit kontabël të aktiveve afat gjata materiale në toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.</p>
15	<p>Mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1740 prot., datë 20.05.2021 në vlerën 4,500,000 lekë (Personi fizik znj. E. R., me emrin tregtar T. S.), për prodhimin e porositur te ciklit të dokumentareve “Koha dhe artisti”</p> <p>Sipas materialit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Arkivave episodi i ciklit të dokumentareve “Koha dhe artisti” gjendej i ruajtur në sistemin ETER/MAM 8 episode dhe në hard disc 2 episode. Përmbajtja e lëndës së 10 dokumentareve përbërës të veprës nuk ishte e njëjtë me përshkrimin sipas sinopsit të projektit për të cilin personi fizik znj “E. R.,” është kualifikuar nga Bordi Artistik i RTSH</p>	Pika 2.9, fq 235-282	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 4,500,000 lekë nga subjekti E. R., (me emrin tregtar Timeless Studio) për projektin artistik “Bota Arbërore”. Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1740 prot. datë 20.05.2021, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik znj. E. R., për vlerën 5,000,000 lekë.</p>
16	<p>Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2262 prot., datë 24.07.2020, e ndryshuar me amendimin e kontratës me nr. 2674 prot., të datës 16.04.2021 për vlerën 2,392,000 lekë (shoqëria S. e përfaqësuar nga znj. E. R.), për bashkëprodhimin filmik “Light Falls”.</p>	Pika 2.9, fq 235-282	E lartë	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 2,392,000 lekë nga shoqëria</p>

<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga përfaqësuesit e subjektit, kopja e parë standarde e filmit “Light falls” është dorëzuar pranë RTSH me datë 26.10.2022, pra 10 muaj pas përfundimit të kontratës, kjo në kundërshtim me kontratën nr. 2674 prot., datë 16.08.2021 ku sipas nenit 1 shoqëria S duhet të dorëzonte kopjen e parë standarde të filmit me datë 15.12.2021. Neni 7 pika 2 e kontratës parashikon se “Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH-në se kopja e para standarde e filmit do të realizohet jo me vonë se data 21 shkurt 2022 dhe do të dorëzohet në RTSH jo me vonë se data 28.02.2022 .Në rast mosrespektimi të afatit të përcaktuar në këtë paragraf nga ana e shoqërisë ,shoqëria detyrohet t’i kthejë RTSH-së çdo shumë në lekë që RTSH ka paguar në përputhje me këtë kontratë ,si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara .Shoqëria është e detyruar që të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit”.</p> <p>Shoqëria S., ka shfrytëzuar 80 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Light falls” në kundërshtim me kontratën nr 2262 prot datë 24.07.2020 e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës duke mos përmbushur kështu detyrimet kontraktuale.Në kundërshtim me rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore).Kontraten e bashkëprodhimit nr 2262. prot datë 27.07.2020</p>		<p>“S”. Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 2262 prot. datë 24.07.2020,ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik znj. E. R. ,për vlerën 2,990,000 lekë.</p>
---	--	--

1.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar⁵).

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së RTSH-së me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e RTSH, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020 deri me datë 30.06.2023, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSAI P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga RTSH dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Në besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar** mbështetur në konstatimet në vijim:

-Për vitin 2022 dhe 6-mujorin e parë 2023, RTSH ka zhvilluar 27 emisione në cilat janë angazhuar 91 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 28,149,936 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 27,535,060 lekë, totali 55,684,996 lekë. Angazhimi i 91 punonjës të RTSH jo vetëm ka krijuar një marrëdhënie juridike në shitblerjen e të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës, por edhe një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH. Vlera 27,535,060 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

- Me urdhër nr. 218 prot, datë 17.01.2023 është urdhëruar prokurimi me mjete elektronike me fond limit 22,231,737 lekë me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem

⁵ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”, trajtuar në Manualin e Përputhshmërisë miratuar me Vendim Kryetari nr. 245, datë 29.12.2022 (Fq 102-103).

storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, procedurë e hapur-mallra, me mjete elektronike. RTSH nuk ka kryer një vlerësim kosto-përfitim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për ruajtjen e të dhënave video. Grupi i auditimit vlerëson se RTSH nuk ka justifikuar nevojën e një investimi sistem+storage, pasi ka pasur në pronësi edhe sistemin MAM me Storage Isilon dhe Kasetat LTO9. Vlera 13,860,000 lekë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet.

-Pagesë e dubluar në procedurën blerje me vlera të vogla “Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”, viti 2023, me kontratën shërbimi nr. 456/33 port., datë 11.05.2023, duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 252,000 lekë.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “F. E.”shpk, me objekt blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH në vlerën 15,409,437 lekë viti 2023, kontratës nga Shoqëria “T” shpk, me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH viti 2023, kontratës nga Shoqëria “S. T. A.”shpk, me objekt: Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent, në vlerën 3,097,546 lekë, viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën operatorët ekonomik kanë fituar procedurat e prokurimit dhe janë likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratave në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.

Deri në paraqitjen nga operatorët ekonomik të raportet e testeve (test raportin e fabrikës) dhe certifikatat e origjinës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilët operatorët ekonomik kanë fituar tenderat dhe janë likuiduar, vlera 18,506,983 lekë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet.

- Në zbatimin e kontratës për bashkëpunim/këmbim reklame nr.1613 prot., datë 05.05.2022 të lidhur me shoqërinë “N.” shpk për vlerën 3000 euro për 5 spote pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, në favor të “N.” shpk u konstatuar një mos realizim në vlerën 1,172 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me diferencën ndërmjet faturës elektronike të RTSH me nr. 134/2022, datë 30.05.2022 për vlerën 3,180 euro dhe furnizimeve të bëra nga shoqëria “N.” shpk që kapin vlerën 2,008 euro. Vlera 1,172 euro, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

-Në zbatimin e kontratës për bashkëpunim/këmbim reklame nr.1633 prot., datë 19.04.2022 të lidhur me shoqërinë “A. E. H. C.,” shpk për vlerën 250,000 lekë për 8 spote pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, në favor të “A. E. H. C.,” u konstatua një mos realizim në vlerën 250,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me mos përmbushjen e detyrimeve kontraktore, pasi përveç faturës elektronike nr. 1/2022, datë 10.05.2022 nuk ka asnjë dokument tjetër që provon se është realizuar kontrata/shkëmbimi, psh, komisionin e marrjen në dorëzim të 10 veshjeve për drejtueset me vlerë 250,000 lekë, fletëhyrjen, fletë daljen etj. Vlera 250,000 lekë, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

- RTSH për projektin artistik “Festivali i 61” i këngës, ka shpenzuar për punonjësit e saj, mbi pagesën mujore të tyre, vlerën 3,153,001 lekë, duke krijuar një marrëdhënie juridike të shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të

detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës, si dhe një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH. Vlera 3,153,001 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet.

- Në 6 raste për vlerën 10,209 euro viti 2022 në shpenzimet për udhëtim dhe dieta të kryera me anë të arkës, dokumentacioni është në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Vlera 8,650 euro përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet.

-Në tre raste për vlerën 4,679,208 lekë, RTSH ka marr me qira pajisje të ndryshme për realizimin e koncerteve, pa argumentuar nëse RTSH i dispononte ose jo pajisjet e marra me qira. Vlera 4,679,208 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

- Në procedurat e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, me vlerë 7,330,000 euro pa TVSh, viti 2020, blerje karburanti me vlerë 32,415,472 lekë, viti 2021 kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi është vendosur kriter i kualifikimit favorizues autorizim nga prodhuesi. Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, ka orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

-Për blerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, ndërmjet RTSH dhe operatorit/e shoqërisë “R. & Sch, O, G,” , është lidhur marrëveshja kuadër me 54/18 prot., datë 26.02.2021. Pagesat janë bërë/kryer: Pa mbajtur akt-kolaudim ndërmjet palëve. Raportet mbi SLA, janë të përgjithshme jo të detajuara, ashtu siç është përcaktuar në specifikimet teknike. Raportet nuk janë sipas aneksit nr. 4 “Formati i raportit periodik për stacionet e RTSH”.

- Në 7 kontrata për transmetim reklame, media planet e transmetimit janë firmosur nga E. K., me detyrë drejtor i shitjes dhe menaxhimit, pa delegim kompetence. Nga verifikimi në arkivën numerike u konstatua që ndeshjet janë të ruajtura bruto pa prerje dhe editime net. Reklammat e transmetuara nuk janë të ruajtura, janë fshirë, janë shkëputur nga ndeshjet e transmetuara dhe të arkivuara. Reklammat u verifikuan në (path-in) rrugën; rtsh_data; Sporti Arkiv; 2022; Mars 2021. Për kontratat për transmetim reklame të përshkruara si më sipër, nuk disponohen programet e transmetimit, dhe asnjë dokument tjetër justifikues për realizimin e kontratave (Media plani/ programet e transmetimit).

-Nga auditimi i nivelit të pagave të miratuar nga këshilli drejtues me vendim nr. 28, datë 22.07.2021 dhe nr. 34, datë 07.12.2022 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, u konstatua që klasifikimi nuk është bërë duke vendosur kriteret specifike për çdo pozicion pune, siç janë niveli i diplomës, arsimimi/kualifikimi, natyra e punës, kushtet e punës, formimi profesional, vjetërsia në punë, vështirësia, përvoja dhe përgjegjësitë, njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet si kusht për të garantuar barazinë në vendosjen e pagave. Këto

kritere nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave.

- Prokurimi i kontratës me objekt blerje shërbimi për Platformën OTT, viti 2020 me vlerë të fondit limit 85,113,600 lekë pa TVSH dhe vlerë të kontratës së lidhur 84,858,280 lekë pa TVSH për një investim i cili ka parashikuar krijimin e aplikacionit RTSH Tani të aksesueshëm në të gjitha platformat si Android, iOS dhe pajisjet Smart TV përmes të cilit të mund të shihen kanalet TV dhe Radio të RTSH në kushtet kur nuk është hartuar një relacion sqarues mbi leverdinë e investimit, pra nuk ka një studim fizibiliteti mbi përfitimet që i sjell ky investim RTSH - së. Aktualisht shërbimi nuk është më funksional pasi kontrata me vlerë 101,829,936 lekë me TVSH ka përfunduar në shtator të vitit 2021 dhe RTSH nuk ka asnjë akses në këtë aplikacion.

-Likuidimi i shërbimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej 7,143,679 lekë pa TVSH për dy kontrata, konkretisht:

1. Kontrata me objekt blerje shërbimi për Platformën OTT, viti 2020, me vlerë 101,829,936 lekë me TVSH për të cilën i është likuiduar B., fitues M. N., & A. T., shuma prej 6,834,738 lekë pa TVSH për shërbime të pakryera në fakt si dhe penalitete të pa aplikuar për vonesat në ofrimin e shërbimeve;

2. Kontrata me objekt blerje shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike, viti 2022, me vlerë 8,512,992 lekë me TVSH për të cilën i është likuiduar OE fitues V., shuma prej 299,941 lekë pa TVSH për shërbime të pakryera në fakt si dhe penalitete të pa aplikuar për vonesat në ofrimin e shërbimeve;

- Mos marrja e masave nga asnjë prej Titullarëve ndër vite arkëtimin e shumave respektive prej 23 kontrata qiraje të cilat arrijnë në total vlerën prej 75,681,234 lekë, nga të cilat vlera 73,878,523 lekë, si këste mujore të papaguara nga ana e subjekteve qiramarrës, si dhe shuma prej 1,802,711 lekë si penaltet i pa aplikuar ndaj tyre për mos kryerjen në kohë të pagesave.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit:

Strukturat menaxheriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar Tiranë janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Stafi drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësia e audituesve të KLSH:

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Në identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur sipas përcaktimeve ligjore është vendosur që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 564/1 prot., datë 26.07.2023, i ndryshuar, nga data 25.07.2023 deri 14.11.2023, në Drejtorinë e Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 30.06.2023, u krye auditim “Përputhshmërie” me përbërje:

1. F. I., përgjegjës grupi,
2. J. H., auditues,

3. V. B., auditues,
4. K. SH., auditues,
5. J. B., auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objekti i auditimit:

Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: Rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: Standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë, që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

-Njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

-Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese, si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

b. Qëllimi i auditimit:

-Është;

-vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Drejtoria e Përgjithshme e Radio Televizionit Shqiptar.

-dhënia e opinionit mbi rregullshmerinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime⁶.

c. Identifikimi i çështjes:

Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar Tiranë, në funksion të shërbimit të transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në bazë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, vendimmarrja e organeve drejtuese etj. Në fokusin e angazhimit është administrimi i pronës, lidhja e kontratave për reklama, rregullshmërinë e dhënies me qira të godinave e kullave metalike, të transmetuesve, studiove dhe pajisjeve teknike etj, në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet e vlerësuara nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 564/1 prot., datë 26.07.2023, i ndryshuar.

d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

⁶ -Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar nga Kryetari KLSH me Vendimin Nr. 107, datë 8.9.2017, me ndryshimet.

Drejtimi i RTSH është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, zbatimin e kuadrit rregullator ligjor dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare. Ky Institucion duhet që të menaxhojnë burimet dhe të ushtrojnë autoritetin në përputhje me vendimet dhe kërkesat e legjislacionit.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe për vendosjen dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, që ai i konsideron të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Është përgjegjësi e subjektit të audituar për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, si edhe pohimet respektive në pasqyrat vjetore.

Drejtimi ka përgjegjësinë e tij për hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për të parandaluar, ose për të zbuluar dhe rregulluar gabimet materiale ose mospërputhshmëritë, që të jetë i përshtatshëm për këtë qëllim.

Drejtimi dhe menaxhimi janë përgjegjës për përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Ata përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator.

e. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Në këtë kontekst duhet:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000* dhe *ISSAI 100*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticismin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse (*ISSAI 1500/ISA 300*).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Në jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI*-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe *ISSAI* 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, në besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

f. Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 97, datë 4.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar; Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar; VKM nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.

g. Standardet e auditimit:

-ISSAI 100- (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*);

-ISSAI 4000- (*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*);

ISSAI 400 - (*Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë*);

- SNA) të IFAC - (*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*);

-Manual i IDI-t -(*Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI për auditimet e përputhshmërisë*);

- *Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë*;

-*Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH-së*;

-*Kodi etik i KLSH*.

h. Metoda e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

i. Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-konstatimeve të mbajtura, observacioneve të paraqitura, u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

RTSH është person juridik publik, jo me qëllim fitimi, me seli në Tiranë, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në bazë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, rregulla të mjaftueshme për garantimin e funksionimit normal të RTSH përcaktohen

në Statutin e saj, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”.

RTSH-ja e kryen veprimtarinë e vet mbështetur në:

- a) drejtimin ekonomik - financiar të decentralizuar;
- b) prodhimin e programeve audio dhe audiovizive për transmetim në RTSH dhe për të tretët;
- c) transmetimin audio dhe audiovizive për programin e RTSH-së dhe për të tretët.

RTSH-ja ka këtë strukturë organizative:

- a. Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së;
- b. Njësia e Programeve;
- c. Njësia e Teknikës;
- ç. Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve;
- d. Departamenti i prodhimit;
- dh. Qendrat vendore audiovizive (Kukës, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër).
- e. Orkestra Simfonike.

Më 29 prill 1960 ka filluar nga puna qendra eksperimentale e Televizionit Shqiptar, e cila shënon njëkohësisht dhe fillimet e tregut televiziv në vendin tonë. Në vitin 1963 u transmetua edicioni parë i lajmeve, ndërsa në vitin 1965 kamera e vetme e TVSh u zhvendos për herë të parë jashtë studios. Prej vitit 1993 RTSH-ja transmeton programet e saj radiofonike dhe televizive edhe nëpërmjet satelitit, dhe aktualisht transmeton në 12 kanale televizive kombëtare, 3 kanale televizive lokale dhe 8 kanale radiofonike.

Sipas strategjisë kombëtare të digjitalizimit, është realizuar kalimi nga transmetimet analogë në ato numerike, një proces me rëndësi kombëtare dhe një nga investimet më të mëdha të RTSH që nga krijimi i saj.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme.

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 842/7 prot., datë 31.12.2013 për periudhën e auditimit të veprimtarisë ekonomiko – financiare të subjektit (RTSH) nga data 01.01.2010 deri më datën 30.06.2013 grupi i auditimit konstatoi se rekomandimet e lëna për përmirësimet ligjore janë zbatuar në masën 100 %, masat organizative janë zbatuar në masën 87.5 %, ndërsa masat shpërblim dëmi dhe masat disiplinore nuk janë zbatuar. RTSH/strukturat drejtuese të saj nuk i kanë ndjekur dhe monitoruar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, deri në plotësimin e zbatimit të tyre në masën 100 %. Për shkak të periudhës së gjatë (gati 10 vjeçare) e cila ka kaluar që nga dërgimi i rekomandimeve, disa prej tyre nuk janë më aktuale për shkak të ndryshimit në vite të bazës ligjore ku referojnë, afateve të parashkrimit referuar Kodit Civil, si dhe dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 21-23 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit*).

A.MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: RTSH/Drejtoria Juridike të marrë masa për të siguruar trajtimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke i monitoruar dhe zbatuar ato brenda afateve të përcaktuara, me qëllim përmirësimin e situatës së funksionimit të institucionit dhe shmangien e afateve të parashkrimit të përcaktuara.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Është hartuar Plan Veprim mbi zbatimimin e rekomandimeve të KLSH, të ndara sipas drejtorive.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

2.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të hartojë kodin e sjelljes lidhur me rregullimin e veprimtarisë së tij për çdo interes apo lidhje me ndonjë subjekt, si dhe çdo interes të mundshëm në ndonjë kontratë, që RTSH-ja ka realizuar ose synon të realizojë; të marrë masa për t'u mbledhur sa herë të jetë e nevojshme por jo më pak se njëherë në dy muaj, si dhe të dokumentojë cilësimin e mungesës së anëtarëve në çdo rast.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit:

KDRTSH nuk ka hartuar kodin e sjelljes, por mbledhur në vijueshmëri sipas përcaktimeve të statutit.

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

3.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të miratojë deklaratat njëvjeçare në lidhje dhe në përputhje me Deklaratën e Qëllimit, të miratojë kriteret kryesore për vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve si dhe të respektojë afatin për dërgimin e materialeve anëtarëve të këshillit para zhvillimit të mbledhjes.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

KD është mbledhur dhe ka vendosur të miratojë deklaratat njëvjeçare në lidhje me Deklaratën e Qëllimit

Rekomandimi është pranuar dhe është duke u zbatuar në vijimësi

4.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa dhe të organizojë punën për nënshkrimin e kontratave me të tretë; informimin e AMA në afat për çështje të prodhimeve të porositura dhe fondin e prodhimit të pavarur; për të raportuar për zbatimin e strategjisë; hartimin dhe zbatimin e plan biznesit për zhvillimin e veprimtarisë; hartimin rregullisht të planeve mujore të punës dhe raportimin në KDRTSH-së për realizimin e planeve të zhvillimit të programeve e të biznesit; raportimin dhe dokumentimin e Drejtuesve të Njësive me shkrim çdo tre muaj Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e planeve përkatëse; si dhe paraqitjen në KD të informacioneve sa herë të kërkohet prej tyre.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Njësia e Programeve ka raportuar për tremujorin dhjetor 2021 - shkurt 2022 .

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

5.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues i RTSH të marrë në shqyrtim veprimtarinë e deritanishme të Bordi i Administrimit, dhe mbi bazën e problematikave të evidentuara në këtë Raport auditimi, të marrë masat e nevojshme organizative në drejtim të funksionimit efektiv të kësaj strukture.

Komenti i grupit të auditimit

Nuk ka vendimmarrje të Këshillit Drejtues në lidhje me këtë çështje.

Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pazbatuar.

5.2 Rekomandimi: Bordi i Administrimit të marrë masa për të zhvilluar veprimtarinë e vet me kapacitet të plotë, duke përpiluar rregulla për çështje financiare; për raportimet financiare mujore, respektimin e afatit për shqyrtimin e dokumentacionit për mbledhje; shqyrtimin e vëmendshëm të projekteve dhe preventivave si dhe hartimin, miratimin dhe më pas zbatimin e plan-biznesit.

Komenti i grupit të auditimit

Bordi i Administrimit nuk ka kryer raportime mujore por 3-mujore, ka analizuar situatën dhe ka rekomandime përkatëse.

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese dhe Bordi i Administrimit të RTSH të marrin masa për hartimin e planit të biznesit; planifikimit e të ardhurave me trend rritës dhe bashkërendim dhe koordinim midis tyre për të hartuar planifikim real treguesish dhe performancë institucionale optimale; gjetjen e mekanizmave kontrollues dhe verifikues për tarifën e aparatit televiziv që arkëtohet nga O., hartimin e një strategjie të caktuar në lidhje me strukturën e të ardhurave nga reklamat në cash dhe me klering; bashkëpunimi më efikas midis Njesisë Teknike, Drejtorisë së Marketingut, Drejtorisë Ekonomike dhe asaj Juridike për uljen e detyrimeve të tretëve ndaj RTSH; si dhe krijimin e fondit për prodhimin e pavarur.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

9.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e RTSH, Drejtoria e Planifikimit dhe Prokurimeve dhe zyrtarët e prokurimeve të blerjeve me vlera të vogla të marrin masat që, për këto procedura prokurimi, të vepohet duke shmangur shkeljeve e konstatuara më sipër.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

10.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Administratës, të marrin masat e duhura për hartimin e kartelave përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet periodike, për të bërë të mundur monitorimin e tyre.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të mësipërm Drejtoria Ekonomike shprehet se mban kartelat e konsumit të karburantit për çdo automjet ndërsa, kartelat e automjeteve, përditësimi i të dhënave, shpenzimet periodike dhe monitorimi janë detyrë e Drejtorisë së Administratës. Drejtoria e Administratës ka filluar punën duke mbledhur informacionet për çdo automjet për të dhënat e përgjithshme dhe specifike si dhe riparimet e kryera për të bërë të mundur hartimin e kartelave.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

11.1 Rekomandimi: Të merren masa në të ardhmen nga RTSH, që në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në rastet e prokurimit për punë publike, para fillimit të procedurave të aplikojë për Deklaratë paraprake të punimeve, konform detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, me qëllim shmangien e risqeve të mundshme nga ndërtimi i objekteve pa leje ndërtimi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Në FV antatena FM viti 2021, punimet janë kryer pa deklaratë paraprake të punimeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

11.2 Rekomandimi: RTSH në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të analizojë parregullsitë e konstatuara nga auditimi i KLSH-së në hartimin e dokumenteve të tenderit, të vlerësojë përgjegjësitë e hartuesve në çdo rast dhe pastaj në varësi të këtij vlerësimi, t'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik vendosjen e masave administrative/disiplinore.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

12.1 Rekomandimi: Të merren masa nga RTSH në cilësinë e Autoritetit Kontraktor që në të ardhmen, hartimi i urdhrave për ngritjen e grupeve të punës për llogaritjen e fondit limit dhe

hartimin e specifikimeve teknike, të bëhet në përputhje të plotë me detyrimet ligjore të prokurimeve publike, në mënyrë që të mos krijohen paqartësi në zbatim të tij.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për angazhimin e punonjësve me profesione të përshtatshme sipas nevojave të investimit të planifikuar me qëllim garantimin e strukturave të nevojshme për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

14.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për aplikimin dhe pajisjen me leje ndërtimi në rastet e investimeve në të cilat janë të përfshira punime ndërtimi, ku termi *punime ndërtimi* kuptohet ai sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është i pazbatuar.

15.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të punës për përlogaritjen e fondit limit të merren masa për marrjen e ofertave dhe më tej hartimin e preventivave me çmime të cilat duhet të rezultojnë nga shuma e nevojshme e çmimeve të ofruara/preventivuara për çdo kategori që është pjesë e strukturës së kostos, për kategoritë Punëtori, Makineri etj. me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për trajnimin e stafit të angazhuar në procedurat e prokurimit si dhe angazhimin e punonjësve me profesione të përshtatshme sipas nevojave të investimit të planifikuar.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Sektori i Akademisë ka planifikuar për vitin 2023 trajnime në fushën e financave , planifikimit buxhetor dhe operacional, legjislacionit lidhur me prokurimin publik; hartimit, shkrimit dhe menaxhimit të ciklit të projekteve, menaxhimit të rriskut, kontrollit dhe auditimit, legjislacionit për burimet njerëzore, sigurinë kompjuterike, komunikimin strategjik si dhe të folurit në publik, paketën office, menaxhimin strategjik dhe lidhësitë , protokoll-arkivën, trajnim në fushën e restaurimit dhe trajtimin të filmit 16mm.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar.

17.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH si dhe strukturat e ngritura për monitorimin e investimeve të merren masa për shmangien e pranimit të dosjeve teknike me mangësi në dokumentacion me qëllim sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë në drejtim të furnizimit të AK për mallrat e blerë dhe dokumentimit të punës së kryer.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

18.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masa për emërimin e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në rastet e investimeve në punime ndërtimi.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është i pazbatuar.

19.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturave të ngritura për monitorimin e investimeve të merren masa për shmangien e pranimit të dosjeve teknike me mangësi në dokumentacion me qëllim sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë në drejtim të furnizimit të AK për aktivet e furnizuara.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

20.1 Rekomandimi: Nga ana e strukturave të ngritura për monitorimin e investimeve të merren masa për shmangien e pranimit të dosjeve teknike me mangësi në dokumentacion me qëllim sigurimin e transparencës dhe besueshmërisë në drejtim të furnizimit të AK për aktivet e furnizuara.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

21.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, strukturat e ngritura në cilësinë e NJP, të marrin masa në të ardhmen e identifikimit e drejtë të natyrës së investimit me qëllim përzgjedhjen e saktë të procedurës së prokurimit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

22.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

23.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të marrin masa për vlerësimin me përgjegjësi dhe profesionalizëm të dokumentacionit të ofertuesve me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

24.1 Rekomandimi: Personat e emëruar si përgjegjës për prokurimin të marrin masa për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar të ofertuesve të shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurave të prokurimit, krijimin e kushteve të përshtatshme për rritjen e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë si dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

25.1 Rekomandimi: Personat e emëruar si përgjegjës për prokurimin të marrin masa për dërgimin e kërkesave për ofertë vetëm nga OE të cilët operojnë në tregun e fushës së objektit të prokurimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar.

26.1 Rekomandimi: Komisionet e ngritura për hartimin e Kritereve të Përgjithshme/Veçanta të marrin masat e duhura për të argumentuar çdo kriter vendosur.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

27.1 Rekomandimi: Nga drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të RTSH-së, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Për periudhën objekt auditimi, RTSH nuk ka krijuar dhe përditësuar një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri duhet të ishte mbajtur në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

Regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshinë: Datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Nga RTSH nuk është kryer inventari fizik i aktiveve afat gjata materiale. Inventari kontabël i aktiveve afat gjata materiale nuk është i detajuar toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

28.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, Drejtoria Ekonomike të marrin masat që, të kryejë procesin e hartimit të regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së RTSH-së dhe mirë menaxhimin e tyre.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Për periudhën objekt auditimi, RTSH nuk ka krijuar dhe përditësuar një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri duhet të ishte mbajtur në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

Regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshinë: Datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Nga RTSH nuk është kryer inventari fizik i aktiveve afat gjata materiale. Inventari kontabël i aktiveve afat gjata materiale nuk është i detajuar toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

32.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, të rregullohet me marrëdhënie kontraktore, shfrytëzimi i aseteve në pronësi të saj, me qëllim rritjen e të ardhurave të institucionit dhe shmangien e përdorimit nga të tretët.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Për periudhën objekt auditimi, RTSH nuk ka krijuar dhe përditësuar një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri duhet të ishte mbajtur në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

Regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshinë: Datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Nga RTSH nuk është kryer inventari fizik i aktiveve afat gjata materiale. Inventari kontabël i aktiveve afat gjata materiale nuk është i detajuar toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

33.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e RTSH dhe Drejtoria Burimeve Njerëzore të marrin masa për emërimin e Drejtuesit të Njesisë së Auditit të brendshëm në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Drejtoria e Burimeve Njerëzore vijoi me hapjen e konkursit për drejtuesin e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Për këtë pozicion pati 2 aplikante dhe në konkurs u paraqit vetem një kandidat, konkurs i cili rezultoi pa fitues pasqyruar në procesverbalin nr. 672 Prot. Datë 13.03.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

36.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH të merren masa për plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar në drejtim të njohjes nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentët e tij, delegimin e kompetencave, hartimin e regjistrit të riskut dhe koordinatorit për menaxhimin e tij, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve të cilat mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit, si dhe rregulla të shkruara në rastet e largimeve nga puna të punonjësve. Gjithashtu të merren masa për përcaktimin e saktë të detyrave ndërmjet pozicioneve të punës për çështje të raportimit, delegimit dhe përgjegjësi, si dhe të regjistrit të riskut e strategjisë së njesisë.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

37.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e RTSH të marrë masa për të rregulluar situatën e paqartë për procesin e ndjekjes dhe vjeljes së detyrimeve të subjekteve debitore të krijuara nga kontratat e qirave dhe kontratat e marketingut me qëllim vjeljen e debitorëve dhe evidentimin e përgjegjësi për krijimin e tyre, përfshirë dhe aplikimin e kamatave.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Konkretisht, Drejtoria e Shitjes dhe Menaxhimit të Trafikut ka bashkëpunuar me Drejtorinë Ekonomike, për ndjekjen dhe vjeljen e detyrimeve referuar shkresave nr. 4189-4189/17 datë 13.12.2021, të hartuara drejtuar subjekteve debitorë. Nuk janë aplikuar kamat vonesat.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

38.1 Rekomandimi: RTSH të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e “Rregullores”, duke përcaktuar procedurën për inventarizimin e dokumentacionit si dhe miratimin e listës së dokumenteve që duhet të përmbajë dosja që administrohet nga njësitet zbatuese të projekteve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Janë hartuar amendamentet për përmirësimin e “Rregullores së miratimit dhe zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe blerjes së të drejtave, të miratuara me vendimin nr. 10, datë 26.03.2018”.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

39.1 Rekomandimi: RTSH të marrë masa në të ardhmen që vendimet e Bordit të Administrimit të shprehen duke bërë argumentim të plotë nga pikëpamja artistike për projektet që miratohen apo në rastet e blerjes së të drejtave.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

39.2 Rekomandimi: RTSH si subjekt i iniciativës ligjore të marrë masa për përmirësimin e “Rregullores”, neni 7, ku të përcaktohet afati ligjor brenda të cilit duhet të miratohet projekti artistik/filmik vlera financiare të cilave është deri në 1% të vlerës së buxhetit vjetor të RTSH-së, nga Bordi Artistik dhe Drejtori Përgjithshëm i RTSH, me qëllim minimizimin e veprimeve burokratike në vendimmarrje.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

40.1 Rekomandimi: Titullari i RTSH nisur nga parregullsitë dhe mungesat e konstatuara në përcjelljen e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues në procedurën e paraqitjes së projektit “Java-RTSH”, për miratimin e projektit artistik, të analizojë përgjegjësitë e Njesisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve RTSH, me qëllim që në të ardhmen propozimi për miratimin e kërkesës për miratim projektit të shoqërohet me dokumentacionin e plotë konform kërkesave të “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”, me ndryshime.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

41.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë në lidhje me mungesën e miratimit nga ana e Bordit artistik, duke marrë masa për eliminimin e kësaj parregullsie; për moszbatimin e vendimit të KDRTSH për kryerjen e pagesës prej 1,370,000 lekë e cila ishte preventivuar për t’u bërë nga bashkëpunëtorët në aktivitetet e programit social; për zbatimin e kuotave të përcaktuara nga KDRTSH për dhuratat, si dhe për parregullsitë e faturave financiare të zbatimit të këtij projekti.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

42.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Administrimit të shqyrtojnë me vëmendje sipas zërave përkatës të preventivave të projekteve artistike dhe filmike, me qëllim që të harmonizohet zbatimi i akteve të dala për këtë qëllim, duke rritur efektivitetin e përdorimit të parasë publike.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

42.2 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrin masa për të shqyrtuar të gjithë dokumentacionin justifikues dhe argumentues të këtij projekti, duke nxjerrë përgjegjësitë financiare dhe funksionale për preventivin dhe shpenzimet e këtij projekti.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Drejtoria e auditit të brendshëm ka audituar projektet e Eurosong.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar.

43.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të propozojë dhe më pas të miratojë në KD Rregulloren e Festivalit; të bashkërendojë dhe të koordinojë në kohë nënshkrimin e kontratave për materiale dhe stafin përkatës, duke përcaktuar kritere të qarta ofertimi dhe siguruar gjurmën dokumentare përkatëse; si dhe respektimin e çmimeve të librit të tarifave dhe të kritereve në rastin e sponsorizimeve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

DMPJ në bashkëpunim me Zv Drejtorin e Përgjithshëm po hartojnë rregulloren e re të festivalit të këngës.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

44.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për nënshkrimin e kontratave me të tretë vetë ose me autorizim, si dhe të ngarkojë Drejtoritë që të përcaktojnë kritere dhe gjurmën e auditimit për përzgjedhjen e subjekteve dhe personelit të projekteve, duke nënshkruar dhe vepruar në kohë me kontratat përkatëse, si dhe të ngarkojë me përgjegjësi nëpunësin zbatues në rastet e mosrespektimit të kritereve ligjore dhe financiare në menaxhimin e projekteve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje. Në mënyrë të detajuar është pasqyruar në aktkonstatimin nr.5, datë 14.11.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është nuk është zbatuar.

45.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Njësive dhe Sektori i Projekteve të marrin masa për hartimin e preventivit në përputhje me librin e tarifave dhe shqyrtimin e atyre të reja me qëllim realizmin e projekteve artistike me kosto optimale, për rritjen e efektivitetit të shpenzimeve publike.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje. Në mënyrë të detajuar është pasqyruar në aktkonstatimin nr.10, datë 14.11.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është nuk është zbatuar.

47.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për të kryer veprimet e duhura pas miratimit final të projekteve, të garantojë respektimin e kushteve kontraktore, reflektimin e librit të tarifave për çmimet e preventivit, si dhe respektimin e kuadrit ligjor dhe rregullator ekonomik dhe financiar.

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje. Në mënyrë të detajuar është pasqyruar në aktkonstatimin nr.10, datë 14.11.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është nuk është zbatuar.

49.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arkivit pranë RTSH të studiojnë situatën dhe të marrin të gjitha masat e duhura që të digjitalizohen të gjitha materialet e ndodhura në arkivin e filmit, edhe për periudhën para vitit 1996 si dhe të arkivohen dhe konvertohen në formate digjitale materialet e viteve 70-90 në formatin Ampex, Film, Bosch dhe audio shirit CPR, DISK, CD dhe LGR në mënyrë sa më të shpejtë me qëllim ruajtjen, mosdegradimin e mëtejshëm dhe mos humbjen e tyre.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e kësaj Drejtorie në periudhën Shkurt- Prill 2022 janë hartuar Urdhërat nr 11, datë 10.2.2022 dhe nr. 23 datë 01.04.2022 si dhe nr. 26, datë 04.04.2022 për ngritjen e grupeve të punës për përpilimin e listave të materialeve arkivore sipas formateve përkatëse.

Brenda muajit Tetor 2022 do të evidentohen materialet sipas gjinive, dhe do të fillojë përpilimi i dokumentave digjitale sipas të dhënave përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

50.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë veprimtarinë e deritanishme të Bordit artistik dhe të marrë masa për që veprimtaria e tij të jetë funksionale në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale të RTSH

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

51.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të shqyrtojë dhe të analizojë në mënyrë të veçantë veprimtarinë e deritanishme të Këshillit për shikuesit dhe dëgjuesit, duke marrë masa për vënien në eficiencë të plotë të kësaj strukture për të siguruar përfaqësimin e shikuesve dhe dëgjuesve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

52.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për të rishqyrtuar dhe për t'ia paraqitur më pas Këshillit Drejtues vendimin për rimbursimin e shpenzimeve të telefonisë celulare duke vendosur kritere për to, për punonjësit përfitues dhe saktësimin të pozicioneve përkatëse, me qëllim rritjen e efektivitetit të shpenzimeve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nuk u vendos në dispozicion asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi i veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar të periudhës së aktivitetit 01.07.2017 – 31.12.2019, kanë rezultuar shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator me pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e RTSH në vlerën gjithsej 23,761,927 lekë**, si më poshtë:

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **11,700,000 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE “M. N.” SHPK, si furnizime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 75/9 prot., datë 17.12.2018 me objekt ‘Blerje licenca për përdorues të Sistemit MAM Etere dhe Playout ETX’.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **3,092,885 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE “S.A.” Sh.P.K si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 me objekt ‘Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese’, Loti II Tarabosh.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,768,140 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE “S. C.” ShPK, “R. C.” Sh.P.K dhe “A. T.” si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 20/13 prot., datë 26.04.2019 me objekt ‘Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2019’.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,470,800 lekë**, shkaktuar si dëm ekonomik nga veprimet dhe mosveprimet e z. Thoma Gëllçi, në cilësinë e Titullarit të AK dhe z. G. A., z. A. M. dhe znj. G. H., në cilësinë e Komisionit të procedurave të blerjeve të vogla.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Sipas RTSH, RTSH nuk është në kushtet e shkeljes së VKM nr. 914, datë 19.12.2014 të RrPP (tashmë të shfuqizuar) dhe rrejdhimisht në mosmarrjen e veprimeve për arkëtimin e vlerës prej 1.480,800 lekë të pretenduar si dëm i shkaktuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,081,600 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE “2. C. & S. C.” Sh.P.K si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/26 prot., datë 05.07.2017 me objekt ‘Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese’, Loti IV Llogara.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,005,706 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE “H.-2.” Sh.P.K, si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 29/10 prot., datë 18.05.2017 me objekt ‘Rikonstruksion i Godinës së Radio Televizionit të Korçës’.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

7.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **732,292 lekë pa TVSH** ndaj grupit të punës të përbërë nga z. G. A., z. A. B. dhe znj. G. H., në cilësinë e anëtarëve të NJP, për rritje fiktive të fondit limit me pasojë dëm ekonomik në procedurën me objekt ‘Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese’, Loti II Tarabosh.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

8.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **723,250 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE “L.” Sh.P.K, “R. C.” ShPK dhe “A. T.” si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas

aktit me nr. 67/12 prot., datë 07.11.2018 me objekt 'Furnizim vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2-viti 2018'.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **639,888 lekë** nga peronat si më poshtë, pasi nuk ka gjurmë dokumentare të ofrimit të shërbimit të kontraktuar për këtë projekt:

1. Xh. K., në cilësinë e ekonomistes, 271,368 lekë;
2. E. B., në cilësinë e magazinieres, 169,320 lekë;
3. Xh. K., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, 66,400 lekë;
4. M. T., në cilësinë e specialistit të marrëdhënieve me publikun, 132,800 lekë;

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të merren masat e duhura që, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **368,000 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE "S." Sh.P.K si penalitet për vonesa në përfundimin në afat të kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/27 prot., datë 06.07.2017 me objekt 'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese', Loti II Tarabosh.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **330,000 lekë** të përfutur padrejtësisht nga 3 persona për dieta, paguar pa asnjë dokument financiar justifikues.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **271,993 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE "D. I." Sh.P.K, si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 28/9 prot., datë 22.05.2017 me objekt 'Rikonstruksion i tarracës dhe dritareve të Godinës së Radio Kukësit'.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **212,110 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE "2 C. & S. C." Sh.P.K si punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 73/24 prot., datë 05.07.2017 me objekt 'Rikonstruksion i stacioneve ekzistuese', Loti IV Gllavë.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

14.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **175,000 lekë** si pagesë e dubluar për sallën në projektin "Asambleja e Përgjithshme e EBU", pasi janë përfutur padrejtësisht nga subjekti "P." SH.P.K.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Drejtoria Juridike me shkresën me shkresën nr.2288/8, datë 25.07.2022 ka përcjellë njoftimin OE "P" shpk, për arkëtimin e vlerës prej 175,000 lekë pa tvsh. Subjekti debitor në datën 11.08.2022 ka shlyer detyrimin e prapambetur brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në njoftim.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar.

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **115,263 lekë** nga stafi i Drejtorisë së Përgjithshme, si vlerë e përfituar padrejtësisht mbi kuotën mujore të shpenzimeve për telefoninë celulare.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, Drejtoria ekonomike dhe Drejtoria Juridike të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **75,000 lekë** nga znj. E. D., si vlerë të përfituar padrejtësisht për shkak të mungesës së pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit të Administrimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI ME KUSHT

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH ti kërkohet OE "P. I." Sh.P.K zëvendësimi i artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio*, në sasinë e caktuar në preventiv, me produktin të cilin OE ka paraqitur gjatë procedurës së prokurimit, në fund të së cilës edhe është shpallur fitues dhe në rast mos dakordësie me OE mbi këtë zëvendësim, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i shumës prej **27,900,000 lekë pa TVSH** OE "P. I." Sh.P.K, si furnizim i kryer në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 80/17 prot., datë 08.11.2019 me objekt '*Blerje Led Wall pajisje ndriçimi për studion e re të lajmeve në RTSH*' për artikullin e mësipërm.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH ti kërkohet OE "S. A." Sh.P.K zëvendësimi i artikullit *Video Wall i përbërë nga panele për studio*, në sasinë e caktuar në preventiv, me produktin të cilin OE ka paraqitur gjatë marrjes në dorëzim dhe në rast të mos dakordësie me OE mbi këtë zëvendësim, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i shumës prej **10,378,500 lekë pa TVSH** OE "S. A." Sh.P.K, si furnizim i kryer në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 80/11 prot., datë 14.11.2018 me objekt '*Blerje Led Wall dhe aksesore shtesë*' për artikullin e mësipërm.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i RTSH të marrë masat e nevojshme për eliminimin e efekteve negative në përdorimin e fondeve publike, duke përzgjedhur dhe trajnuar zyrtarët e

prokurimeve, për fusha specifike, me qëllim vlerësim e procedurave në përputhje me dokumentacionin përkatës.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të ngritura për përlogaritjen e fondit limit të ezaurohen të gjitha hapat e duhur me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike siç është ai i rasteve të mësipërme në shumën **11,218,830 lekë pa TVSH** (2,073,170 lekë pa TVSH + 9,145,660 lekë pa TVSH) si dhe sigurimin e mirë përdorimit të tyre dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve nëpërmjet përdorimit të çmimeve të marra nga kontratat e mëparshme ose/dhe çmimeve të tregut, kjo nisur nga interesi publik dy ndër të cilat janë edhe rritja e efijencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

3.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të punës për përlogaritjen e fondit limit të merren masa për marrjen e ofertave dhe më tej hartimin e preventivave me çmime të cilat duhet të rezultojnë nga shuma e nevojshme e çmimeve të ofruara/preventivuara për çdo kategori që është pjesë e strukturës së kostos. Konkretisht, këto kategori janë Punëtori (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Transport (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Makineri (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Materiale (sasi e orëve të punës x çmimin përkatës), Shpenzime Plotësuese 8% dhe Fitim 10 % (këto dy të fundit ndryshojnë në varësi të kategorisë së punimeve të ndërtimit). Gjithashtu, përpara marrjes së ofertave në treg për zëra pune, të analizohen këto preventiva për vlerësimin e tyre në përputhje me çmimet e manualit teknik të çmimeve për punimet e ndërtimit.

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

4.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të analizojë situatën e krijuar nga largimet e padrejta nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

Nga ana e RTSH nuk janë përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe nuk është zbatuar.

5.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për eliminimin e veprimeve dhe mosveprimeve të strukturave gjatë hartimit dhe zbatimit të projekteve artistike dhe filmike për të shmangur efektin financiar negativ prej 552,500 lekë për zëra të ndryshëm të preventivit të projektit "Asambleja e Përgjithshme e EBU".

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me shkresën nr. 5215/1, datë 04.07.2022 i është komunikuar mbajtja në vëmendje e fondeve publike.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

6.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa të ngarkojë me përgjegjësi nëpunësin zbatues në rastet e mosrespektimit të kriterëve ligjore dhe financiare në menaxhimin e projekteve.

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Me shkresën nr. 5215/1, datë 04.07.2022 i është komunikuar mbajtja në vëmendje e fondeve publike.

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

Rekomandimi është pranuar dhe është në proces zbatimi.

1. Titulli i gjetjes:	RTSH nuk ka zbatuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.
Situata:	<p>Auditim mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve në RTSH në zbatim të programit nr. Nr. 564/1Prot. datë 26.07.2023.</p> <p>Me program auditimi nr.600/22 prot., datë 21.06.2021 me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në RTSH, Tiranë.</p> <p>RTSH ka marrë Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH-së “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në RTSH me nr. 947/1 prot., datë 28.09.2020, administruar në RTSH me nr. 947/49 prot., datë 06.08.2021.</p> <p>Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, RTSH, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH duke mos respektuar afatin 20 ditor. Nga ana e RTSH nuk është respektuar afati ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.</p> <p>a. Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime; b. Janë rekomanduar 58 masa organizative nga të cilat janë pranuar 58 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 13 masa janë zbatuar plotësisht, 10 masa janë në proces zbatimi, 19 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 15 masa nuk janë zbatuar; c. Janë rekomanduar 16 masa për shpërblim dëmi në vlerën 23,761,927 lekë të cilat janë pranuar 16 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 15 masa të pa zbatuara në vlerën 23,586,927 lekë dhe një masë e zbatuar në vlerën 175.000 lekë; d. Janë rekomanduar 2 masa shpërblimi dëmi me kusht në vlerën 38,278,500 lekë të cilat janë pranuar 2 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose 2 masa të pa zbatuara në vlerën 38,278,500 lekë; e. Është rekomanduar 1 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 20,992,259 lekë e cila është pranuar dhe zbatuar; f. Janë rekomanduar 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitetin në shumën 29,770,126 lekë të cilat janë pranuar 6 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 2 masa të zbatuara në vlerën 1,319,460 lekë, 3 masa në proces zbatimi dhe 1 masë e pa zbatuar; e. Janë rekomanduar 29 masa disiplinore të cilat janë pranuar 29 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 27 masa të zbatuara dhe 2 masa në proces zbatimi.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e

	<i>KLSH</i> ”, nenet 15 germa “j” 30, pika 2.
Ndikimi:	Në arritjen e objektivave dhe politikave të RTSH
Shkaku:	RTSH nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga RTSH të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nga ky auditim rezultuan të pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi.

Për veprimet dhe mosveprimet në realizimin e rekomandimeve të mësipërme mbajnë përgjegjësi: E. J., ish-Drejtor i Përgjithshëm i RTSH, M. L., ish-Drejtor i Përgjithshëm i RTSH, E. L., drejtor i Drejtorisë Juridike, I. B., Drejtor i Auditit të Brendshëm, E. D., drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

2.2. Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese, Bordit të Administrimit e Këshillit

Radio Televizioni Shqiptar është një institucion publik i një rëndësie të veçantë kombëtare (që kryen një shërbim publik në fushën e medias audiovizive, me qëllimin për të siguruar nevojat demokratike, sociale dhe kulturore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe të shqiptarëve në mbarë botën.

Radio Televizioni Shqiptar funksionon sipas statutit funksionon në bazë dhe në detyrim të ligjit nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka për objekt rregullimin e përgjithshëm dhe në hollësi të veprimtarisë së këtij institucioni publik kombëtar.

Kompetencat e organeve drejtuese të RTSH-së janë të parashikuara në Statutin e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH).

Totali i mbledhjeve të Bordit të Administrimit dhe Këshilli Drejtues për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2020 deri në 30.06.2023.

KËSHILLI DREJTUES

1. Në vitin 2020 janë zhvilluar 7 mbledhje nga të cilat janë marrë 51 vendime.
2. Në vitin 2021 janë zhvilluar 18 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 51 vendime.
3. Në vitin 2022 janë zhvilluar 14 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 35 vendime.
4. Në vitin 2023 (deri në 30.06.2023) janë zhvilluar 8 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 25 vendime.

BORDI I ADMINISTRIMIT

1. Në vitin 2020 janë zhvilluar 16 mbledhje nga të cilat janë marrë 34 vendime.
2. Në vitin 2021 janë zhvilluar 18 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 38 vendime.
3. Në vitin 2022 janë zhvilluar 18 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 26 vendime.
4. Në vitin 2023 (deri në 30.06.2023) janë zhvilluar 7 mbledhje nga të cilat janë marrë në total 6 vendime.

Aktualisht Këshilli Drejtues ka 10 anëtarë, nga 11 që duhet të ketë gjithsej, të cilët janë si më poshtë:

1. Z.L. B., **Kryetar** - emëruar më 02.03.2021
2. Z.G. P., **Zv/Kryetar** –emëruar më 07.05.2021
3. Z.M. Sh., **Anëtar** – emëruar më 25.02.2021
4. Z.E. N., **Anëtar** – emëruar më 07.05.2021
5. Z. I. K., **Anëtar** – emëruar më 13.01.2021
6. Z.D. P., **Anëtar** – emëruar më 13.01.2021
7. Znj.A. R., **Anëtar** – emëruar më 25.02.2021
8. Znj.M. S., **Anëtar** – emëruar më 07.05.2021

9. Z.G. P., **Anëtar** – emëruar më 13.01.2021

10. Z.E. T., **Anëtar** – emëruar me 22.09.2022 (Ky vendim i është dërguar Këshillit Datë 30.09.2022)

Për Bordin e Administrimit të riemëruar me vendim nr. 26 datë 04.10.2022

Anëtar të Jashtëm:

1. K. B..

2. V. B., (riemëruar)

Anëtar të brendshëm:

1. V. L., (riemëruar)

2. D. Sh.,

3. A. B.,(riemëruar)

Bordi i mëparshëm përbëhej nga

Anëtar të jashtëm:

1. P.M., (emëruar 2019)

2. V. B.,

Anëtar të brendshëm:

1. V. L., (emëruar Tetor 2019)

2. A. P.,

3. A. B.,

Pavarësisht nga sa u deklarua mësipërm, u konstatuan shkelje të dispozitave dhe ligjore dhe mangësi të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

-Këshilli drejtues nuk është mbledhur sipas përcaktimeve ligjore në kundërshtim me ligjin nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 99, pika 2 ku përcaktohet se: “KDRTSH-ja mblidhet sa herë është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta por jo më pak se një herë në 2 muaj”, KDRTSH nuk është mbledhur në periudhën janar-shkurt dhe qershor-gusht (31.08.2020) të vitit 2020. Në vijim të periudhës 2021 e më tej KD është mbledhur sipas përcaktimeve ligjore.

1.Titulli i gjetjes	Këshilli Drejtues nuk është mbledhur sipas përcaktimeve ligjore.
Situata:	Këshilli Drejtues nuk është mbledhur në periudhën janar-shkurt dhe qershor-gusht (31.08.2020) të vitit 2020.
Kriteri:	Ligji nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Neni 99, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos realizimin e objektivave të performancës dhe besueshmërisë të rezultatit financiar.
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Neni 99, pika 2.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Këshilli Drejtues të vazhdojë të mblidhet sa herë është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta por jo më pak se një herë në 2 muaj për të realizuar plotësisht performancën/objektivat.

Vendimi Nr. 26 datë 04.10.2022

-Nga auditimi u konstatua se për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit të Administrimit Z.A.B., Këshilli Drejtues nuk i është përmbajtur plotësisht Ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në

Republikën e Shqipërisë” Neni 107, ku kërkohet saktësisht që këta anëtarë të jenë ekspertë në problemet e administrimit, financës dhe biznesit. Nga CV e paraqitur nga Z.A. B., u konstatua se ka përfunduar arsimin e lartë për Inxhinjeri Mekanike dhe nuk ka një eksperiencë të lidhur ngushtë në fushën e financave dhe ekonomisë. Kandidatura e Z. A. B., është 1 nga 8 kandidaturat e paraqitura pranë RTSH, ku nga këto kandidatë janë zgjedhur 3 persona. Duke pasur në vëmendje se kandidatët për tu bërë pjesë e Bordit të Administrimit duhet të kenë njohuri ekonomiko-financiare për të përmbushur sic duhet detyrimet e Nenit 111 të Ligjit 97/2013 “Ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues duhet të kishte përzgjedhur ata kandidatë të cilët plotësojnë tërësisht kushtet sipas Nenit 107 pikës 2 të Ligjit 97/2013 “Ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

2.Titulli i gjetjes:	Për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit të Administrimit Z. A. B., Këshilli Drejtues nuk i është përmbajtur plotësisht Ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
Kriteri:	Ligji 97/2013 Ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Neni 107 dhe 111.
Situata:	Për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit të Administrimit Z. A. B., Këshilli Drejtues nuk i është përmbajtur plotësisht Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, pasi Z. A. B., ka përfunduar arsimin e lartë për Inxhinjeri Mekanike dhe nuk ka një eksperiencë të lidhur ngushtë në fushën e financave dhe ekonomisë. Duke pasur në vëmendje se kandidatët për tu bërë pjesë e Bordit të Administrimit duhet të kenë njohuri ekonomiko-financiare sipas Nenit 107 pika 2 të Ligjit 97/2013 dhe për të përmbushur siç duhet detyrimet e Nenit 111 të Ligjit 97/2013, Këshilli Drejtues duhet të kishte përzgjedhur ata kandidatë të cilët plotësojnë tërësisht kushtet.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos realizimin e objektivave dhe besueshmërisë të rezulttit financiar.
Shkaku:	Mosplotësimi tërësisht i kushteve për kandidim sipas Nenit 107 pikës 2 të Ligjit 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Këshilli Drejtues të marrë masa që anëtarë të Bordit të Administrimit të përzgjidhen persona të cilët plotësojnë kriteret e duhura arsimore, me qëllim përmbushjen si duhet prej tyre të detyrave funksionale.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Anëtarët e Keshillit Drejtues të vitit 2022 z. L. B., Kryetar; z. G. P., Zv/Kryetar; z.G. P., Anëtar; znj. A. R., Anëtare; Znj.M. S., Anëtare; Z. I. K., Anëtar; Z. E. T., Anëtar.

Vendimi Nr. 01 datë 21.02.2023

- Bazuar në kërkesën për propozim të Drejtorit të Përgjithshëm E. J., Nr.430 prot, datë 08.02.2022, RTSH ka bërë shpallje publike lidhur me pozicionin “Drejtor” në Qëndrën Vendore Audiovizive Korçë ku kanë aplikuar 3 persona nga të cilët Këshilli Drejtues ka zgjedhur Z. S. Y..
- Nga auditimi u konstatua se në vlerësimin e Drejtorit të Përgjithshëm E. J., e drejtë që i jepet nga Statuti i RTSH konkretisht Neni 13 dhe 14, S. Y., nuk ka paraqitur platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin e punës ku ai kandidon. Sipas Nenit 13 pika 2 të Statutit të RTSH për “Kriteret dhe papajtueshmëritë e zgjedhjes së Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të

RTSH-së dhe drejtuesve të njësive administrative në përbërje të RTSH-së” kandidatët duhet t’i paraqesin Drejtorit të Përgjithshëm curriculumvitae të plotë, platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin drejtues ku kandidojnë. Këshilli Drejtues ka vendosur zgjedhjen e kandidatit S. Y.. Nga verifikimi i grupit të auditimit u konstatua se platforma dhe struktura programore e organizative për vendin e punës ku Z. S. Y., konkuron është e pa protokolluar në RTSH. Në kundërshtim me Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dokumentacioni i dorëzuar nuk mund të vërtëtohet në cilën kohë është parqitur pranë RTSH.

Titulli I gjetje	Mangësi në zbatimin e ligjit për përzgjedhjen e pozicionit Drejtor në Qëndrën Vendore Audiovizive Korçë
Situata:	Në vlerësimin e Drejtorit të Përgjithshëm E. J., e drejtë që i jepet nga Statuti i RTSH konkretisht Neni 13 pika 2 dhe Neni 14 pika 1.a, S. Y., nuk ka paraqitur platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin e punës ku ai kandidon. Nga verifikimi i grupit të auditimit u konstatua se platforma dhe struktura programore e organizative për vendin e punës ku S. Y., konkuron është e pa protokolluar në RTSH.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos realizimin e objektivave dhe besueshmërisë për drejtuesit e njësive administrative në përbërje të RTSH.
Shkaku:	Statuti i Radio Televizionit Shqiptar dt. 22.12.2016 Neni 13 pika 2 dhe Neni 14 pika 1.a
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në përzgjedhjen emërimin e drejtuesve të njësive administrative të RTSH, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm E. J. dhe Anëtarët e Këshillit Drejtues të vitit 2022 L. B., Kryetar; G. P., Zv/Kryetar; G. P., Anëtar; A. R. Anëtare; M. S., Anëtare; I. K., Anëtar; E. T., Anëtar; M. Sh., Anëtar; E. N., Anëtar; D. P., Anëtar.

2.3. Mbi planifikimin, hartimin dhe realizimin e planit vjetor financiar dhe të biznesit të RTSH dhe njësive përbërëse, si dhe raportimi i tyre.

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit nr. 564/1 prot., datë 26.07.2023, “Mbi planifikimin, hartimin dhe realizimin e planit vjetor financiar dhe të biznesit të RTSH dhe njësive përbërëse, si dhe raportimi i tyre”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Programet e buxhetit afatmesëm për periudhën e auditimit;
- 2- Raportet mbi realizimin e treguesve ekonomik – financiarë;
- 3- Informacione dhe Relacione të Drejtorisë Ekonomike;
- 4- Etj.

Programet e shpenzimeve të Radio Televizionit Shqiptar

Financimet e buxhetit të shtetit janë të kufizuara, sipas ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, neni 116, vetëm në këto veprimtari:

- *Shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;*
- *Shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;*
- *Shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;*
- *Projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim;*

- Projekte të rëndësishme prodhimi filmik dhe veprimtari të mëdha artistike mbarëkombëtare, te prodhuara nga RTSH-ja;
- Orkestrën simfonike të RTSH-së dhe kinematografisë.

Nga auditimi konstatohet se:

1. Titulli i gjetjes:	RTSH e ka zhvilluar veprimtarinë ekonomike dhe financiare në mungesë të planit të biznesit, pasi nuk është miratuar.
Situata	RTSH e ka zhvilluar veprimtarinë ekonomike dhe financiare në mungesë të planit të biznesit, pasi nuk është miratuar; ka prirje të planifikimit në rënie të të ardhurave vjetore për vitet e fundit; ka mangësi në planifikim; mungesë të mekanizmave kontrollues dhe verifikues për tarifën e aparatit televiziv; nuk ka hartuar dhe ndjekur një strategji të caktuar në lidhje me strukturën e të ardhurave nga reklamat në cash dhe me klering; ka një nivel të konsiderueshëm të detyrimeve të tretëve ndaj RTSH, nuk ka pasur fond për prodhimin e pavarur etj. Këto veprime janë në mospërputhje me: ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 123; Statuti i RTSH, neni 52, pika 2; neni 53.
Kriteri:	- Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 123; - Statuti i RTSH, neni 52, pika 2; neni 53.
Ndikimi:	Performancë jo në nivelin e kërkuar lidhur me veprimtarinë ekonomike dhe financiare institucionale të RTSH.
Shkaku	Mentaliteti i drejtimit të strukturave i papërqendruar në planin biznesit dhe aktivitetin ekonomik dhe financiar të saj, por vetëm në atë programor.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese dhe Bordi i Administrimit të RTSH të marrin masa për hartimin e planit të biznesit; planifikimit të të ardhurave në bashkërendim dhe koordinim midis tyre; hartimin e një strategjie për strukturën e të ardhurave nga reklamat në cash dhe me klering; si dhe bashkëpunimi më efikas midis Njesisë Teknike, Drejtorisë së Marketingut, Drejtorisë Ekonomike dhe asaj Juridike për uljen e detyrimeve të tretëve ndaj RTSH; si dhe krijimin e fondit për prodhimin e pavarur.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Bordi i Administrimit të RTSH, z. K. B., (kryetar); znj. V. B., znj. V. L., z. D. Sh., (anëtarë); znj. A. P., z. P. M., z. A. B., (ish anëtarë), është paraqitur observacioni me shkresën me nr. 1367/52 prot., datë 21.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/7 prot., datë 21.11.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... Plani i biznesit për periudhën 2022-2026 u përgatit, por nuk u paraqit në strukturat drejtuese të RTSH për miratim. Nga Bordi i Administrimit të RTSH është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme hartimi i Planit të Biznesit për periudhën në vazhdim. Si një dokument shumë i rëndësishëm për ecurinë e RTSH, si dhe detyrimi ligjor, duhet të shpejtohen hapat për hartimin e këtij dokumenti për periudhën 2024-2028.

Qëndrimi i grupit të auditimit

RTSH e ka zhvilluar veprimtarinë ekonomike dhe financiare në mungesë të planit të biznesit, pasi nuk është miratuar, prandaj ky koment merret pjesërisht në konsideratë vetëm përsa i përket mungesës së përgjegjësisë së bordit.

Tabela nr.1: Të ardhurat e RTSH të parashikuara dhe faktike për periudhën e auditimit nga data 01.01.2020-30.06.2023. *(në mijë lekë)*

Nr.	Të ardhurat e RTSH	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023
		Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan
1	Financimi nga Buxheti	634,000	633,134	99.86	606,000	573,736	94.68	567,600	567,600	100	618,000
2	Te ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv	1,420,000	1,139,491	80.25	1,450,000	1,363,257	94.02	1,429,190	1,282,468	89.73	1,779,055
3	Te ardhurat e institucionit	346,000	225,727	65.24	400,000	296,943	74.24	346,250	379,382	109.6	331,000
	TOTALI	2,400,000	1,998,352	83.26	2,456,000	2,233,936	90.96	2,343,040	2,229,450	95.15	2,728,055

Burimi: RTSH.

2. Titulli i gjetjes:	Nga auditimi konstatohet se, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste apo tejkallim nw disa raste. Gjithashtu, u konstatua mungesa e një analize të mirëstrukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament/drejtori/sector.
Situata	<p>Nga auditimi konstatohet se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste apo tejkallim në disa raste. Gjithashtu, u konstatua mungesa e një analize të mirëstrukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament/drejtori/sector dhe mungesa e një udhëzuesi mbi mënyrën e planifikimit të buxhetit dhe programit ekonomik financiar të RTSH.</p> <p>Nga auditimi u konstatua, mungesa e një analize të mirëstrukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament/drejtori/sector.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në rastin e të ardhurave të RTSH dhe më konkretisht për zërat “të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv” dhe “të ardhura të institucionit”.</p> <p>Në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe RTSH, me nr. 29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”, konstatohet se, ka mosrealizim të planit për këtë zë për shkak të mos mbledhjes së tarifës nga O.SH.E.E për përdoruesit familjar e jofamiljarë. Gjatë vitit 2020, niveli i arkëtimeve është 280.5 milionë lekë më pak nga parashikimi. Pra, të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv janë realizuar në masën 80.25%. Gjatë vitit 2021, niveli i arkëtimeve është 86.7 milionë lekë më pak se planifikimi. Pra, të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv janë realizuar në masën 94%. Gjatë vitit 2022, niveli i arkëtimeve është 146.7 milionë lekë më pak se planifikimi. Pra, të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv janë realizuar në masën 89.7%, për pasojë janë arkëtuar më pak para sesa duhej të ishin arkëtuar realisht.</p> <p>Lidhur me zërin tjetër “të ardhurat e institucionit”, për vitin 2020, realizimi i tyre është në masën 65.24%. Për vitin 2021 të ardhurat e institucionit janë realizuar në masën 74.24% dhe për vitin 2022 në masën 109.6% duke e tejkaluar kështu vlerën e planifikuar për këtë zë.</p>

	Të ardhurat për vitin 2020 në total për RTSH-në janë realizuar në masën 83.26% në krahasim me planifikimin, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 401,648,000 lekë. Të ardhurat për vitin 2021 janë realizuar në masën 90.96% në krahasim me planifikimin, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 222,064,000 lekë. Të ardhurat për vitin 2022 janë realizuar në masën 95.15% në krahasim me planifikimin, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 113,589,539 lekë. Ndërsa për vitin 2023 të ardhurat janë planifikuar në masën 2,728,055,000 lekë.
Kriteri:	Ligji nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 29.
Ndikimi:	Mos eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për RTSH.
Shkaku	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Me qëllim që të mos ketë diferenca të dukshme midis zërave të planifikimit dhe realizimit të buxhetit, nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe personave përgjegjës të merren masa, për të kryer planifikimin të studiuar e të mbështetur në nevojat reale, mbi bazën e kërkesave konkrete të të gjitha niveleve të strukturës së RTSH.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të RTSH-së të merren masa që strukturat që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të kryejnë analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatës, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor. Për përmirësimin e situatës dhe minimizimin e risqeve rekomandohet të ndërmerren aktivitete kontrolli shtesë, si dhe të hartohet ndonjë udhëzues për mënyrën, afateve, personat përgjegjës, strukturat, procedurat etj, elementë të cilët duhet të përfshihen në një programim buxhetor.

Tabela nr.2: Të ardhurat e institucionit përgjatë periudhës së auditimit.

(në mijë lekë)

Nr	Të ardhurat e institucionit	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022			Dt. 01.01.-30.06.2023		
		Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Shfrytz. infrastrukt. transmetimi	150,000	122,507	81.7	150,000	137,397	92	126,250	118,250	94	62,500	66,982	107
2	Reklama, njoftime etj.	150,000	78,460	52.3	200,000	143,546	72	185,000	217,057	117	75,000	34,192	45,6
3	Të ardhura të tjera	46,000	24,760	53.8	50,000	16,000	32	35,000	44,075	126	19,750	9,648	48,9
	TOTALI	346,000	225,727	65.2	400,000	296,943	74	346,250	379,382	109,6	157,250	110,822	70

Burimi: RTSH.

Tabela nr.3: Të ardhurat e RTSH nga reklama, njoftime etj.

Nr	Reklama, njoftime etj.	Viti 2020 realizimi	Viti 2021 realizimi	Viti 2022 realizimi	01.01-30.06.2023 realizimi
1	DSHPT (Dep. Shitjes dhe Menaxhimit të Trafikut)	75,691	139,783	212,900	32,240
2	QVAV Korçë	1,590	2,651	1,900	1,212
3	QVAV Gjirokastrë	1,179	1,088	1,800	513
4	QVAV Shkodër	0	24	457	227
	TOTALI	78,460	143,546	217,057	34,192

Burimi: RTSH.

1. Të ardhurat nga shërbimi në ambientet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm janë realizuar në masën 81.7% në vitin 2020; në masën 92% në vitin 2021; në masën 94% në vitin 2022. Ndërsa nga data 01.01.2023-30.06.2023, këto të ardhura janë realizuar në masën 107%, duke tejkaluar vlerën e planifikuar për këtë zë me 4,482,000 lekë.

2. Të ardhura nga reklamat, njoftimet etj, janë realizuar në masën 52.3% në vitin 2020, në masën 72% në vitin 2021. Ndërsa në vitin 2022, këto të ardhura janë realizuar në masën 117%, duke tejkaluar vlerën e planifikuar për këtë zë me 32,057,000 lekë. Nga data 01.01-30.06.2023, këto të ardhura janë realizuar në masën 45.6%.

3. Të ardhura të tjera të institucionit, janë realizuar në masën 53.8% në vitin 2020, në masën 32% në vitin 2021. Ndërsa në vitin 2022, këto të ardhura janë realizuar në masën 126%, duke tejkaluar vlerën e planifikuar për këtë zë me 9,075,000 lekë. Nga data 01.01-30.06.2023, këto të ardhura janë realizuar në masën 48.9%.

Tabela nr.4: Zërat e shpenzimeve të RTSH nga dt. 01.01.2020-30.06.2023.

(në mijë lekë)

N r	Emërtimi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022			Dt. 01.01.-30.06.2023	
		Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt	Realizimi në %	Plan	Fakt
1	Paga, shpërblime, sig. Shoq	827,000	824,569	99.7	924,400	915,597	99	908,220	885,685	97.5	563,603	553,106
2	Materiale, lëndë djegëse	71,300	67,964	95.3	61,400	61,000	99.3	54,140	55,245	102	33,500	26,004
3	Projekte film, artistike, bl. Dr. Tv, f.p.pav etj	314,000	307,526	97.9	316,000	315,684	99.9	326,190	324,467	99.5	211,000	136,159
4	Organizma Ndërkombëtare	87,000	86,066	98.9	90,000	86,161	95.7	84,000	88,890	105.8	46,750	31,806
5	Shërbime nga të tretët	280,000	225,755	80.6	278,700	264,959	95.1	256,390	252,156	98.3	179,233	170,468
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	82,700	61,469	74.3	65,000	61,127	94	56,250	40,409	71.8	22,800	20,066
7	Shpenzime të tjera operative	63,000	61,050	96.9	67,800	66,576	98.2	58,850	58,489	99.4	42,350	39,593
8	Investime dhe mirëmb. rrjeti digj.	355,000	343,707	96.8	332,700	287,982	86.6	275,000	262,198	95.3	167,500	160,106
9	Shpenzime, këste e interesa kredie	320,000	940	3	320,000	0	0	324,000	0	0	162,400	0
	TOTALI	2,400,000	1,979,046	82.5	2,456,000	2,059,086	83.8	2,343,040	1,967,539	84	1,429,136	1,137,308

Burimi: RTSH.

Në vitin 2022, ka tejkalim të planit për zërin “*Materiale lëndë djegëse*”, pasi vlera e planifikuar është 54,140,000 lekë dhe vlera e realizuar është 55,245,000 lekë. Realizimi i zërit “*Materiale lëndë djegëse*” është në masën 102 %. Gjithashtu, në vitin 2022, ka tejkalim për zërin “*Organizma Ndërkombëtare*”, pasi vlera e planifikuar është 84,000,000 lekë dhe vlera e realizuar është 88,890,000 lekë. Realizimi i zërit “*Materiale lëndë djegëse*” është në masën 105.8%.

Gjatë vitit 2022, u konstatua se ka tejkalim të vlerës së planifikuar për zërin “*Organizma Ndërkombëtare*” që konkretisht është realizuar në masën 105.8 % dhe për zërin “*Materiale, lëndë djegëse*” realizuar në masën 102 %. Në këtë rast kërkesat buxhetore për këto shpenzime

nuk janë llogaritur në përputhje me nevojat e institucionit. Nga auditimi u konstatua, mungesa e një analize të mirëstrukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament/drejtori/sector.

➤ **Programi buxhetor afatmesëm**

PBA për periudhën 2020-2022 :

- Me Vendim nr. 1, datë 06.03.2020 të Këshillit Drejtues me nr. 783 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2020, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,400,000,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,400,000,000 lekë.

- Me Vendim nr. 6, datë 25.02.2020 të Bordit të Administrimit me nr. 643 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2020, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,400,000,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,400,000,000 lekë.

PBA për periudhën 2021-2023 :

- Me Vendim nr. 13, datë 06.04.2021 të Këshillit Drejtues me nr. 1221 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2021, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,456,000,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,456,000,000 lekë.

- Me Vendim nr. 3, datë 23.02.2021 të Bordit të Administrimit me nr. 641 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2021, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,456,000,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,456,000,000 lekë.

PBA për periudhën 2022-2024 :

- Me Vendim nr. 7, datë 15.03.2022 të Këshillit Drejtues me nr. 37/3 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2022, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,343,040,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,343,040,000 lekë.

- Me Vendim nr. 5, datë 25.02.2022 të Bordit të Administrimit me nr. 12/3 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2022, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,343,040,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,343,040,000 lekë.

PBA për periudhën 2023-2025 :

- Me Vendim nr. 7, datë 27.02.2023 të Këshillit Drejtues me nr. 32/1 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2023, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,728,055,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,728,055,000 lekë.

- Me Vendim nr. 2, datë 03.02.2023 të Bordit të Administrimit me nr. 3/1 prot., për miratimin e Projekt Buxhetit të vitit 2023, ku të ardhurat janë përcaktuar në vlerën 2,728,055,000 lekë dhe shpenzimet në vlerën 2,728,055,000 lekë.

➤ **Raportet e monitorimit të Buxhetit të dërguara në MFE:**

-Me shkresën nr. 1352/3 prot., datë 23.09.2020, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për 8-mujorin e vitit 2020.

-Me shkresën nr. 1324/1 prot., datë 28.04.2021, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Tiranë, për 3-mujorin e parë të vitit 2021.

3. Titulli i gjetjes:	RTSH nuk ka përmbushur detyrimin për të dërguar/raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të paktën 3 herë në vit, lidhur me Raportet e Monitorimit të Buxhetit.
Situata	RTSH nuk ka përmbushur detyrimin për të dërguar/raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të paktën 3 herë në vit, lidhur me Raportet e Monitorimit të Buxhetit. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për zbatim buxheti”, kapitulli I, pika 45, ku shprehet në mënyrë eksplicite: “Nëpunësit Autorizues të njësive të Qeverisjes Qendrore, i paraqesin Nëpunësit të Parë Autorizues

	<i>sa herë që kërkohet, por jo më pak se 3 herë në vit</i> ”.
Kriteri:	Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për zbatim buxheti”, kapitulli I, pika 45.
Ndikimi:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për RTSH.
Shkaku	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga ana e Organeve Drejtuese të merren masa për përmbushjen e detyrimit për raportim të paktën 3 herë në vit lidhur me Raportet e Monitorimit të Buxhetit.

4. Titulli i gjetjes:	Bordi i Administrimit nuk i ka paraqitur Këshillit Drejtues raportimin për shpenzimet dhe të ardhurat në formë raportesh financiare mujore, pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga sektorët e RTSH.
Situata	Bordi i Administrimit nuk i ka paraqitur Këshillit Drejtues raportimin për shpenzimet dhe të ardhurat në formë raportesh financiare mujore, pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga sektorët e RTSH dhe janë konstatuar gjithashtu raste mosraportimi 3 apo 6 mujore. Ky veprim është në mospërputhje me nenin 20, pikën “ç”, të Statutit të RTSH-së ku përcaktohet se: <i>“Bordi i Administrimit i paraqet Këshillit Drejtues raportin për shpenzimet dhe të ardhurat në formë raportesh financiare, mujore, 3 mujore dhe 6 mujore, pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga sektorët e RTSH-së”</i> .
Kriteri:	Nenin 20, pikën “ç”, të Statutit të RTSH-së
Ndikimi:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për RTSH.
Shkaku	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga ana e Organeve Drejtuese të merren masa për përmbushjen e detyrimit për shpenzimet dhe të ardhurat në formë raportesh financiare mujore.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Bordi i Administrimit të RTSH, z. K. B., (kryetar); znj. V. B., znj. V. L., z. D. Sh., (anëtarë); znj. A. P., z. P. M., z. A. B., (ish anëtarë), është paraqitur observacioni me shkresën me nr. 1367/52 prot., datë 21.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/7 prot., datë 21.11.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... lidhur me raportet mujore, kjo nuk është realizuar, pasi ka vështirësi dhe pamundësi në përgatitjen e të dhënave mujore nga strukturat e RTSH dhe rrjedhimisht Bordi ka analizuar situatat financiare sipas raportimeve që janë bërë nga Drejtoria Ekonomike e RTSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit e ka paraqitur edhe në aktkonstatim se raportimi për shpenzimet dhe të ardhurat në formë raportesh financiare mujore nuk është realizuar, prandaj ky koment merret pjesërisht në konsideratë vetëm përsa i përket mungesës së përgjegjësisë së grupit.

5. Titulli i gjetjes:	Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk ka respektuar afatin për raportimin dhe njoftimin publik për rezultatet e analizës financiare për vitin 2022.
Situata	<p>Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk ka respektuar afatin për raportimin dhe njoftimin publik për rezultatet e analizës financiare për vitin 2022.</p> <p>Me shkresën e Bordit të Administrimit me nr. 09/3 prot., datë 16.05.2023, drejtuar Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm, është dërguar analiza për realizimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të RTSH-së për vitin 2022 (janar-dhjetor), e cila është dërguar jashtë afatit të përcaktuar. Ky veprim është në mospërputhje me nenin 17, pika “ç”, të Statutit të RTSH-së, ku shprehet: <i>“Këshilli Drejtues i RTSH-së, përveç kompetencave të përcaktuara në nenin 102 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka edhe këto kompetenca: “Në çdo filim viti, por jo më vonë se data 31 mars, në bazë të raportit të Bordit të Administrimit analizon Raportin Financiar të RTSH. Jep njoftimin publik për rezultatet e analizës financiare”.</i></p> <p>Pra, raporti vjetor/realizimi i treguesve ekonomiko-financiar për vitin 2022 nuk është publikuar në faqen zyrtare të RTSH-së, veprim ky në mospërputhje me nenin 35, pika 2 dhe pika 3, të Statutit, ku përcaktohet se: <i>“Pika 2: Operacionet e biznesit të RTSH janë publike. Raporti vjetor duhet të publikohet në një botim të veçantë dhe në faqet zyrtare të internetit të RTSH-së.”</i> dhe: <i>“Pika 3: Raporti vjetor duhet të përmbajë specifikim të shpenzimeve, të përfshira në prodhimin e programeve, sipas kategorive funksionale të programeve dhe përmbajtjes”.</i></p>
Kriteri:	Statuti i RTSH-së, Neni 17, pika “ç” dhe Neni 35, pika “2” dhe “3”.
Ndikimi:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UMT.
Shkaku	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	Ë mesme.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për respektimin e afateve për raportimin dhe njoftimin publik për rezultatet e analizës financiare brenda afateve të përcaktuara në mënyrë që të mos pengohen proceset e punës dhe për të siguruar publikut transparencë në përputhje me kuadrin ligjor.

➤ **Detyrimet**

Nga auditimi u konstatua se, RTSH ka mbartur detyrime ndaj të tretëve të cilat mund të gjenerojnë kamatvonesa dhe të rëndojnë mbi buxhet. Gjithashtu kanë detyrime nga të tjerë të cilat priten t’i arkëtojnë në buxhet.

Tabela nr.5: Detyrimet në fund të secilit vit për periudhën e auditimit.

Detyrime nga të tjerë	Dt. 31.12.2020	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2022	Dt. 30.06.2023
Të pritshme të arkëtohen	62,941,280	64,470,497	171,638,098	122,889,687
Detyrime në kontrata shkëmbimi	7,917,817	19,333,854	24,230,918	37,082,173
Detyrime në proces gjyqësor të pritshme	17,337,546	16,648,931	12,329,693	8,052,794
Detyrime pa shpresë arkëtimi	41,758,291	41,758,291	41,758,291	41,758,291
Totali nga Klientë	129,954,934	142,211,573	249,957,000	209,783,445
Llogaria provigjone	12,941,246	12,941,246	12,941,246	12,941,246
SHUMA KLIENTË DHE PROVIGJONE	142,896,180	155,152,819	262,898,246	222,724,691

Burimi: RTSH.

1. Detyrime të pritshme për arkëtim nga të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës RTSH, transmetime FM, Reklama, Njoftime, Ripërsëritja e programeve nga TV kablore, shitja e materialeve arkivore, dhënia me qira e ambienteve në zbatim të kontratave me subjektet etj. Gjatë viteve 2020, 2021, si rezultat i pandemisë u akumuluan detyrime dy-tre mujore nga subjektet e mësipërme, të cilat ndiqen në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 3010 datë 24.12.2019. Për vitin 2022 e 2023, shifra më e lartë është si rezultat i faturimeve në vlera të larta për transmetimin e kampionatit Botëror të Futbollit, faturuar nëntor, dhjetor 2023, të pritshme të arkëtohen në vitin 2023. Në vitin 2023 është arkëtuar në mënyrë të konsiderueshme arkëtimi dhe po ndiqet në vijim.

2. Detyrime të pritshme të arkëtohen në rrugë gjyqësore ky zë paraqitet me ulje nga një vit në tjetrin, si rezultat i likuidimit të detyrimeve me këste, ose kontrata shkëmbimi dhe ndiqen nga Drejtoria Juridike.

3. Detyrimet në kontrata shkëmbimi mbarten nga një vit në tjetrin, kundrejt mbulimit të nevojave të RTSH.

4. Detyrimet pa shpresë arkëtimi dhe llogaria provigjone, përbëhen nga detyrimet që mbarten në RTSH që nga vitit 2005 e më parë, përbëhet nga subjektet, të fituara në gjyq, subjekte të cilëve u ka përfunduar afati i parashkrimit, pra e drejta për t'i kërkuar në rrugë gjyqësore.

Tabela nr.6: Detyrimet e RTSH ndaj të tjerëve.

Detyrime nga të tjerë	Dt. 31.12.2020	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2022	Dt. 30.06.2023
Detyrime Platforma Digjitale	24,919,173	51,113,798	129,264,919	166,501,139
Blerje të drejta sportive dhe filmike	4,502,988	34,587,268	54,743,509	39,010,132
Detyrime karburant		17,393,720	38,268,142	12,164,073
Detyrime te mbartura Festival		10,391,893		1,891,080
Projekte te tjera	268,306	3,592,760	8,454,125	
Detyrime te tjera Eutelsat blerje		9,596,864	4,026,450	2,845,362
Detyrime ne proces gjyqësor NJ Teknike ndjekje (Drejtoria Juridike)	10,747,853	8,714,453	15,058,202	101,876,001
Shuma Klientë Dhe Provigjone	40,438,320	135,390,756	249,815,347	324,287,787

Burimi: RTSH.

Llogaria 401 "Furnitorë" në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 135,390,756 lekë nga 40,438,320 lekë në fund të vitit 2020. Kjo vlerë si rezultat i likuidimit të detyrimeve të RTSH ndaj të tretëve. Detyrimi në fund të vitit 2021 përfshin detyrimet e krijuara kryesisht në muajt nëntor, dhjetor 2021 dhe të pritshme të likuidohen në vitin 2022. Detyrimet e RTSH ndaj MFE, për kredinë e digjitalizimit, në datë 31.12.2020 janë në vlerën 824,308,738 lekë; në datë 31.12.2021 në vlerën 1,170,065,614 lekë; në datë 31.12.2022 në vlerën 1,416,643,732 lekë dhe në datën 30.06.2023 janë në vlerën 1,471,461,792 lekë.

Tabela nr.7: Detyrime për kreditë e marra në fund të secilit vit për periudhën e auditimit.

Detyrime	Dt. 31.12.2020	Dt. 31.12.2021	Dt. 31.12.2022	Dt. 30.06.2023
Detyrimi ndaj M., për kredinë	824,308,738	1,170,065,614	1,416,643,732	1,471,461,792
Detyrimi ndaj D., Bank	1,301,940,191	975,515,646	609,222,708	425,757,233

Burimi: RTSH.

RTSH ka gjithashtu dhe detyrimin ndaj M., për kredinë e digjitalizimit dhe detyrimin ndaj D., për kredinë e marrë.

2.4. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

RTSH-ja kryen një shërbim publik në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive dhe aktiviteteve multimedia (internet, OTT, IPTV), duke përdorur edhe teknologjitë e reja të transmetimeve. Veprimtaria e RTSH bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në statut, në kontratën e shërbimit të transmetimit publik, në Kodin e Etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale, si dhe në aktet e tjera të organeve drejtuese të RTSH. Në veprimtarinë e vet, RTSH respekton legjislacionin shqiptar, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për veprimtarinë radiofonike dhe audiovizive të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

➤ Niveli i pagave

Gjatë periudhës së auditimit, niveli i pagave me të cilin ka operuar RTSH ka ndryshuar disa herë. Konkretisht:

-Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 14, datë 31.01.2017, protokolluar me nr. 313 prot., janë miratuar emërtesat dhe klasat e pagave për të gjithë punonjësit e strukturave organizative në RTSH.

-Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, datë 20.02.2017, protokolluar me nr. 666 prot., janë miratuar ndryshime në librin e pagave të punonjësve në sistemin e RTSH si dhe disa ndryshime në strukturën organizative.

-Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 34, datë 16.09.2020, protokolluar me nr. 2721 prot., është miratuar indeksimi i pagave të punonjësve të RTSH, në të cilën pagat bruto deri në 50,000 lekë në muaj të rriten me 10 % në muaj dhe pagat bruto mbi 50,000 lekë në muaj të rriten me 5,000 lekë në muaj.

-Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 34, datë 07.12.2022, protokolluar me nr. 130/3 prot., janë miratuar ndryshimet në Librin e Pagave të RTSH.

-Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 8, datë 27.02.2023, protokolluar me nr. 32/2 prot., është miratuar kërkesa e Bordit të Administrimit në RTSH për rritjen e pagesës me 10 %.

Përgjatë periudhës së auditimit, RTSH nuk e ka tejkalluar në asnjë rast numrin e punonjësve të miratuar në strukturë.

Tabela nr.1: Të dhëna sipas muajve për strukturën e miratuar dhe strukturën faktike të punonjësve, viti 2020, 2021.

Viti 2020			Viti 2021		
Muajt	Struk. e miratuar	Struk. fakt	Muajt	Struk.e miratuar	Struk.fakt
Janar	981	883	Janar	1013	952
Shkurt	981	883	Shkurt	1013	952
Mars	981	883	Mars	1013	952
Prill	981	883	Prill	1013	952
Maj	981	883	Maj	1013	952
Qershor	981	883	Qershor	1013	952
Korrik	981	883	Korrik	1013	952
Gusht	981	883	Gusht	1013	952
Shtator	981	883	Shtator	1013	952
Tetor	981	883	Tetor	1013	952
Nëntor	981	883	Nëntor	1013	952
Dhjetor	1013	924	Dhjetor	1040	947

Burimi: RTSH.

Tabela nr.2: Të dhëna sipas muajve për strukturën e miratuar dhe strukturën faktike të punonjësve, viti 2022 dhe 6-mujori i parë i vitit 2023.

Viti 2022			6-mujori i parë i vitit 2023		
Muajt	Struk. e miratuar	Struk. fakt	Muajt	Struktura e miratuar	Struktura faktike
Janar	1040	935	Janar	1039	963
Shkurt	1040	935	Shkurt	1039	963
Mars	1039	914	Mars	1039	963
Prill	1039	914	Prill	1039	963
Maj	1039	914	Maj	1039	963
Qershor	1039	914	Qershor	1039	969
Korrik	1039	914	-	-	-
Gusht	1039	914	-	-	-
Shtator	1039	914	-	-	-
Tetor	1039	914	-	-	-
Nëntor	1039	914	-	-	-
Dhjetor	1039	926	-	-	-

Burimi: RTSH.

➤ **Struktura Organizative**

Struktura organizative është korniza me anë të së cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Strukturat duhet të jenë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësisë dhe misionin e saj, duhet të vlerësohen kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme. Me vendimet respektive të Këshillit Drejtues janë miratuar strukturat organizative për çdo vit. Struktura organizative dhe niveli i pagave kanë ndryshuar disa herë përgjatë periudhës së auditimit. Struktura organizative e shoqërisë miratohet me vendim të Këshillit Drejtues të RTSH dhe ndryshon me propozim të strukturave të shoqërisë që kanë nevojë për ristrukturim, për funksionimin sa më me efikasitet në arritjen e objektivave të shoqërisë. Struktura është e organizuar në formë piramidale, ku paraqitet çdo pozicion pune në nivel hierarkie si dhe linja me strukturat e tjera të shoqërisë. Në rastet e strukturave që kanë varësi hierarkie të dyfishtë, vlen si parësore varësia hierarkike që përcakton dhe i miraton planin e punës mbi të cilën bazohet aktiviteti, kompetencat dhe funksionet e përditshme të saj.

Gjatë vitit 2020 kanë ndodhur disa ndryshime në strukturën organizative të drejtorive/departamenteve/njësive, por në disa drejtori/njësi të RTSH-së. Për vitin 2021 nuk është bërë asnjë ndryshim në strukturën organizative. Ndërsa për vitin 2022 është bërë vetë një ndryshim në strukturën organizative. Konkretisht, me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 9, datë 17.03.2022 u miratuan ndryshimet në strukturën organizative të RTSH, ku Drejtoria e Përgjithshme kalon nga totali prej 108 punonjës në totalin prej 229 punonjës, Njësia e Teknikës kalon nga totali prej 307 punonjës në totalin prej 278 punonjës, Njësia e Programeve kalon nga totali prej 90 punonjës në totalin prej 51 punonjës, Njësia e Prodhimit kalon nga totali prej 177 punonjës në totalin prej 157 punonjës, Njësia e Lajmeve dhe Emisioneve Tematike kalon nga totali prej 152 punonjës në totalin prej 115 punonjës, Drejtoria e Arkivit ndryshon emërtesën dhe riorganizimin e brendshëm dhe shtohet me 2 punonjës, ndërsa QV Shkodër ndryshon brenda numrit të strukturës për çështje riorganizimi (nuk ndryshon numri në total), në të cilën 4 operatorë nga Sektori Teknik kalojnë në varësi të Redaksisë së Lajmeve dhe ndryshohet pozicioni Receptionsist për t'u kthyer në Teknik Transmetimi me klasën IV. Pra, nga riorganizimi i strukturës, rezulton një ulje në numrin total të punonjësve me 1 punonjës, e cila kalon nga 1040 punonjës në 1039 punonjës. Konkretisht, në Drejtorinë e Arkivit krijohet pozicioni Përgjegjës Sektori në Sektorin e Arkivës me klasën IX dhe shtohet një pozicion Redaktues i Materialeve Filmike me klasën VI. Redaktorët e arkivës paguhen të gjithë me klasën VI dhe Arkivistët e

emëruar në vijim do të jenë me klasën VI. Arkivistët dhe Redaktorët duhet të punësohen vetëm me arsim të lartë.

1.Titulli gjetjes:	i Nën RTSH nuk janë rishikuar rregulloret e brendshme për secilën njësi/drejtori në përputhje me ndryshimet strukturore (shtesat e pozicioneve të reja në organikë), edhe pse në RTSH kanë ndodhur ndryshime në mënyrë të vazhdueshme të strukturës organike.
Situata:	Gjatë periudhës së auditimit, në RTSH nuk është rishikuar rregullorja e brendshme për secilën njësi/drejtori në përputhje me ndryshimet strukturore. Rregulloret e brendshme të RTSH-së nuk janë në përputhje me strukturat analitike të RTSH, pasi nuk është bërë përditësim i tyre dhe shumë pozicione të reja nuk janë pasqyruar në rregulloren përkatëse. Konkretisht, në Rregulloren e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë 4 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor Drejtorie dhe 3 specialistë. Ndërkohë, në strukturën analitike të RTSH-së janë gjithsej 9 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor Drejtorie, 1 Përgjegjës Sektori i Burimeve Njerëzore dhe 4 specialistë të I-rë të Sektorit të Burimeve Njerëzore, 1 Përgjegjës Sektori i Akademisë dhe 2 specialistë të Sektorit të Akademisë. Për rrjedhojë, nuk janë pasqyruar as detyrat për pozicionet e shtuara në strukturë. Gjithashtu, në Rregulloren e Drejtorisë Juridike janë 5 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor dhe 4 juristë. Ndërkohë, në strukturën analitike të RTSH-së janë gjithsej 13 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor Drejtorie, 1 Përgjegjës Sektori i Marrëdhënieve Ligjore dhe 4 jurist/specialistë të Sektorit të Marrëdhënieve Ligjore, 1 Përgjegjës Sektori i Prokurimeve dhe 4 specialistë të Sektorit të Prokurimeve, 1 Përgjegjës Sektori GIS (regjistrimin dhe administrimin e pronave) dhe 1 specialist i Sektorit GIS. Për rrjedhojë, nuk janë pasqyruar as detyrat për pozicionet e shtuara në strukturë. Shtesat e pozicioneve të reja në organikë nuk janë pasqyruar në rregullore, pasi përdoret ende rregullorja e vjetër. Konkretisht është shtuar pozicioni Përgjegjës Sektori në Sektorin e Arkivës me klasën IX me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 9, datë 17.03.2022, ndërkohë që detyrat e tij nuk gjenden të përcaktuara në rregulloren e RTSH. Gjithashtu, në rregullore nuk ka të përcaktuar nivelin e arsimimit për secilin pozicion pune. Në RTSH nuk është miratuar një rregullore e re, ku të përcaktohen detyrat e pozicionit të ri të krijuar si: Përgjegjës Sektori në Sektorin e Arkivës me klasën IX. Konkretisht, në Rregulloren e Drejtorisë së Administratës në RTSH, nenin 13 “Punonjësit e arkivit dhe protokollit”, nuk është e përcaktuar nëse ka një përgjegjës për këtë sektor dhe për rrjedhojë nuk janë përcaktuar as detyrat për këtë pozicion.
Kriteri:	Kodi i Punës, statuti, rregulloret e brendshme.
Ndikimi:	Mungesa e rishikimit/ndryshimeve në rregulloret e brendshme në përputhje me ndryshimet e organikës së RTSH, sjell mosfunksionim të mirë të strukturave përkatëse
Shkaku	Mungesa e vëmendjes së strukturave drejtuese në trajtimin e plotë të situatës sipas kuadrit ligjor përkatës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i RTSH dhe strukturat përkatëse, të marrin masa për rishikimin/ndryshimin e rregulloreve të brendshme për secilën

	drejtori/departament/njësi në përputhje me ndryshimet në organikë, të përcaktojë detyrat dhe nivelin e arsimimit për secilin pozicion pune dhe të nxjerrë përgjegjësinë ndaj personave përkatës.
--	--

➤ **Lidhur me emërimet e punonjësve**

2.Titulli i gjetjes:	RTSH nuk ka kriteret e pranimit në punë për të gjithë punonjësit e RTSH-së, vlerësimit të punës dhe nuk ka ngritur komision Ad-Hoc për për zgjedhjen e punonjësve deri më datë 27 shkurt 2023.
Situata:	- Nga auditimi u konstatua se, RTSH nuk ka kriteret e pranimit në punë për të gjithë punonjësit e RTSH-së, vlerësimit të punës dhe nuk ka ngritur komision Ad-Hoc për për zgjedhjen e punonjësve deri më datë 27 shkurt 2023. Konkretisht, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 27.02.2023, të protokolluar me nr. 32/3 prot., datë 27.02.2023 janë miratuar kriteret e marrjes në punë për punonjësit në sistemin e RTSH-së dhe komisionet Ad-Hoc. Pra, punonjësit e RTSH janë emëruar në mospërputhje me ligjin. Ky veprim është në mospërputhje me: -Neni 29, pikën 2 të Statutit të RTSH, ku shprehet se: <i>“Marrja në punë bëhet sipas kriterëve të pranimit në punë, të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të RTSH, ku përcaktohet edhe përbërja e komisionit Ad-Hoc për për zgjedhjen e punonjësve. KDRTSH, në përcaktimin e kriterëve të marrjes në punë, përfshin edhe kriteret e tjera ligjore, për aq kohë sa parashikohen si subjekte të ligjeve të posaçme”</i> . -Neni 102, pika 12 <i>“Kompetencat e Këshillit Drejtues”</i> të Ligjit nr. 97/2013 <i>“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”</i> , ku shprehet se: <i>“KDRTSH-ja ka këto kompetenca: 12) Miraton kriteret kryesore për marrjen në punë, vlerësimin e punës dhe shpërblimin e punonjësve”</i> .
Kriteri:	-Neni 29, pika 2 të Statutit të RTSH; -Neni 102, pika 12 <i>“Kompetencat e Këshillit Drejtues”</i> të Ligjit nr. 97/2013 <i>“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”</i> .
Ndikimi:	Mungesa e komisionit Ad-Hoc për për zgjedhjen e punonjësve të RTSH-së, kriterëve të pranimit në punë, vlerësimit të punës, ka sjellë që: gjatë kësaj periudhe punonjësit e RTSH të jenë emëruar në mospërputhje me ligjin.
Shkaku	Neglizhenca dhe mungesa e vëmendjes së strukturave drejtuese në trajtimin e plotë të kësaj situatë sipas kuadrit ligjor përkatës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për mospërsëritjen e rasteve të tilla në RTSH, si dhe ti kushtohet rëndësi e veçantë për zgjedhjes së punonjësve në mënyrë që të rritet performanca e RTSH-së në të ardhmen dhe të nxjerrin përgjegjësinë ndaj personave përkatës.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. M., Drejtore e Burimeve Njerëzore (deri në datë 06.06.2023), është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1367/80 prot., datë 29.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/27 prot., datë 01.12.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... kriteret e marrjes në punë të punonjësve të RTSH janë miratuar në vite me Vendimet respektive të Këshillit Drejtues, i cili është organi më i lartë drejtues i RTSH: Kriteret e marrjes në punë me vendim nr. 7 të KD, datë 15.02.2018; vendim nr. 24 të KD, datë 05.06.2018; vendim nr. 11 të KD, datë 26.03.2018; vendim nr. 23 të KD, datë 05.06.2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit e ka paraqitur edhe në aktkonstatim se kriteret e marrjes në punë nuk janë të miratuara për të gjithë punonjësit. Duke qenë se: kriteret e marrjes në punë janë miratuar që prej vitit 2018 dhe duke qenë se në strukturën organike të RTSH-së janë bërë shumë ndryshime dhe janë shtuar shumë pozicione të reja, duke shtuar numrin e punonjësve për secilën njësi/drejtori, atëherë rrjedhimisht edhe kriteret e marrjes në punë duhej të ishin miratuar në përputhje me strukturën organike për secilin punonjës të RTSH-së. Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga E. J., Drejtor i Përgjithshëm (nga data 03.12.2021 deri në datë 12.04.2023), është paraqitur observacioni me shkresën pa numër protokoll, datë 20.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/20 prot., datë 23.11.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... Lidhur me procedurat që janë detyrë funksionale e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DBNJ), sqarojmë se emërimet e personelit në RTSH janë zhvilluar me shpallje publike dhe vlerësim me komisione vlerësimi kanë nisur prej fillimit të vitit 2022 (kohë para se të miratohej ngritja e komisioneve Ad-Hoc nga Këshilli Drejtues); kjo si pjesë e procedurave të DBNJ, në përputhje me procedurat e ndjekura nga administrata publike dhe DAP, për pasjen e procedurave të punësimit korrekte, të paanshëm dhe me mundësi për të interesuarit..

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit e ka paraqitur edhe në aktkonstatim se marrja në punë duhet të bëhet në përputhje me: Nenin 29, pikën 2 të Statutit të RTSH, ku shprehet se: “Marrja në punë bëhet sipas kriterëve të pranimit në punë, të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të RTSH, ku përcaktohet edhe përbërja e komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e punonjësve. KDRTSH, në përcaktimin e kriterëve të marrjes në punë, përfshin edhe kriterë të tjera ligjore, për aq kohë sa parashikohen si subjekte të ligjeve të posaçme”, gjë e cila nuk është zbatuar.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

3.Titulli i gjetjes:	Dobësi në politikat e burimeve njerëzore që lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore
Situata:	Politikat e burimeve njerëzore që lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore dhe që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm shfaqin dobësi. Në mënyrën e funksionimit dhe organizimit, Institucioni ka një manual të vitit 2004 për shpalljet e vendeve vakante, procedurat, rekrutimin e stafit etj., i cili nuk ka gjetur zbatim në praktikë, si dhe nuk është përditësuar bazuar ndryshimeve të Kodit të Punës, politikave dhe praktikave të reja të menaxhimit të burimeve njerëzore. Marrëdhëniet e punës në këtë Institucion janë rregulluar me anë të Kodit të Punës si dhe kontratat individuale. Me

	ndryshimet strukturore miratuar me VKD nr. 9 datë 15.03.2022 “Për miratimin e strukturës së RTSH”, nuk janë reflektuar ndryshimet lidhur me: -Nuk janë hartuar strukturat analitike (Situatë e cila ka ndikuar dhe në lëvizjet, largimet e punonjësve); -Nuk janë harmonizuar dhe përditësuar detyrat e punonjësve, përshkrimet e punës sipas strukturës duke mos përcaktuar saktë përgjegjësitë dhe linjat e raportimit midis specialistëve përgjegjësve, drejtorit si dhe raporti me Drejtorin e Përgjithshëm.
Kriteri:	- Statuti i RTSH, - Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
Ndikimi:	Mungesa e politikave të mira e të konsoliduara për burimet njerëzore, të cilat lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore, ka sjellë problematika të vazhdueshme lidhur me mirëfunksionimin e burimeve njerëzore në RTSH.
Shkaku	Neglizhenca dhe mungesa e vëmendjes së strukturave drejtuese në trajtimin e plotë të kësaj situatë sipas kuadrit ligjor përkatës, për të krijuar politika të përshtatshme për RTSH lidhur me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për krijimin e politikave të burimeve njerëzore lidhur me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore, si dhe ti kushtohet rëndësi e veçantë përzgjedhjes së punonjësve në mënyrë që të rritet performanca e RTSH-së në të ardhmen.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. M., Drejtore e Burimeve Njerëzore (deri në datë 06.06.2023), është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1367/80 prot., datë 29.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/27 prot., datë 01.12.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... Drejtoria e Burimeve Njerëzore punën e saj e ka bazuar në legjislacionin referues, i cili është përmendur në fillim të këtij materiali si dhe bazuar në Manualin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të miratuar në vitin 2004, ku në mënyrë të detajuar është përshkruar misioni i kësaj drejtorie si dhe detyrat e gjithë strukturës përbërëse të saj të cilat e udhëheqin në punën e përditshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi është jashtë kontekstit. Grupi i auditimit e ka paraqitur edhe në aktkonstatim se ka raste kur ky Manual i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore i miratuar në vitin 2004, nuk ka gjetur zbatim në praktikë dhe nuk është përditësuar bazuar ndryshimeve të Kodit të Punës, politikave dhe praktikave të reja të menaxhimit të burimeve njerëzore. Në manualin e vitit 2004, duhen bërë ndryshimet përshtatur institucionit dhe kohës. Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

4.Titulli gjetjes:	i	Në kontratën individuale të punës mungojnë çështjet e afatit dhe të mënyrës së pagesës.
Situata		Sipas nenit 29, pika 1 të Statutit, marrëdhëniet e punës rregullohen me

	<p>kontrata pune:</p> <p>a) individuale; b) kolektive; c) me kohë të pjesshme, ku parashikohet garantimi i sigurimeve shoqërore nga institucioni dhe ç) me projekte, ku detyrimet financiare mbulohen nga vetë projekti. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratën individuale dhe kontratën me projekte. Në këtë mënyrë, në rregullimin e marrëdhënieve të punës në RTSH mungon kontrata kolektive dhe kontrata me kohë të pjesshme. Kontrata me kohë të pjesshme krahas mbrojtjes në punë ka të bëjë dhe me pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore për dy degë të tjera që nuk përfshihen në këtë lloj kontrate.</p> <p>- Në kontratën e punës tip <i>nuk janë përfshirë çështjet e afatit dhe të mënyrës së pagesës së pagës për punëmarrësit</i>, të përcaktuar këto në Kodin e Punës, neni 116 dhe 118., <i>si dhe në nuk është përfshirë rasti i ndryshimit të kontratës</i>, i cili referuar Kodit të Punës, neni 23/2: <i>“Ndryshimi i kontratës bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve”</i>. Gjithashtu, kontrata individuale nuk ka të përcaktuar periudhën e provës, në mospërputhje me germën “gj”, pika 3 e nenit 21 të Kodit të sipërcituar.</p>
Kriteri:	Kodin e Punës, neni 116 dhe 118; neni 23/2; neni 21, pika 3, germën “gj”; Udhëzimi i MFE nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, pika 3.2.1
Ndikimi:	Kontrata e punës me mangësi ndikon në performancën e punonjësve.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes së strukturave drejtuese në trajtimin e plotë të marrëdhënieve të punës sipas kuadrit ligjor përkatës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Drejtoria e Burimeve njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa për rishikimin e kontratës individuale të punës, për të përfshirë të gjithë elementët përkatës, si dhe të diferencojë kontratat e punës me kohë të pjesshme.

- Struktura organike e RTSH ka pësuar ndryshime të shpeshta, ka një numër të konsiderueshëm punonjësish të paplotësuar, nuk ka kritere për marrjen në punë të punonjësve të rinj dhe për vlerësimin e performancës vjetore, si dhe trajnimet kanë qenë në numër të vogël pjesëmarrësish dhe jo në mënyrë të vazhdueshme, në mospërputhje me Statutin neni 31, pika 1; neni 29, pika 2; neni 46, pika 2.

-Motivimi në punë nuk është bërë sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës madje duke diskriminuar punonjësit në pagë.

5. Titulli i gjetjes:	Në RTSH nuk janë të unifikuara pagat brenda të njëjtit grup.
Situata	Nga auditimi u konstatua se, në RTSH nuk janë të unifikuara pagat brenda të njëjtit grup. Konkretisht, në lidhje me klasifikimin e pagave për montazhierët, regjisorët, moderatorët, paga brenda të njëjtit grup ka një diferencë page prej 3 nivelesh. Duke qenë se shpërndarja e punës dhe ngarkesa janë njësoj për të gjithë punonjësit brenda të njëjtit grup pavarësisht emërtesës, atëherë edhe paga duhet të jetë e njëjtë. Në lidhje me klasifikimin e pagave për montazhierët dhe regjisorët u konstatua se ka dy lloje klasifikimi page për pozicionet

	montazhier lajme: sporti/emisioneve në studio, që janë klasifikuar në klasë VII, ndërsa për montazhierë spektaklesh dhe reportazhier/montazhierë filmi dhe dokumentarësh, janë klasifikuar në klasë IX. Gjithashtu, dallime në pagë konstatohen dhe për regjisorët. Regjisorët e lajmeve/sportit janë klasifikuar me pagë të klasës IX, ndërkohë që regjisorët e spektakleve/eventeve kulturore, janë të klasifikuara me klasë X. Klasifikimet e pagave në RTSH, janë të miratuara me Vendim të Këshillit Drejtues respektivisht për çdo pozicion pune. Në lidhje me moderatorët u konstatua se, ka dy lloje klasifikimi page për këtë pozicion, respektivisht moderatorë TV, të cilët janë klasifikuar në klasë XII, ndërsa për moderatorë dhe redaktorë, të cilët janë klasifikuar në klasë X. Klasifikimet e pagave në RTSH, janë të miratuara me Vendim të Këshillit Drejtues respektivisht për çdo pozicion pune. Sa më sipër është në mospërputhje me Kodin e punës.
Kriteri:	Kodi i Punës.
Ndikimi:	Kjo ndikon në rritjen e pakënaqësive midis punonjësve dhe në uljen e performancës së tyre në punë.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes së strukturave drejtuese në trajtimin e plotë të marrëdhënieve të punës midis punonjësve të cilët kryejnë të njëjtën punë apo që janë brenda të njëjtit grup, sipas kuadrit ligjor përkatës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për të bërë unifikimin e pagave brenda të njëjtit grup, pasi kjo mund të sjelli rritjen e pakënaqësive midis punonjësve dhe në uljen e performancës së tyre në punë.

Lidhur me shpërblimet, RTSH ka operuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 36, datë 16.05.2007, ku përcaktohet se masa e shpërblimit për punonjësit të cilët dalin në pension pleqërie, për rast fatkeqësie familjare, për shpërblimin e familjes në rast vdekje të një punonjësi, për shpërblim për punë të mirë, për shpërblim për punonjësit që kurohen jashtë vendit të jetë dy paga. Kurse për shpërblim për punonjësit që kurohen brenda vendit dhe për shpërblim në fund viti të jetë një pagë. Baza ligjore: Pika 1, e VKM nr. 493, datë 06.07.2011 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, ku përcaktohen në vlera fikse masa e shpërblimit për secilin rast. Konkretisht për rastin kur punonjësi del në pension pleqërie merr shpërblim nga institucioni në masën 1 pagë mujore (në RTSH është deri në 2 paga). Shpërblimi në rast fatkeqësie, të vdekjes së një punonjësi të institucionit, shpërblimi është në masën një pagë mujore, por jo më pak se 50,000 lekë. Në rast vdekje të një anëtarit të familjes së punonjësit (bashkëshorti/ja, prindërit apo fëmijët), ku masa e shpërblimit është deri në 30,000 lekë për çdo rast. Në rastin e sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje kirurgjikale apo një trajtim mjekësor i gjatë ku shpërblimi është deri në 50,000 lekë për çdo rast.

6. Titulli i gjetjes:	RTSH, përgjatë periudhës së auditimit, ka dhënë shpërblime për punë të mirë në vlerën 5,127,000 lekë.
Situata	RTSH ka dhënë për punonjësit shpërblime për punë të mirë, në mospërputhje me Kodin e Punës. Lidhur me shpërblimet për punë të mirë, në vitin 2020 është shpenzuar vlera 1,990,000 lekë. Në vitin 2021 janë dhënë shpërblime për punë të mirë në vlerën 2,033,000 lekë. Ndërsa për periudhën nga data 01.01.2023-30.06.2023 është dhënë shpërblim për punë të mirë në vlerën

	104,000 lekë për një punonjësit. Pra, vlera totale e shpërblimeve për punë të mirë përgjatë periudhës së auditimit (nga data 01.01.2020-30.06.2023) është 5,127,000 lekë , vlerë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH-së. Kjo ndikon drejtpërdrejt në pakësimin e buxhetit të RTSH-së dhe lindjen e pakënaqësive midis stafit të punonjësve të RTSH-së, duke qënë se nuk kemi tregues konkretë lidhur me mënyrën e matjes së punës së mirë të punonjësve.
Kriteri:	Kodi i Punës
Ndikimi:	Vlera prej 5,127,000 lekë e cila është dhënë për shpërblime për punë të mirë, përbën efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH. Kjo ndikon drejtpërdrejt në pakësimin e buxhetit të RTSH-së dhe lindjen e pakënaqësive midis stafit të punonjësve të RTSH, duke qënë se nuk kemi tregues konkretë lidhur me mënyrën e matjes së punës së mirë të punonjësve.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes së strukturave drejtuese në trajtimin e plotë të kësaj situatë sipas kuadrit ligjor përkatës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për mospërsëritjen e rasteve të tilla për shpërblime për punë të mirë, pasi këto ndikojnë drejtpërdrejt në pakësimin e buxhetit të RTSH-së dhe lindjen e pakënaqësive midis stafit të punonjësve të RTSH, duke qënë se nuk kemi tregues konkretë lidhur me mënyrën e matjes së punës së mirë të punonjësve.

Tabela nr.5: Përmbledhëse e shpërblimeve të dhëna në RTSH për periudhën e auditimit.
(Në mijë lekë)

Nr.	Lloji i shpërblimit	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	01.01-30.06.2023
	Shpërblimet	9,253	9,996	3,953	3,311
1	Për punë të mirë	2,990	2,033	0	104
2	Dalje në pension,leje zak.	1,705	3,845	1,670	1,345
3	Shpërblime për sëmundje	1,037	1,920	1,213	1,030
4	Ndihmë financiare vdekje	3,521	2,198	1,070	832

Burimi: RTSH.

Tabela nr.6: Përmbledhëse.

Emërtimi	01.01.2020-31.12.2020	01.01.2021-31.12.2021	01.01.2022-31.12.2022	01.01.2023-30.06.2023
Shpenzime për pagat	658,266,000	726,918,000	709,055,000	438,028,000
Mbikoha	40,906,000	49,688,000	50,131,000	33,819,000
Kontribute shoqërore e shëndetësore	116,144,000	128,995,000	122,546,000	77,947,000
Shpërblime	9,253,000	9,996,000	3,953,000	3,311,000
Honorare	60,272,000	65,189,000	65,474,000	35,402,000
Numri i miratuar i punonjësve	981	1,013	1,040	963
Emëritime	131	110	150	58
Largime	73	121	138	43

Burimi: RTSH.

➤ **Auditi i Brendshëm**

Sipas strukturës organike të RTSH-së, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka varësi nga Drejtori i Përgjithshëm. Ndërkohë, që sipas ligjit për auditin e brendshëm, kjo drejtori varet nga një organ

vendimmarrës kolegjal, që do të ishte Këshilli Drejtues në këtë rast. (Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 4, pika 19, ku shprehet në mënyrë eksplicite se: “Titullar i njësisë publike është kreu i organit qendror të njësisë publike. Në kuptim të këtij ligji, titullar i njësisë publike që drejtohet me organ vendimmarrës kolegjal, por që nuk organizohet si shoqëri tregtare, konsiderohet ky organ”).

Nga auditimi u konstatua se, pagat e dy specialistëve të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm nuk janë të unifikuara. Struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk respekton kërkesat e minimumit ligjor (minimumi një Drejtues dhe dy specialistë të auditimit të brendshëm), pasi aktualisht në RTSH pozicioni i Drejtorit është vend vakant. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka një strukturë të përbërë nga një Drejtor dhe dy specialistë. Me vendim të Këshillit Drejtues, bazuar në klasifikimet e pagave të përgatitura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, janë miratuar edhe klasat e pagave me 2 klasa diferencë për specialistët e kësaj Drejtorie, duke i ndarë në specialistë të parë dhe specialistë të dytë. Konkretisht, punonjësja znj. B. S.,

me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 58, datë 02.03.2020 është emëruar Specialiste Auditit e dytë në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH. Duke qenë se të dyja specialistet e auditit kryejnë të njëjtat detyra, për tu trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese do të duhet të kishin pagë të së njëjtës klase të librit të pagave. Duke qenë se paga e specialistes së auditit të parë dhe të dytë është e përcaktuar në strukturën organike të RTSH me diferencim në pagë me dy klasa, ndërkohë që sipas rregullores së brendshme për Drejtorinë e Auditit të dyja specialistet e auditit trajtohen njësoj dhe kryejnë të njëjtat detyra pa u diferencuar nga njëra tjetra. *Baza ligjore:* Konkretisht, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 27.02.2023, të protokolluar me nr. 32/3 prot., datë 27.02.2023 janë miratuar kriteret e marrjes në punë për punonjësit. Në këtë vendim lidhur me kriteret e marrjes në punë, janë përcaktuar dhe kriteret e marrjes në punë për pozicionin Specialist i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, por pa e specifikuar në specialist/auditues i parë apo i dytë. Gjithashtu, referuar Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, në nenin 20, janë përcaktuar Detyrat e Audituesit të Drejtorisë së Auditimit pa e ndarë në auditues të parë apo të dytë. Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 14, datë 21.01.2017, të protokolluar me nr. 313 prot., janë miratuar emërtesat dhe klasat e pagave për të gjithë punonjësit, ku konkretisht është specifikuar që Audituesi i parë klasifikohet me pagë klasa X dhe Audituesi i dytë me pagë klasa VIII. *Kjo është në mospërputhje me: Kriteret e marrjes në punë, pasi duke qenë se kanë të njëjtat kriteret të marrjes në punë të dyja specialistet e auditimit dhe kryejnë të njëjtat detyra (sipas Rregullores së Brendshme), atëherë edhe paga duhet të jetë e njëjtë për dy specialistet e auditimit.*

Gjithashtu, në Ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk ka një ndarje të tillë, madje konsiderohet trajtim i pabarabartë dhe diskriminues, veprim i cili është në mospërputhje me Kodin e Punës.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. M., Drejtore e Burimeve Njerëzore (deri në datë 06.06.2023), është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1367/80 prot., datë 29.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/27 prot., datë 01.12.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... Znj. B. B., e cila është paguar “Specialiste e dytë auditit” është emëruar në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në datën 09.03.2020, me Vendim nr.58 të Drejtorit të Përgjithshëm. Ajo nuk përmbushte dy kushtet kryesore për tu kualifikuar si specialiste e parë: mungesa e certifikatës së auditit (kusht ligjor) dhe mungesa e eksperiencës në punë (kusht ligjor).

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit e ka paraqitur edhe në aktkonstatim se aktualisht znj. B. B., tashmë certifikatën e auditit (kartën e audituesit nga MFE) e ka pjesë së dosjes personale.

Prandaj ky koment do të merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit.

7. Titulli i gjetjes:	Mos zhvillim Procedurë rekrutimi
Situata	Me vendim nr. 295, datë 19.07.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, I. B., është komanduar me detyrë Drejtore e Auditit të Brendshëm me pagë klasa XII. Me vendim nr. 540, datë 03.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm është bërë zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës, me arsyetimin se I. B., në momentin e komandimit nuk ka pasur eksperiencën e nevojshme për këtë pozicion dhe as certifikatën e audituesit të brendshëm, në mospërputhje me nenin 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, pika 2/b, të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Deri në datë 14.11.2023, datë që përfundoj auditimi nuk është ndërmarr asnjë procedurë rekrutimi për këtë pozicion pune.
Kriteri:	Kodi i Punës.
Ndikimi:	Dukë qenë se diferenca prej 2,339,895 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së, kjo gjë ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e buxhetit të RTSH-së duke hequr mundësinë e shfrytëzimit të kësaj vlerë në favor të publikut dhe jo të një individi.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes së strukturave drejtuese në trajtimin e plotë të marrëdhënieve të punës sipas kuadrit ligjor përkatës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për emërimin e Drejtorit të Auditit të Brendshëm me qëllim që emërimi të bëhet me “Auditues të brendshëm në sektorin publik” të liçensuar nga Ministria e Financave, por edhe me përvojë 5-vjeçare në profesion.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Th. G., Drejtor i Përgjithshëm i RTSH për periudhën 01.01.2020- 20.05.2021, A. M., Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore (deri në datë 06.06.2023).

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga Znj. I. B., e komanduar Drejtore e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, është paraqitur observacioni me shkresën pa numër dhe pa datë, protokolluar në KLSH me nr. 564/45 prot., datë 02.02.2024, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... Përsa i takon kësaj gjetje po argumentoj bazuar në Kodin e Procedurës Administrative (faqja nr.5)... Nuk ka asnjë shkelje të bazës ligjore të shkarkimit nga një detyrë dhe emërimit në një detyrë tjetër dhe përcaktimit të pagës për të cilën kryen funksionin. Znj. I. B., është liruar nga detyra e specialistes në Drejtorinë Juridike dhe është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm (I komanduar), në të njëjtin vendim përcaktohet dhe paga e pozicionit referuar vendimit për klasifikimin e pagave të Këshillit Drejtues.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi për dëmin ekonomik qëndron.

➤ **Punonjësit me kontratë shërbimi**

8. Titulli i gjetjes:	Pagesë më e lartë se paga e përcaktuar për këtë pozicion në librin e pagave
Situata	Nga auditimi u konstatua se, është lidhur kontratë shërbimi me punonjësin V. Xh., për pozicionin Menaxher i Orkestrës Simfonike, ndërkohë që ky pozicion ka qenë vend vakant në strukturën organike të RTSH. Ky punonjës është paguar me shpërblim mujor me një vlerë më të lartë sesa paga e përcaktuar në librin e pagave për këtë pozicion pune. Kjo gjë ka sjellë efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH-së, pasi shpërblimi sesa paga e përcaktuar në librin e pagave për këtë pozicion pune. Gjithashtu nuk disponohej dokumentacion justifikues lidhur me relativimin me eprorin direkt për punën e kryer nga ky punonjës dhe prencën e tij në punë në mospërputhje me kontratën e shërbimit. Nga auditimi u konstatua se nga data 01.09.2022 deri më 30.12.2022 punonjësi z. V. Xh., ka marrë një shpërblim bruto mujor prej 91,765 lekë, vlerë e cila rezulton të jetë më e lartë se paga e përcaktuar për këtë pozicion në librin e pagave, e cila është konkretisht klasa e X ^{-të} e pagës. Diferenca midis shpërblimit bruto (91,765 lekë) dhe pagës bazë të përcaktuar në librin e pagave për këtë pozicion, (81,000 lekë, nëse: z. Xh., ka pasur eksperiencë mbi 15 vjet, por duke qenë se punonjësi është larguar nuk ishte e mundur verifikimi i praktikës, pasi ky punonjës nuk ka qenë në strukturë, ndaj nuk ka dorëzuar dokumentacion për vjetërsi në pune) është 10,765 lekë në muaj. Në total janë katër muaj gjatë të cilëve z. Xh., është paguar 10,765 lekë më tepër për cdo muaj, se vlera e përcaktuar në tabelën e pagave. Pra, 10,765 lekë * 4 muaj = 43,060 lekë më tepër. Pra, sipas llogaritjeve tona, z. Xh. ka marrë një vlerë prej 43,060 lekë mbi pagesën bruto që i takonte sipas librit të pagave për këtë pozicion nëse do të ishte emëruar në këtë pozicion vakant. Gjithashtu, duke qenë se sipas të dhënave të marra nga RTSH, struktura e miratuar nga struktura faktike nuk është e plotësuar 100% në asnjë muaj përgjatë periudhës së auditimit, konkludojmë se marrja në punë e punonjësit z. Xh., me kontratë shërbimi ka një efekt negativ për financat e RTSH-së. Vlera 43,060 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH-së
Kriteri:	Kontratat e Shërbimit, pika 4, neni 6; Vendim të Këshillit Drejtues të RTSH nr. 28, datë 22.07.2021 të protokolluar me nr. 2447 prot.; Vendim të Këshillit Drejtues të RTSH nr. 34, datë 07.12.2022 të protokolluar me nr.130/3 prot.
Ndikimi:	Efekt financiar negativ për buxhetin e RTSH-së.
Shkaku	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së të marrë masa për rishikimin e kontratës së shërbimit me këtë punonjës dhe gjithë procedurës, për të mos i përsëritur më raste të tilla, të cilat përbëjnë efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH-së.
9. Titulli i gjetjes:	RTSH për largimet e padrejta nga puna e 6 punonjësve është detyruar përmes vendimeve të gjykatave të paguajë vlerën 9,955,078 lekë, duke

	shkaktuar pasoja negative financiare për buxhetin e RTSH-së.
Situata:	Sipas të dhënave të Drejtorisë Juridike, ka pasur 6 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj RTSH për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe në Gjykatën e Apelit për shumën 9,955,078 lekë, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. Kjo vlerë financiare e përfituar nga punonjësit e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme të cilësuar si të tilla me vendime të gjykatës, përbën efekt financiar negativ për buxhetin e RTSH duke ndikuar në performancën e tij financiare, si rezultat i veprimeve të paligjshme të Drejtorit të Përgjithshëm.
Kriteri:	Kontrata individuale
Ndikimi:	Vlera e përfituar nga punonjësit e larguar nga puna pa shkaqe të arsyeshme ndikojnë në performancën financiare institucionale të RTSH.
Shkaku	Mangësi një njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor të marrëdhënieve të punës.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të analizohen të gjitha rastet e largimeve nga puna të punonjësve, të cilat kanë rezultuar me ndëshkim financiar nga ana e gjykatave, duke evidentuar përgjegjësitë dhe duke marrë masa për eliminimin e tyre në të ardhmen.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga S. Gj., Drejtor Juridik (deri në qershor 2021), është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1367/45 prot., datë 20.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/7 prot., datë 21.11.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... Drejtoria Juridike është hallka e fundit që merret me largimet nga puna në të gjithë zinxhirin e strukturave përgjegjëse në RTSH dhe vetëm në fazën kur çështja shkon për gjykim në gjykatë (pra është kryer tashmë largimi nga puna), por jo në fazën e kryerjes së procedurave administrative për largimin nga puna, që është kompetencë e sektorit të burimeve njerëzore.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi është jashtë kontekstit. Grupi i auditimit e ka paraqitur edhe në aktkonstatim se për largimet e 6 punonjësve nga puna, përgjegjësia kryesore bie mbi titullarin e institucionit dhe më tej hallkave të tjera sipas hierarkisë për ndjekjen e kësaj problematike, në mënyrë që të mos përsëriten më raste të tilla në institucion.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. M., Drejtore e Burimeve Njerëzore (deri në datë 06.06.2023), është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1367/80 prot., datë 29.11.2023, protokolluar në KLSH me nr. 564/27 prot., datë 01.12.2023, në lidhje me aktkonstatimin nr. 27, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

..... Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në mënyrë të vazhdueshme, i ka sugjeruar Titullarit të institucionit, për pasojat negative të vendimmarrjeve në rastet e ndërprerjes në mënyrë të menjëhershme të marrëdhënieve të punës, pa zbatuar procedurën e përcaktuar në Ligjin

nr.7961, datë 12.07.1995 për Kodin e Punës (i ndryshuar). Por, në të gjitha rastet jemi ndodhur përpara faktit që vendimmarrja e Titullarit duhej të çohet më tej për zbatim, duke e vënë punën e DBNJ në një pozitë të vështirë, pasi përballja e mëtejshme, si dhe përgjegjësia do ti faturon vetëm kësaj Drejtorie.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit e ka paraqitur edhe në aktkonstatim se për largimet e 6 punonjësve nga puna, përgjegjësia kryesore bie mbi titullarin e institucionit. Prandaj ky koment merret pjesërisht në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Tabela nr.4: Përmbledhëse e punonjësve të larguar që kanë marrë dëmshpërblim page nga RTSH.

Nr.	Emri i punonjës	Pozicioni	Viti i largimit	Vendimi i gjykatës	Nr. i pagave të fituara	Likuidimi (në lekë)	Viti i likuidimit
1.	E. M.	Regjisor në Njësinë e Programeve	Prill 2017	Vendim Gjykata Administrative e Apelit Nr.538, datë 03.11.2021	Përfituar 17 paga mujore	1,131,350	Janar 2022
2.	S. Gj.	Drejtor i Drejtorisë Juridike	Qershor 2021	Ekzekutuar Vendimi Nr.5923, datë 11.11.2022 i Gjykata Shk.1 Tiranë, dhënë ky vendim me ekzekutim të përkohshëm	Përfituar 22 paga mujore + 26 ditë pune + shpenzime gjyqësore	2,682,673	Mars 2023
3.	A. K.	Përgjegjës IT në Njësinë Teknike, kaluar në Specialist i I ^{të} .	Qershor 2019	Vendimi Nr.197, datë 24.11.2022 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë	Përfituar 29 paga	3,065,294	Shkurt 2023
4.	Sh. S.	Drejtor i Departamentit të Krijimitarisë Muzikore	Mars 2017	Vendimi nr.225, datë 06.02.2020, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë	Përfituar 17 paga bruto	1,419,600	Qershor 2020
5.	N. K.	Teknik turni në Radiostacionin Cërriku B.	Gusht 2016	Vendimi nr.125, datë 26.01.2021 Gjykata e Apelit Durrës	Përfituar 18 paga	815,320	Prill 2021
6.	R. K.	Specialiste përkthimi në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë	2017	Vendim nr.438, dt.17.09.2021 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë	Përfituar 16 paga dhe 5 ditë pagë për shkak të moskryerjes së pushimeve vjetore për vitin 2017	840,841	Nëntor 2021
TOTALI						9,955,078	

Burimi: RTSH.

10. Titulli i gjetjes:	RTSH nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës për 14 punonjës edhe pas plotësimit të moshës së daljes në pension.
Situata	- Rezulton se janë 14 punonjës që kanë plotësuar moshën e pensionit nuk iu janë shkëputur marrëdhëniet e punës dhe nuk disponohet dokumentacion justifikues për punën/detyrat që kanë kryer gjatë kësaj periudhe kohore që janë paguar. Këto veprime janë në mospërputhje me VKM nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, pika 4: “Organet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me plotësimin e kushteve për pension pleqërie, sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ndërpresin menjëherë marrëdhëniet e punës për këtë kategori

	<i>nëpunësish/punonjësish</i> ”.
Kriteri:	VKM nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, pika 4.
Ndikimi:	Performancë të ulët të punonjësve dhe për pasojë dhe performancë institucionale.
Shkaku	Interpretim i gabuar i VKM-së përkatëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Këshilli Drejtues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë në lidhje me mbajtjen në punë të punonjësve në moshë pensioni, si dhe të marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënieve të tyre të punës.

-Lidhur me punonjësit që kanë dalë në pension dhe kanë vazhduar marrëdhëniet e punës me RTSH-në me kontratë punë me afat të përcaktuar janë në total 14 punonjës. Konkretisht:
Për vitin 2020 (datë 01.01-31.12.2020):

Nr.	Emri, mbiemri	Pozicioni	Periudha
1.	F.T. (ka dalë në pension pleqërie)	Redaktor Përgjegjës	01.09.2019-31.08.2021
2.	A. Xh. (ka dalë në pension pleqërie)	Gazetar i I në RT 1	01.01.2020-31.12.2020
3.	V. T. (ka dalë në pension pleqërie)	Asistente	18.07.2020-28.02.2021

Burimi: RTSH.

Për vitin 2021 (datë 01.01-31.12.2021):

Nr.	Emri, mbiemri	Pozicioni	Periudha
1.	V. T.	Asistente	01.03.2021-31.05.2021
2.	V. C. (ka dalë në pension pleqërie)	Asistente	17.10.2021-31.12.2021
3.	S. M.(ka dalë në pension pleqërie)	Shofer	01.11.2021-31.01.2022
4.	A. I. (ka dalë në pension pleqërie)	Kryeredaktor i gjuhëve të huaja	01.11.2021-31.01.2022
5.	A. K. (ka dalë në pension pleqërie)	Kameraman	02.04.2021-02.04.2022
6.	M. Z. (ka dalë në pension pleqërie)	Regjisore	20.10.2021-31.12.2021
7.	A. B. (ka dalë në pension pleqërie)	Montazhier	01.11.2021-31.01.2021
8.	A. M. (ka dalë në pension pleqërie)	Përgjegjës Sektori	01.11.2021-30.04.2022
9.	A. Xh. (ka dalë në pension pleqërie)	Gazetar I	01.01.2021-31.12.2021
10.	F. T. (ka dalë në pension pleqërie)	Redaktor përgjegjës	01.01.2021-05.02.2022
11.	D. M. (ka dalë në pension pleqërie)	Regjisore	01.06.2021-28.02.2022

Burimi: RTSH.

Për vitin 2022 (dt 01.01-31.12.2022):

Nr.	Emri, mbiemri	Pozicioni	Periudha
1.	Gj. P. (ka dalë në pension pleqërie)	Përgjegjës laborator	01.02.2022-31.01.2023

Burimi: RTSH.

-Drejtori artistik i Orkestrës Simfonike A. A. Z., është paguar pa qenë në Shqipëri, si dhe duke mos përmbushur detyrimet kontraktore.

Me shkresë përcjellëse nr. 213/prot., datë 17.01.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim aparaturash audio për koncertin e datës 22 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokëse më datën 22 nëntor 2022 nga operatori ekonomik “P.”.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 3827/17prot., datë 28.11.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim aparaturash audio për koncertin e datës 22 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokëse më datën 22 nëntor 2022 nga operatori ekonomik "P."

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 4207/1prot., datë 09.11.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim aparaturash audio për koncertin e datës 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Kad Tedrales Ortodokëse më datën 9 nëntor 2022.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 4174prot., datë 08.11.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për preventivin e datës 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokëse më datën 9 nëntor 2022.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 4857 prot., datë 30.12.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për rimburesimin e udhëtimit për artistët e ftuar në orkestrën simfonike të RTSH në datat 26 shtator, 13 tetor, 1 nëntor dhe 9 nëntor të vitit 2022.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 3766 prot., datë 07.10.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm për preventivin e koncertit muzikor të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin e Operas, Baletit dhe Asambli Popullor më datën 26 shtator 2022.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 154/14 prot., datë 08.02.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim aparaturash audio për koncertin e datës 15 janar 2023 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin e Operas, Baletit më datën 15 janar 2023.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 154/15 prot., datë 08.02.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim aparaturash audio për koncertin e datës 15 janar 2023 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokëse më datën 15 janar 2023, 6 shkurt 2023 dhe 17 shkurt 2023.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 154/16 prot., datë 27.02.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim aparaturash audio për koncertin e datës 15 janar 2023, 6 shkurt 2023 dhe 17 shkurt 2023.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 844 prot., datë 12.04.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim e detyrimit për faturën e akomodimit të trombistit solist R. J. dhe

harpistit solist J. H., që morën pjesë në koncertin e datës 26 shtator 2022 të orkestrës simfonike në koncertin e datës 15 janar 2023, 6 shkurt 2023 dhe 17 shkurt 2023.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 201/15 prot., datë 11.04.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim e detyrimit për faturën e akomodimit të artistëve që morën pjesë në koncertin e datës 6 shkurt dhe 17 shkurt 2023 të orkestrës simfonike Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 226/18 prot., datë 04.04.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim e detyrimit për faturën e akomodimit të artistëve që morën pjesë në koncertin e datës 22 nëntor 2023 dhe 17 shkurt 2023 të orkestrës simfonike. Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 714/11 prot., datë 07.04.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim honorarësh për koncertin e datës 2 prill 2023, të orkestrës simfonike.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 715/22 prot., datë 19.05.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim e detyrimit për faturën për koncertin e datës 07 prill 2023 dhe 28 prill 2023 të orkestrës simfonike Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 880/22 prot., datë 19.04.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet R. N., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm për miratim shpenzimi për koncertin e datës 28 prill 2023 të orkestrës simfonike.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 1083/1 prot., datë 29.05.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim honorarësh për koncertin e datës 18 maj 2023, të orkestrës simfonike.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 989 prot., datë 04.05.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet R. N., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm për miratim shpenzimi për koncertin e datës 18 maj 2023 dhe 13 qershor 2023 të orkestrës simfonike.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Me shkresë përcjellëse nr. 1023/16 prot., datë 27.06.2023 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., i drejtohet E. D., për likuidim honorarësh për koncertin e datës 13 qershor 2023, të orkestrës simfonike.

Shkresa/dokumenti nuk ka emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma. Emër, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje.

Shkresat si më sipër nuk janë dokumente zyrtare pasi emri, mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje, nuk duhet të ishin protokolluar dhe ekzekutuar për shpërblim nga drejtoria ekonomike.

Veprime në kundërshtim me VKM Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”, Neni 6.

Nga informacioni verbal për datat 26 shtator 2022; 07.10.2022; 1 nëntor 2022; 22 nëntor 2022 ; 09.11.2022; 30.12.2022; 17.01.2023; 15 janar 2023; 6 shkurt 2023; 08.02.2023; 17 shkurt 2023.; 27.02.2023; 2 prill 2023; 04.04.2023; 07.04.2023; 12.04.2023; 07 prill 2023; 19.04.2023; 28 prill 2023; 04.05.2023; 18 maj 2023; 22 nëntor 2023; 19.05.2023; 29.05.2023; 13 qershor 2023 dhe 27.06.2023, A. A. Z., ka qenë jashtë shtetit pasi është qytetar Francezë.

Për datat e përshkruara si më lartë: nuk mund të verifikohet ekzistenca ose jo në punë A. A. Z., pasi nuk është përfshirë në listprezencën që drejtorja e burimeve njerëzore harton për prezencën në punë dhe ja çon sektorit të pagave për shpërbim.

Me udhëheqësin artistik të orkestrës simfonike A. A. Z., është lidhur kontratë shërbimi me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, me objekt “RTSH dhe A. A. Z., vendosin të bashkëpunojnë së bashku për ofrimin e shërbimit në pozicionin e udhëheqësit artistik të OSRTSH” me pagë 240,000 lekë në muaj.

Kjo kontratë është miratuar në draft me Vendim të Këshillit drejtues nr. 16, datë 14.07.2022, ku ka vendosur në pikën 1 “Të miratoj draft kontratën e shërbimit të udhëheqësin artistik. Baza ligjore e këtij vendimi: Ligji nr. 97, datë 4.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Statuti, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”.

Në këtë vendim nuk është përcaktuar ligji specifik Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe kontrata kolektive e punës.

Vendimi i Këshillit drejtues nr. 16, datë 14.07.2022 “Për miratimin e draft kontratën e shërbimit të udhëheqësin artistik” bie ndesh me:

- Vendimin e Këshillit drejtues nr. 28, datë 22.07.2021 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, klas XII, i cili përcakton pagën e udhëheqësin artistik të OSRTSH 0-5 vjet 98,000 lekë, 5-15 vjet = 101,000 lekë dhe mbi 15 vjet 104,000 lekë.

-Vendimin e Këshillit drejtues nr. 34, datë 07.12.2022 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, klas XIII, i cili përcakton pagën 135,000 lekë. Referuar të dy vendimeve si më sipër dhe Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, VKM Nr. 286, datë 21.05.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”, me A. A. Z., duhet të ishte lidhur kontratë individuale pune.

Këshillit drejtues është kontradiktor në tre vendimmarrjet e tij të cituara si më sipër.

Për periudhën shtator 2022 deri më 30.06.2023 është likuiduar për vlerën 2,040,000 lekë.

Referuar sa më sipër: Vendimi i Këshillit drejtues nr. 16, datë 14.07.2022, për miratimin e draft kontratës së shërbimit të udhëheqësin artistik A. A. Z., Kontrata shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, e firmosur për RTSH nga E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm dhe A. A. Z., është në kundërshtim me:

-Statuti, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”, Neni 28, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Marrëdhëniet e punës në RTSH rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe me akte të tjera që rregullojnë këto marrëdhënie”.

Neni 29 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen me

kontrata pune:

a) individuale;

b) kolektive;

c) me kohë të pjesshme, ku parashikohet garantimi i sigurimeve shoqërore nga institucioni;

ç) me projekte, ku detyrimet financiare mbulohen nga vetë projekti.

2. Marrja në punë bëhet sipas kriterëve të pranimit në punë, të miratuara me vendim të Këshillit drejtues të RTSH-së, ku përcaktohet edhe përbërja e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e punonjësve. KDRTSH, në përcaktimin e kriterëve të marrjes në punë, përfshin edhe kriterë të tjera ligjore, për aq sa parashikohen si subjekte të ligjeve të posaçme.

- VKM Nr. 286, datë 21.5.2018, “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

-Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115.

-Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Referuar sa më sipër, për datat 26 shtator 2022; 07.10.2022; 1 nëntor 2022; 22 nëntor 2022 ; 09.11.2022; 30.12.2022; 17.01.2023; 15 janar 2023; 6 shkurt 2023; 08.02.2023; 17 shkurt 2023.; 27.02.2023; 2 prill 2023; 04.04.2023; 07.04.2023; 12.04.2023; 07 prill 2023; 19.04.2023; 28 prill 2023; 04.05.2023; 18 maj 2023; 22 nëntor 2023; 19.05.2023; 29.05.2023; 13 qershor 2023 dhe 27.06.2023, nuk provohet/dokumentohet që drejtori artistik A. A. Z., të ketë qenë në Shqipëri, duke ushtruar detyrën e tij.

Si pasojë e çështjeve të trajtuar si më sipër grupi i auditimit refuzon të jap opinion, për saktësinë dhe vërtetësinë e shpërblimit të marr nga drejtori artistik A. A. Z., për periudhën 07.09.2022 deri më 30.06.2023.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si mësipër ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Këshillit drejtues që kanë firmosur Vendimin i Këshillit drejtues nr. 16, datë 14.07.2022; G. P., Ë. N., M. S., G. P., D. P., A. R., E. J., me detyrë drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Nga A. A. Z., nuk është zbatuar Neni 5 i kontratës së shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, e firmosur për RTSH nga E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm dhe A. A. Z., ku është përcaktuar: Udhëheqësi artistik i Orkestrës Simfonike i RTSH, duhet ti paraqes Drejtorit të Përgjithshëm të gjithë:

-a. Riprodhimin e veprave muzikore shqiptare e të huaja dhe prodhimin e regjistrimeve të muzikës së lehtë dhe popullore.

-b. Promovimin e trashëgimisë së vërtet muzikore shqiptare dhe krijimtarisë bashkëkohore.

-c. Përgatitjen dhe shfaqjen e koncerteve dhe të shkaqeve të tjera publike.

-d. Regjistrimin e krijimeve artistike të vendit dhe të huaj.

Pasi A. A. Z., nuk provohet/dokumentohet të ket paraqitur tek Drejtori i Përgjithshëm ose në RTSH asnjë produkt të përcaktuar kontratë, në zbatim të pikave a,b,c dhe d.

Veprim ne kundërshtim me:

- Kontratën e shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 Neni 20 dhe Neni 52.

- Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si mësipër ngarkon me përgjegjësi E. J., me detyrë ish-drejtor i Përgjithshëm, E. D., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe D. D., me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike.

1. Titulli i gjetjes:	Kontrata e shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022 me drejtorin artistik është lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
Situata:	<p>Me udhëheqësin artistik të orkestrës simfonike A. A. Z., është lidhur kontratë shërbimi me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, me objekt: RTSH dhe A. A. Z., vendosin të bashkëpunojnë së bashku për ofrimin e shërbimit në pozicionin e udhëheqësit artistik të OSRTSH” me pagë 240,000 lekë në muaj.</p> <p>Kjo kontratë është miratuar në draft me Vendim të Këshillit drejtues nr. 16, datë 14.07.2022, ky vendim bie ndesh me:</p> <p>-Vendimin e këshillit drejtues nr. 28, datë 22.07.2021 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, klas XII, i cili përcakton pagën e udhëheqësin artistik të OSRTSH 0-5 vjet 98,000 lekë, 5-15 vjet = 101,000 lekë dhe mbi 15 vjet 104,000 lekë.</p> <p>-Vendimin e këshillit drejtues nr. 34, datë 07.12.2022 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, klas XIII, i cili përcakton pagën 135,000 lekë. Referuar të dy vendimeve si më sipër, dispozitave ligjore që rregullojnë mardhëniet e punës, me A. A. Z., duhet të ishte lidhur kontratë individuale pune.</p> <p>Këshillit drejtues është kontradiktor në tre vendimmarrjet e tij të cituara si më sipër.</p> <p>Referuar sa më sipër: Vendimi i këshillit drejtues nr. 16, datë 14.07.2022, për miratimin e draft kontratën e shërbimit të udhëheqësin artistik A. A. Z., Kontrata shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, e firmosur për RTSH nga E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm dhe A. A. Z., është në kundërshtim me Statutin e RTSH si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë mardhëniet e punës dhe pagave.</p>
Kriteri:	<p>-Statuti, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”, Neni 28.</p> <p>-Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115.</p> <p>-VKM Nr. 286, datë 21.5.2018 “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keqmenaxhim i fondeve dhe të burimeve njerëzore.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në menaxhimin e fondeve dhe të burimeve njerëzore.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për të shfuqizuar kontratën e shërbimit nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022 me drejtorin artistik Orkestres Simfonike A. A. Z., dhe të lidhet kontratë individuale pune.
---------------------	---

2. Titulli i gjetjes:	Mos zbatim i detyrimeve kontraktore nga drejtorin artistik i orkestrës simfonike.
Situata:	-Nga A. A. Z., nuk është zbatuar Neni 5 i kontratës së shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, ku është përcaktuar: Udhëheqësi artistik i Orkestrës Simfonike i RTSH, duhet ti paraqes Drejtorit të Përgjithshëm të gjithë: -a. Riprodhimin e veprave muzikore shqiptare e të huaja dhe prodhimin e regjistrimeve të muzikës së lehtë dhe popullore. -b. Promovimin e trashëgimisë së vërtet muzikore shqiptare dhe krijimtarisë bashkëkohore. -c. Përgatitjen dhe shfaqjen e koncerteve dhe të shkaqeve të tjera publike. -d. Regjistrimin e krijimeve artistike të vendit dhe të huaj. Pasi A. A. Z., nuk provohet/dokumentohet të ketë paraqitur tek drejtori i përgjithshëm ose në RTSH asnjë produkt të përcaktuar në kontratë, në zbatim të pikave a,b,c dhe d.
Kriteri:	-Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690. -Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52. -Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b. -Kontrata e shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keqmenaxhim të burimeve njerëzore.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në zbatimin e kontratave të shërbimit, duke ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim me qëllim jo vetëm pranimin dhe marrjen në dorëzim me specialist të fushave, për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

3. Titulli i gjetjes:	Drejtori artistik i Orkestres Simfonike A. A. Z., është paguar pa qenë në Shqipëri, duke mos përmbushur detyrimet kontraktore.
Situata:	Nga RTSH nuk provohet/dokumentohet që drejtori artistik A. A. Z., të ketë qenë në Shqipëri, duke ushtruar detyrën e udhëheqësit artistik të OSRTSH, për datat 26 shtator 2022; 07 tetor 2022; 1 nëntor 2022; 22 nëntor 2022; 09. Nëntor 2022; 30 dhjetor 2022; 17 janar 2023; 15 janar 2023; 6 shkurt 2023; 08.02.2023; 17 shkurt 2023; 27 shkurt 2023; 2 prill 2023; 04 prill 2023; 07 prill 2023; 12 prill 2023; 07 prill 2023;

	<p>19.04.2023; 28 prill 2023; 04 maj 2023; 18 maj 2023; 22 nëntor 2023; 19 maj 2023; 29 maj 2023; 13 qershor 2023 dhe 27 qershor 23, duke mos argumentuar dhe dokumentuar për saktësinë dhe vërtetësinë e shpërblimit të marr nga drejtori artistik A. A. Z., për periudhën 07.09.2022 deri më 30.06.2023.</p> <p>Si pasojë e çështjeve të trajtuar si më sipër grupi i auditimit refuzon të jap opinion, për saktësinë dhe vërtetësinë e shpërblimit të marr nga drejtori artistik A. A. Z., për periudhën 07.09.2022 deri më 30.06.2023.</p>
Kriteri:	<p>-VKM Nr. 286, datë 21.5.2018, “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”.</p> <p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.</p> <p>-Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.</p> <p>-Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115.</p> <p>-Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keqmenaxhim i fondeve publike dhe burimeve njerëzore.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në fondeve publike dhe burimeve njerëzore .
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korigjuar këtë praktikë në drejtimin e orkestrës simfonike/por jo vetëm, duke eliminuar trajtimin me standard të dyfishtë të punonjësve të RTSH, si dhe të saktësohet periudha e pa dokumentuar për të cilën është përfutuar edhe pagesa përkatëse.

4. Titulli i gjetjes:	Pagesa për honorarë, koncerte etje, pa dokumentacion zyrtar të rregullt.
Situata:	Në 18 shkresa përcjellëse hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., drejtuar E. D. dhe titullarëve për likuidim honorarësh për koncertin etje, shkresat nuk janë dokumente zyrtare pasi emri mbiemër i nënshkruesit dhe firma janë fotokopje, si dhe janë protokolluar në Institucion.
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, Neni 6.</p> <p>-VKM Nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, neni 4, pika 4.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk për abuzim me fondet publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në administrimin e dokumenteve zyrtare.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për administrimin e dokumenteve zyrtare të protokolluara, me qëllim që pagesa për honorarë, koncerte etje të bëhet me dokumentacion të protokolluar, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.
---------------------	--

-Klasifikim i nivelit të pagave nuk është bërë duke vendosur kritere specifike për çdo pozicion pune.

Nga auditimi i nivelit të pagave të miratuar nga këshilli drejtues nr. 28, datë 22.07.2021 dhe nr. 34, datë 07.12.2022 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, u konstatua që klasifikimi nuk është bërë duke vendosur kritere specifike për çdo pozicion pune siç janë niveli i diplomës, arsimimi/kualifikimi, natyra e punës, kushtet e punës, formimi profesional, vjetërsia në punë, vështirësia, përvoja dhe përgjegjësitë, njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet si kusht për të garantuar barazinë në vendosjen e pagave.

Këto kritere nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Si shembull marrim:

Nga shqyrtimi i strukturave analitike rezulton se brenda grupit (sektori/ drejtorie) ka nivele të ndryshme page për specialistë të cilët realizojnë të njëjtat punë dhe që kanë të njëjtat përshkrime pune. Diferenca page brenda së njëjtës drejtori, ka në disa drejtori, nga grupi i auditimit janë marrë në shqyrtim si më poshtë:

-Në Njësinë e Programeve, Radio Tirana (përshkrimi i punës është i njëjtë), Gazetar I klasa VII dhe Gazetar II klasa VI pra ka një ndarje të Gazetarëve në dy nivele;

-Sektori Programacionit, në përshkrimet e detyrave nuk ka ndarje të redaktorëve të parë apo të dytë, ndërkohë që Redaktor I klasa VII dhe Redaktor II klasa VI.

-Në Drejtorinë Juridike (kriteret dhe përshkrimi i punës është i njëjtë), specialist klasa VII dhe specialist klasa VIII;

-Sektori Projekteve dhe Administrimit të Drejtave, Specialist klasa VIII dhe specialist klasa VII, me të njëjtët kritere dhe përshkrime pune.

-Në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve: Redaksia e Gazetarëve të Gjuhëve të huaja, gazetar përkthyes i parë klasa IX, gazetar përkthyes i dytë klasa VIII dhe gazetar përkthyes i tretë klasa VII; me të njëjtët kritere dhe përshkrime pune.

-Departamenti i Sportit, gazetar I klasa X dhe gazetar II Klasa VII (me të njëjtët kritere dhe përshkrime pune)

-Për Njësinë Teknike- Sektori IT, në përshkrimet e punës nuk ka ndarje të specialistëve të parë apo të dytë, referuar vendimit të KD nr 23/2018 , Specialist IT i I klasa VIII dhe Specialist IT i II klasa VII’. Pra specialistët paguhen me paga të ndryshme pa një unifikim dhe pa vendosur kritere objektive siç janë natyra e punës, cilësia dhe sasia e saj, kushtet e punës, formimi profesional dhe vjetërsia në punë, përvoja dhe përgjegjësitë.

-Departamenti Teknikës TV, Sektori i regjistrim – transmetimit, teknik figure I klasa VI dhe teknik figure II klasa IV; teknik zëri I Klasa VI dhe teknik zëri II Klasa IV; teknik ndriçimi I klasa VI dhe teknik ndriçimi II klasa IV; titriste I klasa VI dhe titriste II klasa IV; Departamenti Teknik dhe Radio, teknik regjistrim dhe montazh I klasa VII dhe teknik regjistrim dhe montazh klasa VI.

-Departamenti i Prodhimit, Sektori i Studiove, grimior i parë klasa IX dhe grimior klasa V dhe kostumograf i I klasa IX dhe kostumograf klasa VII.

-Në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm ka diferencime në pagë, kur përshkrimet e punës janë të njëjta, referuar vendimit të këshillit drejtues nr 23/2018, nuk ka të specifikuar specialist i parë

apo i dytë, ndërkohë specialist i parë sipas strukturës është me klasën X dhe specialist i dytë (ka përfunduar studimet master shkencor) me klasën VIII. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të kategorizohet si “Specialist i parë” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “specialist i dytë” duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional . Një ndarje e tillë është e pambështetur as në klasifikimin e pagave të RTSH, as në Ligjin e posacëm nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” apo në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Në lidhje me këtë problematikë, B. H. (S.), B., Specialisti dytë në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm ka bërë një kërkesë për unifikim page datë 01.03.2023, së cilës me shkresën me numër 594/1 datë 06.03.2023 i është kthyer përgjigje se: *“Në momentin e emërimit specialisti nuk ka patur vjetërsi pune si auditues dhe nuk ka qënë i certifikuar”*, ndërkohë që një gjë e tillë nuk është e bazuar në ligj. Referuar gërma “ç” të pikës 2 të Nenit 11 të Ligjit nr.114/2015 shprehet si më poshtë: *“Punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si "Auditues i brendshëm", por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t'i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si "Auditues i brendshëm"”*. Përpos sa mësipër B. H. (S.) B., me detyrë specialisti dytë në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, është certifikuar nga MFE në vitin 2021 dhe është pajisur me certifikatë me nr. regjistri 2009 datë 01.10.2021.

Me shkresën me nr.594/3 prot., datë 17.03.2023 DBNJ ka vijuar të kundërshtojë unifikimin e pagës duke arsyetuar ndër të tjera që *“Një ndarje e tillë në specialist të parë dhe të dytë është bërë referuar VKM-së nr.545, datë 11.08.2011, lidhjes nr.3 të tij”*, i cili i ndante inspektorët në Drejtorinë e Auditimit në dy kategorizime, III a dhe III b.

Referenca ligjore nr.594/3 prot., datë 17.03.2023 (pra VKM-së nr.545, datë 11.08.2011) është e gabuar, pasi VKM 545/2011, është shfuqizuar që në vitin 2017 me VKM nr. 187/2017 për rrjedhojë dhe lidhja 3 është ndryshuar, nuk ka patur dhe as nuk ka diferencim page midis specialistëve auditues të brendshëm.)

Referuar ndryshimeve të pagave brenda një sektori apo drejtorie, ka një standart të dyfishtë, shkelje të barazisë, parimit të drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit për trajtimin me pagë të punonjësve të RTSH, në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 9 dhe 109, 110, Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17 dhe Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin drejtues, Th. G., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm për periudhën 01.01.2020- 20.05.2021, E. J., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i RTSH për periudhën 03.12.2021-12.04.2023, R. N., në cilësinë zv/drejtorit të përgjithshëm për periudhën 13.04.2023 deri më 13.06.2023.

1. Titulli i gjetjes:	Vendosja e nivelit të pagës për secilin pozicion nuk është vlerësuar bazuar në kriteret të mirë përcaktuara.
Situata:	Nga auditimi i nivelit të pagave të miratuar nga këshilli drejtues me vendim nr. 28, datë 22.07.2021 dhe nr. 34, datë 07.12.2022 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, u konstatua që

klasifikimi nuk është bërë duke vendosur kritere specifike për çdo pozicion pune siç janë niveli i diplomës, arsimimi/kualifikimi, natyra e punës, kushtet e punës, formimi profesional, vjetërsia në punë, vështirësia, përvoja dhe përgjegjësitë, njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet si kusht për të garantuar barazinë në vendosjen e pagave.

Këto kritere nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Konkretisht:

-Në Njësinë e Programeve, Radio Tirana (përshkrimi i punës është i njëjtë), gazetar I klasa VII dhe gazetar II klasa VI pra ka një ndarje të gazetarëve në dy nivele.

-Sektori Programacionit, në përshkrimet e detyrave nuk ka ndarje të redaktorëve të parë apo të dytë, ndërkohë që redaktor I klasa VII dhe redaktor II klasa VI.

-Në Drejtorinë Juridike (kriteret dhe përshkrimi i punës është i njëjtë), specialist klasa VII dhe specialist klasa VIII.

-Sektori Projekteve dhe Administrimit të Drejtave, specialist klasa VIII dhe specialist klasa VII, me të njëjtët kritere dhe përshkrime pune.

-Në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve: Redaksia e Gazetarëve të Gjuhëve të huaja, gazetar përkthyes i parë klasa IX, gazetar përkthyes i dytë klasa VIII dhe gazetar përkthyes i tretë klasa VII; me të njëjtët kritere dhe përshkrime pune.

-Departamenti i Sportit, gazetar I klasa X dhe gazetar II Klasa VII (me të njëjtët kritere dhe përshkrime pune).

-Për Njësinë Teknike- Sektori IT, në përshkrimet e punës nuk ka ndarje të specialistëve të parë apo të dytë, referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 23/2018 , specialist IT i I klasa VIII dhe specialist IT i II klasa VII'. Pra specialistët paguhet me paga të ndryshme pa një unifikim dhe pa vendosur kritere objektive siç janë natyra e punës, cilësia dhe sasia e saj, kushtet e punës, formimi profesional dhe vjetërsia në punë, përvoja dhe përgjegjësitë.

-Departamenti Teknikës TV, sektori i regjistrim – transmetimit, teknik figure I klasa VI dhe teknik figure II klasa IV; teknik zëri I Klasa VI dhe teknik zëri II Klasa IV; teknik ndriçimi I klasa VI dhe teknik ndriçimi II klasa IV; titriste I klasa VI dhe titriste II klasa IV; Departamenti Teknik dhe Radio, teknik regjistrim dhe montazh I klasa VII dhe teknik regjistrim dhe montazh klasa VI.

-Departamenti Prodhimit, Sektori i Studiove, grimior i parë klasa IX dhe grimior klasa V dhe kostumograf i I klasa IX dhe kostumograf klasa VII.

-Në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm ka diferencime në pagë, kur përshkrimet e punës janë të njëjta, referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 23/2018, nuk ka të specifikuar specialist i parë apo i dytë, ndërkohë specialist i parë sipas strukturës është me klasën X dhe specialist i dytë (ka përfunduar studimet master shkencor) me klasën VIII. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të

	kategorizohet si “Specialist i parë” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “Specialist i dytë” duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional. Një ndarje e tillë është e pambështetur as në klasifikimin e pagave të RTSH, as në Ligjin e posacëm nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” apo në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.
Kriteri:	Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 9 dhe 115. Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Ligji nr 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” apo në akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Ligji Nr.10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keqmenaxhim të burimeve njerëzore
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale në ushtrimin e përgjegjësive në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të RTSH të rishikohen dhe llogariten nivelet e pagave të punonjësve duke u bazuar në kritere të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si master shkencor, master profesional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë dhe vështirësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune dhe duke synuar motivimin e tyre.

Trajtim ankese administruar në KLSH me Nr. 995 prot., datë 09.11.2023.

Në zbatim të pikës IV të programit të auditimit, lidhur me ankesën J. K., bazuar në Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe “Rregulloren e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, miratuar me vendimin Nr. 63, datë 22.06.2020 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit., u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Kërkesa Nr. 995 prot., datë 09.11.2023 e J. K., me detyrë specialiste e drejtorisë së burimeve njerëzore drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga auditimi u konstatua se:

J. K., me detyrë specialiste në sektorin e akademisë, në drejtorinë e burimeve njerëzore është emëruar në këtë detyrë me vendimin nr. 576, datë 31.10.2022 të E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm.

Për këtë emërim është lidhur kontrata individuale e punës pa afat të përcaktuar me nr. 3946/2 prot., datë 01.11.2022.

Nga data e emërimit deri në datën 04.06.2023 nuk ka pasur asnjë masë disiplinore.

Me vendim Nr. 219, dt. 05.06.2023, të zv/drejtorit të përgjithshëm R. N., i është dhënë masa disiplinore: “Tërheqje vëmendje me shkrim” për thyerje të etikës në punë pasi në datë 22 maj 2023 në zyrën e sektorit të akademisë ka përdorur gjuhë jo të përshtatshme ndaj eprorëve, tone të larta të zërit në komunikim, për mosbindje të urdhrat të eprorëve, si dhe për tejkallim

kompetencash në komunikim, gjë e cila bie ndesh me rregulloren e kabinetit të drejtorit të përgjithshëm.

Kjo masë ka filluar më datë 22.05.2023 mbi bazën e e-mailit (kërkesë) të F. T., me detyrë përgjegjëse e sektorit të burimeve-njerëzore, në Drejtorinë e Burimeve-Njerëzore, pranë RTSH-së.

A. M., me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë së Burimeve-Njerëzore në cilësinë e eprorit direkt ka njoftuar me shkresë Nr. 1062 Prot, datë. 23.05.2023 me subjekt “Njoftim për zhvillim takimi për bisedime”, J. K., me detyrë specialiste në sektorin e akademisë, F. T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Burimeve-Njerëzore, E. Z., me detyrë specialiste në Sektorin e Akademisë, B. H., me detyrë përgjegjës Sektorin pranë Drejtorisë Juridike, ku citohet jeni të ftuar të merrni pjesë në takim që do të zhvillohet më datë 24.05.2023, ora 10:00 në sallën e mbledhjeve në drejtorinë e përgjithshme, për të diskutuar në lidhje me problematikën e ndodhur në zyrën e Burimeve-Njerëzore në datë 22.05.2023, **por pa përcaktuar objektin e problematikës.**

Veprim në kundërshtim me:

- Nenin 42, “Komunikimi me palët” të Ligjit 43/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, organi publik ka detyrimin ligjor të kryejë identifikimin e palëve, cili është roli dhe pozicioni i tyre në një proces, t’u komunikojë fillimin e procedurës duke i siguruar informacionin e nevojshëm që do t’u mundësonte palëve që të merrnin pjesë në mënyrën e duhur në procedurën administrative dhe të ushtronin të drejtat e tyre (njohja me dosjen, parashtrimi i argumenteve, e drejta e përfaqësimit me avokat, etj).

- Pikës 1, Neni 45, “E drejta e palëve për t’u njohur me dosjen” të Kreut III, “Të Drejtat e palëve gjatë procedurës administrative”, të Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i RTSH-së”.

- Nenin 47 të Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”.

-Nenin 48 “Detyrimi i Vlerësimit” të Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative” i ka munguar vullneti për të kryer hetim administrativ të mirëfilltë, si dhe për të vlerësuar me shkrim mendimet, kërkesat dhe shpjegimet e palëve të paraqitura në përputhje me Nenin 47 të këtij Kodi.

Takimi datë 24.05.2023, ora 10:00 është dokumentuar me procesverbalin Nr.1062/1 prot., datë 24.05.2023, ku kanë firmosur J. K., B. H., F. T., A. R., në cilësinë e protokollueses.

Pjesëmarrësit në këtë takim, duke përjashtuar J. K., dhe F. T., që duhet të ishin prezent për sqarim, dhe në mungesë të A. M., me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë së Burimeve-Njerëzore, ngelet vetëm B. H., me detyrë drejtores e Drejtorisë Juridike për të bërë vlerësimin e pretendimeve të palëve edhe kjo e pa autorizuar nga zv/drejtori i përgjithshëm.

Në këtë takim u vendos që të zhvillohet një takim i dytë që të ishte e pranishme dhe A. M., me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë së Burimeve-Njerëzore në cilësinë e eprorit direkt, pasi nuk ishte në takim, edhe pse kishte njoftuar zyrtarisht paraqitjen me shkresë Nr. 1062 prot, datë 23.05.2023, për takim datë 24.05.2023, ora 10:00

Nuk ka urdhër zyrtar të zv/drejtorit të përgjithshëm R. N., për ngritje e grupit të punës për seancën dëgjimore të datës 24.05.2023, ora 10:00, ku në përbërje të jetë J. K., B. H., F. T., A. R. dhe A. M., pra ky takim është i pa legjitimuar, veprim në kundërshtim me Nenin 43 Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Titullari i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënligjor, cakton paraprakisht një njësi përgjegjëse për çdo tip Procedurë administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm*”.

Por vetëm me e-mail të datës 22.05.2023 ora 6.05 PM, R. N., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm i drejtohet A. M. dhe në CC F. T., ku citohet në mënyrë eksplicite se “A., Cakton takimin me qëllim ndjekjen e procedurës, në lidhje me problematikën e mëposhtme. Është e pa tolerueshme që të mos respektohen rregullat e etikës në drejtorinë që kujdeset për këtë. Të procedohet për vlerësimin me seriozitet të situatës dhe të merren masat përkatëse, për rastin në fjalë.

Nuk ka caktuar emra konkret, në CC është dhe F. T., e cila është palë në proces në kundërshtim me Ligjin nr . 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve Publike”, ndryshuar, Neni 37 pika 1 “*Vetë përjashtim nga vendimmarrja dhe*” pika 2.” *Moslejimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje*”. Në këtë takim u vendos që të zhvillohet një takim i dytë që të ishte e pranishme dhe A. M.

Me e-mail datë 22 maj ora 16.23 F. T., i drejtohet R. N., me detyrën e zv/drejtorit të përgjithshëm ku i shpjegohet pretendimi për shkelje të etikës nga ana e specialistes J. K.

F. T., nuk i është drejtuar eprorit direkt A. M., në cilësinë e drejtores së burimeve njerëzore në kundërshtim me Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Me e-mail të datës 01.06.2023 A. M., i drejtohet R. N., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm, ku citohet”

“.....në lidhje me rastin e punonjës J. K., si dhe me dështimin e takimit të datës 24.05.2023, pasi kjo punonjëse nuk pranoi të zhvillohej mbledhje, i është kërkuar F. T., me detyrë përgjegjëse e sektorit të burimeve-njerëzore, që të raportonte me situatën e ndodhur në këtë takim. Ky relacion ju është dërguar juve, në cilësinë e titullarit më datën 23.05.2023, me qëllim që të merrej vendimmarrja nga ana juaj për rastin në fjalë. Edhe pse nuk kemi pasur reagim nga ana juaj, ditën e martë datë 30.05.2023 znj. K., është thirrur në zyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, si dhe në prezencën e përgjegjëses së këtij sektori, pas ballafaqimit të bërë i është tërhequr vëmendje për situatën e krijuar më datën 22.05.2023, si dhe braktisjen e takimit në datën 24.05.2023. Znj. K., ka mohuar me tone të larta të zërit, si dhe kontekstin e fjalëve të përdorura në atë moment, duke thënë që nuk kanë qenë të qëllimshme. Fakt i cili nuk provohet nga ana dokumentare ose verbale.

Znj. K., i është tërhequr vëmendje për tonet e larta të zërit në komunikim, për mos bindje të urdhrat të eprorit si dhe tejkalim kompetencash në komunikim, gjë e cila bie ndesh me rregulloren e kabinetit të drejtorit të përgjithshëm.

Në fakt rregullorja e kabinetit miratuar me vendim të këshillit drejtues nr. 32, datë 11.09.2018 nuk ka lidhje me rregulloren e burimeve njerëzore e miratuar po me këtë vendim.

Me e-mailin e datës 24.05.2023 ora 12.32, A. M., i drejtohet R. N., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm, ku citohet “Në vijim të e-mailit të zv/drejtorit të përgjithshëm të datës 22.05.2023 për vlerësimin e rastit të komunikimit jo etik dhe me tone të larta në bisedë Znj. J. K., ndaj përgjegjësit të sektorit të burimeve njerëzore F. T., (situatë e relatuar nga znj. T., në e-mailin informues të datës 22.05.2023) ditën e djeshme u përgatit njoftimi me shkresën nr. 1062 prot., ku u ndoq procedura përkatëse në rastin në fjalë. Në njoftimin e nxjerr me shkresën nr. 1062 prot., datë 23.05.2023, është përcaktuar qartë se cilët punonjës do të ishin prezent në këtë takim. Nuk është detyrë e znj. K., që të vendosë se cilët punonjës duhet të jenë ose jo, pjesë e takimeve të tilla të organizuara nga burimet njerëzore.

Në fakt ky deklaram është në kundërshtim me rregulloren e burimeve njerëzore e miratuar vendim të këshillit drejtues nr. 32, datë 11.09.2018, Neni 11 “Të drejtat dhe detyrat e drejtorit të burimeve njerëzore”, pika 1, pika 8, tek detyrat specifike pika 2, pika 3.

Mbi të gjitha është në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve Publike”, ndryshuar, Neni 37 pika 1 “*Vetë*

përrjashtim nga vendimmarrja dhe” pika 2.” Moslejimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje”, pasi F. T., është palë në konflikt.

Duke ju referuar rasteve të tilla të mëparshme të ngjashme, në lidhje me takimet e organizuara për njoftimet e nxjerra nga drejtoria e burimeve njerëzore, ju bëj me dije se drejtoria e burimeve njerëzore nuk ka qenë asnjëherë pjesë e këtyre takimeve.

Në fakt ky deklaram është në kundërshtim me rregulloren e burimeve njerëzore e miratuar vendim të këshillit drejtues nr. 32, datë 11.09.2018, Neni 11 “Të drejtat dhe detyrat e drejtorit të burimeve njerëzore”, pika 1, pika 8, tek detyrat specifike pika 2, pika 3.

Me e-mailin e datës 06.02.203 ora 2.13 mbazdite R. N., i drejtohet A. M., me objekt “Njoftim për relacion përfundimtar”. E nderuar, Pas sqarimit të mëposhtëm propozoj që të kalohet me vërejtje me shkrim për punonjësen në fjalë.

Për pasojë

Vendimi Nr. 219, dt. 05.06.2023, i zv/drejtorit të përgjithshëm R. N., për dhënie mase disiplinore: Tërheqje vëmendje me shkrim” për thyerje të etikës në punë pasi në datë 22 maj 2023 në zyrën e sektorit të Akademisë ka përdorur gjuhë jo të përshtatshme ndaj eprorëve, tone të larta të zërit në komunikim, për mosbindje të urdhrat të eprorëve, si dhe për tejkallim kompetencash në komunikim, gjë e cila bie ndesh me rregulloren e Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Vendimi është në kundërshtim me:

-Vendimin e këshillit drejtues nr. 32, datë 11.09.2018 “Për rregulloren e burimeve njerëzore dhe rregulloren e kabinetit”;

- Nenin 9 “Ndalimi i diskriminimit”; të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, gërma c “Parandalon çdo qëndrim që cënon dinjitetin e punëmarrësit”, pika 1 e Nenit 32 “Mbrojta e personalitetit”;

-Nenin 37 “Masat disiplinore” të Ligjit Nr. 7961, dt. 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Nenin 38 “Vendosja në dispozicion e legjislacionit” të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ku citohet se “Punëdhënësi duhet të vërë në dispozicion të punëmarrësve, në çdo ndërmarrje, Kodin e Punës, si dhe çdo ligj tjetër që rregullon detyrimet dhe të drejtat midis punëmarrësve dhe punëdhënësve”;

-Pika 2 “Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cënohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor” e Nenit 4 “Parimi i ligjshmërisë”, i Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të RTSH-së”;

-Nenin 5 Parimi i transparencës “Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të”, si dhe të neneve 13, 14, 15,16, 17, “Parimi i drejtësisë dhe paanësisë, i objektivitetit, i përgjegjësisë dhe i marrjes së vendimeve, i barazisë dhe i diskriminimit”, të Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të RTSH-së”;

- Neni 45 “E drejta e palëve për njohje me dosjen”, e Nenit 47 “E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime” ku shprehimisht citohet se: “Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”, i Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të RTSH-së”;

-Neneve 48, 80, 81, 100 i Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të RTSH-së”, për vetë faktin se në dispozitivin e tij nuk jepen të dhëna mbi:

-Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;

-Cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku;

-Pretendimet e palës së proceduar/ dëshmitarëve;

-Shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;

-Nenet 42, 48, 69 si dhe 87 “Njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar” të Nenet 88 “Ushtimi i së drejtës për t’u dëgjuar” të Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të RTSH-së”;

-Ligjin nr .9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve Publike”, ndryshuar, Neni 37 pika 1 “*Vetë përjashtim nga vendimmarrja dhe*” pika 2.” *Moslejimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje*”, pasi F. T., është palë në konflikt.

Për pos sa më sipër nuk është provuar nga ana dokumentare, ose me deklaratë nga persona të pranishëm që Znj. J. K., ka shkelur kodin e etikës ndaj përgjegjësit të sektorit të burimeve njerëzore F. T.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi R. N., me detyrë ish-zv/drejtor i përgjithshëm, A. M., me detyrë ish-drejtoresh e drejtorisë së burimeve njerëzore dhe F. T., me detyrë përgjegjëse e sektorit të burimeve njerëzore.

1. Titulli i gjetjes:	Masë disiplinore nuk është e mbështetur në fakte dhe prova për mos zbatimin e kodit të etikës ndaj përgjegjësit të sektorit të burimeve njerëzore.
Situata:	J. K., me detyrë specialiste në sektorin e akademisë, në drejtorinë e burimeve njerëzore është emëruar në këtë detyrë me vendimin nr. 576, datë 31.10.2022 të E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm. Për këtë emërim është lidhur kontrata individuale e punës pa afat të përcaktuar me nr. 3946/2 prot., datë 01.11.2022. Nga data e emërimit deri në datën 04.06.2023 nuk ka pasur asnjë masë disiplinore. Me Vendimin Nr. 219, dt. 05.06.2023, të zv/drejtorit të përgjithshëm Redi Neziri, i është dhënë masë disiplinore J. K., me detyrë specialiste në sektorin e akademisë, në drejtorinë e burimeve njerëzore me motivimin: “Tërheqje vëmendje me shkrim” për thyerje të etikës në punë pasi në datë 22 maj 2023 në zyrën e sektorit të Akademisë ka përdorur gjuhë jo të përshtatshme ndaj eprorëve, tone të larta të zërit në komunikim, për mosbindje të urdhrave të eprorëve si dhe për tejkallim kompetencash në komunikim, gjë e cila bie ndesh me rregulloren e Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm. Nga auditimi u konstatua se kjo masë disiplinore nuk është e mbështetur në fakte dhe prova për mos zbatimin e kodit të etikës ndaj përgjegjësit të sektorit të burimeve njerëzore.
Kriteri:	-Vendimi i këshillit drejtues nr. 32, datë 11.09.2018 për rregulloren e burimeve njerëzore dhe rregulloren e kabinetit. -Ligji Nr. 7961, dt. 12.07.1995, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar Neni 9, 32, 37, 38. - Ligji 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të RTSH-së”, Neni 4, 5, 13, 14, 15,16, 17, 42, 45, 48, 69, 80,81,100. -Ligji nr .9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve Publike”, ndryshuar, Neni 37

	pika 1 “Vetë përjashtim nga vendimmarrja dhe” pika 2.” Moslejimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje”.
Ndikimi/Efekti:	Cënim i dinjitetit dhe personalitetit të punëmarrësit.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E mesme

2.5. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Auditimi u ushtrua me zgjedhje⁷, konkretisht u audituan:

- Urdhër transertat (Shpenzimet me anë të bankës), për muajin dhjetor 2022, janar- 30 qershor 2023. Për muajin dhjetor 2022 transaksione gjithsej 392 me vlerë 267,886 mijë lekë. Për periudhën janar-qershor 2023 transaksione gjithsej 1818 me vlerë 1,363,576 mijë lekë.

Në mënyrë të detajuar: Për muajin janar 2023, transaksione 453 me vlerë 237,908 mijë lekë, për muajin shkurt 2023 transaksione 381 me vlerë 314,597 mijë lekë, për muajin mars 2023 transaksione 323 me vlerë 214,565 mijë lekë, për muajin prill 2023 transaksione 312 me vlerë 193,639 mijë lekë, për muajin maj 2023 transaksione 270 me vlerë 213,908 mijë lekë, për muajin qershor 2023 transaksione 79 me vlerë 188,959 mijë lekë.

-Shpenzimet me anë të arkës për muajin janar 2022 dhe shkurt 2022

Për këtë periudhë janë kryer 19 mandat pagesa me vlerë 2865 mijë lekë. Konkretisht për muajin janar 2022, mandat pagesa 7 me vlerë 929 mijë lekë, për muajin shkurt 2022 janë kryer 12 mandat pagesa me vlerë 1,936 mijë lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se transaksionet janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit 83/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.

Veprimet financiare janë regjistruar në regjistrat e kontabilitetit, bazuar në dokumente vërtetues. Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Me pagesë cek personal, nga U. B., është tërhequr vlera 4,000 euro. Ky dokument është firmosur nga B. A., dhe nga banka datë 7 janar 2022. Për këtë çek është prerë mandat arkëtimi pa numër, datë 07.01.2022 i firmosur nga financieri V. L., dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

Me pagesë cek personal, nga U. B., është tërhequr vlera 3,000 euro. Ky dokument është firmosur nga B. A., dhe nga banka datë 14 janar 2022. Për këtë çek është prerë mandat arkëtimi pa numër, datë 14.01.2022 i firmosur nga financieri V. L. dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

⁷ *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampinonët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”.

Me tërheqje me çekë me nr. serie 601919 nga R. B., është tërhequr vlera 1,650 euro. Ky dokument është firmosur nga B. A., dhe nga banka datë 21 janar 2022. Për këtë çek është prerë mandatarëkëtimi pa numër, datë 21.01.2022 i firmosur nga financieri V. L. dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

Me tërheqje me çek me nr. serie 601920 nga R. B., është tërhequr vlera 1,500 euro. Ky dokument është firmosur nga B. A. dhe nga banka datë 21 janar 2022. Për këtë çek është prerë mandat arkëtimi pa numër, datë 21.01.2022 i firmosur nga financieri V. L. dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

Me tërheqje me çek me nr. serie 601923 nga R. B., është tërhequr vlera 2,500 euro. Ky dokument është firmosur nga B. A., dhe nga banka datë 21 janar 2022. Për këtë çek është prerë mandat arkëtimi pa numër, datë 21.01.2022 i firmosur nga financieri V. L., dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

Me tërheqje me çekë me nr. serie 601919 nga R. B., është tërhequr vlera 2,200 euro. Ky dokument është firmosur nga B. A., dhe nga banka datë 19 janar 2022. Për këtë çek është prerë mandat arkëtimi pa numër, datë 21.01.2022 i firmosur nga financieri V. L., dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

Me tërheqje me çek me nr. serie 601919 nga R. B., është tërhequr vlera 3,000 euro. Ky dokument është firmosur nga B. A., dhe nga banka datë 19 janar 2022. Për këtë çek është prerë mandat arkëtimi pa numër, datë 16.02.2022 për vlerën 3,000 euro i firmosur nga financieri V. L., dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

Me tërheqje me çekë me nr. serie 601922 nga R. B., është tërhequr vlera 5,000 USD. Ky dokument është firmosur nga B. A. dhe nga banka datë 11 shkurt 2022. Për këtë çek është prerë mandat arkëtimi pa numër, datë 11.02.2022 për vlerën 5,000 USD i firmosur nga financieri V. L. dhe drejtori ekonomik E. K., nuk është firmosur nga arkëtari, dhe dorëzuesi B. A., pasi në organikën e RTSH nuk ka arkëtar.

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa, pa numër, datë 10.01.2022 për vlerën 2,850 euro, për pagesë M. M., gazetar i RTSH, por mandat pagesa nuk është firmosur nga marrësi i kësaj shume, si dhe nga arkëtari. Dokument vërtetues për këtë mandat pagesë: Vendimi nr. 122, datë 30.12.2021 i zv/drejtor i përgjithshëm M. L. dhe E. M.. Shkresa e Kuvendit të Shqipërisë nr. 33343 prot., datë 30.12.2021, firmosur nga sekretari i përgjithshëm G. Gj..

Urdhër shërbimi i firmosur nga M. M., për vlerën 950 euro, V. L. dhe zv/drejtori i përgjithshëm M. L., bileta e hotelit(5 ditë x 40 euro/ditë = 200 euro, plus 750 euro (5 x 150 euro/ditë hotel), urdhër shërbimi i firmosur nga E. V., për vlerën 950 euro, V. L. dhe zv/drejtori i përgjithshëm M. L., bileta e hotelit(5 ditë x 40 euro/ditë = 200 euro, plus 750 euro (5 x 150 euro/ditë hotel), urdhër shërbimi i firmosur nga H. M., për vlerën 950 euro, V. L., dhe zv/drejtori i përgjithshëm M. L., bileta e hotelit (5 ditë x 40 euro/ditë = 200 euro, plus 750 euro (5 x 150 euro/ditë hotel).

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, nga punonjësit M. M., E. V. dhe H. M., Mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7 dhe Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....Nëpunësi i ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit financiar të njësisë nuk duhet të ngarkohet me detyrën e arkëtarit dhe/ose të magazinierit”.

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa, pa numër, pa numër serie, datë 10.02.2002 për vlerën 2,500 euro, për pagesë D. Sh., gazetar i RTSH, mandat pagesa e firmosur nga marrësi i kësaj shume D. SH., por jo nga punonjësi tjetër që është në urdhër shërbim E. K. dhe nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar. Dokument vërtetues për këtë mandat pagesë: Vendimi nr. 2, datë 10.12.2021 i drejtorit të përgjithshëm E. J.. Shkresa e Njesisë së emisioneve tematike dhe lajmeve nr. 76 prot., datë 09.02.2022. Shkresa e Kryeministrisë nr. 691 prot., datë 03.02.2022. Urdhër shërbimi për D. SH., dhe E. K.. Urdhër shërbimet janë firmosur nga D. SH., E. K., B. Z. dhe V. L.. Urdhërshërbimet nuk janë firmosur nga nëpunësi zbatues, por nga V. L., në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 1, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, paragrafi i fundit, Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, arkëtari, E. K., mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15.

Për sa konstatuar si më lart grupi i auditimit kërkoj sqarim nga D. SH. dhe E. K., në lidhje me marrjen dhe dhënien e shumës respektive ndërmjet njëri tjetrit, të cilët deklaruan me gojë dhe me shkrim datë 20.10.2023 se D. SH., i ka dhënë 1,417 euro E. K., dhe E. K., ka marr 1417 euro nga D. SH.. Deklaratat do të jenë pjesë e dosjes së auditimit.

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa me nr. 25, datë 17.02.2002 me nr. serie 0000571 për vlerën 5000 USD, për pagesë D. SH., gazetar i RTSH-së, E. K., me detyrë operator në RTSH, mandat pagesa e firmosur nga marrësi i kësaj shume D. SH. dhe E. K., por jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar. Dokument vërtetues për këtë mandat pagesë: Vendimi nr. 2, datë 10.12.2021 i drejtorit të përgjithshëm E.J.. Shkresa e Njesisë së emisioneve tematike dhe lajmeve nr. 76 prot., datë 09.02.2022. Shkresa e Kryeministrisë nr. 691 prot., datë 03.02.2022. Urdhër shërbimi për D. SH., dhe E. K.. Urdhër shërbimet janë firmosur nga D. SH., E. K., B. Z. dhe V. L..

Urdhër shërbimet nuk janë firmosur nga nëpunësi zbatues por nga V. L..

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit dhe arkëtari, në urdhër shërbim nëpunësi zbatues cilësohet V. L.. Mandat pagesa nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 1, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, paragrafi i fundit.

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa, pa numër, datë 15.02.2002 për vlerën 4,150 euro, për pagesë A. Ç., me detyrë shofer gazetar i RTSH, por mandat pagesa nuk është firmosur nga marrësi i kësaj shume, si dhe nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar. Dokument vërtetues për këtë mandat pagesë: Vendimi nr. 125, datë 30.12.2021 i zv/drejtorit të përgjithshëm M. L., dhe E. M.. Shkresa për Institucionit të Presidentit të Republikës nr. 2721 31.12.2021 prot., firmosur nga sekretari i përgjithshëm O. Z., urdhër shërbimi i firmosur nga A. Ç., për vlerën 2,095 euro nga këto: Dietë 7 ditë x 40 euro/dita = 280 euro, 6 ditë = 1815 hotel= 302 euro për nate hoteli dhe G. Gj., për vlerën 2,095 euro, Dietë 7 ditë x 40 euro/dita =

280 euro, 6 ditë = 1,815 hotel= 302 euro për nate hoteli. Urdhër shërbimi firmosur nga V. L. dhe zv/drejtori i përgjithshëm M. L..

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor. Mandat pagesa nuk është regjistruar në librin e arkës.

Urdhër shërbimet si më sipër janë në kundërshtim me formatin standart të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “ Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nuk akt ë përcaktuar :

-Nr. _____ Protokoll Data _____/_____/ dhe përshkrimin

-urdhër – shërbimi – per jashtë vendit

-pjesën për shkrimore: Në zbatim të VKM nr. nr.870, datë 14.02.2011 të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, dhe Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013, te Ministrit te Financave, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 te Këshillit te Ministrave “Për trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe, mbështetur ne autorizimin nr. _____ Datë, _____ Z/Znj. _____, specialist/drejtor/titullar _____ i

drejtorisë/institucionit _____, do te përfaqësojë Ministrinë/institucionin _____ (ose) do te marrë pjese si përfaqësues ne aktivitetin/konferencën/takimin _____, me teme _____ qe do te organizohet ne shtetin _____ për _

- II – Paradhënie

Për të kthyer kur I – II = (-)

Për të marrë kur I – II = (+)

-Nuk janë përcaktuar ora e nisjes dhe e kthimit në kundërshtim me pikën 6 të këtij udhëzimi.

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa nr. datë 21.01.2022, pa nr. serie për vlerën 1,650 euro, për pagesë G. Gj., me detyrë operator, mandat pagesa e firmosur nga G. Gj., dhe jo nga B. C., me detyrë gazetare e RTSH dhe A. C., me detyrë shofer, si dhe jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar. Dokument vërtetues për këtë mandat pagesë: Shkresa e Institucionit të Presidentit të Republikës nr. 50 prot., datë 06.01.2022. Propozim me nr. 35/1 prot., datë 07.01.2022 për nisjen e grupit të xhirimit nga B. Z., me detyrë drejtues i njësisë së emisioneve tematike dhe lajmeve, drejtuar E. J., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm. Urdhër shërbimet G. Gj., A. C. dhe B. C., për vlerat respektive 520 euro, 611 dhe 520 të firmosura nga G. Gj., A. C., B. C., B. Z., V. L. dhe E. J..

Urdhër shërbimet nuk janë firmosur nga nëpunësi zbatues por nga V. L., në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 1 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “ Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, paragrafi i fundit,

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit dhe arkëtari, në urdhër shërbim nëpunësi zbatues cilësohet V. L.. Mandat pagesa nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprime në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7.

- Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” , pika 15.

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Nga V. L., është prerë mandat pagesa pa numër datë 19.01.2022 pa nr. serie për vlerën 2,080 euro, për pagesë F. R., solist dhe dirigjent i huaj dhe mandat pagesa e firmosur nga marrësi i kësaj shume por jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar. Dokument vërtetues për këtë mandat pagesë: Shkresa E. K., me detyrë drejtor ekonomik nr. 288 prot., datë 19.01.2022 drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, kërkesë për kryerjen e pagesave të orkestrës simfonike të RTSH datë 19.01.2022. Drejtori i përgjithshëm nuk ka nënshkruar autorizimin/vendimmarrjen për kërkesën e bërë, por tek shkresa e udhëheqësit artistik A.P., nr. 150, datë 10.01.2022 për propozim për preventivin e koncertit të datës 19.01.2022 të orkestrës simfonike, ka vënë shënimin “Për vlerësim të drejtorisë ekonomike dhe drejtorisë së marketingut, kontrata datë 19.01.2022 me nr. 275 protokoli, e nënshkruar nga F. R. dhe E. J., për vlerën 250,000 lekë. Në këtë kontratë nuk është përcaktuar në asnjë nen të saj që RTSH do ti paguaj biletën e avionit për 323 euro, as dhe shpenzime të tjera, si shpenzime hotelerie, siguracioni etj.

Biletat e avionit Lufthansa, ardhë në Shqipëri 15 janar 2022 larguar nga Shqipëria më datën 20 janar 2022, për vlerën 323 euro, listë pagesa e honorarëve për vlerën 250,000 lekë, bruto dhe neto 212,500 lekë, e firmosur nga ekonomiste A. P., V. L., me detyrë përgjegjëse e financës dhe E. P., me detyrë drejtore ekonomike.

Nuk ka situacion ose një dokument të barasvlershëm me të për realizimin e koncertit të orkestrës simfonike të RTSH më datën 19.01.2022.

Mos nënshkrimi i autorizimit/vendimmarrjes nga drejtori i përgjithshëm për kërkesën e bërë për këtë shpenzim bie ndesh me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2 dhe 8, , Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2 Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35.

Vlera 323 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet në zbatim të Neni 32, të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”. Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, arkëtari, mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35 ,pika 15.

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër datë 04.02.2022, pa nr. serie për vlerën 1,040 euro, për pagesë C. G., shtetas nga Franca, mandat pagesa e firmosur me firmë të mbyllur në këtë mënyrë pa dalluar saktësisht se kush është marrësi i parave. Urdhër shërbimet për jashtë vendit për llogari të C., firmosur me firmë të mbyllur, i pa dallueshëm se kush ka udhëtuar, A. P., dhe V. L., për vlerën 445 euro, e detajuar shpenzime biletë udhëtimi 354 euro, taksi 11 euro dhe 80 euro udhëtim dhe dieta (2 x 40 euro/ditë).

Për vlerën 595 euro, listë pagesa e honorarëve e firmosur nga ekonomiste A. P., V. L., me detyrë përgjegjëse e financës dhe E. P., me detyrë drejtore ekonomike. Kontrata nr. 532 prot., datë 04.02.2022 e lidhur ndërmjet C. G. dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, për vlerën 700 euro.

Shkresa e A. P., në cilësinë e udhëheqësit artistik nr.468 prot., datë 02.02.2022 drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, shkresa e udhëheqësit artistik A. P., 468 prot., datë 02.02.2022, drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, preventiv për koncertin e Kameratës të orkestrës simfonike datë 05.02.2022, shkresë në të cilën është vënë shënim nga drejtori i përgjithshëm OK. (Drejtoria ekonomike dhe sektori i projekteve). Në kontratë nuk është përcaktuar në asnjë

nen të saj që RTSH do ti paguaj biletën e avionit për 354 euro, shpenzime transporti/bileta udhëtimi brenda Shqipërisë 11 euro dhe shpenzime diete 80 euro (2 ditë x 40 euro/dita = 80 euro).

Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit. Nuk ka situacion ose një dokument të barasvlershëm me të për realizimin e koncertit të orkestrës simfonike të RTSH më datën 05.02.2022.

Vlera 455 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit. Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit dhe arkëtari. Mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor. Mandat pagesa nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprime në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Ligjin nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2, Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 15. ***Vlera 445 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet .***

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër, datë 16.02.2022 pa nr. serie për vlerën 1,539 euro, për pagesë P. F., shtetas Francez, mandat pagesa e firmosur nga ky shtetas, jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.

Urdhër shërbimet për jashtë vendit për llogari të P. F., firmosur nga A. P. dhe V. L., për vlerën 1,539 euro, e detajuar shpenzime biletë udhëtimi 359 euro, 160 udhëtim dhe dieta (4x 40 euro/ditë, si dhe 1,020 euro honorar).

Për vlerën 1,020 euro, listë pagesa e honorarëve e firmosur nga ekonomiste A. P., V. L., me detyrë përgjegjëse e financës dhe E. P., me detyrë drejtore ekonomike. Kontrata nr. 687 prot., datë 16.02.2022 e lidhur ndërmjet P. F., dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, për vlerën 1,020 euro.

Shkresa e A. P., në cilësinë e udhëheqësit artistik nr. 665 prot., datë 16.02.2022 drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, shkresa e udhëheqësit artistik A. P., nr.665 prot., datë 16.02.2022, drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, preventiv për koncertin e orkestrës simfonike datë 16.02.2022, shkresë në të cilën është vënë shënimi nga drejtori i përgjithshëm “OK” (Drejtorja ekonomike dhe sektori i projekteve). Në kontratë nuk është përcaktuar në asnjë nen të saj që RTSH do ti paguaj biletën e avionit për 359 euro, dhe udhëtim dhe dieta 160 euro (4 ditë x 40 euro/dita = 160 euro).

Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.

Vlera 519 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit”.

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, nga arkëtari, është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Ligjin nr. 57/2016

për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 15.

Vlera 519 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet..

Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër, datë 16.02.2022 pa nr. serie për vlerën 1,114 euro, për pagesë N. B., shtetas Francez, mandat pagesa e firmosur me firmë të mbyllur, për pasojë nuk mund të provohet saktësisht se kush është marrësi i parave, nuk është firmosur nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.

Urdhër shërbimet për jashtë vendit për llogari të N. B., firmosur me firmë të mbyllur, për pasojë nuk mund të provohet saktësisht se kush ka udhëtuar, firmosur nga A. P. dhe V. L., për vlerën 1,114 euro, e detajuar shpenzime biletë udhëtimi 359 euro, udhëtim, dieta 160 (4 x 40 euro/ditë dhe 595 euro honorar.

Për vlerën 595 euro, listë pagesa e honorarëve firmosur nga ekonomiste A. P., V. L., me detyrë përgjegjëse e financës dhe E. P., me detyrë drejtore ekonomike. Kontrata nr. 688 prot., datë 16.02.2022 e lidhur ndërmjet N. B. dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, për vlerën 700 euro.

Shkresa e A. P., në cilësinë e udhëheqësit artistik nr.468 prot., datë 02.02.2022 drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, shkresa e udhëheqësit artistik A. P.,655 prot., datë 16.02.2022, drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, preventiv për koncertin e orkestrës simfonike datë 16.02.2022, shkresë në të cilën është vënë shënimi nga drejtori i përgjithshëm “OK” (Drejtoria ekonomike dhe sektori i projekteve). Në kontratë nuk është përcaktuar në asnjë nen të saj që RTSH do ti paguaj biletën e avionit për 359 euro, e shpenzime udhëtim dhe dietë 160 euro (4 ditë x 40 euro/dita = 160 euro).

Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.

Nuk ka situacion ose një dokument të barasvlershëm me të për realizimin e koncertit të orkestrës simfonike të RTSH më datën 19.01.2022.

Vlera 519 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Mandatpagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, arkëtari, mandatpagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Ligjin nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit

publik” pika 35, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7.

Koment i grupi të auditimit

Dokumentet e arkës dhe rregullat e hartimit të tyre.

Mandat arkëtimi, është dokument që vërteton hyrjen e mjeteve monetare në arkë. Ky dokument pritët nga arkëtari kundrejt një dokumenti (origjinë) të mjeteve monetare që futet në arkë. Dokumenti i origjinës mund të jetë çek-për tërheqjet nga banka, derdhjet nga grandet, derdhjet për të shlyer një detyrim, derdhjet për të paguar faturën e mallit, produktit të gatshëm, shërbimit të kryer, etj. Mandat arkëtimi është dokument justifikues dhe të tillë e bënë nënshkrimi i arkëtarit, i cili duke u nënshkruar vërteton se ka marr në dorëzim shumën e shënuar në dokument. Mandat arkëtimi përgatitet në tre kopje. Një kopje e mbanë arkëtari për të vërtetuar veprimin e kryes, një kopje i jepet personit që ka dorëzuar paratë në arkë dhe kopja tjetër i dorëzohet kontabilistit (shefit të financës-kontabilitetit) për të bërë veprimet e regjistrimit në kompjuter.

Mandat arkëtimi përshkruan “Institucioni, arka nr.1, lekë, ose valutë

Nr. i llogarisë. Nr. Dhe data nr. i serisë.

Përshkrimi i veprimit “Arkëtoni nga ____, shuma lekë ____

Firmat: Financieri; arkëtari.

Mandat pagesa, është dokument, që vërteton daljen e parave nga arka. Ky dokument pritët nga arkëtari, kundrejt një dokumenti urdhërues nga ana e drejtuesit të institucionit (ose i ngarkuari i tij), siç mund të jenë: urdhri për pagesën e faturës së furnitorit etj. Mandat pagesa së pari, është një dokument autorizues. Nënshkrimi i drejtuesit të institucionit buxhetor/ Nëpunësi Autorizues, shërben për të autorizuar arkëtarin të kryej një pagesë të caktuar. Nëpunësi Autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhërues të nënshkruar prej tij. Së dyti, ai është dokument justifikues. Të tillë e bënë nënshkrimi i arkëtarit dhe nënshkrimi i personit që ka marr paratë në dorëzim prej tij. Mandat pagesat duhet të shoqërohen me dokumentacion për natyrën e shpenzimit të kryer.

Mandat pagesa përpilohet në tre kopje. Një kopje e mban arkëtari, një kopje i jepet personit që ka marr paratë dhe një kopje i dorëzohet kontabilistit (shefit të financës-kontabilitetit) të institucionit, për të bërë veprimet e regjistrimit në kompjuter.

Mandat pagesa përshkruan “Institucioni, arka nr.1, lekë, ose valutë

Nr. I llogarisë. Nr. __Dhe data__ nr. i serisë.

Përshkrimi i veprimit “Paguani _____ shuma lekë ____

Firmat: Financieri; drejtuesi i Institucionit, arkëtari-marrësi.

Të dhënat e mandat arkëtimeve dhe mandat pagesave regjistrohen në librin e arkës. Ky libër është i detyrueshëm të mbahet nga arkëtari. Në librin e arkës, arkëtari regjistron çdo ditë të gjitha mandat arkëtimet dhe mandat pagesat që përpilon gjatë ditës, duke shënuar numrin, datën dhe shumën. Në fund të çdo dite pune arkëtari përcakton tepricën e librit të arkës dhe inventarizon mjetet monetare që ndodhen në arkë. Teprica e librit të arkës duhet të përputhet me gjendjen e mjeteve monetare në arkë të rezultuar nga inventarizimi. Dorëzimi i dokumenteve të arkës (mandatarkëtimi dhe mandat pagesa) bëhet nga arkëtari si rregull, çdo ditë, bashkë me një kopje të librit të arkës. Kontabilisti (shefi financë-kontabilitetit) firmos kopjen e librit të arkës që mbetet në bllokun e arkëtarit, për marrjen në dorëzim të dokumenteve.

Pasi priten mandatpagesa dhe mandat arkëtimi, kryhet regjistrimi në kontabilitet.

Për shkëljen e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër ngarkohen me përgjegjësi M. L., me detyrë ish-zv/drejtori i përgjithshëm, E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm, E. P., me detyrë

ish-drejtores ekonomike, Erjon Dylgeri me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike, V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit.

- Marrje me qira Studio televizive lëvizëse transmetuese OB Van Broadcast –Regjia HD (në vijim regjia HD)

a. Me urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2023 nëpërmjet R. B., është likuiduar shoqëria “N. P.” sh.p.k në vlerën 2,400,000 lekë”. Dokument vërtetues: Fatura nr. 67/2022 datë 27.12.2023 për vlerën 2,400,000 lekë. Kontrata nr. 1465/117 port., datë 16.12.2023 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “N. P.” shpk për vlerën 2,400,000 lekë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë zv/drejtorit të përgjithshëm dhe për “N. P.” shpk nga N. Gj., me afat 16 dhjetor deri 22 dhjetor 2022. Proces verbal për marrjen e shërbimit me nr. 1465/130 prot, datë 23.12.2022 , të firmosur nga A. M., njësia teknike, B. K., teknik mix figure dhe A. E., teknik figure.

Objekti i kontratës: Shoqëria i jep RTSH me gëzim të përkohshëm kundrejt shpërblimit të përcaktuar në Nenin 4 të kontratës (në vijim shpërblimi) mjetin televizivë të llojit “Studio televizive lëvizëse transmetuese OB Van Broadcast –Regjia HD (në vijim regjia HD) së bashku me pajisjet teknike dhe televizive (në vijim pajisjet) të përcaktuara në aneksin A. Regjia HD së bashku me pajisjet do të përdoret nga RTSH për të kryer regjistrimin audioviziv të festivalit përmes video kamerave dhe për të realizuar prodhimin e sinjalit audioviziv përfundimtar për komunikimin në publik me anë të transmetimit në mënyrë të drejtpërdrejtë në formatin HD (High definition) të festivalit në kanalet televizive të platformës transmetuese të RTSH, si dhe në platformat e tjera transmetuese, ku përcillet sinjali televiziv i kanaleve televizive të platformës transmetuese të RTSH.

Në aneksin A “Pajisjet” janë përcaktuar “

-OB VAN Broadcast (studio lëvizëse e pajisur me transmetues).

-10 kamera broadcast grass valley LDX x 80 me gjithë llojet e objektivave.

-4 objektiva Box Canon me stabilizator 1 x 86, 2x 72, 1x 55.

-1 pajisje broadcast e kontrollit të cilësisë së vidio dhe audio.

6 aux feed

-playot.

Në procesverbalin për marrjen e shërbimit me nr. 1465/130 prot., datë 23.12.2022 është shprehur “Pajisjet e mësipërme pasi u testuan, rezultojë se ishin teknikisht në rregull. Gjatë zhvillimit të festivalit në datat 19-22 dhjetor, u konstatua se këto pajisje funksionuan teknikisht në mënyrë optimale, konformë kontratës.

Referuar Nenit 1 të kontratës, RTSH është realizuese dhe prodhuese e festivalit të 61 të këngës në RTSH, që zhvillohet në data 19 dhjetor 2022 nata e parë, 20 dhjetor 2022 nata e dytë, 21 dhjetor 2022 nata e tretë dhe 22 dhjetor 2022 nata finale. Pra gjithsej 4 net.

Për 4 netë RTSH ka shpenzuar për marrjen me qira 2,400,000 lekë ose 600,000 lekë/natë.

Vlera 2,400,000 lekë është zë i preventivit të festivalit të 61 të këngës në RTSH, i miratuar me vendim të këshillit drejtues dhe të bordit të administrimit edhe pse në inventarin e RTSH ka dy mjet televizivë të llojit “Studio televizive lëvizëse transmetuese me vlerë kontabël 93,180,371 lekë.

Vlera 2,400,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Veprim në kundërshtim me :

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

Shkelja e dispozitave ligjore si më sipër ngarkon me përgjegjësi E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm, E. D., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike për periudhën 21.02.2022 deri më 04.07.2023, D. D., me detyrë ish-drejtor i drejtorisë juridike për periudhën 26.01.2022 deri më 03.07.2023.

-Urdhër transfertë pa nr, datë 12.12.2023 nëpërmjet R. B., është likuiduar shoqëria “P.” Sh.p.k në vlerën 2,033,208 lekë për emisionin “Ti duhet ta dish”. Dokument vërtetues: -Fatura nr. 830/2022 datë 30.11.2023 për vlerën 2,033,208 lekë.

-Kontrata nr. 3254/19 port., datë 17.10.2022 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “P.” Sh.p.k për vlerën 1,682,208 lekë me TVSH e firmosur për RTSH nga E. J., në cilësinë drejtorit të përgjithshëm dhe për “P” shpk nga A. E., me afat 1 muaj nga nënshkrimi i saj. Amenduar me nr. 3254/47 port., datë 15.11.2022 me zgjatje afati deri 30.11.2022 duke shtuar dhe vlerën nga 1,694,340 lekë në 2,033,208 lekë me një diferencë në vlerën 338,868 lekë, (nga 17.11.2022 zgjatet 30.11.2022).

-Shkresë përcjellëse nr. 3254/67 prot., datë 15.12.2022 hartuar nga E. S., me detyrë ish-përgjegjëse e sektorit të studiove, mbi procesverbalin e marrjes në dorëzim të pajisjeve me qira, firmosur nga . S. dhe K. M., kryetëknik, M. K., me detyrë specialist ekonomist. Në këtë proces verbal pasqyrohen pajisjet si më poshtë: Nriçues profile led copë 14; ndriçues led RGBV me zom copë 9, ndriçues të lëvizshëm led spot copë 10, ndriçues të lëvizshëm leg wash copë 10, ndriçues efekti televiziv 2 modele copë 10, pajisje komandimi ndriçimi copë 1, filtra të ndryshëm për ndriçuesit, frost, minus green, cosmetic nga 1 set copë 2, artnet node copë 1, splitera ndriçimi copë 2, ledëall m² 17.

Nuk ka asnjë dokumentacion përsa sa i përket:

A ka në inventar RTSH aparaturat e përdorura, si është përcaktuar çmimi, kush është personi përgjegjës që e ka përcaktuar, referenca, ku është personi që e ka miratuar. Pse i njëjti operator ekonomik etj. Nuk ka vendim të bordit artistik për këtë emision.

Vlera 2,033,208 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet.

Urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2022 nëpërmjet R. B., është likuiduar shoqëria “P” shpk në vlerën 72,000 lekë për koncertit 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokse më datë 09.11.2022. Dokument vërtetues: -Fatura nr. 783/2022 datë 10.11.2022 për vlerën 72,000 lekë. Shkresë përcjellëse nr. 4174/20 prot., datë 28.12.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., për likuidim aparaturash të koncertit 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokse më datë 09.11.2022.

Urdhër transfertë pa nr, datë 22.12.2022 nëpërmjet R. B., është likuiduar shoqëria “P” shpk në vlerën 72,000 lekë për koncertin datë 13.10.2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin e Operës dhe të Baletit më datë 13.10.2022. Dokument vërtetues:

-Fatura nr. 724/2022 datë 14.10.2022 për vlerën 72,000 lekë. Shkresë përcjellëse nr. 4174/20 prot, datë 28.12.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., për likuidim aparaturash të koncertit 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin e Operës dhe të Baletit më datë 13.10.2022. Shkresë përcjellëse nr. 3520/11 prot., datë 04.11.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z..

Me urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2022 nëpërmjet R. B., është likuiduar shoqëria “P” shpk në vlerën 102,000 lekë për koncertin e datës 1 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin Petro Marko më datë 01.11.2022. Dokument vërtetues:

-Fatura nr. 758/2022 datë 03.11.2022 për vlerën 102,000 lekë. Shkresë përcjellëse nr. 4174/20 prot, datë 28.12.2022 hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., për likuidim aparaturash të koncertit 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin Petro Marko të qytetit të Vlorës.

Për 3 koncerte datë 13.10.2022, 01.11.2022 dhe 9.11.2022, RTSH ka paguar vlerën 246,000 lekë për likuidim aparaturash.

Në të tre shkresat përcjellëse nuk ka të argumentuar pse kjo orkestër ka marr me qira aparatura, çfarë aparaturash janë, a ka në inventar RTSH aparaturat e përdorura, si është përcaktuar çmimi, kush është personi përgjegjës që e ka përcaktuar referenca, ku është personi që e ka miratuar. Pse i njëjti operator ekonomik etj.

Si konkluzion i këtyre likuidimeve “Orkestra Simfonike e RTSH nuk ka qenë në gjendje për vitin 2022 të jepte tre koncerte, edhe pse në stafin e saj ka 62 persona me një pagesë mujore 5,109,814 lekë dhe vjetore 61,317,769 lekë, por duhet të merrte me qira aparatura për vlerën 246,000 lekë.

Vlera 246,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet

Me urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2022 nëpërmjet R. B., është likuiduar shoqëria “A.” Sh.p.k në vlerën 345,000 lekë. Dokument vërtetues:

Fatura nr. 22/2022 datë 09.12.2022 për vlerën 345,000 lekë, me objekt “Faturim i dërgesave të mallrave dhe shërbimeve bazuar në një kontratë. Kontrata pa numër protokolli, datë 17.11.2022 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “AA” shpk për vlerën 2,070,000 lekë, ose 345,000 lekë në muaj, e firmosur për RTSH nga E. J., në cilësinë drejtorit të përgjithshëm dhe për “A.” shpk nga A. K., me afat 01.12.2022-31.05.2023. Në kontratë është përcaktuar; Ambient me sipërfaqe 1234 m² nga këto: Atelie kati i dytë me sipërfaqe 1034 m²; Salla e komandimit me sipërfaqe 80 m²; Ambiente ndihmëse për stafin me sipërfaqe 80 m².

Kjo kontratë nuk ka bashkëlidhur certifikata e pronësisë dhe hartën treguese/ose plan vendosjen, për të verifikuar pronësinë dhe sipërfaqen.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, por i kanë keq menaxhuar ato duke mos arritur qëllimin e tyre, veprim në kundërshtim me :

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52”

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

Për mos maksimizim dhe eficientësi dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, ngarkohen me përgjegjësi E. J., me detyrë drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

-Harxhim karburanti për automjete e përdorura nga drejtuesit e RTSH, pa fletë udhëtimi.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, për periudhën 01.01.2022-30.06.2023 nuk vërtetohet plotësisht kryerja e shpenzimeve për karburantin, për automjetin me targë “AA...TN” dhe “AA... BK”, për sasinë 2805 litra me **vlerë 553,895 lekë.**

Automjeti me targë “AA...TN”

Me shkresën nr. 1846/1 prot., datë 01.01.2022 E. J., i është drejtuar drejtorisë së administratës dhe kryetarit të këshillit drejtues, duke bërë me dije se automjeti me targë AA...TN do të përdoret nga kryetari i këshillit drejtues: Referenca ligjore në këtë shkresë është VKM nr. 98/2016 “Për miratimin e Statutit të RTSH”.

Referuar autorizimit për tërheqje karburanti i firmosur nga E. P., me detyrë drejtor i shërbimeve mbështetëse dhe firmosjes fletëdaljeve të karburantit nga magazina, kjo makinë është përdorur nga drejtuesi i mjetit J. T..

Për periudhën 01.01.2022-30.06.2023 ky automjet ka harxhuar 1850 litra naftë për vlerën 363,840 lekë. Konkretisht 01.01.2022-31.12.2022; në sasinë 850 litra në vlerën 165,990 lekë, ndërsa për 01.01.2023-30.06.2023; në sasinë 1000 litra naftë për vlerën 197,850 lekë.

Për harxhimin e kësaj sasive karburanti nuk ka fletë udhëtimi si dokumentacionit justifikues bazë, për pasojë nuk ka rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr.

-Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8/1; Ligjin Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6, 7 dhe 8; Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si mësipër, ngarkon me përgjegjësi E. P., me detyrë ish-drejtor i shërbimeve mbështetëse dhe J. T., me detyrë drejtues i mjetit.

Automjeti me targë AA...BK.

Referuar autorizimit për tërheqje karburanti i firmosur nga E. P., me detyrë ish-drejtor i shërbimeve mbështetëse dhe firmosjes së fletëdaljeve të karburantit nga magazina të drejtuesit të mjetit S. M..

Për periudhën 01.01.2022-30.06.2023 ky automjet ka harxhuar 955 litra naftë për vlerën 190,055 lekë. Konkretisht 01.01.2022-31.12.2022; në sasinë 505 litra në vlerën 103,955 lekë, ndërsa për 01.01.2023-30.06.2023; në sasinë 450 litra naftë për vlerën 86,100 lekë.

Ky automjet nuk është drejtuar nga drejtuesit i mjetit S. M., që është autorizuar nga E. P., me detyrë drejtor i shërbimeve mbështetëse për tërheqje karburanti/naftë nga magazina për automjetin me targë AA...BK, por nga R. N., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm.

Ky fakt është i provuar me deklaratën e datës 26.09.2023 lëshuar nga S. M., i cili është i punësuar shofer në RTSH dhe ka në përdorim mjet tjetër.

Për harxhimin e kësaj sasive karburanti nuk ka fletë udhëtimi si dokumentacion justifikues bazë, për pasojë nuk ka rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr.

-Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8/1; Ligjin Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6, 7 dhe 8; Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si mësipër, ngarkon me përgjegjësi E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm, R. N., me detyrë ish-zv/drejtor i përgjithshëm, E. P., me detyrë ish-drejtor i shërbimeve mbështetëse dhe S. M., me detyrë drejtues i mjetit.

-Keq menaxhim i fondeve te RTSH për bërjen e emisioneve televizive.

Për vitin 2022 RTSH ka zhvilluar 17 emisione janë angazhuar 56 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 15,187,939 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 14,754,400 lekë, totali 29,942,339 lekë.

Konkretisht

- Për emisionin “Mirëmëngjesi Shqipëri,” për 6 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 2,549,182 dhe 2,048,100 lekë, totali 4,595,282 lekë.

- Për emisionin “Flasim për Ekonominë”, për 2 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 132,800 lekë dhe 140,000 lekë, totali 272,800 lekë.

-Për emisionin “Si në Familje”, për 3 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 612,800 dhe 314,500 lekë për honorarë, totali 927,300 lekë.

-Për emisionin “Shëndetësi”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga në vlerën 240,000 dhe për honorarë 295,000 lekë, totali 535,000 lekë.

-Për emisionin “Bibliotekë”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 600,000 dhe për honorarë 1,107,000 lekë, totali 1,707,000 lekë

-Për emisionin “You should Know”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 180,000 dhe për honorarë 120,000 lekë, totali 300,000 lekë.

-Për emisionin “Intervista”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 416,000 dhe për honorarë 320,000 lekë, totali 736,000 lekë.

-Për emisionin “Publikisht”, për 11 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 6,849,090 dhe për honorarë 7,511,000 lekë, totali 14,360,090 lekë.

-Për emisionin “Ndërtesat e pushtetit”, për 86 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 903,295 dhe për honorarë 380,000 lekë, totali 1,283,295 lekë.

-Për emisionin “Ditë pas dite”, për 2 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 416,000 dhe për honorarë 409,300 lekë, totali 825,300 lekë.

-Për emisionin “N’kofidencë”, për 4 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 390,772 dhe për honorarë 890,000 lekë, totali 1,280,772 lekë.

-Për emisionin “Zëri i Popullit”, për 3 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 866,000 dhe për honorarë 395,000 lekë, totali 1,261,000 lekë.

-Për emisionin “Dimensioni i katërt”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 300,000 dhe për honorarë 183,500 lekë, totali 483,500 lekë.

-Për emisionin “Ora7”, për 1 punonjës të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 300,000 dhe për honorarë 306,000 lekë, totali 606,000 lekë.

-Për emisionin “Kohë moderne”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 120,000 dhe për honorarë 175,000 lekë, totali 295,000 lekë.

-Për emisionin “Ura”, për 1 punonjës te saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 312,000 dhe për honorarë 160,000 lekë, totali 472,000 lekë.

Për 6-mujorin e par të vitit 2023 RTSH ka zhvilluar 10 emisione janë angazhuar 35 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga vlerën 12,961,997 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 12,780,660 lekë, totali 25,742,657 lekë.

- Për emisionin “Mirëmëngjes Shqipëri”, për 4 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 1,695,440 dhe për honorarë 2,059,000 lekë, totali 3,754,440 lekë.

-Për emisionin “Flasim për ekonominë”, për 5 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 1,197,811 dhe për honorarë 721,500 lekë, totali 1,919,311 lekë.

-Për emisionin “Si në familje”, për 3 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 1,317,120 dhe për honorarë 732,160 lekë, totali 2,049,280 lekë.

-Për emisionin “Shëndetësi”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 620,480 dhe për honorarë 500,000 lekë, totali 1,120,480 lekë.

-Për emisionin “Bibliotekë”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 448,560 dhe për honorarë 621,000 lekë, totali 1,069,560 lekë.

-Për emisionin “You should Know”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 441,000 dhe për honorarë 625,000 lekë, totali 1,066,000 lekë.

-Për emisionin “Intervista”, për 1 punonjës të saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 762,240 dhe për honorarë 500,000 lekë, totali 1,262,240 lekë.

-Për emisionin “Publikisht”, për 7 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 4,024,884 dhe për honorarë 5,460,000 lekë, totali 9,484,884 lekë.

-Për emisionin “Ndërtesat e pushtetit”, për 6 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 622,504 dhe për honorarë 832,000 lekë, totali 1,454,504 lekë.

-Për emisionin “Dosjet e hapura”, për 6 punonjësit e saj të angazhuar në këtë emision ka shpenzuar për paga vlerën 1,831,958 dhe për honorarë 730,000 lekë, totali 2,561,958 lekë.

Me vendim të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004, për miratimin e sistemit tarifor të shërbimeve që ofron RTSH, në pikën 1 është përcaktuar: Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti. Pra nuk do të merret paga për punën e përditshme referuar kontratës së punës. Baza ligjore e këtij vendimi të këshillit drejtues: Ligji Nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radio televizionin publik dhe privat në RTSH”, VKM nr. 440, datë 01.06.2000 “Për miratimin e statutit të RTSH” Neni 54 Neni 99/8.

Me vendim të këshillit drejtues nr. 85, datë 21.12.2007, është vendosur shfuqizimi i paragrafit të par të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti. Pra, punonjësit do të marrin pagën sipas kontratës së punës dhe pagën e përfituar nga projektet(do të marrin dy paga).

Me vendim të këshillit drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimi i paragrafit të par të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhet me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH.

Referuar sa më sipër në RTSH për 27 emisione me angazhim 91 punonjës të RTSH është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, por tashmë të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës.

Duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, Neni 77, Neni 78, Neni 80 dhe Neni 81.

-Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19, Neni 20 dhe 52.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si mësipër ngarkon me përgjegjësi E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, E. D., me detyrë ish-drejtor i drejtorisë ekonomike.

Vlera 27,535,060 (14,754,400+ 12,780,660) lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm dhe E. D., i me detyrë ish-drejtor i drejtorisë ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

1. Titulli i gjetjes:	Keq menaxhim i fondeve te RTSH për bërjen e emisioneve televizive.
Situata:	<p>Për vitin 2022 RTSH ka zhvilluar 17 emisione, janë angazhuar 56 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 15,187,939 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 14,754,400 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 29,942,339 lekë. Për 6-mujorin e parë të vitit 2023 RTSH ka zhvilluar 10 emisione janë angazhuar 35 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 12,961,997 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 12,780,660 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 25,742,657 lekë. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 38, datë 01.07.2004, “Për miratimin e sistemit tarifor të shërbimeve që ofron RTSH”, në pikën 1 është përcaktuar: Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti. Me vendim të këshillit drejtues nr. 85, datë 21.12.2007, është vendosur ç fuqizimi i paragrafit të par të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti”. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur ç fuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimin e paragrafit të par të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhet me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH”. Referuar sa më sipër në RTSH për 27 emisione me angazhim 91 punonjës, është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës. Duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH. Vlera 27,535,060 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115.</p> <p>-Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.</p> <p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe</p>

	kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8. -Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19, Neni 20 dhe 52.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën 27,535,060 lekë.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 27,535,060 lekë nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. -Këshill Drejtues brenda kompetencave ligjore, statusore dhe rregullatore të tij, të analizojë mënyrën e pagesës/shpërblimit të punonjësve të angazhuar në projekte artistike dhe filmike në RTSH, dhe të merret vendimi përkatës me argument shterues për të shmangur keq interpretimet e zbatimit të vendimmarrjeve të mëparshme nga drejtoria në lidhje me këtë çështje.

2. Titulli i gjetjes:	Shpenzime udhëtim dhe dieta pa dokumentacion të rregullt ligjor.
Situata:	Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa, pa numër, datë 10.01.2022 për vlerën 2,850 euro, për pagesë M. M., gazetar i RTSH, por mandat pagesa nuk është firmosur nga marrësi i kësaj shume, si dhe nga arkëtari. Mandatpagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, nga punonjësit M. M., E. V., dhe H. M.. Mandatpagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.
Kriteri:	-Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7. -Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, pika 15.
Ndikimi/Efekti:	Risk në administrimit të mjeteve monetare.
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7 dhe Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi me specialist të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e mbajtjes së kontabilitetit financiar dhe administrimit të mjeteve monetare), i cili të kryejë verifikimet përkatëse për vlerën 2,850 euro të

	<p>shpenzuar për udhëtim dhe dieta pasqyruar në mandat pagesën, pa numër, datë 10.01.2022.</p> <p>Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se vlera 2,850 euro e shpenzuar për udhëtim dhe dieta nuk është përfituar nga M. M., E. V. dhe H. M., konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 2,850 euro nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit.</p>
--	---

3. Titulli i gjetjes:	Shpenzime udhëtim dhe dieta pa dokumentacion të rregullt ligjor.
Situata:	<p>Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa, pa numër, për vlerën 4,150 euro, për pagesë A. Ç., me detyrë shofer gazetar i RTSH, por mandat pagesa nuk është firmosur nga marrësi i kësaj shume, si dhe nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.</p> <p>Mandatpagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, mandatpagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15,</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk në administrimin e mjeteve monetare.
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7 dhe Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35.
Rëndësia:	E Lart
Rekomandimi:	<p>Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi me specialist të fushës (përfshirë ata që kanë qenë pjesë e mbajtjes së kontabilitetit financiar dhe administrimit të mjeteve monetare), i cili të kryejë verifikimet përkatëse për vlerën 4,150 euro të shpenzuar për udhëtim dhe dieta pasqyruar në mandat pagesën, pa numër, datë 15.02.2022.</p> <p>Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se vlera 4,150 euro e shpenzuar për udhëtim dhe dieta nuk është përfituar nga A. Ç. dhe G. Gj., konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 4,150 euro nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit</p>

4. Titulli i gjetjes:	Shpenzime udhëtim dhe dieta pa dokumentacion të rregullt ligjor.
Situata:	<p>Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa nr. datë 21.01.2022, pa nr. serie për vlerën 1,650 euro, për pagesë G. Gj., me detyrë operator, mandat pagesa e firmosur nga G. Gj., dhe jo nga B. C., me detyrë gazetare e RTSH dhe A. C., me detyrë shofer, si dhe jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar. Urdhërshërbimet nuk janë firmosur nga nëpunësi zbatues por nga V. L., në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 1 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, paragrafi i fundit.</p> <p>Mandatpagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit dhe arkëtari, në urdhër shërbim nëpunësi zbatues cilësohet V. L.. Mandat pagesa nuk është regjistruar në librin e arkës.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk në administrimit të mjeteve monetare.
Shkaku:	Mos zbatimi i Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7 dhe Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandimi:	<p>Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi me specialist të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e mbajtjes së kontabilitetit financiar dhe administrimit të mjeteve monetare), i cili të kryej verifikimet përkatëse për vlerën 1,650 euro të shpenzuar për udhëtim dhe dieta pasqyruar në mandat pagesën, pa numër, datë 21.01.2022.</p> <p>Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se vlera 1,100 euro e shpenzuar për udhëtim dhe dieta nuk është përfituar nga A. Ç. dhe B. C., konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 1,100 euro nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit. Vlera 1100 euro është përlogaritur si diferencë (1650 :3= 550 x2 =1100).</p>

5. Titulli i gjetjes:	Shpenzime udhëtim dhe dieta pa dokumentacion të rregullt ligjor.
Situata:	<p>Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër datë 04.02.2022, pa nr. serie për vlerën 1,040 euro, për pagesë C. G., shtetas nga Franca, mandat pagesa e firmosur me firmë të mbyllur në këtë mënyrë pa dalluar saktësisht se kush është marrësi i parave. Urdhër shërbimet për jashtë vendit për llogari të C., firmosur me firmë të mbyllur, i pa dallueshëm se kush ka udhëtuar, A. P. dhe V. L., për vlerën 445 euro.</p> <p>Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.</p> <p>Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit dhe arkëtari. Mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës. Vlera 445 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.</p> <p>-Ligji nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b.</p> <p>-Ligji nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8.</p> <p>- Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2, Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35.</p> <p>-Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7.</p> <p>-Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondeve.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Këshilli drejtues të shqyrtohet vlera 445 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime udhëtim dhe dieta për C. G., solist nga Franca, i cili ka marr pjesë koncertin e kameratës të orkestrës simfonike datë 05.02.2022. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

6. Titulli i gjetjes:	Shpenzime udhëtim dhe dieta pa dokumentacion të rregullt ligjor.
Situata:	<p>Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër, datë 16.02.2022 pa nr. serie për vlerën 1,539 euro, për pagesë P. F., shtetas Francez, mandat pagesa e firmosur nga ky shtetas, por jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.</p> <p>Në kontratë nuk është përcaktuar në asnjë nen të saj që RTSH do ti paguaj biletën e avionit për 359 euro, dhe udhëtim dhe dieta 160 euro. Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.</p> <p>Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, arkëtari. Mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës. Vlera 519 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.</p> <p>-Ligji nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b.</p> <p>-Ligji nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8.</p> <p>-Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2.</p> <p>Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35 dhe 15.</p> <p>-Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondeve.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Këshilli drejtues të shqyrtohet vlera 519 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime udhëtim dhe dieta për P. F., solist nga Franca, i cili ka marr pjesë në koncertin e orkestrës simfonike të RTSH më datën 16.02.2022. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.
7. Titulli i gjetjes:	Shpenzime udhëtim dhe dieta pa dokumentacion të rregullt ligjor.
Situata:	Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër, datë 16.02.2022 pa nr. serie për vlerën 1,114 euro, për pagesë N. B., shtetas Francez, mandat pagesa e firmosur me firmë

	<p>të mbyllur, për pasojë nuk mund të provohet saktësisht se kush është marrësi i parave, nuk është firmosur nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.</p> <p>Në kontratë nuk është përcaktuar në asnjë nen të saj që RTSH do ti paguajë biletën e avionit për 359 euro, e shpenzime udhëtim dhe dietë 160 euro.</p> <p>Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.</p> <p>Nuk ka situacion ose një dokument të barasvlershëm me të për realizimin e koncertit të orkestrës simfonike të RTSH më datën 19.01.2022.</p> <p>Vlera 519 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.</p> <p>Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, arkëtari, mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.</p> <p>-Ligji nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b.</p> <p>-Ligji nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8.</p> <p>- Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2 Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35.</p> <p>-Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7.</p> <p>- Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondeve.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga këshilli drejtues të shqyrtohet vlera 519 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime udhëtim dhe dieta për N. B., solist nga Franca, i cili ka marr pjesë në koncertin e orkestrës simfonike të RTSH më datën 19.01.2022. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

8. Titulli i gjetjes:	Shpenzim i pa nevojshëm
Situata:	<p>Marrje me qira Studio televizive lëvizëse transmetuese OB Van Broadcast –Regjia HD (në vijim regjia HD).</p> <p>Me urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2023 nëpërmjet R.B. është likuiduar Shoqëria “N. P.,” shpk në vlerën 2,400,000 lekë.</p> <p>Për 4 netët RTSH ka shpenzuar për marrjen me qira të studiove lëvizëse në vlerën 2,400,000 lekë ose 600,000 lekë/natë, vlerë e cila nuk është zë i preventivit të “<i>Festivalit të 61 të këngës</i>” në RTSH, i miratuar me vendim të këshillit drejtues dhe të bordit të administrimit edhe pse në inventarin e RTSH ka dy mjet televizivë të llojit “Studio televizive lëvizëse transmetuese” me vlerë kontabël 93,180,371 lekë.</p> <p>Vlera 2,400,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.</p>
Kriteri:	<p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19.</p> <p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8.</p> <p>-Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondeve.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet marrja me qira e studiove televizive lëvizëse transmetuese OB Van Broadcast –Regjia HD (në vijim regjia HD), në vlerën 2,400,000 lekë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për përdorimin pa ekonomicitet të burimeve financiare publike kur RTSH ka në inventarin e saj dy mjet televizivë të llojit “Studio televizive lëvizëse transmetuese” me vlerë kontabël 93,180,371 lekë.

9. Titulli i gjetjes:	Shpenzim i pa nevojshëm
Situata:	<p>Me urdhër transfertën pa nr, datë 12.12.2023 nëpërmjet R. B. është likuiduar Shoqëria “P” shpk në vlerën 2,033,208 lekë për emisionin “Ti duhet ta dish”, për marrjen me qira të pajisjeve: Nriçues profile led copë 14, ndriçues led RGBV me zom copë 9, ndriçues të lëvizshëm led spot copë 10, ndriçues të lëvizshëm leg wash copë 10, ndriçues efekti televiziv 2 modele copë 10, pajisje komandimi ndriçimi copë 1, filtra të ndryshëm për ndriçuesit, frost, minus green, cosmetic nga 1 set copë 2, artnet node copë 1, splitera ndriçimi copë 2, ledwall m² 17.</p> <p>RTSH nuk ka të dokumentuar inventarin e aparaturave të marra me qira, përcaktimin dhe referencat e çmimit dhe personat që i kanë përcaktuar, miratuar këto çmime. Nuk ka vendim të bordit artistik për këtë emision.</p> <p>Vlera 2,033,208 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet.</p>
Kriteri:	<p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19.</p> <p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.</p> <p>-Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondeve
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Nga këshilli drejtues të shqyrtohet vlera 2,033,208 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me marrje me qira ndriçues etj nga shoqëria “P” shpk, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e RTSH. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëmin ekonomik.
10. Titulli i gjetjes:	Shpenzim i pa nevojshëm
Situata:	<p>Me urdhër transfertën pa nr, datë 30.12.2022 nëpërmjet R. B., është likuiduar Shoqëria “P” shpk në vlerën 72,000 lekë për koncertit 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturore të Katedrales Ortodokse më datë 09.11.2022. Me urdhër transfertë pa nr, datë 22.12.2022 nëpërmjet R. B., është likuiduar Shoqëria “P” shpk në vlerën 72,000 lekë për koncertit 13.10.2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin e Operës dhe të Baletit më datë 13.10.2022. Me urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2022 nëpërmjet R. B., është likuiduar Shoqëria “P” shpk në vlerën 102,000 lekë për koncertin 1 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin Petro Marko më datë 01.11.2022.</p> <p>RTSH për 3 koncerte datë 13.10.2022, 01.11.2022 dhe 9.11.2022,</p>

	<p>RTSH ka paguar vlerën 246,000 lekë për marrje qira aparaturash, pa argumentuar pse kjo orkestër ka marr me qira aparatura, çfarë aparaturash janë, a ka në inventar aparaturat e marra me qira, si është përcaktuar çmimi, kush është personi përgjegjës që e ka përcaktuar, referenca e çmimit, ku është personi që e ka miratuar. Pse i njëjti operator ekonomik etj.</p> <p>Orkestra simfonike e RTSH nuk ka qenë në gjendje për vitin 2022 të jepte tre koncerte, edhe pse në stafin e saj ka 62 persona me një pagesë mujore 5,109,814 lekë dhe vjetore 61,317,769 lekë, por duhet të merrte me qira aparatura për vlerën 246,000 lekë.</p> <p>Vlera 246,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmshpërblehet.</p>
Kriteri:	<p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19.</p> <p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.“</p> <p>-Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondeve.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Nga Këshilli drejtues të shqyrtohet vlera 246,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me marrje me qira aparatura nga shoqëria “P” shpk, për dhënie 3 koncerte të orkestrës simfonike datë 13.10.2022, 01.11.2022 dhe 9.11. vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e RTSH. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëmin ekonomik.

11. Titulli i gjetjes:	Harxhim karburanti për automjetet e përdorura nga drejtuesit e RTSH, pa fletë udhëtimi.
Situata:	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, për periudhën 01.01.2022-30.06.2023 nuk vërtetohet kryerja e shpenzimeve për karburantin, për automjetin me targë AA ... TN dhe AA ... BK, për sasinë 2805 litra me vlerë 553,895 lekë, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi.</p> <p>Konkretisht për harxhimin e kësaj sasive karburanti nuk ka fletë udhëtimi si dokumentacionit justifikues bazë, për pasojë nuk ka rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8/1.</p> <p>-Ligji Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6, 7 dhe 8.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për</p>

	menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c. -Ligji- Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.
Ndikimi/Efekti:	Risk për shpërdorim karburanti.
Shkaku:	Mos zbatim i Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a,b,c.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që të ndërpritet praktika e shpenzimeve për karburant për automjetet e RTSH, në mungesë të të gjithë dokumentacionin e nevojshëm justifikues që kërkon procedura e shpenzimit të këtij malli.

11. Titulli i gjetjes:	Keq menaxhim i fondeve të RTSH për bërjen e emisioneve televizive.
Situata:	<p>Për vitin 2022 RTSH ka zhvilluar 17 emisione janë angazhuar 56 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga vlerën 15,187,939 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 14,754,400 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 29,942,339 lekë. Për 6-mujorin e par të vitit 2023 RTSH ka zhvilluar 10 emisione janë angazhuar 35 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga vlerën 12,961,997 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 12,780,660 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 25,742,657 lekë. Me vendim të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004, për miratimin e sistemit tarifor të shërbimeve që ofron RTSH, në pikën 1 është përcaktuar: Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti. Me vendim të këshillit drejtues nr. 85, datë 21.12.2007, është vendosur ç fuqizimi i paragrafit të par të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti. Me vendim të këshillit drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur ç fuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimi i paragrafit të par të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhet me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH.</p> <p>Referuar sa më sipër në RTSH për 27 emisione me angazhim 91 punonjës të RTSH është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, por tashmë të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës.</p> <p>Duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH.</p> <p>Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si mësipër ngarkon me E. J.,</p>

	<p>me detyrë drejtor i përgjithshëm, E. D., me detyrë ish-drejtor i drejtorisë ekonomike.</p> <p>Vlera 27,535,060 (14,754,400+ 12,780,660) lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i drejtorisë ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115.</p> <p>-Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.</p> <p>-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.</p> <p>-Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19, Neni 20 dhe 52.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq menaxhim i fondeve të RTSH për bërjen e emisioneve televizive.
Shkaku:	Mos zbatim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 27,535,060 lekë nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>-Këshill Drejtues në kompetencat ligjore, statusore dhe rregullatore të bëjë parashikime specifike (çfuqizojë dhe/ose ndreqje gabimi material të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 09.01.2014,) në lidhje me pagesën e punonjësve që fitojnë projekte artistike dhe filmike në RTSH, për të shmangur keq interpretimet e zbatimit të vendimmarrjeve të mëparshme nga drejtoria në lidhje me këtë çështje.</p>

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike është paraqitur observacioni me nr. 32/4 prot., datë 29.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/34 prot., datë 30.01.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

-Nuk ka asnjë pengesë ligjore të shprehur në formën e vendimmarrjes së këshillit drejtues, për mos pagesën e punonjësve që përfitojnë projekte dhe paguhen në honorarë referuar Vendimit Këshillit Drejtues nr. 38, datë 01.07.2004, nr. 85, datë 21.12.2007 dhe nr. 3, datë 09.01.2014, përjashto drejtuesit e zgjedhur nga këshilli drejtues.

-Me stafin e angazhuar me prodhimet e RTSH, është lidhur një kontratë e re, përpos asaj të punës që ka me RTSH, nga ku përcaktohen qartësisht detyrat dhe që janë shtesë ndaj detyrave përgjatë orarit zyrtar të punës .

-RTSH ka mundësuar që ekspertizën e punonjësve të saj ta shtrij jo vetëm në atë çka përfshin kontrata e punës, por dhe në programe dhe angazhime të tjera artistike.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Ka një keq interpretim të vendimit këshillit drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, ku është vendosur ç fuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimin e paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 ku është përcaktuar: “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhen me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH”.

Këshilli drejtues nuk është shprehur specifikisht për punonjësit e tjerë. Në kushtet e mos shprehjes dhe të shfuqizimit të vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, interpretimi i grupit të auditimit është se këshilli drejtues ka lënë në heshtje zbatimin e kontratave individuale të punës.

Së dyti. Kontrata e lidhur me stafin angazhuar me prodhimet e RTSH, bie ndesh me:

-Rregulloren e organizmit dhe funksionimit të RTSH, detyrat funksionale për secilin punonjës.

-Kontratën individuale neni 4, pika 4.1, kohëzgjatja javore e punës është jo më shumë se 40 orë.

-Kontratën individuale neni 4, pika 4.2. Ku është shprehur “Mbështetur në Statutin e RTSH dhe detyrat funksionale të RTSH, palët kanë dijeni dhe bien dakort që për nevojat e punës, orari i punës është i organizuar me turne.

-Kontratën individuale neni 4, pika 4.3. Ku është shprehur “Punëdhënësi ka të drejt ti kërkojë punëmarrësit kryerjen e orëve shtesë sipas nevojave të punës, në kushte dhe rrethana të caktuararritjes së papritur të punës ose nevoja të një projekti që të përfundoj brenda një afati specifik të pa parashikuar”.

Në orarin punës për realizimin e detyrave funksionale RTSH me punonjës të veçantë ka lidhur dhe një kontratë tjetër, duke krijuar një marrëdhënie juridike të shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës. Duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH, deri atje sa punonjës të veçantë të marrin vetëm nga honorarët brenda një viti sa dyfishi i pagës sipas kontratës së punës.

Së treti. Nuk ka të përcaktuar kritere të përzgjedhjes dhe transparencë të punonjëseve të angazhuar në projekte artistike dhe filmike.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115, Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Bazuar në kodin civil dëmi mund të shkaktohet si rezultat i një veprimi ose mos veprimi të paligjshëm. Dëmi i shkaktuar në formën e pagave dhe honorarëve të marra nga punonjësit do

duhet të dëmshpërblehet apo kthehet po nga personi/personat të cilët e kanë marr padrejtësisht këtë pagë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi është në kundërshtim me:

Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 609 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit dhe mosveprimit të personit. Mos pengimi i një ngjarje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar”.

-Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 659 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”, çka do të thotë që RTSH ka lidhur kontratë me punonjësit e saj për pagesën e honorarëve.

-Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 690 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”, çka do të thotë që RTSH ka lidhur kontratë me punonjësit e saj për pagesën e honorarëve.

-Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 657 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Nuk mund të kërkohet kthimi i asaj që personi ka dhënë vullnetarisht për ekzekutimin e një detyrimi, i cili, megjithëse i pa kërkueshëm, nuk është i pavlefshëm”.

-Ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 31, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij.

Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik”.

Neni 32, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Personi juridik është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga organet e tij gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

Personi juridik përgjigjet për detyrimet e tij brenda kufijve të pasurisë së tij. Personat që kanë vepruar me cilësinë e organit të personit juridik, kanë përgjegjësi vetjake për shpërblimin e dëmeve që janë shkaktuar për fajin e tyre”.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Grupi i auditimit ka konstatuar dëm dhe nuk ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi qëndron

Prandaj ky koment do merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga V. L., është paraqitur observacioni me nr. 32/4 prot., datë 29.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/35 prot., datë 30.01.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Nga ana e jonë u kontaktua me të gjithë personat që janë përmendur në këtë gjetje që tashmë për një periudhë disa mujore dhe vjeçare nuk janë pjesë e stafit të RTSH. Konkretisht: H. S. M., ka dalë në pension më datë 31.01.2022, E. V., ka shkëputur marrëdhëniet me RTSH më datë 04.08.2023, G. Gj., ka shkëputur marrëdhëniet me RTSH më datë 13.07.2023, B. C., ka shkëputur marrëdhëniet me RTSH më datë 13.07.2023. Persona kanë deklaruar me deklaratë se kanë tërhequr shumat përkatëse: E. V., ka tërhequr vlerën 950 euro, H. M., ka tërhequr 950

euro, A. Ç., ka tërhequr vlerën 2095 euro, G. Gj., ka tërhequr vlerën 2095 euro, B. C., ka tërhequr vlerën 520 euro, A. Ç., ka tërhequr vlerën 611 euro, H. S. M., ka tërhequr vlerën 950 euro.

Deklarata datë 23.01.2024 e H. S. M., për vlerën 950 euro, deklarata datë 23.01.2024 e B. C., për vlerën 520 euro, deklarata datë 23.01.2024 e E. V., për vlerën 950 euro (e pa firmosur prej tij), deklarata datë 23.01.2024 e B. C., për vlerën 520 euro, deklarata datë 23.01.2024 e G. Gj., për vlerën 2055 euro, deklarata datë 23.01.2024 e A. Ç., për vlerën 611 euro, deklarata datë 23.01.2024 e E. V., për vlerën 950 euro.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në kushtet kur:

-Mandat pagesa, pa numër, datë 10.01.2022 për vlerën 2,850 euro, për pagesë M. M., gazetar i RTSH, nuk është firmosur nga marrësi i kësaj shume, dhe nuk ka paraqitur deklaratë.

- Deklarimi nuk është bërë me gojë dhe me shkrim në prezencë të grupit të auditimit, edhe pse këtë gjë e ka kërkuar për dy muaj radhazi. Këtë deklaram e ka bërë vetëm D. SH. dhe E. K., në lidhje me marrjen dhe dhënien e shumës respektive ndërmjet njëri tjetrit, të cilët deklaruan me gojë dhe me shkrim datë 20.10.2023 se D. SH., i ka dhënë 1,417 euro E. K., dhe E. K., ka marrë 1417 euro nga D. SH..

Deklarimi nuk është bërë me gojë dhe me shkrim në RTSH në prani të drejtorit ekonomik/juridik ose punonjësi të ngarkuar nga drejtori i përgjithshëm, ose me deklaratat të firmosur tek noteri.

Grupi i auditimit, deklaratat nuk mund ti vlerësoj si dokumente të besueshme.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.6. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Auditimi u krye me zgjedhje⁸.

Për vitin 2020 janë zhvilluar 49 procedura prokurimi me vlerë 1,121,066 mijë lekë.

Për vitin 2021, janë zhvilluar 58 procedura prokurimi me vlerë 180,491 mijë lekë.

Për vitin 2022, janë zhvilluar 98 procedura prokurimi me vlerë 97,878 mijë lekë.

Për periudhën 01.01-30.06.2023, janë zhvilluar 55 procedura prokurimi me vlerë 77,299mijë lekë.

Viti 2020						
Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës	Diferenca	
					Vlerë	%
1	Procedurë e hapur	4	183.634.948,0	174.820.001,00	8.814.947,00	4,80%
2	Procedurë e hapur ndërkombëtare	1	908.187.000,0	907.816.536,80	370.463,20	0,04%

⁸ Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur”

3	Procedurë Kërkese për propozim	4	7.085.287,0	4.812.717	2.272.570	32%
4	Procedurë Negocim pa shpallje	-	-	-	-	-
5	Modifikim Kontrate	-	-	-	-	-
6	Procedurë Blerje e vogël	27	9.158.565,0	6.227.731	2.930.834	32,00%
7	Sistem dinamik (Blerje bileta për udhëtime)	13	13.000.000,0	2.163.694	10.836.306	83,36%
	Shuma	49	1.121.065.800	1.095.840.679,80	25.225.120,20	2.25

Burimi të dhënave: RTSH

Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës	Diferenca	
					Vlerë	%
1	Procedurë e hapur	3	133.947.016,0	125.006.944,00	8.940.072,00	6,67%
2	Procedurë e hapur e thjeshtuar	4	17.080.422,0	15.802.700,00	1.277.722,00	7,48%
3	Procedurë Kërkese për propozim	2	6.516.093,0	5.612.500	903.593	14%
4	Procedurë Negocim pa shpallje	-	-	-	-	-
5	Modifikim Kontrate	-	-	-	-	-
6	Procedurë Blerje e vogël	26	12.946.757,0	8.434.893	4.511.864	34,85%
7	Sistem dinamik (Blerje bileta për udhëtime)	23	10.000.000,0	2.794.255	7.205.745	72,06%
	Shuma	58	180.490.288	157.651.292,00	22.838.996,00	12.65

Burimi të dhënave: RTSH

Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës	Diferenca	
					Vlerë	%
1	Procedurë e hapur	5	55.643.418,0	47.664.928,00	7.978.490,00	14,34%
2	Procedurë e hapur e thjeshtuar	6	21.876.215,0	16.312.616,00	5.563.599,00	25,43%
3	Procedurë Kërkese për propozim	-	-	-	-	-

4	Procedurë Negocim pa shpallje	-	-	-	-	-
5	Modifikim Kontrate	-	-	-	-	-
6	Procedurë Blerje e vogël	21	10.358.790,0	8.237.880	2.120.910	20,47%
7	Sistem dinamik (Blerje bileta për udhëtime)	66	10.000.000,0	9.412.351	587.649	5,88%
	Shuma	98	97.878.423	81.627.775,00	16.250.648,00	16.6

Burimi të dhënave: RTSH

Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlerë	%
1	Procedurë e hapur	2	59.497.446,00	31.501.226,00	27.996.220,00	47,05%
2	Procedurë e hapur e thjeshtuar	1	3.283.233	1.819.000,00	1.464.233,00	45%
3	Procedurë Kerkese per propozim	0	0		0	0%
4	Procedurë Negocim pa shpallje	-	-	-	-	-
5	Modifikim Kontrate	0	0,00	0,00	0	0
6	Procedurë Blerje e vogel	9	4.517.973	3.363.800	1.154.173	25,55%
7	Sistem dinamik (Blerje bileta per udhetime)	43	10.000.000	5.236.754	4.763.246	47,63%
	Shuma	55	77.298.652,00	41.920.780,00	35.377.872,00	46%

Burimi të dhënave: RTSH

Nga grupi i auditimit u audituan procedurat e prokurimit në tabelën si më poshtë vijon:

Nr. rendor	Emërtimi	Viti	Vlera lekë
1.	Blerje Shërbimi për Mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2	2020	908,187,000
2.	Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH,	2023	14,314,505
3.	Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH.	2023	22,231,737
4.	Blerje karburanti	2021	32,415,472
5.	Për Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”.	2023	252,000

6.	Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent.	2023	22,231,737
7.	Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Shërbimi për Platformën OTT”, me nr. REF-62147-06-22-2020)	2020	85,113,600
8.	Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”, me nr. REF-20554-02-24-2022)	2022	11,260,600
9.	Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me Fibër Optike”, me nr. REF-62192-03-10-2023)	2023	37,265,708.
10.	Blerje pajisje elektronike për nevojat e transmetimit”.	Viti 2020	23,851,028
11.	Blerje Video Wall, Televizor, pajisje ndriçimi dhe rinovimi i pajisjeve elektrike për Studiot në RTSH	2022	53,489,406
12.	Led Wall për nevoja të RTSH-së	2021	11,100,330
13.	Mirëmbajtja e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar	2022	11,533,793
14.	Blerje vaj, goma, bateri dhe adblue për automjetet e Radio Televizionit Shqiptar	2022	3,551,600
15.	Blerje mikrofona valor lavalier për nevoja të RTSH-së”.	2022	84,3150
16.	Rikonceptim i Studios 5	2022	95,5800
17.	Blerje inverter dhe bateri inverteri per studion levizese SNG.	2023	20,8800
18.	Blerje materiale muzikore per Orkestren	2021	79,5000
19.	Blerje sistem konference per RTSH-në	2021	760,000
20.	Blerje pajisje elektronike për nevojat e transmetimit	2020	23,851,028

Në procedurat e audituara, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimi në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e procedurave të prokurimit, llogaritjen e fondit limit, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin, shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore, të cilat në mënyrë të detajuar për çdo procedurë prokurimi paraqiten si më poshtë vijon:

1. Blerje Shërbimi për Mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020

Blerje Shërbimi për Mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 54 prot, datë 01.09.2020	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit Urdhër Nr. 54/ prot, datë 10.08.2020 -G. A.. -E.K.. -G. H..	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 54/10 prot, datë 02.11.2020 -S. G.. -E. K.. -M. A.. -F. Z.. -M. L..
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur , marrëveshje kuadër”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 908,187,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 908,187,000 lekë 195,591,960 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit	9. Burimi Financimit	10. Operatorët Ekonomike

08.01.2021	Fond nga Buxheti i Shtetit	a)Pjesëmarrës në tender Numër _1_ OE a) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik -
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 54/18 prot, datë 26.02.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 908,187,000 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 1803/1 prot., datë 28.07.2020 H. M., Njësia Teknike dhe S. Gj., me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, i është drejtuar Th. G., me detyrë drejtor i përgjithshëm, për të marrë masa për kryerjen e procedurës për të vijuar shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit, pasi marrëveshja aktuale mbaron në 30 nëntor 2020.

Me urdhër nr. 54, datë 01.09.2020 titullarit i autoritetit kontraktor, ka urdhëruar të kryhet prokurimi për vlerën 227,046,750 lekë për 12 muaj, ose 908,187,000 lekë për 48 muaj ose 4 vite, Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2 për RTSH, financuar nga buxheti i shtetit, procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar (marrëveshje kuadër).

Me urdhër nr. 54, datë 01.09.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, i përbërë nga B. M., i mesëm elektrik, E.B., me profesion ing. mekanik dhe Q. P..

Specifikimet teknike janë hartuar me procesverbal nr. 54/1 prot, datë 25.09.2020 i firmosur nga B. M., E. B. dhe Q. P..

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë në bazë të një kontrate të më përparshme me Operatorin Ekonomik “R. & S., – O. G.,” Vjenë, Austri, kontrata Nr. 3237prot., datë 05.10.2016 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga Th. G., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “R. & S., – O. G.,” përfaqësuar nga administrator P. S., për vlerën 7,330,000 euro pa TVSh.

-Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me procesverbalin e datës 10.06.2020 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga G. A., E. K., dhe G. H.. Në këto kërkesa nuk janë dhënë arsye konkrete në argumentimin e kriterëve të vlerësuar për objektin e prokurimit, në raport me natyrën dhe përmasat e këtij objekti.

Konkretisht, në Nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

Në kërkesat për kualifikim pika 3.3 .2 “Kapaciteti teknik”, është kërkuar “Operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë autorizim suporti nga prodhuesi i pajisjeve specifikisht për këtë objekt prokurimi, për:

a- Operimin dhe rinovimin në bazë vjetore të licencave për Head-End që kemi aktualisht në përdorim Rohde Schwarz AVHE 100.

b- Kolaudimin, riparimin dhe furnizimin me pjesë për të gjitha pajisjet që përbëjnë sistemin aktual të transmetimit UHF:

- Excitera Rohde Schwarz
- Amplifikator Rohde Schwarz
- Controller Rohde Schwarz
- Filtera RF Rohde Schwarz

c- Furnizimin me pjesë ndërrimi dhe përditësimin e licencave të sistemit aktual të ndërlidhjes nëpërmjet radio releve SIAE ALS dhe sistemit aktual të rrugëzimit të trafikut alcatel lucent (router/switch).

Kjo kërkesë për kualifikim është “Super/specifikim” në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Neni 20 dhe Neni 23 pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “*Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime*”.

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 28, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me Nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*”.

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” apo “Super specifikimit” Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendim Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” apo “Super specifikimin” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mall/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, ç’ka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën

e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Në pikën 3.3.2 "Kapaciteti teknik" është kërkuar: Për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës në të gjitha vendndodhjet e kërkuara, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtëm: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të siguruar jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës inxhinier në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve dhe profili i punës së secilit.
- b. Kontrate individuale pune
- c. Diplomë

Kërkesa për 10 punonjës (Inxhinier) është e përgjithshme nuk është e specifikuar në përputhje me objektin e kontratës, konkretisht ing. elektronik/mekanik etj.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "

1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese;

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, Neni 28 "Kontrata e shërbimeve", pika 5, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën"

Edhe pse në kundërshtim përsa trajtuar si mësipër, ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi Kompania "R. & Sch. O. G," nuk provohet/nuk ka paraqitur asnjë dokument që të ketë siguar jo më pak se 10 punonjës inxhinier në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Në kërkesat për kualifikim, pikën 3.3.4 "Kapaciteti teknik" është kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

- o ISO 9001 : 2015, Certifikatë për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente me to, lëshuar nga Institucionet e Akredituara për këtë qëllim
- o ISO 14001 : 2015, Certifikatë për sistemin e menaxhimit mjedisor ose ekuivalente me to, lëshuar nga Institucionet e Akredituara për këtë qëllim”.

Këto janë ISO të përgjithshme. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kërkuar asnjë licencë profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar, edhe pse kjo kontratë shërbimi është në vlerën 908,187,000 lekë. Si: ISO 20000-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve IT), ISO 27001-2013 (Për sigurinë e informacionit) etj.

Për shkëlqen e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër ngarkohen me përgjegjësi Th. G., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, njësia e prokurimit e përbërë nga G. A., E. K., dhe G. H..

Në proces verbalin e datës 26.10.2020 është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Nëse certifikatat dhe dëshmitë janë në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.

Me urdhër nr. 54/2, datë 28.09.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur grupi i KVO, i përbërë nga V. L., M. A., R. K., G. H. dhe F. Z.. Asnjë nga anëtarët e KVO nuk është specialist i fushës (ing. Elektronik), veprim në kundërshtim me:

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 58 *“Komisioni i vlerësimit të ofertave” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës”.*

Çka ngarkon me përgjegjësi Th. G., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i RTSH.

Me urdhër nr. 54/11, datë 09.12.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor është pezulluar procedura e prokurimit, si pasojë e rekomandimeve të APP.

Me procesverbal datë 10.12.2020 njësia e prokurimit e përbërë nga G. A., E. K., dhe G. H., kanë ri miratuar kërkesat për kualifikim të cilat janë sipas shtojcë nr. 54/13 prot., datë 11.12.2020, ku afati i fundit i dorëzimit të ofertave është data 08.01.2021 ora 11.

Me urdhër nr. 54/14, datë 14.12.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor është hequr pezullimi i procedurës së prokurimit.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, konkretisht “R.& S. O. G.”, Vjenë; Austri.

Dokumentacioni i paraqitur është në gjuhën angleze, në kundërshtim me:

- kërkesat për kualifikim të përcaktuara me procesverbal datë 26.10.2020 të njësisë së prokurimit e përbërë nga G. A., me profesin jurist, E. K., ing. telekomacion-IT dhe G. H., me profesion juriste, ku në këtë procesverbal është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Nëse certifikatat dhe dëshmitë janë në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.*

- Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14.

Dokumentacioni i paraqitur është në gjuhën angleze është pa vulë apostile të lëshuar nga zyra kompetente Austriake, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, “Për verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë.

Me kërkesë nr.54/15 prot., datë 12.01.2021, KVO i është drejtuar Th. G., në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, me lëndë “Duke qenë se kjo është një procedurë ndërkombëtare, rezultoi që pas hapjes së procedurës në sistemin elektronik, ka marrë pjesë një operator ekonomik i vetëm

ndërkombëtar, i cili ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në gjuhën angleze. Sa më lartë kërkojmë nga ana e juaj, të ngarkohet një përkthyes i institucionit për përkthimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në mënyrë që KVO të ketë mundësinë e vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit.

Dokumentet janë të përkthyer, të firmosura me firmë të mbyllur pa u përcaktuar është përkthyes i licensuar/ose jo nga Ministria e Drejtësisë.

Raporti përmbledhës është me nr. 54/6 prot., datë 02.02.2021 firmosur nga KVO.

Me këtë raport është shpallur fitues operatori ekonomik “R. & Sch, O, G,” me ofertë në vlerën 7,329,968 euro ose 907,816,536 lekë.

Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 54/17 prot., datë 03.02.2021.

Marrëveshja Kuadër është lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga Th. G., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “R. & Sch, O, G,” përfaqësuar nga administrator P. S., për vlerën 7,329,968 euro ose 907,816,536 lekë pa TVSh, me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës nga palët dhe fillon të zbatohet nga 01 mars 2021 dhe përfundon pas 48 muaj.

Marrëveshja Kuadër/kontrata me 54/18 prot., datë 26.02.2021, është hartuar në dy gjuhë, anglisht dhe shqip. Baza ligjore e kontratës nuk është e saktë, pasi ka vendosur Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, që fakt duhet të ishte Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, ligj i cili ka shfuqizuar Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006.

Për sa trajtuar mësipër, kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik “R. & Sch, O, G,” është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 46 pika Neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave i përbërë nga S. Gj., E. K., M.L., F. Z. dhe M. A..

Autoriteti kontraktor me këtë procedurë prokurimi ka kryer një formalitet burokratik dhe jo procedurë të mirëfilltë prokurimi, duke mos maksimizuar eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, në kundërshtim me legjisllacionin në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim, por edhe kundërshtim me parimet për rritjen e integritetit në prokurimin publik të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), parime që kanë efekt të drejtpërdrejtë në konkurrencë, në çmimin e paguar nga administrata publike për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

Zbatimi i kontratës

Në dokumentet e tenderit dhe në kontratë është përcaktuar organizimi, trajnimi për stafin inxhiniero-teknik për çdo komponent të sistemit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk u provua përmbushja e kësaj kërkesë nga operatori ekonomik.

Për periudhën 01.03-31.12.2021 është likuiduar për vlerën 2,525,892 euro ose 309,548,659 lekë, për vitin 2022 është likuiduar për vlerën 2,198,990 euro ose 262,198,452 lekë, për 01.01.-30.06.2023 është likuiduar për vlerën 1,282,744 euro ose 144,136,490 lekë. Shuma totale në vlerën 6,007,626 euro e konvertuar 715,883,601 lekë.

Për vitin 2020 është likuiduar në vlerën 1,961,396 euro e konvertuar 243,213,145 lekë. Likuidimi për vitin 2020 ka të bëjë me zbatimin e kontratës Nr. 3237prot., më datë 05.10.2016 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga Th. G., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “R. & Sch, O, G,” përfaqësuar nga administrator P. S., për vlerën 7,330,000 euro pa TVSh.

Dokumentacioni i likuidimit: Urdhër transfertat, faturat elektronike, raport SLA e kryer “R. & Sch, O, G,” për çdo muaj drejtuar drejtuesit të njësisë teknike të RTSH H. M., i firmosur nga

grupet e punës/komisionet të ngritura me urdhër të drejtorit të përgjithshëm për vlerësimin e disponueshmërisë së rrjetit DVB-T2: E. K., M. D., B. M., E. B., E.M., në mënyrë të njëanshme pa firmosur nga “R. & Sch, O, G,” Shkresat muaj për muaj drejtuar drejtorit i përgjithshëm nga H. M., me detyrë drejtor i njësisë teknike, për dërgimin e raporteve/procesverbale për shpërblim të kompanisë “R. & Sch, O, G,”.

Pagesat janë bërë/kryer pa akt-kolaudim të mbajtur ndërmjet palëve, veprim në kundërshtim me: -Marrëveshjen kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, Nenin 21 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Përfituesi do të paguaj ofertuesin e shërbimit për shërbimin e kryer sipas akt-kolaudim të mbajtur ndërmjet palëve të bërë një herë në muaj, konfirmuar nga përfaqësuesit e të dy palëve duke respektuar dhe zbatuar të gjitha detyrimet që përcaktohen në këtë kontratë”.

Neni 5, pika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Shuma e llogaritur në shtojcën 5 si pagesë mujore, do të kryhet për 48 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, si dhe duke u mbështetur në akt-kolaudimit apo procesverbalet e mbajtura nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate (marrëveshje).

Neni 6, pika 4, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshje, pagesa për shërbimet bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së shërbimeve, ose nga pranimi i faturës. Dorëzimi i faturës bëhet gjithmonë brenda ditës së 5-të të muajit pasues, pas dorëzimit të aktit të kolaudimit”.

-Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690 në të cilin është shprehur “.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos për mbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar”.

Në kontratën në gjuhën angleze, Neni 36, pika 1, është shprehur në mënyrë eksplicite “In any interpretation case of agreement the parties agree that English version will be referered to”, pra çdo çështje interpretimi të kësaj marrëveshje, palët bien dakord që do ti referohen versionit Anglisht. Në versionin shqip të kontratës kjo fjali nuk është pasqyruar fare. Në versionin në gjuhën shqipe përmendet termi “Akt kolaudim”. Në versionin anglisht, termi i duhur është procesverbalet e pranimit.

Nga strukturat drejtuese/drejtori i përgjithshëm/drejtoria juridike/teknike nuk është rinegociuar me Kompaninë “R. & Sch, O, G,”. Austri, marrëveshja kuadër me 54/18 prot., datë 26.02.2021, për të bërë amendimet përkatëse me qëllim që kopjet në anglisht të akt kolaudimeve/procesverbalet e pranimit/akt pranimeve në zbatim të kontratës të jenë të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët, referuar: Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14; Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, Kreu VII “Detyrimet dhe kontratat”, Neni 45 “Liria e zgjedhjes së Ligjit të zbatueshëm”; Rregullores (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore", Neni 11, pika 1,2,3.

Raportet mbi SLA e kryer, janë të përgjithshme jo të detajuar për shërbimin ashtu siç është përcaktuar në specifikimet teknike.

Konkretisht në raportet duhet të pasqyrohet :

Raportet për muajin përfshin raportet javore, raportet mujore të mirëmbajtjes periodike, raportin mbi disponueshmërinë e sistemit, planin e mirëmbajtjes dhe disa të dhëna ndihmuese.

Raporte mujore duhet të pasqyrojnë vizitat e parashikuara në stacionet për kryerjen e mirëmbajtjes mujore periodike të sistemeve si transmetues, MW links, Ac, sistemi elektrik, dhe motor gjeneratorëve, switcheve dhe te kamerave sipas listës bashkëlidhur. Gjatë këtij muaji është

kryer dhe mirëmbajta mujore e pajisjeve dhe e sistemeve të softwareve të instaluar në headend sipas raportit të paraqitur.

Raporte mbi disponueshmërinë e sistemit bazohet mbi funksionimin në mënyrë të rregullt të stacioneve të ndezur gjatë muajit.

Raporte duhet të pasqyrojnë vizitat për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes së stacioneve.

Në fakt asgjë nuk pasqyrohet në raport për sa cituar sa në lart.

Raportet nuk janë sipas aneksit nr. 4 “Formati i raportit periodik për stacionet e RTSH. Konkretisht nuk pasqyrohen personat e ngarkuar, data, tipi i stacionit, 4 “Kulla”, 5 “Rrethimi”: a. përshkrimi, b. rezultati i kontrollit, nuk është kontrolluar, c. aktivitete korrektive, shënime; komente; personat e ngarkuar; firma; data.

Veprime në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, Nenin 21, Neni 5, pika 3, Neni 6, pika 4, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690.

Në lidhje me këtë situatë nga ana e drejtorit të njësisë teknike H. M., nuk është raportuar tek drejtori i përgjithshëm që për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera nga Kompania “R. & S. O. G.”, Austri konform specifikimeve teknike të përcaktuar në kontratë dhe anekset bashkëlidhur kontratës, duhet rinegociuar me Kompaninë “R. & Sch, O, G,” , Austri, Marrëveshja Kuadër e lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, duhen bërë amendimet përkatëse me qëllim që kopjet në anglisht të akt kolaudimeve/procesverbalet e pranimit/akt pranimeve në zbatim të kontratës të jenë të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët referuar: Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14; Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, Kreu VII “Detyrimet dhe kontratat”, Neni 45 “Liria e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm”; Rregullores (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore”, Neni 11, pika 1,2,3.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi H. M., me detyrë drejtor i njësisë teknike.

Lidhja e kontratës (marrëveshjes kuadër), pavarësisht se ka marrëveshje kuadër, si shpenzim ka shkuar tek vlera e prokuruar, duke mos arritur në këtë mënyrë uljen kostove të blerjeve/shërbimeve. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e APP Nr. 6, datë 16.01.2018, “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, me ndryshimet vijuese të tij, pikat 7.1,7.2 dhe 7.3.

Lidhja e kontratës mbi bazën e marrëveshjeve kuadër, nuk është konsideruar si rast i veçantë dhe autoriteti kontraktor nuk duhet në asnjë rast të abuzojë me përdorimin e këtij instrumenti, me qëllim shtrembërimin e konkurrencës. Përdorimi i kësaj forme prokurimi detyrimisht duhet të arrij reduktimin e kostove transaksionale, përmirësimin e vazhdueshëm në harkun e marrëdhënieve afat-gjatë ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomik, në interes të konsumatorit, në rastin konkret përmirësimin e shërbimit të RTSH.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre jo vetëm nuk kanë maksimizuar efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, por i kanë keq menaxhuar ato.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

Ligjin nr. 9643 , datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1 është shprehur në mënyrë eksplicite se “Objekti dhe qëllimi”

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b ku është shprehur në ligjëratë të drejt “Sigurimin e përdorimit me efizienzë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike që ai menaxhon. Nëpunësi autorizues vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”:

- Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, ku është shprehur në ligjëratë të drejt “Titullarët e njësive publike, të përmendura në Nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë.

-Neni 2 “Qëllimi i Ligjit” Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”.

Neni 52 “Kryerja e shpenzimeve” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik”.

Për mos maksimalizim dhe efizienzë dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, ngarkohet me përgjegjësi Th. G., me detyrë drejtor i përgjithshëm për periudhën 01.01.2020- 20.05.2021, M. L., me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm për periudhën 21.05.2021 deri më 02.12.2021, E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm i RTSH për periudhën 03.12.2021-12.04.2023, R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të përgjithshëm për periudhën 13.04.2023 deri më 13.06.2023.

VO: Theksojmë se 2 kontratat e mirëmbajtës, janë lidhur pas realizimit të kontratës me Operatorin Ekonomik “R & S. O. G.,” Vjenë, Austri, kontratë e lidhur më datë 19.03.2015 ndërmjet Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike përfaqësuar nga ministre M. H., RTSH të përfaqësuar nga M. L., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “R & S. O. G.,” përfaqësuar nga F. B., vlerën 21,558,341 euro pa TVSh, me objekt “Ndërtimi i rrjeteve dixhitale për përdorimin nga RTSH nëpërmjet financimit, projektimit, furnizimit, instalimit, trajnimit dhe transferimit të rrjetit në territor që duhet të arrijë mbulimin 96.5 % të popullsisë.

Në Nenin 18 “Shërbimi i mirëmbajtjes” është përcaktuar “Sipërmarrësi dhe RTSH mund të negociojnë dhe të lidhin një kontratë të veçantë për ofrimin nga sipërmarrësi të shërbimit të mirëmbajtës në përputhje me marrëveshjen e shërbimit të rëndë dakort, me kusht që kontrata do tu përmbahet përcaktimeve të kërkesës për ofertë”.

Titulli i gjetjes Nr. 1	Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “R. & Sch, O, G,” , nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë.
Situata:	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020 me vlerë 7,330,000 euro pa TVSh, kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “R. & S. O. G,” nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë. Konkretisht:</p> <p>-Në pikën 3.3.2”Kapaciteti teknik” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë siguruar jo më pak se 10 punonjës inxhinier në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Kërkesa për10 punonjës (Inxhinier) është e përgjithshme nuk është e specifikuar në përputhje me objektin e kontratës konkretisht ing. elektronik/mekanik etj.. Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi Kompania “R. & S. O. G,” nuk provohet/nuk ka paraqitur asnjë dokument që të ketë siguruar jo më pak se 10 punonjës inxhinier në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.</p> <p>Dokumentacioni i paraqitur është në gjuhën angleze, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të përcaktuara me procesverbal datë 26.10.2020 të njësisë së prokurimit, ku në këtë procesverbal është shprehur në mënyrë eksplicite se “Nëse certifikatat dhe dëshmitë janë në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.</p> <p>-Dokumentacioni i paraqitur në gjuhën angleze është pa vulë apostile të lëshuar nga zyra kompetente Austriake.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 46 pika Neni 53 pika 3’.</p> <p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 66 pika 3.</p> <p>Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118.</p> <p>-Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14.</p> <p>VKM nr. 134, datë 07.03.2003, “Për verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga RTSH t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe

	ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.
--	---

Titulli i gjetjes Nr. 2	Vendosje në kërkesat për kualifikim i autorizimit të prodhuesit
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020 me vlerë 7,330,000 euro pa T.V.Sh, në kërkesat për kualifikim pika 3.3 .2 “Kapaciteti teknik”, është kërkuar “Operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë autorizim suporti nga prodhuesi i pajisjeve specifike për këtë objekt prokurimi, për: Operimin dhe rinovimin në bazë vjetore të licencave për Head-End që kemi aktualisht në përdorim R. S. AVHE 100; Kolaudimin, riparimin dhe furnizimin me pjesë për të gjitha pajisjet që përbëjnë sistemin aktual të transmetimit UHF: (Excitera R. S.; Amplifikator R. S.; Controller R. S.; Filtera RF R. S.); Furnizimin me pjesë ndërrimi dhe përditësimin e licencave të sistemit aktual të ndërlidhjes nëpërmjet Radio Releve SIAE ALS dhe sistemit aktual të rrugëzimit të trafikut alcatel lucent (router/switch). Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, ka orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik, është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Neni 20 dhe Neni 23 pika 5, Neni 28, pika 2. Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17. Vendimi i Kolegjit Administrativë të Gjykatës së Lartë me Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015.
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Autoriteti kontraktor, në vijimësi në hartimin e specifikime teknike të shmang vendosjen e parametrave specifik fikse (apo me intervale të ngushta), pasi këto përcaktime orientojnë ofertuesit drejt markave specifike prodhuese, drejt distributorëve specifik të mallrave, sjellin kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik, të cilët ofertojnë pajisje me parametra më të “lartë” se ato të kërkuar (apo dhe vlera të ngjashme) dhe që plotësojnë kërkesat që pajisja duhet të ketë për të përmbushur qëllimin e kontratës.

Titulli i gjetjes Nr. 3	Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kërkuar asnjë licencë profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020 me vlerë 7,330,000 euro pa TVSh, në kërkesat për kualifikim, pikën 3.3.4 "Kapaciteti teknik" është kërkuar operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë: -ISO 9001: 2015, Çertifikatë për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente me to, lëshuar nga Institucionet e Akredituara për këtë qëllim -ISO 14001: 2015, Çertifikatë për sistemin e menaxhimit mjedisor ose ekuivalente me to, lëshuar nga Institucionet e Akredituara për këtë qëllim".TBS 96 Këto janë ISO të përgjithshme. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kërkuar asnjë licencë profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar, edhe pse kjo kontratë shërbimi është 908,187,000 lekë. Si: ISO 20000-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve IT), ISO 27001-2013 (Për sigurinë e informacionit) etj.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Neni 20 dhe Neni 23 pika 5, Neni 28, pika 2. Ligji Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimi i konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Njësia e prokurimit, Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që në kërkesat për kualifikim në procedura e prokurimit për shërbimet dhe pajisjet të parashikojnë paraqitjen nga operatorët e ekonomikë të licencave profesionale/ISO specifike në përputhje me vlerën dhe natyrën e kontratës.

Titulli i gjetjes Nr. 4	Komisioni i vlerësimit të ofertave pa specialist të fushës.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020, me urdhër nr. 54/2, datë 28.09.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga V. L., M. A., R. K., G. H. dhe F. Z.. Asnjë nga anëtarët e KVO nuk është specialist i fushës (ing. Elektronik)
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, Neni 58.
Ndikimi/Efekti:	Mos kompetencë në vlerësimin e operatorit ekonomik
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korigjuar këtë praktikë në ngritjen e komisioneve të vlerësimit të ofertave pa specialist

	të fushës, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.
--	---

Titulli i gjetjes Nr. 5	Dokumentacion jo i plotë në likuidimin e shërbimit
Situata:	<p>Për blerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, ndërmjet ndërmjet RTSH dhe operatorit/e shoqërisë “R. & S. Os. G.”, është lidhur marrëveshja kuadër me 54/18 prot., datë 26.02.2021 për vlerën 7,329,968 euro me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj.</p> <p>Për periudhën 01.03.2021 deri 30.06.2023 është likuiduar për vlerën 6,007,626 euro.</p> <p>Dokumentacioni i likuidimit: Urdhër transfertat, fatura elektronike, raport SLA të kryera për çdo muaj drejtuar drejtuesit të njësisë teknike të RTSH, i firmosur nga grupet e punës/komisionet e ngritura me urdhër të drejtorit të përgjithshëm për vlerësimin e disponueshmërisë së rrjetit DVB-T2, në mënyrë të njëanshme pa firmosur nga “R. & S. O. G.”. Shkresat muaj për muaj drejtuar drejtorit të përgjithshëm nga drejtori i njësisë teknike, për dërgimin e raporteve/procesverbaleve për shpërblim të kompanisë R. & S. O. G.”.</p> <p>Pagesat janë bërë/kryer :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pa mbajtur akt-kolaudim ndërmjet palëve. -Raportet mbi SLA e kryera, janë të përgjithshme jo të detajuar, ashtu siç është përcaktuar në specifikimet teknike. - Raportet nuk janë sipas aneksit nr. 4 “Formati i raportit periodik për stacionet e RTSH. konkretisht nuk pasqyrohen personat e ngarkuar, data, tipi i stacionit, 4 “Kulla”, 5 “Rrethimi”: a. përshkrimi, b. rezultati i kontrollit, nuk është kontrolluar, c. aktivitete korrektive, shënime; komente; personat e ngarkuar; firma; data.
Kriteri:	Marrëveshja Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, Nenin 21, Neni 5, pika 3, Neni 6, pika 4. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690.
Ndikimi/Efekti:	Risk në likuidim shërbimi të pa kryer
Shkaku:	Keq interpretim i marrëveshjes kuadër.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	- Nga Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa për të rinegociuar me Kompaninë “R. & S. Os. G.”, Austri, Marrëveshjen Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, për të bërë amendimet përkatëse me qëllim që kopjet në anglisht të akt kolaudimeve/procesverbalet e pranimit/akt pranimeve në zbatim të kontratës të jenë të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët, referuar: Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14/1; Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, Kreu VII “Detyrimet dhe kontratat”, Neni 45 “Liria e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm”; Rregullores (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit

	<p>"Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore", Neni 11, pika 1,2,3.</p> <p>- Marrja në dorëzim i shërbimeve të kryera nga Kompania "R. & S. Os. G." Austri, të bëhet konform specifikimeve teknike të përcaktuar në kontratë dhe anekseve përkatëse, me akt kolaudime/procesverbale të pranimit/akt pranime të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët.</p>
--	--

Titulli i gjetjes Nr. 6	Mos zbatim i detyrimeve kontraktuale.
Situata:	Në dokumentet e tenderit dhe në Marrëveshjen Kuadër të lidhur me nr. 54/18 prot., datë 26.02.2021 neni 16, pika 3 është përcaktuar "Ofertuesi i shërbimit organizon trajnime teknike për operimin në mënyrë të pavarur të rrjetit DVB-T2, ose përditësimeve teknologjike për personelin tekniko-inxhinierik të RTSH-së, sipas kërkesave të bëra me shkrim jo më shumë se një herë në vit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk u provuar përmbushja e kësaj kërkesë kontraktuale pasi as RTSH ka bërë kërkesë për trajnim as operatori ekonomik ka bërë trajnime.
Kriteri:	Marrëveshja Kuadër të lidhur me nr. 54/18 prot., datë 26.02.2021 neni 16, pika 3
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos kryerjen e shërbimit konformë specifikimeve teknike
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa që për kontratën marrëveshje kuadër me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2021 të lidhur me nr. 54/18 prot., datë 26.02.2021, nga kontraktori të përmbushet detyrimi kontraktual për trajnimin e personelit tekniko-inxhinierik të RTSH për çdo komponent të sistemit.

2. Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH, viti 2023.

"Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. nr. 558 prot., datë 23.02.2023	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit Urdhër nr. 558 prot., datë 23.02.2023 - E. K.; ing. elektrik - M. K.; - H. Ç..	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 558/1 prot., datë 23.02.2023 - D. D., juriste - V.B.; teknik ndricimi - E. J. S.; ekonomist
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e hapur elektronike-mallra"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 14,314,505 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 13,897,400 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 417,105 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 20.03.2023	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>1</u> OE a) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik 1

b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave	
14. Lidhja e kontratës Nr. Nr. 558/9 prot., më datë 21.04.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 16,676,880 lekë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 139/16 prot., datë 21.02.2023 drejtori i departamentit të prodhimit, i është drejtuar D. D., me detyrë drejtore e drejtorisë juridike duke vënë në dijeni dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, kërkesë për hapje Procedurë prokurimi “Pajisje ndriçimi për studio televizive të RTSH” me vlerë të kontratës 14,314,505 lekë.

Me urdhër Nr. 558/1 prot., datë 23.02.2023 të E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga D. D., juriste, V. B., teknik ndriçimi, E. B., me detyrë specialiste sektori i planifikimit.

Me relacion të protokolluar nr. 139/15 prot., datë 14.02.2023, grupi i punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, i përbërë nga E. K., M. K., dhe H. Ç., ka përcaktuar vlerën 14,314,505 lekë pa TVSH, duke marrë për bazë mesataren e çmimit për çdo artikull nga operatorët “F. E.” Sh.p.k, “T. L. S.” Sh.p.k, “T. S.” Sh.p.k, “T. S.” Sh.p.k dhe “T.S.” Sh.p.k dhe “T. S.” Sh.p.k S. CO ..

Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga Instituti i Statistikave (INSTAT), organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, televizionet private te tjera), veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se :

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoritet/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurimet

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga E. K., M. K. dhe H. Ç..

Me urdhër nr. 558 prot., datë 23.02.2023 të E. J., është urdhëruar prokurimi me mjete elektronike me fond limit 14,314,505 lekë, financuar nga buxheti të ardhurat e RTSH, me objekt “Pajisje

ndriçimi për studio televizive të RTSH”, procedurë e hapur-mallra, me mjete elektronike, grupi për hartimin e dokumenteve të tenderit E. K., H. Ç. dhe M. K..

Kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike janë hartuar me procesverbal me 24.02.2023 i firmosur nga E. K., H. Ç. dhe M.K..

Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3/b “Kapaciteti teknik” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin). Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e përkthyer dhe motorizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave. Ky kriter është “Specifikim i tepërt” apo “Super specifikim”.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Vendosja e këtij kriteri/specifikimi është në keqinterpretim me:

- Rekomandimin Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.

-Ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 93.

-Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021, “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.

-Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

-Vendimin Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur sa më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga E. K., H. Ç. dhe M. K..

Në specifikimet teknike është përcaktuar:

-Driçues fresnel LED

Paketa IP20: Pesha neto: 8.5 kg, pesha bruto: 10 kg.

-Driçues Fresnel LED

Paketa IP20: Pesha neto: 8.5 kg, pesha bruto: 10 kg.

-Ndriçues LED PAR ZOOM (RGBW me zoom).

Dimensioni: 268*270*348mm / pesha neto: 4.5 kg / pesha bruto: 6.5 kg.

-Ndriçues të lëvizshëm LED Spot.

Pesha: 16 kg; Përmasat: 312 x 222 x 590 mm.

-Ndriçues të lëvizshëm LED Wash

Dimensioni: 330*140*345mm; Pesha neto: 7.5 kg, pesha bruto: 8 kg.

-Ndriçues efekti televiziv: Ndriçues retro rrethor led.

Dimensioni: 1040*350*928mm; Pesha neto: 29.5 kg, pesha bruto: 32 kg.

-Ndriçues efekti televiziv: Ndriçues retro vertikal led

Dimensioni: 1040*350*928mm; Pesha neto: 21.5 kg, pesha bruto: 25 kg.

Vendosja në specifikimet teknike të parametrave teknik (përmasat dhe pesha) fiks të ndriçuesve, kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi/ofertuesi në treg, që është Shoqëria “F. E.”Shpk. Për pasojë operatori ekonomik që pajisjet i ka me këto parametra, është fitues i tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*”.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi E. K., anëtar i njësisë së prokurimit me profesion ing. elektrik.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatori ekonomik “F. E.”Sh.p.k.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria “F. E.” Sh.p.k, me ofertë në vlerën 13,897,400 lekë.

Kontrata me operatorin ekonomik “F. E.” Sh.p.k , është lidhur me Nr. 558/9 prot., më datë 21.04.2023 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “F. E.” Sh.p.k përfaqësuar nga administrator A. K., për vlerën 16,676,880 lekë, me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës, me garanci 2 vite nga dorëzimi i mallit pranë RTSH. Nuk është përcaktuar asnjë vlerë/shumë për garancinë e garancisë së kontratës.

Autoriteti Kontraktor nuk ka hartuar plani i zbatimit të kontratës, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

Neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj*”.

Neni 125, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite e “Autoriteti ose enti kontraktor njofton Agjencinë e Prokurimit Publik për nënshkrimin e planit të zbatimit brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij”.

- Udhëzimin e APP nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

-Rekomandimin APP “Drejtoria e Kordinimit dhe Monitorimit”, nr. 7212 prot., datë 19.11.2021.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtorë e drejtorisë juridike dhe R. N., me detyrë ish-zv/drejtor i përgjithshëm.

Autoriteti kontraktor me këtë procedurë prokurimi ka kryer një formalitet burokratik dhe jo procedurë të mirëfilltë prokurimi, duke mos maksimizuar eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, në kundërshtim me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim, por edhe kundërshtim me parimet për rritjen e integritetit në prokurimin publik të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), parime që kanë efekt të drejtpërdrejtë në konkurrencë, në çmimin e paguar nga administrata publike për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e shtetit, pra në burimet e taksapaguesve.

Në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi*

“Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtorë e drejtorisë juridike dhe R. N., me detyrë zv/drejtorit të përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Në kontratën e lidhur si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

-VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës”.

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës”.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtorë e drejtorisë juridike dhe R. N., me detyrë zv/drejtorit të përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Me urdhër nr. 77, datë 12.06.2023, ndryshuar me urdhrin nr. 82, datë 03.07.2023 dhe nr. 82/1, datë 06.07.2023 është ngritur grupi i punës për ndjekjen e kontratës sipas specifikimeve teknike i përbërë nga A. SH., teknik ndriçimi arsimit mesëm i përgjithshëm K. P., teknik ndriçimi bachelor marrëdhënie ndërkombëtare, dhe K. D., teknik ndriçimi arsimit mesëm i përgjithshëm.

Me procesverbal nr. 558/16 prot., datë 19.07.2023 grupi i marrjes në dorëzim është shprehur se pajisjet janë në përputhje me sasitë dhe specifikimet teknike. Në grupin e marrjes në dorëzim nuk ka asnjë specialist të fushës ing. elektrik, ose i mesëm elektrik. Në proces verbal nuk është shënuar kodi i pajisjes, numri serial e të tjera të dhëna teknike, që administrimi dhe ruajtja e pajisjeve të ndriçimit të jetë konform dispozitave ligjore të kontrollit dhe menaxhimit financiar.

Me urdhër tranfertën pa nr. datë 07.08.2023 për vlerën 15,409,437 lekë, është likuiduar Shoqëria “F. E.” Sh.p.k. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi: Faturë elektronike Nr. 39/2023, datë 11.07.2023 për vlerën 16,676,880 lekë, procesverbal me nr. 558/16 prot., datë 19.07.2023 dhe 558/17 prot., datë 26.07.2023 i marrjes në dorëzim nga A. SH., K. P. dhe K. D., fletë hyrje Nr. 184, datë 19.07.2023.

Për mos realizimin në kohë të kontratës operatorit ekonomik “F. E.” Sh.p.k. janë mbajtur 1,267,443 lekë penaltet.

Edhe pse në Nenin 6 të kontratës është përcaktuar garancia me një afat 2 vjeçar, por pa vlerë, nuk është mbajtur asnjë lekë për këtë garanci, duke rrisur në këtë mënyrë që operatori ekonomik mund të mos kryej shërbimin e kontraktuar, për arsye nga më të ndryshmet përfshi dhe ndonjë faliment të mundshëm, duke i dashur në këtë mënyrë RTSH të përcaktoj fonde të tjera.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike dhe R. N., me detyrë zv/drejtorit të përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Pajisjet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Duhet të respektohen termet e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.

Grupi i auditimit i kërkoi RTSH, që kontraktori duke qenë brenda garancisë së difekteve të paraqiste në RTSH: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, dokumentacion të cilin nuk i paraqiti.

Mos shoqërimi/mos paraqitja e raportet e testeve (test raportin e fabrikës) për pajisjet, dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimin dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), nuk mund të konfirmohet që pajisjet janë të njëjta me ata të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “F. E.” Sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike dhe R. N., me detyrë zv/drejtorit të përgjithshëm në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, por i kanë keq menaxhuar ato duke mos arritur qëllimin e tyre, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.

Për mos maksimalizim dhe eficientësi dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, ngarkohet me përgjegjësi R. N., me detyrë ish-zv/drejtorit të përgjithshëm.

Titulli i gjetjes Nr. 1	Dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “F. E.” Sh.p.k, me objekt: “Blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH”, për vlerën prej 15,409,437 lekë viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, duke mos garantuar saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të

	bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “F. E.” Sh.p.k ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.
Kriteri:	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, Neni 21, pika 5 dhe neni 122. Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe neni 690. Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “F. E.”Sh.p.k. Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8. Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.
Ndikimi/Efekti:	Përftimi i pa drejt nga Shoqëria “F. E.”Shpk në vlerën 15,409,437 lekë
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijtur ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “F. E.”, Sh.p.k nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 15,409,437 lekë nga Shoqëria “F. E.” Sh.p.k.

Titulli i gjetjes Nr. 2	Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH në vlerën 14,314,505 lekë viti 2023 përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera/televizioneve private.
Kriteri:	VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76, pik 1 dhe 2.
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale

Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Autoriteti kontraktor të merren masa që përlogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlerë, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Titulli i gjetjes Nr. 3	Në specifikimet teknike janë vendosur parametra teknik fiks.
Situata:	Në procedurën e prokurimit blerje Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH për vlerën 14,314,505, viti 2023, në specifikimet teknike janë vendosur parametra teknik fiks si: Përmasa dhe pesha fiks e ndriçuesve (psh; ndriçues të lëvizshëm led spot; pesha: 16 kg; përmasat: 312 x 222 x 590 mm. etj, parametra që kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi/ofertuesi në treg, që është Shoqëria “F. E.” Sh.p.k. Për pasojë operatori ekonomik që pajisjet i ka me këto parametra, është fitues i tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.
Kriteri:	Ligji Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 Neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2. VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 2 dhe Neni 93. Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë specifikime teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Titulli i gjetjes Nr. 4	Autoriteti Kontraktor nuk ka hartuar plani i zbatimit të kontratës.
Situata:	Kontrata me operatorin ekonomik “F. E.”Shpk, është lidhur me Nr. 558/9 prot., më datë 21.04.2023 për vlerën 16,676,880 lekë, me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës, me garanci 2 vite nga dorëzimi i mallit pranë RTSH. Nuk është përcaktuar asnjë vlerë/shumë për garancinë e garancisë së kontratës. Autoriteti Kontraktor nuk ka hartuar plani i zbatimit të kontratës.
Kriteri:	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, pika 3 dhe Neni 125, pika 1. -Udhëzimi e APP nr. 8, datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. -Rekomandimi APP “Drejtorja e Kordinimit dhe Monitorimit”, nr.

	7212 prot., datë 19.11.2021.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos monitorim siç duhet i kontratës.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që për cdo kontratë të lidhur të bëhet sigurimi i kontratës duke përcaktuar vlerën e garancisë së kontratës, me qëllim garantimin e autoritetit kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Gjithashtu të hartohet plani për zbatimin e kontratës., me qëllim për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, me cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Titulli i gjetjes Nr. 5	Dokumentacionin që shoqëron pajisjet nuk është i plotë, si dhe nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës.
Situata:	Në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023 me operatorin ekonomik “F. E.” Sh.p.k, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. Në kontratën e lidhur si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës.
Kriteri:	-Rekomandimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. -VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5, pika 6. -Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Risk që pajisjet të mos jen sipas përcaktimit në specifikimeve teknike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në përcaktimin e dokumentacionin që shoqëron pajisjet, raportimin në APP për çdo fazë të realizimit të kontratave, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Titulli i gjetjes Nr. 5	Përcaktimi në kërkesat për kualifikim autorizimi i prodhuesit.
Situata:	Në procedurën e prokurimit blerje “Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH” për vlerën 14,314,505, viti 2023, në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3/b “Kapaciteti teknik” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin). Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe motorizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së

	<p>ofertave. Ky kriter është “Specifikim i tepërt” apo “Super specifikim”. Vendosija e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.</p>
Kriteri:	<p>- Rekomandimi Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.</p> <p>-Ligji Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 93.</p> <p>-Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.</p> <p>-Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.</p> <p>-Vendimi Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.</p>
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

3. Furnizim-vendosije, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, viti 2023.

“Furnizim-vendosije, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 218 prot, datë 17.01.2023	3. Hartimi i dokumenteve të tenderit Urdhër 218 prot, datë 17.01.2023 -F. V.; ing. IT -Xh. J.; ekonomiste -M. P.; juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 218/1 prot, datë 17.01.2023 -B. M.; ing. IT -D. D.; juriste -G. Z.; ing. IT
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur elektronike-mallra”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 22,231,737 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 12,500,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 9,731,737 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 08.01.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 5_OE

.		a) Kualifikuar ___5___ OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik 1
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 15,000,000 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 2264/24 prot., datë 04.01.2023 B. M., me detyrë drejtore e drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit, i është drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, kërkesë për hapje Procedurë prokurimi “Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH” , me vlerë të kontratës 22,231,737 lekë.

Me kërkesë nr. 3500/15 prot., datë 25.10.2022 B. M., i drejtohet D. D., me detyrë drejtore e drejtorisë juridike duke vënë në dijeni dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, ku ndër të tjera citohet: “...Grupi i punës duhet të bëjë rishikimin dhe riorganizimin e specifikimeve teknike, bazuar në nevoja emergjence të RTSH për riparimin e harddiskut të dëmtuar, eliminimin e gabimeve të shfaqura në sistemin e operimit, rikthimin në gjendjen e plotë funksionale të sistemit në tërësi, si dhe garantimin e shërbimit të mirëmbajtjes për një periudhën 2-vjeçare”.

Me kërkesë nr. 3500/6 prot., datë 28.10.2022 D. D., me detyrë drejtore e drejtorisë juridike i drejtohet B. M., me detyrë drejtore e drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit duke vënë në dijeni dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm , ku ndër të tjera citohet “..... Ju lutem konkretizoni objektin e procedurave që referoheni në shkresën tuaj. Duke qenë se keni referuar nevojën për mirëmbajtje e cila është shërbim dhe gjithashtu “Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH, na sqaroni nëq procedura e mirëmbajtjes ka lidhje të drejtpërdrejt me zhvillimin e procedurës për zgjerimin storage”. Gjithashtu na sqaroni nëq këto procedura janë homogjene apo jo, si dhe nëse kemi të bëjmë me procedura shërbimi në të dyja rastet, në mënyrë që të vijojmë me ngritje e grupi/grupeve të punës sipas kërkesës suaj, por dhe për të shmangur rrezikun e dështimit të realizimit të procedurave”.

Me kërkesë nr. 3500/17 prot., datë 04.11.2022 B. M., i drejtohet D. D., me detyrë drejtore e drejtorisë juridike duke vënë në dijeni dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, ku ndër të tjera citohet: Kërkesë për ri ngritjen e grupit të punës për argumentimin e nevojave, specifikimeve teknike dhe fondit limit për realizimin e procedurës për “Mirëmbajtjen dhe garantimin e funksionalitetit të storage ekzistues, si dhe shtimin e kapaciteti për nevoja të RTSH. Nevojitet shërbimi mirëmbajtje për storage ekzistues për një periudhë 2-vjeçare, ku përfshihet për riparimin e harddiskut të dëmtuar, eliminimin e gabimeve të shfaqura në sistemin e operimit, rikthimin në gjendjen e plotë funksionale të sistemit në tërësi”. Gjithashtu, bazuar në natyrën që institucioni yn ka, ku gjatë gjithë kohës, është në prodhim dhe arkivim, nevoja për shtim kapaciteti në storage sa vjen dhe rritet. Për këtë arsye, kërkojmë ngritjen e grupi të punës për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe fondin limit me objekt “Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH”.

Me relacion të protokolluar nr. 2264/23 prot., datë 27.12.2023, grupi i punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, i përbërë nga F. V., A. N. dhe M. P., ka përcaktuar vlerën 22,231,737 lekë pa TVSH, duke marr mesataren e tre ofertave, pas ofertës në çmim mestar të ofruar nga operatorët “TBS” Sh.p.k në vlerën 14,800,000 lekë, “A.” Sh.p.k në vlerën 34,325,000 lekë dhe “A.A.N” Sh.p.k në vlerën 8,600,000 lekë.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, televizionet private, etj) veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoritet/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga F. V., A. N. dhe M. P..

Me urdher nr. 218 prot, datë 17.01.2023 të E. J., është urdhëruar prokurimi me mjete elektronike me fond limit 22,231,737 lekë financuar nga të ardhurat e RTSH, me objekt Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, procedurë e hapur-mallra, me mjete elektronike, grupi për hartimin e dokumenteve të tenderit F. V., Xh. J. dhe M. P..

Theksojmë se:

-Në vitin 2020, RTSH ka zhvilluar procedurën e prokurimit Furnizim-vendosje, pajisje dhe programeve për shtimin e arkivës për nevoja te RTSH, për vlerën 32,154,035 lekë. Kontrata me Operatorin Ekonomik “S. T. A.”sh.p.k, është lidhur Nr. 35/16 prot., më datë 01.07.2020 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga Th. G., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “S. T. A.”sh.p.k përfaqësuar nga administrator K. P., për vlerën 32,154,035 lekë.

-RTSH nuk ka kryer një vlerësim kosto-përfitim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për ruajtjen e të dhënave video. Aktualisht, RTSH ka në pronësi dhe përdorim:

- Sistemin Storeasy

- Sistemin Mam me Storage (hapësirë ruajtjeje e të dhënave) Isilon dhe Backup Veam+ LTO9,

- Sistemin QSAN

Këto sisteme janë prokuruar për të njëjtin qëllim, ruajtjen dhe arkivimin e Videove të RTSH.

Në opinionin e grupit të auditimit, RTSH nuk ka justifikuar nevojën e një investimi sistem+Storage , pasi ka pasur në pronësi edhe sistemin MAM me Storage Isilon dhe Kasetat LTO9.

Veprime në kundërshtim me:

Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” , Neni 2 dhe Neni 21, pika 5.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.

Referuar sa më sipër vlera 13,860,000 lekë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga B. M., me detyrë drejtore e drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit dhe E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me urdhër Nr. 142, datë 04.11.2022 protokolluar në RTSH me Nr. 3500/18 prot., datë 04.11.2022, i ndryshuar me 142/1 datë 08.11.2022 të E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm është ngritur grupi i punës për argumentimin e fondit limit, si dhe hartimin e specifikimeve teknike i përberë nga S. B., N. M. dhe M.P..

Me urdhër Nr. 218/1 prot., datë 17.01.2023 të E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga B. M., ing. IT, D. D., juriste, G. Z., ing. IT.

Specifikimet teknike janë hartuar me procesverbal datë 20.01.2023 i firmosur nga F. V., Xh. J. dhe M. P., për pajisjet si më poshtë:

-Pajisje për ruajtjen dhe leximin e medias -30233000-1;

-Pajisje elektronike-31710000-6;

-Paketa software dhe sisteme informacioni- 48000000-8;

-Paketa software për komunikim dhe multimedia 48500000-3.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me procesverbalin e datës 08.02.2023 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F. V., Xh. J. dhe M. P..

Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.1 “Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale” është kërkuar Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

-ISO 9001: 2015, Certifikatë për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente me to, lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim

-Certifikatë ISO/IEC 27001:2013 ose ekuivalente e tij për “Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit”.

Nuk është kërkuar asnjë licencat profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar, edhe pse kjo kontratë shërbimi është 15,000,000 lekë. Si ISO 20000-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve IT) etj.

Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3 “Kapaciteti teknik:” është kërkuar operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për sistemin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.

Ky kriter është “Specifikim i tepërt” apo “Super specifikim”.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e

tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Vendosja e këtij kriteri/specifikimi është në keqinterpretim me:

- Rekomandimin Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.

-Ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 93.

-Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021, “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.

-Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet vijuese të tij, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

-Vendimin Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur sa më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga F. V., Xh. J. dhe M. P..

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë:

-Shoqëria ”T.” Shpk, me ofertë në vlerën 12,500,000 lekë.

-Shoqëria ”P. S.” Sh.p.k, me ofertë në vlerën 16,674,000 lekë.

-Shoqëria ”S&T A.” Shpk, me ofertë në vlerën 16,674,500 lekë.

-Shoqëria ”B. E.” Shpk, me ofertë në vlerën 17,154,370 lekë.

-Shoqëria ”A.” Shpk, me ofertë në vlerën 17,984,000 lekë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria “T.” Shpk, me ofertë në vlerën 12,500,000 lekë.

Kontrata me operatorin ekonomik “T.” shpk, është lidhur Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “T.” shpk përfaqësuar nga administrator A. Xh., për vlerën 15,000,000 lekë, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Nga autoriteti kontraktor nuk hartuar plani i zbatimit të kontratës, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

-Neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj*”.

-Neni 125, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite e “Autoriteti ose enti kontraktor njofton Agjencinë e Prokurimit Publik për nënshkrimin e planit të zbatimit brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij”.

- Udhëzimin e APP nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

-Rekomandimin APP “Drejtoria e Kordinimit dhe Monitorimit”, nr. 7212 prot., datë 19.11.2021. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike dhe R. N., me detyrë ish-zv/drejtor i përgjithshëm.

Në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në

mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike dhe R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të përgjithshëm.

Në kontratën e lidhur si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës në kundërshtim me:

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penaltet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës”.*

Pika 6, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“.....Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin”.*

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 125 “Detyrimet e autoritetit kontraktor ndaj Agjencisë së Prokurimit Publik”, pika 3 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Në përfundim të zbatimit të një kontrate, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrim të dërgojë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, jo më vonë se 30 ditë nga data e përfundimit të kontratës”.*

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike dhe R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të përgjithshëm.

Me urdhër tranfertën pa nr, datë 28.06.2023 për vlerën 13,860,000 lekë, është likuiduar Shoqëria “T.” Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH”. Dokumentet vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi, faturë elektronike Nr. 123/2023, datë 15.06.2023 për vlerën 15,000,000 lekë, relacion mbi marrjen në dorëzim të storage me nr. 218/16 prot., datë 03.07.2023 drejtuar E. D., me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike nga grupi i punës i marrjes në dorëzim i përbërë nga E. J., S. B. dhe E. K., procesverbal datë 03.07.2023 i marrjes në dorëzim nga E. J., S. B. dhe E. K., fletë hyrje Nr. 180, datë 03.07.2023 deklaratë e garancisë për një afat 2-vjeçar.

Pajisjet janë të pa shoqëruara me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Operatori ekonomik “T” Shpk në ofertën teknike ka paraqitur: Emërtimi i kompanisë prodhuese “Q.” dhe origjina e mallit Taiwan. Duke mos paraqitur certifikatën e origjinës , operatori ekonomik nuk provon/vërteton se pajisjet janë me origjinë nga Taiwan.

Grupi i auditimit i kërkoj RTSH që kontraktori duke qenë brenda afatit të kontratës të paraqiste në RTSH : Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, dokumentacion të cilin nuk u paraqit.

Mos shoqërimi me raportet e testeve (test raportin e fabrikës) për pajisjet, dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimin dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), që të konfirmohet që pajisjet janë të njëjta me ata të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “T” Sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Nga operatori ekonomik është paraqitur test raport nga distributori ISL (International Standarts Laboratory Corp.), distributor i autorizuar nga “Q.”, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokument i cili është i akredituar për të bërë test raportet e pajisjeve, test raporti ne këto kushte (referuar ofertës teknike) duhet te ishte lëshuar nga kompania prodhuese Q..

Për sa trajtuam si më sipër test raporti i paraqitur është dokument i pa besueshëm për tu marr në konsideratë nga grupi i auditimit..

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtores e drejtorisë juridike dhe R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të përgjithshëm.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar efikasitetin dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, por i kanë keqmenaxhuar ato jo vetëm duke mos arritur qëllimin e tyre, por edhe duke shkaktuar dëm ekonomik RTSH dhe Buxhetit të Shtetit veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.

Për mos maksimalizim dhe efikasitet dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, ngarkohet me përgjegjësi E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm dhe R. N., me detyrë ish-zv/drejtor i përgjithshëm.

Titulli i gjetjes Nr. 1	RTSH nuk ka kryer një vlerësim kosto-përfitim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për ruajtjen e të dhënave video, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 32,154,035 lekë.
Situata:	Me urdhër nr. 218 prot, datë 17.01.2023 të E. J., është urdhëruar prokurimi me mjete elektronike me fond limit 22,231,737 lekë me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, procedurë e hapur-mallra, me mjete elektronike. Në vitin 2020, RTSH ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: Furnizim-vendosje, pajisje dhe programeve për shtimin e arkivës për nevoja te RTSH, për vlerën 32,154,035 lekë. Kontrata me operatorin ekonomik “S. T. A.”sh.p.k, është lidhur Nr. 35/16 prot., më datë 01.07.2020 për vlerën 32,154,035 lekë. -RTSH nuk ka kryer një vlerësim kosto-përfitim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për ruajtjen e të dhënave video. Aktualisht, RTSH ka në

	<p>pronësi dhe përdorim: Sistemin Storeasy; Sistemin Mam me Storage (hapësirë ruajtjeje e të dhënave) Isilon dhe Backup Veam+ LTO9; Sistemin QSAN. Këto sisteme janë prokuruar për të njëjtin qëllim, ruajtjen dhe arkivimin e videove të RTSH.</p> <p>Grupi i auditimit gjykon se RTSH nuk ka justifikuar nevojën e një investimi sistem+Storage, pasi ka pasur në pronësi edhe sistemin MAM me Storage Isilon dhe Kasetat LTO9 dhe duhet të kishte investuar për rritjen e kapacitetit të sistemit ekzistues.</p> <p>Referuar sa më sipër vlera 13,860,000 lekë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga B. M., me detyrë drejtore e drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit dhe E. J., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>
Kriteri:	<p>Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” , Neni 2 dhe Neni 21, pika 5.</p> <p>Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8.</p> <p>Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq menaxhim i fondeve publike.
Shkaku:	Shkelje e dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 13,860,000 lekë nga B. M., me detyrë ish-drejtore e Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit dhe E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..

Titulli i gjetjes Nr. 2	Dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “T” sh.p.k, me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH në vlerën 13,860,000 lekë, viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, duke mos garantuar vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “T” ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Grupi i auditimit

	i kërkoj RTSH që kontraktori duke qenë brenda afatit të kontratës të paraqiste në RTSH: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, dokumentacion të cilin nuk u paraqit.
Kriteri:	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” , Neni 2 dhe Neni 21, pika 5. Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8. Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.
Ndikimi/Efekti:	Përfitim i pa drejt i vlerës 13,860,000 lekë nga Shoqëria “T” Sh.p.k.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përbërësuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Titulli i gjetjes Nr. 3	Nuk është kërkuar asnjë licencat profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar.
Situata:	Në procedurën e prokurimit Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH, viti 2023, në kërkesat për kualifikim, pikën 2.1 “Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale” është kërkuar Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë: -ISO 90012015, Certifikatë për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente me to, lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim -Certifikatë ISO/IEC 27001:2013 ose ekuivalente e tij për “Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit”. Nuk është kërkuar asnjë licencat profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar, edhe pse kjo kontratë shërbimi është 15,000,000 lekë. Si ISO 20000-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve IT) etj.
Kriteri:	Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 Neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2. VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 2 dhe Neni 93. Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë specifikime teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.
---------------------	---

Titulli i gjetjes Nr. 4	Përcaktimi në kërkesat për kualifikim kriteri autorizimi i prodhuesit.
Situata:	<p>Në procedurën e prokurimit Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, viti 2023, në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3 “Kapaciteti teknik:” është kërkuar operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për sistemin objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.</p> <p>Ky kriter është “Specifikim i tepërt” apo “Super specifikim”.</p> <p>Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.</p>
Kriteri:	<p>- Rekomandimi Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.</p> <p>-Ligji Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 93.</p> <p>-Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021, “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.</p> <p>-Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.</p> <p>-Vendimi Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.</p>
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë

Rekomandime:	Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.
---------------------	--

Titulli i gjetjes Nr. 5	Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun.
Situata:	Në procedurën e prokurimit Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH, viti 2023, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, televizionet private, etj).
Kriteri:	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76. “ 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për shpërdorimi i fondeve publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Autoriteti kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlerë, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Titulli i gjetjes Nr. 6	Autoriteti Kontraktor nuk hartuar planin e zbatimit të kontratës.
Situata:	Kontrata me Operatorin Ekonomik “T” shpk, për furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH, viti 2023, është lidhur Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, për vlerën 15,000,000 lekë, me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Autoriteti Kontraktor nuk hartuar plani e zbatimit të kontratës.
Kriteri:	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: -Neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, pika 3. Udhëzimi i APP nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. -Rekomandimi APP “Drejtorja e Kordinimit dhe Monitorimit”, nr. 7212 prot., datë 19.11.2021.
Ndikimi/Efekti:	Risk për shpërdorimi i fondeve publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korigjuar këtë

	praktikë në përcaktimin e vlerës/shumës për garancinë e kontratës, hartimin e planit të zbatimit të kontratës, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.
--	---

Titulli i gjetjes Nr. 7	Nga Autoriteti Kontraktor nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike
Situata:	Në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, për Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH, për vlerën 15,000,000 lekë viti 2023, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. Në kontratën e lidhur si më sipër nuk është raportuar në APP për çdo fazë të realizimit të kontratës.
Kriteri:	Rekomandimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 12.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos zbatimin e specifikimeve teknike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në përcaktimin e dokumentacionin që shoqëron pajisjet, raportimin në APP për çdo fazë të realizimit të kontratave, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

4. Blerje karburanti viti 2021

Blerje karburanti viti 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. nr. 8/2 prot., datë 19.03.2021	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit Urdhër 8/2 prot., datë 19.03.2021 - G. A., jurist - E.B., ing. mekanik - F. Z..	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 8/3 prot., datë 23.03.2021 - B. M.. - M. A.. - K.. B..
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur elektronike-mallra-marrëveshje”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 32,415,472 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 32,415,472 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 20.04.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër <u>1</u> BOE a) Kualifikuar <u>1</u> BOE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. Nr. 558/9 prot., më datë 21.04.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 32,415,472 lekë x 2= 64,830,944 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me urdhër titullarit të autoritet kontraktor nr. /2 prot., datë 19.03.2021, është urdhëruar të kryhet procedura e prokurimit elektronike, procedurë e hapur, me fond limit 32,415,472 lekë, financiar nga të ardhurat e RTSH, marrëveshje kuadër me afat 24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Me urdhër të titullarit Nr. 8/3 prot., datë 23.03.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga: B. M., M. A. dhe K. B..

Asnjë nga anëtarët e KVO nuk është specialist i hidrokarbureve, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 58, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës”. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Th. G., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm.

Me urdhër të titullarit të autoritet kontraktor nr. 8, datë 11.02.2021, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga F. Z., M. A. dhe K. B..

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 32,415,472 lekë, pas çmimit mesatar litër (134.17 lekë/litër) të ofruara nga operatorët ekonomik “BOV-OIL” 133.3 lekë/litër, “2A.-L. Oil” Shpk 135 lekë/litër dhe “A&T” Sh.a 134.2 lekë/litër.

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni n.q.s ka, ose radio televizioneve private).

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Si konkluzion, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, ose radio televizioneve private, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 59, pika 2.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi F. Z., M. A. dhe K. B..

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me procesverbal nr. 8/6 datë 30.03.2021 të firmosur nga njësia e prokurimit te përbërë nga G. A., E. B. dhe F. Z..

Me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 8/2 prot., datë 19.03.2021 është emëruar njësia e prokurimit ë përbërë nga G. A., E. B. dhe F. Z.. Asnjëri prej tyre nuk është specialist i hidro karbureve.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 57 pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

Veprimi cili ngarkon me përgjegjësi Th. G., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm.

Në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik” është përcaktuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë lejen e tregtimit të karburanteve ose autorizim nga pushteti vendor në përputhje me Ligjin Nr.8450 dt. 24.02.1999, “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Duhet të ishte: Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me autorizim/licencë për tregtim karburantesh me pakicë, lëshuar nga pushteti vendor, sipas adresave të stacioneve të shitjes me pakicë të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga G. A., E. B. dhe F. Z. Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, kanë marr pjesë operatorët ekonomike.

-Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “O.” shpk & “P. R. O.” sh.a me ofertë marzh fitimi 19.9 %, me vlerë 64,830,944 lekë për sasinë 883,200 litra .

Kontrata e bashkëpunimit lidhur datë 16.04.2021 ndërmjet shoqërisë “P. R. O.” (PRO) sh.a dhe shoqërisë “O.” shpk, për blerje karburanti, në pikën 1/c është përcaktuar “Shoqërisë “P. R. O.,” sh.a do të ofroj 20 % të sasisë së furnizimit me karburant të parashikuar në grafikun e lëvrimit. Kjo përqindje do të shërbejë dhe për ndarjen e fitimit. Në pikën 1/K është përcaktuar “Palët do të bashkëpunojnë në partneritet me njëri tjetrin për kërkesat e kërkuara në DST, sipas kushteve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi “P. R. O.,” (PRO) sh.a 20% dhe shoqëria “O.” shpk me 80%, kjo përqindje do të shërbejë dhe për ndarjen e fitimit ndërmjet palëve.

Në pikën 1/l është përcaktuar: Furnizimi do të realizohet në të gjitha pikat e shitjes “O.” Sh.p.k me tollona, karta elektronike etj.

Në pikën 1/m është përcaktuar: Palët bien dakort që të gjitha faturimet dhe pagesat do të bëhen në emër të shoqërisë “O.” Sh.p.k, e cila në përputhje më kushtet në këtë kontratë bashkëpunimi, do të realizojë shlyerjen e vlerës përkatëse pranë shoqërisë “P. R.” (P.)sh.a.

Kjo kontratë në pikën 1/K dhe 1/M është në kundërshtim me objektin e aktivitetit të shoqërisë “P. R. O.,” (P.), objekt i cili referuar:

-Ekstraktit të regjistrimit tregtar të kësaj shoqërie është “Import-Eksport, tranzit, përpunim, transport, **tregti me shumicë i naftës**, gazit dhe nënprodukteve”. Pra kjo shoqëri nuk ka të drejt të tregtoj me pakicë i naftë.

-Licencës së dhënë nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë Qendra Kombëtare e Biznesit) LN-5558-08-212 me objekt “Tregtim me shumicë i produkteve, benzinë kateg II/A, gazoil kat. III/A, solar kat. IV/B, Mazut kat. V/B , naftë bruto kat. 0/A. Vendi i veprimtarisë: Qarku Fier, rrethi: Fier, Patos B/K: Q/F. Adresa Grizq, Qarku Durrës: Rrethi Durrës B/K, Katundi i Ri Q/F: Adresa Porto Romano.

Objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik “P. R. O.,” (P.), është në kundërshtim me kërkesat për kualifikim pika 2.3.3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi SSH EN 590:2013 + A1:2017 për Gazoil (10 ppm ULSD) me tollona (bileta)/ karta elektronike të vlefshme në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës), të vendosura në qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Peqin, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Ersekë, Tepelenë, Gjirokastrë, Sarandë, Shkodër, Burrel, Kukës. (Jo më pak se 3(tre) pika në Tiranë).

Deri më datë 16.07.2023, datë që përfundoi kontrata, operatori ekonomik “P. R. O.,” (P.), nuk ka furnizuar asnjë litër naft RTSH.

Marrëveshja kuadër/kontrata është lidhur me nr. 08/11 prot., datë 16.07.2021, ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga M. L., në cilësinë e zv/drejtorit të përgjithshëm dhe bashkimit të operatorëve/e shoqërive “O.” Sh.p.k dhe Shoqërisë “P. R. O.,” (P.) Sh.a në vlerën 77,797,132 lekë pa TVSh, me marzh fitimi 19.9 %, kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 24 muaj, me datë fillimi nënshkrimit e kontratës, në sasinë 242,000 litra me kartë elektronike dhe 241,200 litra për motor gjeneratorët.

Referuar sa mësipër, kualifikimi, shpallja fitues e bashkimit të operatorëve/e shoqërive “O.” Sh.p.k dhe Shoqërisë “P. R. O.,” (P.) Sh.a, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 66 pika 3, Neni 74, pika 1 dhe 2, Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga B. M., M. A. dhe K. B..

Titulli i gjetjes Nr. 1	Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun.
Situata:	Në procedurën e prokurimit Blerje karburanti viti 2021, për vlerën 32,415,472 lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, televizionet private, etj).
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 59, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për shpërdorimi i fondeve publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga Autoriteti kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlerë, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Titulli i gjetjes Nr. 2	Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit pa specialist të fushës.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje karburanti viti 2021 32,415,472 lekë, me urdhër të titullarit Nr. 8/3 prot., datë 23.03.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga: B. M., M. A. dhe K. B.. Asnjë nga anëtarët e KVO nuk është specialist i hidrokarbureve. Me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 8/2 prot., datë 19.03.2021 është emëruar njësia e prokurimit të përbërë nga G. A., E. B. dhe F. Z.. Asnjëri prej tyre nuk është specialist i hidro karburëve.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 57 pika 2d dhe Neni 58, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Shtrembërimin e konkurrencës
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në ngritjen e komisioneve të vlerësimit të ofertave dhe njësie së prokurimit pa specialist të fushës, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Titulli i gjetjes Nr. 3	Kualifikimi, shpallja fitues e Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “O.” shpk & “P. R. O.” sh.a, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje karburanti viti 2021 për vlerën 32,415,472 lekë, kualifikimi, shpallja fitues e Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “O.” shpk & “P. R. O.” sh.a, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë. Konkretisht: Kontrata e bashkëpunimit lidhur datë 16.04.2021 ndërmjet shoqërisë “P. R. O.” (P.) sh.a dhe shoqërisë “O.” Sh.p.k, për blerje karburanti, në pikën 1/c është përcaktuar “Shoqërisë “P. R. O.” (P.) sh.a do të ofrojë 20 % të sasisë së furnizimit me karburant të parashikuar në grafikun e lëvrimin. Kjo kontratë në pikën 1/K dhe 1/M është në kundërshtim me: Objektin e aktivitetit të shoqërisë “P. R. O.” (P.), objekt i cili referuar, ekstraktit të regjistrimit tregtar të kësaj shoqërie është “Import-Eksport, tranzit, përpunim, transport, <i>tregti me shumicë i naftës</i> , gazit dhe nënprodukteve”. Pra kjo shoqëri nuk ka të drejtë të tregtojë me pakicë naftë. -Licencës së dhënë nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë Qendra Kombëtare e Biznesit) LN-5558-08-212 me objekt “Tregtim me shumicë i produkteve, benzinë kateg II/A, gazoil kat. III/A, solar kat. IV/B, Mazut kat. V/B , naftë bruto kat. 0/A. Vendi i veprimtarisë: Qarku Fier, rrethi: Fier, Patos B/K: Q/F. Adresa Grizq, Qarku Durrës: Rrethi Durrës B/K, Katundi i Ri Q/F: Adresa Porto Romano. Objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik “P. R. O.” (P.), është në kundërshtim me kërkesat për kualifikim pika 2.3.3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë

	furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi SSH EN 590:2013 + A1:2017 për Gazoil (10 ppm ULSD) me tollona (biletë)/ karta elektronike të vlefshme në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës), të vendosura në qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Peqin, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Ersekë, Tepelene, Gjirokastër, Sarandë, Shkodër, Burrel, Kukës. (Jo me pak se 3(tre) pika në Tiranë). Deri më datë 16.07.2023, datë që përfundoi kontrata me operatorin ekonomik “P. R. O.,” (PRO), nuk ka furnizuar asnjë litër naft RTSH.
Kriteri:	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92. VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 66 pika 3, Neni 74, pika 1 dhe 2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118.
Ndikimi/Efekti:	Keq menaxhim i fondeve
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga RTSH t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

5. Zbatimi i kontratës së shërbimit nr. 456/33 port., datë 11.05.2023 “Për Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”, viti 2023.

Me urdhër transertë pa nr, datë 13.06.2023 nëpërmjet B. është likuiduar shoqëria “T” shpk në vlerën 252,000 lekë. Dokument vërtetues: Fatura nr.96/2023 datë 30.05.2023 për vlerën 252,000 lekë. Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 456/43 prot., datë 30.05.2022 i firmosur nga F. M., E. F. dhe D. Rr..

Kontratë shërbimi nr. 456/33 port., datë 11.05.2023 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T” për vlerën 252,000 lekë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë zv/drejtorit të përgjithshëm dhe për “T” shpk nga A. H., në cilësinë e administratorit. Raport teknik nr. 456/44 prot., datë 30.05.2023 i mbajtur nga “T.” Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”.

RTSH ka lidhur kontratë shërbimi nr. 68/16 prot., datë 14.04.2021, ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.”, për 36 muaj me vlerë totale 14,011,200 lekë e firmosur për RTSH nga Th. G., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe për “T” sh.p.k nga A. H., në cilësinë e administratorit.

Kjo kontratë është me objekt: Shërbim mirëmbajtje për Head-End-In Satelitor”, sipas çmimit të deklaruar në ofertë, specifikimeve teknike, afateve të përcaktuara në këtë kontratë si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor.

Zhvillimi i procedurës blerje me vlera të vogla ”Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”, me urdhër prokurim nr. 456/28 prot., datë 27.04.2023 firmosur nga R. N., në cilësinë zv/drejtorit të përgjithshëm shkaktonte mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e shërbimit nr. 68/16 prot., datë

14.04.2021 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T” për 36 muaj me vlerë totale 14,011,200 lekë.

Siç pasqyrohet në të dy kontratat është i njëjti operator ekonomik fituesi i të dy shërbimeve “T” sh.p.k .

Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Begotimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqërinë “T.” sh.p.k në vlerën **252,000** lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 655, “Begotimi pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit”.

Vlera **252,000 lekë** përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria “T” sh.p.k

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar efijencën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, por i kanë keq menaxhuar ato duke mos arritur qëllimin e Tyre, veprim në kundërshtim me :

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, pika 23/f, g.

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2.

-Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

Për mos maksimizimi dhe efijencë dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, ngarkohet me përgjegjësi H. M., me detyrë drejtor i njësisë teknike, R. N., me detyrë zv/drejtorit të përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i drejtorisë ekonomike për periudhën 21.02.2022 -04.07.2023.

Titulli i gjetjes Nr. 1	Pagesë e dubluar
Situata:	Me urdhër transertë pa nr, datë 13.06.2023 nëpërmjet B. është likuiduar shoqëria “T” sh.p.k në vlerën 252,000 lekë. Dokument vërtetues: Fatura nr. 96/2023 datë 30.05.2023 për vlerën 252,000 lekë. Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 456/43 prot., datë 30.05.2022 i firmosur nga F. M., E. F. dhe D. Rr.. Kontratë shërbimi nr. 456/33 port., datë 11.05.2023 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T” për vlerën 252,000 lekë. Raport teknik nr. 456/44 prot., datë 30.05.2023 i mbajtur nga “T.” Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”. RTSH ka lidhur kontratë shërbimi nr. 68/16 prot., datë 14.04.2021, ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.” për 36 muaj me vlerë

	<p>totale 14,011,200 lekë. Kjo kontratë është me objekt: Shërbim mirëmbajtje për Head-End-In Satelitor”, sipas çmimit të deklaruar në ofertë, specifikimeve teknike, afateve të përcaktuara në këtë kontratë si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor.</p> <p>Zhvillimi i procedurës blerje me vlera të vogla ”Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”, me urdhër prokurim nr. 456/28 prot., datë 27.04.2023 firmosur nga R. N., në cilësinë zv/drejtorit të përgjithshëm shkakton mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e shërbimit nr. 68/16 prot., datë 14.04.2021 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.” për 36 muaj me vlerë totale 14,011,200 lekë.</p> <p>Siç pasqyrohet në të dy kontratat është i njëjti operator ekonomik fituesi i të dy shërbimeve “T.” shpk .</p> <p>Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Bëgatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht shoqërinë “T.” sh.p.k në vlerën 252,000 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 655, “Bëgati pa shkak”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të bëgatimit”.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, pika 23/f, g.</p> <p>Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2, Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21.</p> <p>Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.</p> <p>Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq menaxhim i fondeve publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 252,000 lekë nga shoqëria “T.” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkakton mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën nr. 68/16 prot., datë 14.04.2021, ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.”, për 36 muaj me vlerë totale 14,011,200 lekë.

6. Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent, viti 2023.

Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 41/1 prot, datë 23.01.2023	3. Hartimi i dokumenteve te tenderit Urdhër 41/1 prot, datë 23.01.2023 -S. B., ing. IT -L. M., ing. IT -M. P., juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 41/2 prot., datë 23.01.2023 -B. M., ing. IT -D. D., juriste -A. N., ing. IT
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur elektronike-sherbime”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 22,231,737 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 20,650,320 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,581,417 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.02.2023	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _1_ OE a) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime-	12. -	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik 1
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. Nr. 41/11 prot., më datë 13.03.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh), 20,650,320 lekë	

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Me shkresën nr. 41 prot., datë 05.01.2023 B. M., me detyrë drejtore e drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit, i është drejtuar E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, kërkesë për hapje Procedurë prokurimi “Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent me vlerë të kontratës 20,880,000 lekë.

Me urdhër Nr. 143, datë 04.11.2022 protokolluar në RTSH me Nr. 3500/19 prot., datë 04.11.2022, i ndryshuar me nr. 143/1, datë 08.11.2022 të E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm është ngritur grupi i punës për argumentimin e fondit limit, si dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga S. B., L. M. dhe M. P..

Me kërkesë nr. 3500/15 prot., datë 25.10.2022 B. M., i drejtohet D. D., me detyrë drejtore e drejtorisë juridike duke vënë në dijeni dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, ku ndër të tjera citohet: “...Grupi i punës duhet të bëjë rishikimin dhe riorganizimin e specifikimeve teknike, bazuar në nevoja emergjence të RTSH për riparimin e harddiskut të dëmtuar, eliminimin e gabimeve të shfaqura në sistemin e operimit, rikthimin në gjendjen e plotë funksionale të sistemit në tërësi, si dhe garantimin e shërbimit të mirëmbajtjes për një periudhën 2-vjecare”.

Me kërkesë nr. 3500/16 prot., datë 28.10.2022 D. D., me detyrë drejtore e drejtorisë juridike i drejtohet B. M., me detyrë drejtore e drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit e vënë në dijeni dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, ku ndër të tjera citohet “..... Ju lutem konkretizoni objektin e procedurave që referoheni në shkresën tuaj. Duken qenë se keni referuar nevojën për mirëmbajtje e cila është shërbim dhe gjithashtu “Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH, na sqaroni nëq procedura e mirëmbajtjes ka lidhje të drejtpërdrejt me zhvillimin e procedurës për zgjerimin storage”. Gjithashtu na sqaroni nëq këto procedura janë homogjene apo jo, si dhe nëse kemi të bëjmë me

procedura shërbimi në të dyja rastet, në mënyrë që të vijojmë me ngritje e grupi/grupeve të punës sipas kërkesës suaj, por dhe për të shmangur rrezikun e dështimit të realizimit të procedurave”.

Me relacion të protokolluar nr. 3500/42 prot., datë 29.12.2022, grupi i punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, i përbërë nga S. B., L. M. dhe M. P., ka përcaktuar vlerën 22,231,737 lekë pa TVSH, duke marrë mesataren e katër ofertave, pas ofertës në çmim mestar të ofruar nga operatorët “T.” Sh.p.k në vlerën 19,800,000 lekë, “A.” Sh.p.k në vlerën 19,994,005 lekë, “S. A.” Sh.p.k në vlerën 20,945,995 lekë, “A..” Sh.p.k në vlerën 22,780,000 lekë.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, televizionet private të tjera) veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoritet/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga S. B., N. M. dhe M. P..

Me kërkesë nr. 3500/17 prot., datë 04.11.2022 B. M., i drejtohet D. D., me detyrë drejtores drejtorisë juridike duke vënë në dijeni dhe E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm, ku ndër të tjera citohet: Kërkesë për ri ngritjen e grupit të punës për argumentimin e nevojave, specifikimeve teknike dhe fondit limit për realizimin e procedurës për “Mirëmbajtjen dhe garantimin e funksionalitetit të storage ekzistues, si dhe shtimin e kapaciteti për nevoja të RTSH. Nevojitet shërbimi mirëmbajtes për storage ekzistues për një periudhë 2-vjeçare, ku përfshihet për riparimin e harddiskut të dëmtuar, eliminimin e gabimeve të shfaqura në sistemin e operimit, rikthimin në gjendjen e plotë funksionale të sistemit në tërësi”. Gjithashtu, bazuar në natyrën që institucioni yn ka, ku gjatë gjithë kohës, është në prodhim dhe arkivim, nevoja për shtim kapaciteti në storage sa vjen dhe rritet. Për këtë arsye, kërkojmë ngritjen e grupi të punës për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe fondin limit me objekt “Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH”.

Me urdhër nr. 41/1 prot., datë 23.01.2023 të E. J., është urdhëruar prokurimi me mjete elektronike me fond limit 22,231,737 lekë financuar nga të ardhurat e RTSH, me objekt: Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent, procedurë e hapur-mallra, me mjete elektronike, grupi për hartimin e dokumenteve të tenderit S. B., L. M. dhe M. P..

Me Urdhër Nr. 41/2 prot., datë 23.01.2023 të E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga B. M., ing. IT, D. D., juriste, A. N., ing. IT.

Specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim janë hartuar me procesverbal me 26.01.2023 i firmosur nga S. B., L. M. dhe M. P..

Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3 “Kapaciteti teknik:” është kërkuar Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi, për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurt dhe pjesë origjinale të pajisjeve objekt në këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.

Ky kriter është “Specifikim i tepërt” apo “Super specifikim”.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Vendosja e këtij kriteri/specifikimi është në keqinterpretim me:

- Rekomandimin Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.

-Ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 93.

-Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021, “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.

-Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

-Vendimin Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur sa më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit e përbërë nga S. B., L. M. dhe M. P..

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatori ekonomik “S. T. A.” Sh.p.k me vlerë 20,650,320 lekë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria “S. T. A.” Sh.p.k., me ofertë në vlerën 20,650,320 lekë.

Kontrata me Operatorin Ekonomik “S. T. A.”sh.p.k, është lidhur Nr. 41/11 prot., më datë 13.03.2023 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga E. J.,në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm dhe

operatorit/e shoqërisë “S. T. A.” Sh.p.k përfaqësuar nga administratorët K. P. dhe E. H., për vlerën 24,780,384 lekë, me afat 24 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Në kontratën e shërbimit Nr. 41/11 prot., më datë 13.03.2023, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve) në zbatim të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Veprim që ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtorë e drejtorisë juridike dhe E. J., në cilësinë e ish-drejtorit të përgjithshëm.

Zbatimi i kontratës

Raport mirëmbajtje me nr. 41/17 prot., datë 12.06.2023 i firmosur nga grupi i ngarkuar për ecurinë e zbatimit të kontratës G. N., F. V. dhe G. Z. dhe për shoqërinë A. Ç..

Fatura e lëshuar nga Shoqëria “S. T. A.” Sh.p.k me nr, 385/2023 datë 12.06.2023 për vlerën 3,097,546 lekë. Deri më 30.06.2023 nuk është likuiduar kjo faturë. Raport mirëmbajtje është përcaktuar Hard disku me Nr serisë SN:D5HP50WF4WQ.

Në specifikimet teknike dhe në kontratë është përcaktuar:

2) Hard disku të jetë i llojit “i brendshëm”

3)Madhësia fizike 3.5 inch

4)Ndërfaqja SATA

5)Kapaciteti memories 12 TB

6)RPM: 7200

Pajisja e dëmtuar/zëvendësuar e raportuar në raportin e mirëmbajtjes të përshkruar si më sipër, nuk i është lënë Autoritetit Kontraktor, por është marr nga Shoqëria “S. T. A.” sh.p.k.

Për pjesët e dëmtuar/zëvendësuar gjatë mirëmbajtjes që merren nga kontraktori Shoqëria “S. T. A.”sh.p.k nuk është përcaktuar në dokumentet e tenderit/specifikimet teknike as dhe në kontratën e nënshkruar nga palët.

Në opinionin e grupi të auditimit, pjesët e dëmtuara të pajisjeve pas zëvendësimit të futen në specifikimet teknike, të përcaktohen në kontratë dhe t’ju jepen n.q.s do t’i dëshirojnë kontraktorët duke i vlerësuar me vlerën e tregut.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1 dhe Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690.

Pajisja e re/ Hard disku është i pa shoqëruar me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës), veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021, “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Duhet të respektohen termat e përcaktuara në dispozitat e kontratave mbi “Kushtet e dorëzimit” të mallit, duke administruar në kohën e marrjes në dorëzim të mallrave edhe dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në kontratën e nënshkruar si: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat”, që shërbejnë për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë apo garancinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor”.*

Grupi i auditimit i kërkoj RTSH që kontraktori duke qenë brenda afatit të zbatimit të kontratës të paraqiste në RTSH : Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, dokumentacion të cilin nuk i paraqiti.

Mos shoqërimi/mos paraqitja me raportet e testeve (test raportin e fabrikës) për pajisjen, dokument i rëndësishëm për të bërë verifikimin dokumentar të specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës (raportet e testeve), nuk mund konfirmohet që pajisja e zëvendësuar është e njëjtë me ata të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “S. T. A.” Sh.p.k ka fituar tenderin dhe ka faturuar shërbimin.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi D. D., me detyrë ish-drejtores dhe drejtorisë juridike dhe E. J., në cilësinë e ish-drejtorit të përgjithshëm.

Menaxhmenti dhe personat e përfshirë në këtë proces, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimalizuar eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, por i kanë keqmenaxhuar ato duke mos arritur qëllimin e tyre, veprim në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 8, dhe 52.

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.

Për mos maksimalizim dhe eficientësinë dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, në referencë të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, ngarkohet me përgjegjësi E. J., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm.

Titulli i gjetjes Nr. 1	Dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “S. T. A.”shpk, me objekt: Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent, në vlerën 3,097,546 lekë, viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “S. T. A.” ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.
Kriteri:	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,

	<p>Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122. Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690. Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “S. T. A.” Shpk. Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8. Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq menaxhim i fondeve te RTSH.
Shkaku:	Keinterpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshirë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “S. T. A.” shpk nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 3,097,546 lekë nga Shoqëria “S. T. A.” Shpk.</p>

Titulli i gjetjes Nr. 2	Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun.
Situata:	Përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, televizionet private të tjera).
Kriteri:	Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të fondeve publike.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Autoriteti kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlerë, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Titulli i gjetjes Nr. 3	Në specifikimet teknike është vendosur autorizimi nga prodhuesi, si dhe vendosje e specifikimet teknike në parametra teknik që kanë përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.
Situata:	Në kërkesat për kualifikim, pikën 2.3 “Kapaciteti teknik:” është kërkuar Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi, për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurt dhe pjesë origjinale të pajisjeve objekt në këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit. Ky kriter është “Specifikim i tepërt” apo “Super specifikim”. Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.
Kriteri:	-Rekomandimi Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12. -Ligji Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 93. -Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021, “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2. -Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17. -Vendimi Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
Ndikimi/Efekti:	Ulje në mënyrë të ndjeshme e konkurrencën.
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Titulli i gjetjes Nr. 4	Në kontratë nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve), si dhe pajisja është e pa shoqëruar me këto dokumente.
Situata:	Në kontratën e shërbimit Nr. 41/11 prot., më datë 13.03.2023, nuk është përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve). Pajisja e re/ Hard disku është i pa shoqëruar me certifikatën e origjinës dhe raportet e testeve (test raportin e fabrikës).
Kriteri:	Rekomandimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1. Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 122 “Rregullat që zbatohen për kontratën”, pika 1. Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476 659, 698 dhe 690.
Ndikimi/Efekti:	Përfitim i pa drejt në vlerën 3,097,546 lekë nga Shoqëria “S&T Albania”.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në përcaktimin e dokumentacionin që shoqëron pajisjet, raportimin në APP për çdo fazë të realizimit të kontratave, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga H. M., M. D., B. M., E. B., dhe E. M., është paraqitur observacioni pa numër protokolli datë 26.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/31 prot., datë 29.01.2024 dhe nr. 32/1 prot., datë 29.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/36 prot., datë 30.01.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Për akt kolaudimet, theksojmë se marrëveshja kuadër/kontrata me 54/18 prot., datë 26.02.2021, është hartuar në dy gjuhë anglisht dhe shqip. Në kontratën në gjuhën angleze, Neni 36, pika 1, përcaktohet shprehimisht “In any interpretation case of agreement the parties agree that English version will be referered to”, pra çdo çështje interpretimi të kësaj marrëveshje, palët bien dakord që do ti referohen versionit anglisht. Këtë ka pasur parasysh grupi i punës që realizon ndjekjen e kontratës. Theksojmë se në versionin shqip të kontratës kjo fjali nuk është pasqyruar fare. Në versionin në gjuhën shqipe përmendet termi akt kolaudim. Në versionin anglisht, i cili sipas kontratës është bazë për palët, termi i duhur është procesverbalet e pranimit.

Në nenin 21, pika 2, është përcaktuar “ART will pay the Service Provider, for the service according to the acceptance act help between parties once a month, confrirmed by both parties, by respecting and appplying all obligations as definned in this contract”. Pra përkthimi i saktë do të ishte “Përfituesit do të paguajnë ofertuesin e shërbimit për shërbimin e kryer sipas akt pranimit të mbajtur ndërmjet palëve të bërë njëherë në muaj, konfirmuar nga përfaqësuesit e të dy palëve duke respektuar dhe zbatuar të gjitha detyrimet që përcaktohen në kontratë dhe jo akt kolaudimet, siç është përkthyer realisht.

Për pasojë ndjekja e kontratës është kryer në përputhje të plotë me versionin në gjuhën angleze të kontratës. Ky detyrim mburon edhe nga Ligji nr. 10,428, neni 45, pika 1, dhe marrëveshja kuadër/kontrata me 54/18 prot., datë 26.02.2021 në nenin 32, pika 1.2, ku ka përcaktuar

juridiksionin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Palët bien dakort që “Arbitrazhi t’i japë zgjidhjen përfundimtare mosmarrëveshjeve sipas rregullave të arbitrazhit të dhomës ndërkombëtare të Tregtisë. Selia e arbitrazhit është Paris-Franca, gjuha e arbitrazhit anglishtja”.

Në problemin e evidentuar nga grupi i auditimit për nevojën e firmave të të dyja palëve, mbetet çështje e interpretimit të kontratës, e cila duhet të evidentohet nga strukturat e tjera të RTSH dhe jo e grupit të punës. Kontrata ka ardhur tek grupi i punës për ndjekjen e saj dhe jo për interpretime dhe sugjerime dhe ndryshime të saj.

Në shqyrtim të tre elementëve të rëndësishëm të kontratës Objekti i kontratës dhe shërbimi (neni 3); Raportimi i shërbimeve (neni 22) dhe tarifrat e shërbimit dhe pagesat (neni 5), grupi i punës dhe të gjitha strukturat e tjera të njësisë teknike kanë monitoruar me rigozitet 24/366, gjendjen e punës të stacioneve monitoruese. Nivelet e shërbimit të mirëmbajtjes të ofruara nga kompania kanë qenë në bazë ditore, javore dhe mujore. Në dokumentacionin dërguar KLSH me observacionin nr. 1367/67 prot, datë 21.11.2023, gjenden raportet periodike të kryera, parashikimet për kontrollin në vijimësi, raportimet dhe çdo informacion i parashikuar në kontratë. Në raportet javore dhe mujore që janë dërguar nga ofertuesi i shërbimit, pasqyrohen sipas specifikimeve teknike kontrolli i mirëmbajtjes sipas kategorive; HeadEnd, sistemi i transmetuesve, sistemi i radioRL, sistemi i routimit, antenat UHT, sistemi i energjisë elektrike, sistemi i sigurisë dhe pajisjeve të survejimit, kulla, kablllo (feeder) dhe power, splitter, programet software, liçensat dhe sistemi i kondicionimit, tipi i shërbimit, sugjerimet/përshkrimi, pjesëve të reja të përdorura.

Raportet periodike dhe çdo raport tjetër i parashikuar në kontratë, kanë paraqitur elemente të kryerjes së shërbimit në përputhje me nivelin e shërbimit përkatës. Raportet periodike, janë analizuar dhe janë krahasuar me të dhënat e sistemeve të monitorimit nga grupi i punës së RTSH. Në përfundim të analizës është paraqitur materiali me shkrim i grupit të punës (në versionin anglisht të kontratës, ky material me shkrim përcaktohet me termin procesverbal), i cili i është dërguar titullarit të institucionit. Specifikisht në versionin anglisht të kontratës, neni 5, pika 3, parashikohet procesverbali i pranimit të shërbimit nga grupi i punës. Në nenin 9 pika 3, përcaktohet qartësisht se nivelet e shërbimit dhe disponueshëria hartohen dhe paraqiten nga ofruesi i shërbimit dhe aprovohen nga RTSH. Në zbatim të kësaj pike, ofertuesi i shërbimit ka paraqitur evidencat (formularët) e niveli të shërbimit dhe disponueshmërinë, ndërsa grupi i punës i ka kontrolluar dhe miratuar në përputhje me gjendjen faktike rezultuese.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në nenin 36 të marrëveshjes kuadër/kontrata me 54/18 prot., datë 26.02.2021, është përcaktuar: Kjo marrëveshje hartohet në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe 4 kopje origjinali në gjuhën angleze.

Në përgjigje të observacionit nr. 1367/67 prot, datë 21.11.2023 për akt konstatimin nr. 2, datë 14.11.2023, grupi i auditimit është shprehur: Çështjet e përkthimit i përkasin përkthyesve të liçensuar nga Ministria e Drejtësisë dhe çështjet e interpretimit i përkasin Drejtorisë Teknike dhe asaj Juridike, nuk i përkasin grupit të marrjes në dorëzim.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion asnjë nga anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim nuk është i liçensuar nga Ministria e Drejtësisë për përkthim në gjuhën angleze/ose dokumentet që disponon zyrtarisht mbrojtjen e gjuhës angleze, si dhe në dispozicion të grupit të auditimit nuk është vënë asnjë korrespondencë e grupit të marrjes në dorëzim me Drejtorinë Teknike dhe atë Juridike për interpretimet e pretenduar në observacion, që i përkasin versionit shqip dhe anglisht të kontratës.

Në këto kushte, si dhe faktit që akt kolaudimet/procesverbalet e pranimit/akt pranimeve në zbatim të kontratës janë në anglisht dhe nuk janë të përkthyer dhe në shqip referuar: Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14; Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, Kreu VII “Detyrimet dhe kontratat”, Neni 45 “Liria e zgjedhjes së Ligjit të zbatueshëm”; Rregullores (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore”, Neni 11, pika 1,2,3, baza e interpretimit është marrëveshja në versionin shqip.

Theksojmë se opinioni i grupi të auditimit është dhënë brenda sigurisë së arsyeshme referuar Rregullores së Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendim nr. 107, datë 08.08.2017, të Kryetarit të KLSH dhe Rregullores së auditimit të përputhshmërisë miratuar me Vendim nr. 245, datë 29.12.2022, të Kryetarit të KLSH.

Pretendimi se ky shërbim përfshin mbulimin dhe mirëmatjen e stacioneve të përcaktuara në kontratë, qëndron për mos pasje dëm ekonomik dhe do të merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit, ndërsa pretendimi tjetër nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Për SLA

Në lidhje me aneksin nr.4 “Formati i Raportimit periodik për stacionet e RTSH”, specifikimet teknike, të cilat janë pjesë e kontratës, nuk kanë pjesë të tyre asnjë aneks. Në dokumentet standarte të tenderit (shtojca 9), specifikimet teknike janë njësoj si në kontratë. Aneksat ku bënë pjesë edhe aneksi nr.4, përmenden, por nuk janë pjesë e kontratës nr. 564/31 prot., datë 29.01.2024. Për këtë shkak, grupi i punës nuk mund të mbajë përgjegjësi për mungesën e raporteve sipas një formati të caktuar, për të cilin nuk është vendosur në dijeni.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari: Kontrata referuar legjislacionit të prokurimit publik, kodit të procedurës administrative dhe kodit civil është kontratë publike dhe kontratë administrative. Në këtë kontekst dhe anekset duhet të ishin/jenë pjesë e kontratës. Me vendim Nr. 577, datë 14.01.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se “Një ndër qëllimet e legjislacionit për prokurimin publik është përdorimi i drejtë, transparent dhe me efektivitet i fondeve publike. Pikërisht për këtë arsye, legjislacioni i posaçëm në lidhje me prokurimet publike, ka parashikuar një procedurë specifike që duhet ndjekur duke filluar që nga momenti i zgjedhjes së palës me të cilën organi shtetëror do të hyjë në marrëdhënie kontraktore duke përdorur fondet publike, lidhjes së kontratës, kushteve kontraktore, ekzekutimit të saj e deri në zgjidhjen e kontratës”.

Së dyti. Nuk keni paraqitur asnjë dokument shkresor të marrjes në dorëzim të kontratës, ku të jenë përshkruar të gjitha gjenalitetet. Data, personi nga i cili e keni marr në dorëzim, numri i fletëve etj.

Së treti. Në përgjigje të observacionit nr. 1367/67 prot, datë 21.11.2023 për akt konstatimin nr. 2, datë 14.11.2023, keni paraqitur vetëm të dhënat elektronike që gjenerohen nga sistemi (1.sistemi i transmetimit, 2. Transmitterat 3. Kontrolli i pjesëve elektrike dhe pajisjeve ndihmese). Nuk është paraqitur i plotë aneksi nr. 4 “Formati i raportit periodik për stacionet e RTSH. Konkretisht nuk është paraqitur: 4. Kulla; 5 rrethimi; a. Përshkrimi; b. rezultati i kontrollit; nuk është kontrolluar; c. aktivitete korrektive; Shënime; Komente Personat e ngarkuar; firma; data; Pavarësisht mos paraqitjes sipas formatit tip të SLA, observacioni se ky shërbim përfshin mbulimin dhe mirëmatjen e stacioneve të përcaktuara në kontratë, qëndron për mos pasje dëm ekonomik dhe do të merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit, ndërsa pretendimi tjetër nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Grupi/grupet e marrjes në dorëzim nuk kanë përgjegjësi për mos raportim tek drejtori i përgjithshëm që për marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera nga Kompania “R. S., O, G, ”, Austri konformë specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë, duhet rinegociuar me Kompaninë “R. S., O. . ”, Austri, Marrëveshja Kuadër e lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, duhen bërë amendimet përkatëse me qëllim që kopjet në anglisht të akt kollaudimeve/procesverbalet e pranimit/akt pranimeve në zbatim të kontratës të jenë të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët referuar: Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14; Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, Kreu VII “Detyrimet dhe kontratat”, Neni 45 “Liria e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm”; Rregullores (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore”, Neni 11, pika 1,2,3.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi qëndron për grupin e marrjes në dorëzim dhe jo për drejtorin e njësisë teknike. Prandaj ky koment do merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga M. D., B. M., E. B. dhe E. M., është paraqitur observacioni me nr.32/12 prot, datë 29.03.2024 administruar në KLSH me nr. 564/51 prot., datë 29.03.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

.....Grupet e marrjes në dorëzim kanë kryer verifikimet përkatëse dhe kanë dërguar raportet periodike të kontrollorëve në stacionet e transmetimit të RTSH dhe në Shqip në protokollin e RTSH, për periudhat mars 2021-gusht 2021, shtator 2021-qershor 2022 dhe korrik 2022-tetor 2023.

Raportet dhe procesverbalet e pranimit në nëntor 2023 e në vazhdim , po ndiqen sipas amenimit të kontratës të prptokolluar në RTSH me nr.298/1 prot, datë 01.02.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Grupi i auditimit ka kryer auditim nga data 25.07.2023 deri 14.11.2023, për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 30.06.2023.

Gjatë auditimit dhe në observacionet për aktkonstatimet dhe projektraportin grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion amenimit të kontratës të protokolluar në RTSH me nr.298/1 prot, datë 01.02.2024.

Gjatë auditimit dhe në observacionet për aktkonstatimet grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion raportet periodike të kontrollorëve në stacionet e transmetimit të RTSH dhe në Shqip në protokollin e RTSH. Raportet e SLA të dërguara me këtë observacion janë fotokopje të pa sigluara nga Institucioni “E njëjtë me orgjinalin” ose të noterizuar. Për pasojë janë dokumente të pabesueshme për tu marr në konsideratë.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. P., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm është paraqitur observacioni me nr. 32/10 prot., datë 02.02.2024 administruar në KLSH nr. 564/46 prot., datë 05.02.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

a. Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim;

- Zotërimi i autorizimit të suportit nga prodhuesi i pajisjeve, pretendimi 1.

- Të ketë të siguarur jo më pak se 10 punonjës inxhinier, pretendimi 2.

- Licensat profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar, pretendimi 3.

-etj

b. Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

-Paraqitja nga operatori fitues i certifikatave dhe dëshmitë në gjuhë të huaj, dhe mos shoqërimi me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Në dijeninë e grupit të auditimit A. P., është emëruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së me vendim të këshillit drejtues nr.25, datë 13.06.2023. Referuar VKM nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të radio televizionit shqiptar (RTSH)”, neni 18, Ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, nenin 105, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet, 21, 56, 57, 58, 60, 61, 68 dhe 78 , Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 8, Neni 2, Neni 52, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet vijuese të tij, neni 98,104 dhe 105 A. P., **nuk ka asnjë tagër administrativ/ligjor** të bëjë observacion për procedurën e prokurimit “Blerje Shërbimi për Mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020”, pasi nuk ka qenë në RTSH në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm ose në ndonjë pozicion pune tjetër.

Titullari i Autoritet Kontraktor ka qenë Th. G., i cili me urdhër prokurimi nr. 54, datë 01.09.2020 ka urdhëruar të kryhet prokurimi me procedurë të hapur ndërkombëtare “Marrëveshje kuadër”, ka firmosur raportin përmbledhës të zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe ka lidhur dhe marrëveshjen kuadër/kontrata me 54/18 prot., datë 26.02.2021 me operatorin ekonomik “R. S., O, G, ”, Austri.

Së dyti. Në aktkonstatimin nr. 2, datë 14.11.2023 dhe në projektraportin e auditimit për hartimin kërkesave të veçanta për kualifikim, me përgjegjësi është ngarkuar Th. G., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, njësia e prokurimit e përbërë nga G. A., E. K. dhe G. H., si dhe komisioni i vlerësimit të ofertave të përbërë nga S. Gj., E. K., M. L., F. Z. dhe M. A., për kualifikim të operatorit ekonomik pa përmbushur të gjitha kërkesat e veçanta.

Për projektraportin e auditimit nga Th. G., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, njësia e prokurimit e përbërë nga G. A., E. K. dhe G. H., nuk është bërë observacion, çka do të thotë që janë dakortësuar me shkeljet e konstatuar nga grupi i auditimit, ndërsa A. P., **pa asnjë tagër administrativ/ligjor në lidhje me këtë procedurë nuk** është dakort (shkeljet nuk qëndrojnë).

Së treti. A. P., me detyrë drejtor i përgjithshëm nuk ka paraqitur asnjë dokument përfaqësimi (prokurë të posaçme ose të përgjithshme) për të bërë observacion për Th. G., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, njësinë e prokurimit e përbërë nga G. A., E. K. dhe G. H., si dhe për komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga S. Gj., E. K., M. L., F. Z. dhe M. A..

Së katërti. Argumentimi tekniko-juridik, përse observacioni nuk qëndron është dhënë në mënyrë të detajuar në aktkonstatimin nr.2, datë 14.11.2023 dhe në Projekt Raportin e Auditimit.

Prandaj ky koment nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Për aktkolaudimin, SLA, interpretimi i kontratës në gjuhën angleze ose shqipe, raportet e marrjes në dorëzim të shërbimit etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nuk qëndron, argumentimi është i njëjtë si në sqarimin e bërë për observacionin e bërë nga H. M., M. D., B. M., E. B. dhe E. M., pa numër protokolli datë 26.01.2024 administruar

në KLSH me nr. 564/31 prot., datë 29.01.2024 dhe nr. 32/1 prot., datë 29.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/36 prot., datë 30.01.2024.

Prandaj ky koment nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit. Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga E. B., me detyrë specialiste Sektori i Planifikimit dhe Kostifikimit, është paraqitur observacioni me nr. 2006/4 prot., datë 15.11.2023 administruar në KLSH me nr. 564/3 prot., datë 20.11.2023 për ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Anëtare e komisionit në procedurën e prokurimit , blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH, viti 2023, me urdhër nr. 3401/4 prot, datë 19.09.2022 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nuk është E. B., por është J. S..

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi qëndron

Prandaj ky koment do merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit. Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga M. L., F. Z. dhe M. A., është paraqitur observacioni me nr. 32/9 prot., datë 30.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/40 prot., datë 30.01.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Hartimi i kërkesave për kualifikim “Autorizim suportit nga prodhuesi” APP nuk ka vënë në dijeni, vendimi nr. 851 datë 03.12.2021 i Autoritetit të Konkurrencës, ISO, numrin e inxhinierëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari: Në Projektraportin e Auditimit dhe në Aktkonstatimin nr.2, datë 14.11.2023 për procedurën e prokurimit “Blerje Shërbimi për Mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2”, viti 2020, për mos përcaktimin e drejt të kërkesave për kualifikim është ngarkuar njësia e prokurimit e përbërë nga G. A., E. K. dhe G. H., të cilët nuk kanë bërë observacion për Projektraportin e Auditimit në lidhje me këtë çështje

Së dyti: Në Projektraportin e Auditimit, për autorizimin e prodhuesit si kërkesë për kualifikim nga grupi i auditimit nuk ka asnjë referencë të vendimit nr. 851 datë 03.12.2021 i Autoritetit të Konkurrencës.

Referencat ligjore në Projektraportin e Auditimit janë: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Neni 20 dhe Neni 23 pika 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 28, pika 2, Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17, vendimi Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Do të ishte në korrektësinë/përgjegjshmërinë tuaj që ti ishiti referuar Projektraportit të Auditimit. Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

-Për përshtatshmërinë profesionale të 10 punonjësve inxhinier, ku kompania fituese ka dorëzuar deklaratë për secilin prej tyre, bashkëlidhur dokumentacioni provues.

- Referuar përkthimit të bërë, nëse certifikatat dhe dëshmitë janë në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe, është lapsus nga ana e tyre.

-Procedurat e prokurimit janë kryer konforme VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Së pari. Bashkëlidhur observacionit nuk keni asnjë dokument provues, që kompania fituese ka

dorëzuar deklaratë për 10 punonjësit inxhinier.

Së dyti. Referuar VKM 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 58, detyrat e KVO, nuk ka qenë në kompetencën e KVO, për ta vlerësuar është lapsus ose jo kërkesa për kualifikim. Specifikisht në këtë nen është përcaktuar “Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave; Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkojnë sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla”.

Së treti. Në vlerësimin tonë deklarimi i juaj se procedurat e prokurimit janë kryer konformë VKM nr. 285, datë 19.05.2021, duhet të jetë lapsus, pasi raporti përmbledhës është me nr. 54/6 prot., datë 02.02.2021 firmosur nga KVO, datë e cila nuk është në fuqi VKM nr. 285, datë 19.05.2021, por VKM 914, datë 29.12.2014.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga, F. Z., M. A., B. M. dhe K. B., është paraqitur observacioni me nr. 32/8 prot., datë 30.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/44 prot., datë 30.01.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Përlllogaritja e fondit limit, pretendimi nr.1.

Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorëve ekonomik, pretendimi nr. 2.

-Furnizimin me karburant, nga shoqëria “Porto Romano” (PRO)sh.a, pretendimi nr.3.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimet nuk qëndrojnë. Në mënyrë të detajuar argumentimi tekniko-juridik përse nuk qëndrojnë janë dhënë në akt konstatimin nr. 14, datë 14.11.2023 dhe në Projekt Raportin e Auditimit.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe B. M., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit është paraqitur observacioni pa numër protokolli, datë 17.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/39 prot., datë 30.01.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Për autorizimin e prodhuesit

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi është në kundërshtim me rekomandimin Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12, Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 Neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2 dhe Neni 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 93, Vendimin e Autoriteti i Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2, Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 4,5,11,13,14 dhe 17, Vendimin Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativë i Gjykatës së Lartë.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa është trajtuar në Observacionin mbi Projekt Raportin e KLSH me nr.S64/30 prot, datë 29.12.2023 administruar ne RTSH nr. 32 prot. datë 04.01.2024 dhe ardhur ne KLSH datë. 30.01.2024 me nr. prot 564/39 po ju bëjmë me dije qendrimit si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Referuar konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit përfaqësuesit e RTSH sqarojnë se në mënyrën e paraqitur dhe të dhënë lidhur me sistemet ka dukshëm konfuzion të koncepteve teknike, për sa kohë që grupi i auditimit nuk është i saktë teknikisht se për çfarë është i dedikuar secili prej tyre duke u shprehur "sisteme janë prokuruar për të njëtin qëllim, ruajtjen dhe arkivimin e Videove të RTSH" ...

Si shihet dhe kuptohet qartë të gjitha sistemet e sipërcituara nga grupi i auditimit ndryshojnë në teknologji dhe në funksionet që kryejnë...


Në arsyetimin tonë mosndarja e koncepteve në parim per secilin system, si dhe mungesa e informacionit të grupit të auditimit, për funksionet e secilit system ka cuar në gjykime të gabuara...

Qendrimi i grupit të auditimit:

Storeeasy, sistem storage për ruajtjen e materialeve e cila është përdorur përpara sistemit MAM dhe sistemit QSAN.

Nga auditimi konstatohet se sistemi Storeeasy me një hapsirë storage 34.7 TB nuk është më në përdorim nga RTSH pasi ka arritur pothuajse limitin e kapacitetit storage.

Figura nr. 5: Pamje në lidhje me kapacitetin storage të sistemit Storeeasy




MAM: Sistemi MAM (Media Asset Management) konsiderohet si një ndër hallkat më kryesore të strukturës teknologjike në një radio-televizion modern. Sistemi multifunksional modern për menaxhimin e asetëve multimedia (MAM), është sistem, i cili është si qendër për të ndërlidhur të gjitha nënsistemet e tjera që ngrihen për playout, livestream, VOD (platforma OTT⁹) etj. Sistemi MAM është një komponent i cili ndihmon në menaxhimin e efektshëm të resurseve audiovizuale, duke përfshirë video, audio, dhe materiale të tjera të lidhura me media.

Platforma MAM shërben si shtylla kurrizore për të tjerë elementë të rëndësishëm të një studioje televizive, duke filluar që nga sistemi i playout, sistemi i shërbimit on-demand në ëeb, sistemi informativ në web, sistemet e apps-eve për device ndër më të ndryshmit, si dhe për platformën Over-the-Top (OTT).

Sistemi MAM përdoret si arkivë, për një periudhë 1-vjecare është pa mirëmbajtje dhe support.

Storage i Isilon Data Storage me një hapsirë storage rreth 912.55 TB ku ruhen të gjitha materialet multimediale online të ruajtura ndër vite ka arritur pothuajse limitin e kapacitetit të mundshëm për ruajtjen e materialeve arkivore.

Figura nr. 4: Pamje nga ndërfaqja e sistemit storage Isilon në lidhje me kapacitetin storage




Sistemi QSAN

Sistemi QSAN është në përdorim që në korrik të vitit 2023, i cili ka zëvendëuar sistemin MAM dhe përdoret për ruajtjen dhe transmetimin e materialeve që RTSH prodhon. Materialet e këtij sistemi janë të organizuara në File Sharing të ndara sipas kategorive. Montazhi me anë të sistemit Storage të Montazheve realizon montimin e çdo materiali bruto i cili përgatitet për transmetim dhe ruhet në sistemin QSAN. Materialet merren nga sistemi QSAN dhe nëpërmjet softit **Playbee**

bëhet transmetimi i tyre.

Figura nr. 2: Pamje nga ndërfaqja kryesore e sistemit QSAN




Burimi: RTSH, sistemi QSAN

Nga auditimi konstatohet se, për sistemin QSAN nuk disponohet një workflow i mirëfilltë si dhe një rregullore mbi përdorimin e sistemit. Sistemi administrohet nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, pa një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e sistemit dhe përdoruesve të tij. Gjithashtu konstatohet se, për sistemin QSAN nuk disponohet një rregullore në lidhje me arkivimin e materialeve në sistem, qoftë ato në storage dhe ato në arkivë offline. Materialet ruhen në 2 vende dhe nga 2 herë për të njëjtin material, qoftë dhe materialet bruto të pa përpunuara, duke zënë një kapacitet të konsiderueshëm në storage të sistemit.


Figura nr. 3: Përdoruesit e teknologjisë QSAN

Materialet në QSAN janë në një File Sharing të ndara me kategori të ndryshme sipas përdoruesve për montazhin, transmetimin, capture, marketingun, redaktimin, kryeredaktor, transkodimin, playout, programacionin, promocioni, radioarkiv dhe emisioni.



Nga auditimi konstatohet se, ky sistem është instaluar në datë 06.07.2023 me një hapsirë storage 573 TB dhe për një periudhë të shkurtër kapaciteti storage i QSAN ka arritur në 30%, ku me ritmet e punës së përditshme të materialeve të cilat përpunohen dhe ruhen nuk është i mjaftueshëm dhe nuk plotëson kapacitetet për storage në të ardhmen.

Figura nr. 4: Pamje nga ndërfaqja e sistemit QSAN në lidhje me kapacitetin storage



Burimi: RTSH, sistemi QSAN

Pretendimi i subjektit

Aktualisht Storage XcubeNXT 8000D Series RTSH është duke e përdorur (konstatim i bërë edhe nga Raport i Auditit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit pranë KLSH), dhe nuk ka paraqitur asnjë pakënaqësi në funksionimin dhe performancën e kesaj pajisjeje.

Qendrimi i grupit të auditimit

Storage i Sistemit QSAN është në një kapacitet 573TB por për një periudhë të shkurtër kapaciteti storage i QSAN ka arritur në 30%, ku me ritmet e punës së përditshme të materialeve të cilat përpunohen dhe ruhen nuk është i mjaftueshëm dhe nuk plotëson kapacitetet për storage në të ardhmen, dhe duke marrë parasysh këtë fakt, RTSH duhet të kishte investuar në rritjen e kapaciteteve storage të sistemit ekzistues MAM dhe jo blerjen e një sistemi të ri (QSAN), duke mos siguruar qëllimin për të cilin është bërë sistemi i ri, rritja e kapaciteteve storage.

7. Procedura me objekt “Blerje Shërbimi për Platformën OTT”, viti 2020.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Shërbimi për Platformën OTT”, me nr. REF-62147-06-22-2020)		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 30/2 datë 18.06.2020	3. Përlogaritja e vlerës së Fondit Limit dhe Specifikimet teknike Shkresa nr. 30/1 prot., datë 11.05.2020 z. G. N. z. E. T. znj. G. H. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 30/2 datë 18.06.2020 z. G. A., – Jurist z. O. H., – Specialist znj. G. H., – Specialiste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 30/3 prot., datë 18.06.2020 z. E. K., – Kryetar z. H. K., – Anëtar z. M. A., – Anëtare
2. Lloji i Procedurës “E hapur”, Marrëveshje Kudër “Shërbim”, format elektronik		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 85,113,600 lekë 5.1 Afati 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës	6. Oferta e kualifikuar e para MC N. & A. T., Kontrata me nr. 30/10 prot., datë 17.09.2020 me vlerë 101,829,936 lekë me TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 255,320 lekë 0.3 %
8. Data e hapjes së tenderit 22.07.2020, ora 10:00	9. Burimi Financimit Të ardhurat e RTSH	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH) <u>Pjesëmarrës:</u> MC Networking & A. T.- 84,858,280 <u>S’kualifikuar:</u> -
11. Ankimime -	12. Përgjigje Ankesës -	
Titullari i Autoritetit Kontraktor z. Th. G.		

NË LIDHJE ME KRITERET

Sipas procesverbalit të datës 22.06.2020 janë hartuar dokumentet e procedurës së prokurimit *Marrëveshje kudër* përfshirë kriteret e veçanta të kualifikimit.

Në lidhje me kriteret janë dërguar sugjerime nga ana e APP sipas e-mailit të datës 07.07.2020 pas të cilave sipas shkresës me nr. 30/6 prot., datë 09.07.2020 është pezulluar procedura e prokurimit nga ana e ish Titullarit deri në rishikimin e kriterëve të vendosura. Pas miratimit të shtojcës sipas shkresës me nr. 30/6 prot., datë 13.07.2020 është shtyrë afati i dorëzimit të ofertave deri me datë 22.07.2020.

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të planifikimit dhe leverdishmërisë së investimit.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>Blerje Shërbimi për Platformën OTT</i> , viti 2020 marrëveshje kudër me një OE rezulton se ky investim ka parashikuar krijimin e një aplikacioni <i>RTSH Tani</i> , të aksesueshëm në të gjitha platformat si Android, iOS dhe pajisjet Smart TV përmes të cilit të mund të shihen kanalet TV dhe Radio të RTSH. Procedura është iniciuar me shkresën e administruar në Njësinë Teknike me nr. 436 prot., datë 21.06.2019 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH me nr. 1912 prot., datë 21.06.2019 është bërë kërkesë nga ana e Drejtorit të NJT për zhvillimin e mëtejshëm të platformës OTT. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është hartuar një relacion sqarues mbi leverdinë e investimit, pra nuk ka një studim fizibiliteti mbi përfitimet që i sjell ky investim RTSH.

	Aktualisht shërbimi nuk është më funksional pasi kontrata me vlerë 101,829,936 lekë me TVSH ka përfunduar në shtator të vitit 2021 dhe RTSH nuk ka asnjë akses në këtë aplikacion. Për rrjedhojë nga sa më sipër rezulton se nuk ka asnjë indikator vlerësues të dobishmërisë së investimit.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, ku përcaktohet se: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
Ndikimi:	Mungesa e argumentimit të qenësishëm për kryerjen e këtij investimit nuk dëshmon për një përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej 84,858,280 lekë pa TVSH .
Shkaku:	Mungesa e veprimeve dhe mosveprimeve të Titullarit të AK.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH të kërkohet për çdo investim të parashikuar për tu kryer nga institucioni në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, një studim i qartë fizibiliteti me indikatorë konkretë e të matshëm, kjo më qëllim vlerësimin real të impaktit të investimeve dhe shmangien kështu të praktikave të kryerjes së investimeve të panevojshme dhe përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve.

Lidhur me sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Titullari i AK z. Th. G..

2. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të hartimit të fondit limit të investimit.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Shërbimi për Platformën OTT”, viti 2020 marrëveshje kuadër me një OE rezulton se me shkresën nr. 74 prot., datë 25.06.2019 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit me përbërje të grupit z. I. V., z. G. N. dhe z. A. D.. Ky grup pune është ndryshuar me shkresën nr. 30 prot., datë 02.03.2020 me Urdhër të ish Titullarit z. Th. G., grupi i punës me përbërje të grupit z. G. N., z. E. T. dhe znj. G. H.. Me shkresën nr. 30/1 prot., datë 11.05.2020 grupi i punës si më sipër ka hartuar specifikimet teknike dhe ka përlllogaritur fondin limit mbështetur në ofertat e marra nga 3 OE: A. T., – 0.45 lekë/ për 8,000,000 gb/muaj ENIGMA DEVELOPEMENT – 0.47 lekë/ për 8,000,000 gb/muaj

	<p>MC NETWORKING – 0.41 lekë/ për 8,000,000 gb/muaj</p> <p>Për afatin prej 24 muaj ka rezultuar një vlerë prej 85,113,600 lekë pa TVSH. Kjo vlerë është përdorur edhe për vlerën e fondit limit të procedurës. Nga auditimi nuk rezulton asnjë gjurmë dokumentare për të vërtetuar se këta OE, mbi të cilët ky komision është mbështetur, kanë një eksperiencë të tillë aq sa të justifikojë marrjen e ofertës për këtë lloj shërbimi. Mungesa e disponimit të eksperiencës së këtyre tre ofertuesve, 2 nga të cilët janë bashkuar për të krijuar edhe bashkimin e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, konfirmohet edhe nga dokumentacioni që secili nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh ka ngarkuar në sistem si punë e ngjashme, ku asnjë prej tyre nuk ka eksperiencë në hartimin e këtyre aplikacioneve. Komisioni i ngritur për përcaktimin e vlerës së fondit limit duhet të kishte dokumentuar, si pjesë e gjurmës së auditimit, eksperiencën e këtyre OE përpara se të merrte ofertat.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, ku përcaktohet se:</p> <p>a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;</p> <p>b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</p> <p>c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;</p> <p>d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.</p> <p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2 ku përcaktohet se:</p> <p>Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe</p> <p>a) çmimet e tregut; ose/dhe</p> <p>b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;</p> <p>Rregullore e Përgjithshme të Punës.</p>
Ndikimi:	Mungesë e transparencës për këtë fazë të prokurimit e cila ka jo pak rëndësi dhe impakt në përdorimin e fondeve publike.
Shkaku:	Mungesa e veprimeve dhe mosveprimeve të Titullarit të AK si dhe komisioneve të ngritura për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit.
Rëndësia:	E mesme.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të AK, Personit Përgjegjës për prokurimin dhe në kryesisht nga ana e komisioneve të ngritura për përcaktimin e fondit

	limit të investimeve, të merren masat e nevojshme për dokumentimin e plotë të eksperiencës së mjaftueshme të operatorëve ekonomikë sipas natyrës së investimit, tek të cilët AK mbështetet për të përlloritur vlerën limit të kontratës që do të prokurojë. Kjo e fundit duhet të jetë sa më reale dhe të përfaqësojë me objektivitet dhe siguri të mjaftueshme çmimin e tregut.
--	--

Lidhur me sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Titullari i AK z. Th. G., si dhe komisioni i ngritur me Urdhër nr. 30 prot., datë 02.03.2020 për përgatitjen e specifikimeve teknike me argumentimin e fondit limit me përbërje z. G. N., z. E. T. dhe znj. G. H..

3. Titulli i gjetjes:	Kualifikim dhe shpallje fitues e OE me mangësi në dokumentacion.
Situata:	<p>Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues si dhe dokumentacionit fizik të sjellë nga ana e subjektit të audituar rezulton se në procedurë ka marrë pjesë vetëm një OE i cili është bashkimi i operatorëve ekonomikë “A. T. & M. N” me vlerë të ofertës 84,858,280 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës i procedurës i administruar në RTSH me nr. 30/8 prot., datë 05.08.2020 ka shpallur fitues këtë bashkim operatorësh. Në përfundim të procedurës është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit nr. 30/10 prot., datë 17.08.2020 me vlerë të kontratës 101,829,936 lekë me TVSH për 24 muaj shërbim, ose 4,242,914 lekë pa TVSH në muaj (3,535,761 lekë pa TVSH). Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se OE A. T., nuk plotëson kriterin në lidhje me punët e ngjashme për sa i takon vlerës. Konkretisht, sipas kontratës së bashkëpunimit OE M. N., ka marrë përsipër të kryejë 75 % të vlerës së kontratës (ose 63,835,200 lekë pa TVSH¹⁰) dhe OE A. T., ka marrë përsipër të kryejë 25 % të vlerës së kontratës (ose 21,278,400 lekë pa TVSH¹¹). Nga të dhënat e ngarkuara në SPE rezulton se B., në tërësi nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme, pasi konkretisht OE A. T., nuk ka dëshmuar për një kontratë për punë të ngjashme në masën prej 40 % të vlerës takuese, ose shumë prej 8,511,360 lekë pa TVSH (21,278,400 lekë pa TVSH x 0.4) por si dëshmi ka sjellë një kontratë të lidhur mes RTSH dhe B. A., & E. F., me nr. 183/5 prot., datë 24.11.2017. Në fakt kjo kontratë, sikundër është përmendur edhe në auditimin e mëparshëm, nuk ka diktuar qartë se cilat kanë qenë punët konkrete të marra përsipër nga secili prej tyre, kjo pasi të dyja palët kanë marrë përsipër furnizimin dhe i vetmi OE i cili ka pretenduar për marrjen përsipër të plotësimin të të gjitha kërkesave specifike të kërkuara në procedurën e tenderit për stafin dhe dokumentacione fakti ka qenë OE E. F., Pra, në një situatë të tillë pjesa e furnizimit është marrë përsipër nga të dy OE dhe pjesa e stafit dhe kërkesave për dokumentacion është marrë përsipër nga ana e OE E. F. dhe nuk ka një dëshmi të qartë të punës së kryer. Por pavarësisht kësaj rezulton se vlera totale e kontratës së paraqitur si dëshmi është në masën 7,777,900 lekë pa TVSH nga 8,511,360 lekë pa TVSH që duhet të ishte, pra 733,460</p>

¹⁰ Referuar vlerës së fondit limit prej 85,113,600 lekë pa TVSH.

¹¹ Referuar vlerës së fondit limit prej 85,113,600 lekë pa TVSH.

	<p>lekë pa TVSH më pak. Për sa më sipër ky B. nuk duhet të ishte shpallur fitues i procedurës së prokurimit.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;</p> <p>b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</p> <p>c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;</p> <p>d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.</p> <p>Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, <u>ku përcaktohet se:</u> Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorohet dhe jodiskriminuese:</p> <p>Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>Pika 3: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji;</p> <p>Pika 5: Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:</p> <p>c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;</p> <p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:</p> <p>Neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 3, <u>ku përcaktohet se:</u> “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”;</p> <p>neni 74 Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 1, 2 dhe 3 citohet se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.</p> <p>2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një</p>

	<p><i>marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.</i></p> <p>3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”;</p> <p>Rregullore e Përgjithshme të Punës.</p>
Ndikimi:	Mungesë e plotësisht të kriterëve të kualifikimit nga ana e OE fitues nuk siguron kryerjen e punimeve/furnizimeve/shërbimeve sipas kërkesave të AK.
Shkaku:	Mungesa e veprimeve dhe mosveprimeve të Titullarit të AK si dhe komisioneve të vlerësimit të ofertave.
Rëndësia:	E mesme.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të AK si dhe personave të angazhuar në komisionet e vlerësimit të ofertave të merren masat e nevojshme për kualifikimin e OE vetëm pas përmbushjes së të gjitha kriterëve të kualifikimit me qëllim sigurimin e përdorimit me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO z. E. K., z. H. K. dhe z. M. A..

4. Titulli i gjetjes:	Likuidim i shërbimeve të pakryera në fakt.
Situata:	<p>Për zbatimin e kontratës me objekt “Blerje Shërbimi për Platformën OTT” me shkresën nr. 438/1 prot., datë 19.09.2020 është ngritur nga ana Drejtorit të Njësisë Teknike z. H. M., grupi i punës për zbatimin e kontratës me përbërje të grupit z. F. V., z. F. M. dhe z. H. K.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultojnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Referuar pagesave të bëra ndaj ofruesit të shërbimit rezultojnë se për periudhën 27.01.2021 – 26.02.2021, grupi i punës ka mbajtur procesverbalin e datës 31.08.2020 sipas të cilës ka cituar faktin se

trafiku në total që është konsumuar për këtë periudhë për platformën OTT është 8,758,675 GB. Në fakt fatura tatimore nr. 380 datë 11.03.2021 bashkëlidhur ka një sasi GB prej 9,051,450.26 GB me një vlerë prej 4,800,563.33 lekë me TVSH. Duke bërë korrigjimet përkatëse për sasinë e vërtetuar me relacionin e grupit të punës rezulton se janë përfituar tepër nga ana e ofruesit të shërbimit sasia prej 292,775.26 GB, ose vlera prej **155,277 lekë me TVSH;**

- Referuar pagesave të bëra ndaj ofruesit të shërbimit rezulton se për periudhën 27.07.2021 – 26.08.2021, grupi i punës ka mbajtur procesverbalin e datës 31.08.2020 sipas të cilës ka cituar faktin se trafiku në total që është konsumuar për këtë periudhë për platformën OTT është 1,118,540 GB. Në fakt fatura tatimore nr. 560/2021 datë 10.09.2021 bashkëlidhur ka një sasi fluksi prej 7,952,645.26 GB me një vlerë prej 4,217,797.2 lekë pa TVSH. Duke bërë korrigjimet përkatëse për sasinë e vërtetuar me relacionin e grupit të punës rezulton se janë përfituar tepër nga ana e ofruesit të shërbimit sasia prej 6,834,105.13 GB, ose vlera prej **3,624,563.33 lekë me TVSH;**

- Për periudhën 27.12.2020 – 26.01.2021 rezulton se shërbimi nga ana e B. M. N. & A. T., nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale pasi sipas verifikimeve të bëra nga grupi i monitorimit të kontratës me shkresën nr. 438/1 prot., datë 19.09.2020 disponueshmëria e shërbimit ka qenë nën 99.5 %, e konkretisht 99.0 %. Në lidhje me këtë situatë nga ana e Drejtorit të Njësisë Teknike z. H. M., nuk janë marrë masa për raportimin në Drejtorinë Ekonomike të kësaj mospërputhjeje me qëllim aplikimin e penalteteve për mos përmbushje të nenit 14 të kontratës së lidhur sipas aktit me nr. 30/10 prot., datë 17.09.2020. Duke bërë reflektimet përkatëse rezulton se është favorizuar padrejtësisht sipërmarrësi B. M. N. & A. T., duke mos aplikuar ndaj tij penaltetin e përllogaritur në shumën prej **3,054,898 lekë** si më poshtë nga ana e Grupit të Auditimit:

Shërbimi/mallrat e ofruara	Vlera	25 % e vlerës së kontratës	Nr. i ditëve	Tarifa Ditore	Shuma e Dëmeve
(a)	(b)	(c)	(d)	(e)	(f=c x d x e)
Shërbimi OTT	4,596,662	25,457,484	30	0.004	3,054,898

Si përfundim, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e B. M. N. & A. T., tepër në vlerë për shërbime të pakryera dhe penaltete të pa aplikuar në total në shumën prej 6,834,738 lekë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të arkëtohet ndaj B..

Kriteri:

Kontrata nr. 30/10 prot., datë 17.10.2020;
Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, neni 54 ku përcaktohet se:
“Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit,

	<i>certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.”</i> Rregullore e Përgjithshme të Punës.
Ndikimi:	Dëm ekonomik në shumën prej 6,834,738 lekë .
Shkaku:	Mungesa e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të gjetur me përgjegjësi.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të AK të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës prej 6,834,738 lekë ndaj B. M. N. & A. T., për shërbime të likuiduara por të porealizuara si dhe për penalitete të pa aplikuar për dorëzimin me vonesë të shërbimeve në kontratën me objekt “ <i>Blerje Shërbimi për Platformën OTT</i> ” të lidhur sipas aktit me nr. 30/10 prot., datë 17.10.2020.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. Th. G., ish zv. Drejtori i Përgjithshëm z. M. L., znj. E. K., znj. V. L., Drejtori i NJT z. H. M., si dhe Grupi i Monitorimit të kontratës z. F. V., z. F. M. dhe z. H. K..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit është mbajtur Akt Konstatimi nr. 16 për të cilin nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni i administruar në RTSH me nr. 32/2 prot., datë 29.01.2024 dhe në KLSH me nr. 564/37 prot., datë 30.01.2024 nga ana e z. F. V. dhe z. H. K..

Pretendimi i subjektit:

“Siç e kemi paraqitur në objeksionet për akt konstatimin nr. 16, vërejmë që nuk merrni në konsideratë Urdhrin nr. 438/1 prot., datë 18.09.2020 ‘Për krijimin e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës Blerje shërbimi për platformën OTT për RTSH’ në pinë II citohet: Komisioni do të kryejë verifikimet përkatëse në lidhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës të cilat janë pjesë e kontratës në fjalë, të kërkuara në DST. Ky komision do të përpilojë procesverbalin përkatës ku do të pasqyrohet saktësia ose jo e shërbimit si dhe të kryejnë kontrolle periodike të sistemit për disponueshmërinë e moduleve të përcaktuar teknike të procedurës. Ky procesverbal do të mbahet në tre kopje dhe do të shërbejë si bazë për plotësimin e dokumentacionit sipas kontratës. Një kopje e këtij procesverbali do të dorëzohet pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Prokurimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH. ... ”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH^{-së}:

Pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë si dhe nuk i përmbahen gjetjeve dhe konstatimeve. Sqarojmë se përgjegjësitë e personave të gjetur me shkelje janë individuale dhe në rastin konkret nuk është përfshirë komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për kryerjen e pagesës mbi volumet e konstatuara nga ana e këtij komisioni sepse kjo është përgjegjësi e njësisë përkatëse që kryen pagesën ndaj furnitorit. Përgjegjësia e komisionit qëndron në mos evidentimin e faktit se ofruesi i shërbimit nuk ka realizuar kontratën sipas parashikimeve përkatëse. Konkretisht nga auditimi rezultoi se për periudhën 27.12.2020 – 26.01.2021 shërbimi nga ana e B. M. N. & A. T., nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale pasi sipas verifikimeve të bëra nga vetë ju si grupi i monitorimit të kontratës, përmes shkresës me nr. 438/1 prot., datë 19.09.2020 keni konstatuar se disponueshmëria e shërbimit ka qenë nën 99.5 %, e konkretisht 99.0 % ku më pas rezultoi se as nuk janë marrë masa për raportimin në Drejtorinë Ekonomike të kësaj mospërputhjeje me qëllim aplikimin e penaliteteve për mos përmbushje të nenit 14 të kontratës së lidhur sipas aktit me nr.

30/10 prot., datë 17.09.2020. Ajo çka vlen të theksohet në këtë rast është fakti se komisioni i ngritur është një element i rëndësishëm i kontrollit të cilësisë në këtë rast dhe ushtrimi i kësaj detyre nuk duhet parë si diçka formale, përkundrazi duhet të evidentojë kryerjen ose jo të shërbimit, pra situatën *Kontratë vs. Fakt* dhe diferencat kur ka të tilla. Në rastin tuaj, komisioni është mjaftuar duke cituar sasinë e shërbimeve që ka ofruar pa evidentuar saktë, qartë, kuptueshëm dhe dukshëm mangësitë. Praktikisht ju jeni komisioni i cili krahasoni shërbimet që kontraktori kryen dhe/apo deklaron se kryen me ato çka ju realisht konstatooni se realizohen dhe është detyrë e juaja njohja e kontratës, kushteve të saj dhe detyrimeve mes palëve pasi në të kundërt as nuk do të mund të kryenit këtë monitorim dhe ndjekje të kontratës. Risqarojmë edhe një herë se përgjegjësia është në aspektin teknik dhe jo në aspektin financiar, pasi nuk ka dalë qartë mangësia e ofruesit të shërbimit. Për sa më sipër pretendimet Tuaja nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit.

8. Procedura e prokurimit me objekt Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike, Viti 2022.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”, me nr. REF-20554-02-24-2022)		
<p>1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 557/16 prot., datë 23.02.2022</p>	<p>3.1 Përlogaritja e Specifikimeve teknike Shkresa nr. 557/1 prot., datë 08.02.2022 z. G. N. z. E. T.</p> <p>3.2 Përlogaritja e vlerës së Fondit Limit Shkresa nr. 557/12 prot., datë 18.02.2022 z. G. N. z. E. T. z. F. Z.</p> <p>Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 557/16 prot., datë 23.02.2022 znj. K. B. – Juriste z. F. Z. – Specialist z. G. N. – Specialist</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 557/25 prot., datë 11.03.2022 z. B. M., – Kryetar znj. N. M., – Anëtare znj. M. P., – Anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës “E hapur”, “Shërbim”, format elektronik</p>		
<p>5. Fondi Limit (pa TVSh) 11,260,600 lekë 5.1 Afati 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës</p>	<p>6. Oferta e kualifikuar e para V. A. Kontrata me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 me vlerë 8,512,992 lekë me TVSH</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 4,292,040 lekë 37.7 %</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit 15.03.2022, ora 10:00</p>	<p>9. Burimi Financimit Të ardhurat e RTSH</p>	
<p>11. Ankimime Në AK Në lidhje me vlerësimin Shkresa nr. 1241 prot., datë 30.03.2022</p> <p>Në KPP Në lidhje me mos shqyrtimin e ankesës Në lidhje me vlerësimin</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës Nga AK Po, shkresa nr. 1241/1 prot., datë 01.04.2022 Po, shkresa nr. 1241/7 prot., datë 14.04.2022</p> <p>Nga KPP Po, shkresa nr. 1241/5 prot., datë 12.04.2022 Po, shkresa nr. 1567 prot., datë 04.05.2022</p>	<p>10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)</p> <p><u>Pjesëmarrës:</u> TIBO – 6,960,000 V. A. - 7,094,160 ALBTELECOM – 7,319,000 ATU – 7,447,200</p> <p><u>S’kualifikuar:</u> TIBO – 6,960,000</p>
<p>Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E. J.</p>		

NË LIDHJE ME PLANIFIKIMIN E INVESTIMIT

Ky investim është iniciuar me shkresën e administruar në Njësinë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve me nr. 36 prot., datë 24.01.2022 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme (DP) të RTSH me nr. 356 prot., datë 25.01.2022 ku është bërë kërkesë nga ana e Drejtorit të kësaj njësie drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm z. E. J., për vendosjen e fibrave optike në 6 Bashki për nevoja të mbulimit me transmetim të zgjedhjeve lokale të pjesshme. Gjithashtu, kërkesë për këtë një investim të tillë është bërë edhe nga ana e Drejtorit të NJT z. H. M., sipas shkresës së administruar pranë kësaj Drejtorie me nr. 75 prot., datë 07.02.2022 dhe në DP të RTSH me nr. 543 prot., datë 07.02.2022.

NË LIDHJE ME FONDIN LIMIT

Me shkresën nr. 557 prot., datë 08.02.2022 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike me argumentimin e fondit limit me përbërje të grupit z. G. N., z. E. T. dhe z. F. Z.. Sipas shkresës me nr. 557/1 prot., datë 08.02.2022 është bërë hartimi i specifikimeve teknike nga ana e punonjësve z. G. N. dhe z. E. T.. Përcaktimi i vlerës së fondit limit është bërë në bazë të ofertave të kërkuara ndaj OE A., V. A., T. TV, D. dhe P., sipas shkresës të Titullarit me nr. 557/2 prot., datë 09.02.2022. Pas marrjes së ofertave është bërë përcaktimi i vlerës së fondit limit si një mesatare e ofertave të marra duke bërë përcaktuar shumën prej 11,250,200 lekë pa TVSH.

NË LIDHJE ME KRITERET

Sipas procesverbalit pa nr. prot. datë 24.02.2022 janë hartuar dokumentet e procedurës së prokurimit për kontratën e shërbimit përfshirë kriteret e veçanta të kualifikimit. Sipas shkresës nr. 557/19 prot., datë 02.03.2022 është bërë pezullimi nga ana e Titullarit i procedurës pas kërkesës për sqarim së OE V. A., në lidhje me xhiron vjetore. Pas kësaj procedura është pezulluar serish deri në reflektimin e sugjerimeve të APP të bëra në adresën e-mail të datës 03.03.2022.

NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E OFERTAVE

Nga verifikimi i SPE rezulton se në procedurë kanë marrë pjesë 4 OE. Pas klasifikimit paraprak dhe s'kualifikimit të OE T. C., është bërë ankesë në AK dhe KPP. Sipas shkresës me nr. 1241/3 prot., datë 08.04.2022 është bërë pezullimin i procedurës nga ana e Titullarit dhe sipas shkresës nr. 1241/4 prot., datë 11.04.2022 është ngritur komisioni shqyrtimit të ankesave (KSHA) me përbërje të këtij komisioni znj. D. D., znj. A. D. dhe z. F. V.. Me shkresën e administruar në RTSH me nr. 1241/5 prot., datë 12.04.2022 është përcjellë në institucion vendimi i KPP sipas të cilit nuk është marrë në konsideratë ankesa e OE T. C., në lidhje me mos shqyrtimin e ankesës e duke lejuar AK vijimin e procedurave. Përveç sa më sipër edhe KSHA nuk ka marrë në konsideratë ankesën e OE në lidhje me arsyen e s'kualifikimit.

Në vijimësi KPP, përmes shkresës së administruar në RTSH me nr. 1567 prot., datë 04.05.2022 ka përcjellë Vendimin nr. 385/2022 sipas të cilit nuk ka marrë në konsideratë ankesën e bërë nga ana e OE T. C., në lidhje me arsyet e s'kualifikimit të bërë nga ana e AK.

Raporti përmbledhës i procedurës i administruar në RTSH me nr. 1241/10 prot., datë 08.05.2022 ka shpallur fitues OE V. A. dhe në vijim është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 me vlerë të kontratës 8,512,992 lekë me TVSH për 12 muaj shërbim.

5. Titulli i gjetjes:	Likuidim i shërbimeve të pakryera në fakt.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike</i> , viti 2022, rezulton se sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me OE

fitues V. A., me afat të zbatimit të kontratës 12 muaj. Me urdhër nr. 320/1 prot., datë 31.05.2022 të ish Titullarit z. E. J., është ngritur Grupi i Punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës me përbërje të grupit z. S. M., z. O. H. dhe z. S. B.. Referuar dokumentacionit të pagesave konstatohet se janë përfituar tepër shumat për pagesat respektive si më poshtë:

Për periudhën e faturimit 11.05.2022 – 31.05.2022, rezulton se është përfituar tepër vlera prej **4,640 lekë pa TVSH**, prej mos paraqitjes së ditëve të sakta në të cilat ka nisur shërbimi;

Për periudhën e faturimit 01.06.2022 – 30.06.2022, rezulton se është përfituar tepër vlera prej **38,000 lekë pa TVSH**, prej përfshirjes në faturën tatimore të shërbimit në pikat Stadiumi “Arena Kombëtare” dhe “Elbasan Arena”, pika në të cilat, sipas procesverbalit të datës 05.07.2022 ky shërbim nuk është ofruar;

Për muajin tetor 2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH, kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.11.2022 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin nëntor/2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.12.2022 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin dhjetor/2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.01.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin janar/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.02.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin shkurt/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.03.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin mars/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.04.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin prill/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.05.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma

	<p>prej 18,000 lekë me TVSH, ose 15,000 lekë pa TVSH;</p> <p>Për muajin maj/2023 është faturuar shuma prej 239,879 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 19.05.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 225,754 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 14,125 lekë me TVSH, ose 11,771 lekë pa TVSH;</p> <p>Për periudhën maj 2022 – maj 2023 rezulton se nga ana e ofruesit të shërbimit për pikën e emërtuar si “<i>Pallati i Sportit G. B.</i>” nuk është ofruar internet i llojit Dark Fiber me çmim 23,000 lekë pa TVSH por është ofruar me transmetim oIP, me një çmim prej 15,000 lekë. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 96,000 lekë pa TVSH [12 muaj x (23,000 – 15,000)];</p> <p>Nga verifikimi i pagesave mujore konstatohet se në pikat “<i>Pallati i Brigadave</i>”, “<i>Stadiumi Shijak</i>”, dhe “<i>Hotel Tirana</i>” nuk është ofruar shërbim për të gjithë afatin e kontratës, për 12 muaj AK Radio Televizioni Shqiptar nuk ka marrë shërbimi për të cilin OE V. A., është kontraktuar sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 me vlerë 8,512,992 lekë me TVSH. Për sa më sipër nga ana e grupit të monitorimit të kontratës, zyrës së fiancës si dhe Titullari nuk janë marrë masat e nevojshme për aplikimin e penalteteve për mos realizim të kontratës përmes aplikimit të penalteteve. Kjo shumë e paaplikuar rezulton të jetë në masën prej 44,530 lekë pa TVSH;</p> <p>Si përfundim, rezulton se janë përfituar vlera financiare tepër nga ana e OE V. A., për shërbime të pakryera dhe penaltete të pa aplikuar, në total në shumën prej 299,941 lekë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të arkëtohet ndaj OE.</p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën e shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 17.10.2020, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>”, i ndryshuar dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:</p> <p>Neni 107, “<i>Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës</i>”, pika 3 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p><i>“Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, Autoriteti/enti Kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.</i></p> <p><i>pika 6 ku përcaktohet se:</i></p> <p><i>6. Personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës lidhur me ecurinë e zbatimit të kontratës, përgatisin informacione të vazhdueshme për problematikat në këtë proces dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, të cilat ia përcjellin personit përgjegjës për prokurimin, me qëllim raportimin prej këtij të fundit, pranë APP-së. Në përfundim të kontratës, personi ose strukturat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës përgatisin</i></p>

	<p><i>një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti, si dhe paraqet një informacion për likuidimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i kontratës, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.”</i></p> <p><i>Pika 7 ku përcaktohet se:</i></p> <p><i>“Personi apo strukturat e ngarkuara nga Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:</i></p> <p><i>a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;</i></p> <p><i>b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;</i></p> <p><i>c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;</i></p> <p><i>ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;</i></p> <p><i>d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;</i></p> <p><i>dh) raporton tek titullari i Autoritetit/entit Kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;</i></p> <p><i>e) administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë; ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;</i></p> <p><i>f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së.”</i></p> <p><i>Kontrata nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022;</i></p> <p><i>Urdhri nr. 320/1 prot., datë 31.05.2022;</i></p> <p><i>Rregulloren e Përgjithshme të Punës.</i></p>
Ndikimi:	Dëm ekonomik në shumën prej 299,941 lekë.
Shkaku:	Mungesa e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të gjetur me përgjegjësi.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të AK të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës prej 299,941 lekë ndaj OE V. A. , për shërbime të likuiduara por të porealizuara si dhe për penalitete të pa aplikuar për dorëzimin me vonesë të shërbimeve në kontratën me objekt <i>“Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”</i> të lidhur sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E. J., ish zv. Drejtori i Përgjithshëm, z. E. D., (Drejtoria Ekonomike), Drejtori i Njësisë Teknike z. H. M., Grupi i Monitorimit të kontratës z. S. M., z. O. H. dhe z. S. B..

9. Procedura e prokurimit me objekt Blerje shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me Fibër Optike, Viti 2023.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me Fibër Optike”, me nr. REF-62192-03-10-2023)		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 613 prot., datë 03.03.2023	3.1 Argumentimi i fondit limit dhe Specifikimeve teknike Shkresa nr. 54/5 prot., datë 30.01.2023 znj. B. M. z. M. M. znj. K. B. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 613 prot., datë 03.03.2023 znj. B. M. – Kryetare z. M. M. – Anëtare znj. K. B. – Person përgjegjës për prokurimin	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 613/1 prot., datë 03.03.2023 z. B. M. – Kryetar znj. M. P. – Anëtare znj. J. S. – Anëtare
2. Lloji i Procedurës “E hapur”, “Shërbim”, format elektronik Marrëveshje Kuadër me një OE ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 37,265,708.33 lekë 5.1 Afati 24 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër	6. Oferta e kualifikuar e para O. A., Marrëveshja kuadër sipas aktit me nr. 613/17 prot., datë 12.05.2023. Minikontrata nr. 613/21 prot., datë 12.05.2023.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 18,264,482 lekë 49 %
8. Data e hapjes së tenderit 05.04.2023, ora 11:00	9. Burimi Financimit Të ardhurat e RTSH	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH) Piesëmarrës: O. A., – 19,001,226 TIBO – 24,840,500 V. A. & ASC & A. & A. - 34,500,006 <u>S’kualifikuar:</u>
11. Ankimime -	12. Përgjigje Ankesës Nga AK -	
Titullari i Autoritetit Kontraktor z. R. N.		

NË LIDHJE ME PLANIFIKIMIN E INVESTIMIT

Ky investim është iniciuar me shkresën me nr. 54, datë 06.01.2023 ku është bërë kërkesë nga ana e Drejtorit të Teknologjisë dhe Informacionit për përsëritjen e kontratës së mëparshme në lidhje me shërbimin me internet.

5. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të përcaktimit të vlerës së fondit limit të investimit.
Situata:	Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me Fibër Optike”, viti 2023, rezulton se me shkresën nr. 54/5 prot., datë 30.01.2023 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit me përbërje të grupit znj. B. M., z. M. M. dhe znj. K. B.. Përcaktimi i vlerës së fondit limit është bërë në bazë të ofertave të kërkuara ndaj OE V. A., O. A., A., A. S. C., D., T. dhe T. tv. Pas marrjes së ofertave, sipas shkresës me nr. 54/24 prot., datë 01.03.2023 është bërë përcaktimi i vlerës së fondit limit si një mesatare e ofertave të marra duke bërë përcaktuar shumën prej 37,265,708.33

	<p>lekë pa TVSH. Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në momentin e nxjerrjes së Urdhrit me nr. 54/5 prot., datë 30.01.2023, për përgatitjen e specifikimeve teknike me argumentimin e fondit limit, RTSH ka patur në proces një kontratë të lidhur me OE V. A., me të njëjtin objekt prokurimi e konkretisht “<i>Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike</i>”. Në këtë procedurë është konstatuar se operatori ekonomik i shpallur fitues ka rezultuar me një ofertë fituese, e cila ka një ulje në vlerë prej 4,292,040 lekë pa TVSH nga fondi limit, ose në masën prej 37.7 %. Pra, procedura e mëparshme ka rezultuar e suksesshme me çmime shumë më të ulëta nga ato të parashikuara nga AK në procedurën e aktuale. Për rrjedhojë, në këtë rast AK nuk duhet ti ishte referuar mesatareve të marra nga ofertat e operatorëve ekonomikë V. A., A., A. S. C., A. T. U. O. A., por të merrte në konsideratë edhe çmimet e kontratës së parë. Nga përllogaritjet rezulton se nëse vlera e fondit do të ishte përllogaritur me vlerën e kontratës së vitit 2022, do të ishte në masën 17,861,930 lekë pa TVSH, ose 19,403,778 lekë pa TVSH më pak nga vlera prej 37,265,708 lekë pa TVSH që ka parashikuar AK për vitin 2023. Gjithashtu, konstatohet se as ulja e realizuar nga ana e operatori ekonomik fitues O. A., si rezultat i diferencës midis vlerës së ofertës me vlerën e fondit limit, nuk e ka korrigjuar një efekt të tillë i cili ka bërë që AK të lidh një kontratë për ofrim shërbimi me vlerë 1,139,296 lekë pa TVSH, më tepër mbi vlerë e duhur të fondit limit¹², vlerë kjo e cila përbën përdorim pa eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Ligji 162/2020 <i>Për Prokurimin Publik</i> neni 34 <i>Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit</i>, pika 3 <u>ku përcaktohet se:</u> “3. Autoriteti ose enti kontraktor në fazën e hartimit të nevojave të tyre për mallra, punë, shërbime mbajnë në konsideratë metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale përpara dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës”;</p> <p>VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “<i>Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik</i>”, neni 12 <i>Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës</i>, pika 4 <u>ku përcaktohet se:</u> “4. Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit.”</p> <p>neni 13 <i>Studimi paraprak i tregut</i>, pika 2 <u>ku përcaktohet se:</u> “2. Studimi i tregut ka për qëllim përllogaritjen e një vlerë reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut.”</p> <p>neni 76 <i>Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit</i>, “1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti</p>

¹² Nëse vlera e fondit limit do të ishte sipas çmimeve të kontratës së mëparshme.

	<p>kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:</p> <p>a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT) ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe</p> <p>b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe</p> <p>c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe</p> <p>ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.</p> <p>Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.</p>
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumë prej 1,139,296 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Mungesa e njohjes së kuadrit ligjor e rregullator të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
5.1 Rekomandimi:	Nga ana e RTSH të merren masat e nevojshme për një vlerësim objektiv të mundësive që ofron kuadri ligjor e rregullator i prokurimit publik në përcaktimin e vlerës së fondit limit, duke përzgjedhur mes tyre variantin më të përshtatshëm i cili siguron përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

Lidhur me sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Titullari i AK z. E. J., si dhe grupi i ngritur për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit znj. B. M., z. M. M. dhe znj. K. B..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Akt Konstatimi nr. 18 për të cilin nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni i administruar në RTSH me nr. 32/6 prot., datë 30.01.2024 nga ana e z. M. M. dhe znj. K. B., ku janë paraqitur pretendimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

“Grupi i KLSH ka vendosur si bazë ligjore ligjin nr. 162/2020 neni 34, pika 2 si dhe VKM nr. 285, neni 12, pika 4. Sipas këtij citimi NJP ka zbatuar në mënyrë korrekte bazën ligjore ku përlllogaritja e vlerës së fondit limit i është referuar nenit 76, pika 1, germa b e VKM nr. 285 I. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT) ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.”

AK mund ti referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të

krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë OE. Dispozita nuk përbën kusht kumulativ por alternativ zgjedhjeje midis tyre për të ezauruar një ose disa nga alternativat. Grupi i punës ju referua pikës b, specifikisht studimit të tregut bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim.

Së pari, Në lidhje me konstatimet e sipërcituara nga grupi i auditimit, lidhur me përzgjedhjen e argumentimit të fondit limit bazuar në studimin e tregut, mbi mesataren e çmimeve të marra nga ky studim sqarojmë se: Në nenin 76 të VKM 285 citohet se: ...

Lidhur me sa më sipër grupi i ngritur për përllogaritjen e fondit limit në mënyrë që të bënte një përllogaritje të saktë dhe reale të fondit limit në zbatim të dispozitës ligjore ku citohet autoriteti/enti kontraktor mund ti referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e fondit limit me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë OE për argumentimin e fondit limit grupi i punës ju referuar alternativës b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim, grupi i punës ngritur me urdhër nr. 54/5, datë 30.01.2023 për argumentimin e fondit limit, ju drejtua me kërkesë për ofertë 9 OE për të bërë studim real tregu, duke ju drejtuar OE të cilët jo vetëm e kanë objektin e prokurimit në ekstraktet e tyre të QKB – së por operojnë prej vitesh në treg duke u konsideruar OE të suksesshëm. Për përllogaritje të fondit limit mori në studim 6 oferta ekonomike të OE të cilët u janë përgjigjur kërkesave për ofertë, për të përllogaritur një vlerë reale të tregut me një gamë më të gjerë të OE në studim. Grupi i punës ka përzgjedhur pikën b të neni 76. Në këtë rast duke u nisur dhe nga fakti që kemi të bëjmë një shërbim për të cilin operojnë një numër i konsiderueshëm OE me infrastrukturë, zgjidhje dhe teknologji të ndryshme që operojnë në tregun shqiptar, çdo specifikim mund të jetë i veçantë dhe të ndikojë drejtpërdrejtë në vlerë.

Së dyti, grupi i punës sqaron se e kishte të pamundur që për argumentimin e fondit limit të bazohej të çmimet e kontratave të mëparshme pasi:

- referuar faktit që shërbimi për sinjalin mbulon një pjesë të rëndësishme të Radios de TV ... vlerësoi shtrirjen për një periudhë 24 mujore;
- AK bazuar në eksperiencat e mëparshme ku mund të lind nevoja për heqje, zëvendësim, shtim të pikave të lidhjeve .. u vlerësua që kjo procedurë prokurimi të realizohet në formën e marrëveshjes kuadër;
- përllogaritja e fondit limit për marrëveshjen kuadër për shërbimin e kërkuar është mbi bazën e çmimit ditor dhe jo mujor, ndryshe nga ajo e vitit 2022;
- procedura e vitit 2023 bazohej në nevoja dhe kërkesa ndryshe nga procedura e vitit 2022 e cila konsistoi në rritjen e pikave të lidhjeve si nevoja për një sistem monitorimi SLA për shërbimin e blerjes dark fibër dhe over IP.

Për sa më sipër për procedurën e mëparshme ka ndryshime.”

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH-së:

Pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga pretendimet e paraqitura në Projektraportin e Auditimit.

NË LIDHJE ME KRITERET

Sipas procesverbalit përkatës janë hartuar dokumentet e procedurës së prokurimit për kontratën e shërbimit përfshirë kriteret e veçanta të kualifikimit. Sipas shkresës nr. 613/3 prot., datë 23.03.2023 është bërë pezullimi nga ana e Titullarit i procedurës pas rekomandimeve të lëna nga ana e APP.

NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E OFERTAVE

Nga verifikimi i SPE rezulton se në procedurë kanë marrë pjesë 3 OE dhe gjatë klasifikimit paraprak rezulton se nuk janë bërë s’kualifikime të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës **duke**

shpallur në vend të parë ofertën me vlerën më të ulët nga pjesëmarrësit, atë të OE O. A., me vlerë të ofertës 19,001,226 lekë pa TVSH, se 49 % më pak se vlera e fondit limit të parashikuar. Me shkresën nr. 613/15 prot., datë 02.05.2023 është miratuar nga ana e Titullarit Raporti Përmbledhës i Procedurës duke shpallur fitues OE O. A..

NË LIDHJE ME ZBATIMIN E KONTRATËS

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se është lidhur Marrëveshja kuadër sipas aktit me nr. 613/17 prot., datë 12.05.2023 dhe me shkresën me nr. 613/21 prot., datë 12.05.2023 është lidhur minikontrata përkatëse me vlerë 5,676,094 lekë pa TVSH, ose 6,811,312.8 lekë me TVSH. Në lidhje me zbatimin e kontratës rezulton se janë mbajtur deri aktualisht procesverbalet e mëposhtëm nga ana e grupit të ngritur për këtë qëllim me përbërje të grupit z. S. M., z. G. Z. dhe z. S. B.. Konkretisht janë mbajtur:

Procesverbali i datës 01.06.2023 për periudhën 12 – 31 maj 2023

Procesverbali i datës 05.07.2023 për periudhën 1 – 30 qershor 2023

Procesverbali i datës 07.08.2023 për periudhën 1 – 31 korrik 2023

Procesverbali i datës 01.09.2023 për periudhën 1 – 31 gusht 2023

Për sa më sipër nga ana e ofruesit të shërbimit është faturuar shuma prej 2,687,176.8 lekë me TVSH dhe referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion shumat e situacionuara përputhen me përshkrimet e bëra në procesverbalet mujore të realizimit të transmetimit.

10. Procedura e prokurimit “Blerje pajisje elektronike për nevojat e transmetimit”, viti 2020 Njësia e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve, Departamenti i Prodhimit dhe Departamenti Teknik TV i kanë shtruar një kërkesë për blerje ish-Drejtorit të Pergjithshëm të RTSH z.Th.G.. Me kërkesën me Nr.256 Prot datë 27.05.2020 janë kërkuar nga këto departamente materiale elektronike te cilat do të shërbenin për rritjen e cilësisë së programeve.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Blerje pajisje elektronike për nevojat e transmetimit”		
1. Urdhër Prokurimi Nr.39/2, datë 24.06.2020		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur	2. Njësia e Prokurimit z. G. A. z. F. Z. z. O. T.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. D. M. z. G. J. z.F. Z.
4. Fondi limit (pa tvsh) 28.788.242,7 lekë	5. Burimi i Financimit Të ardhurat e RTSH	6. Data e hapjes së tenderit 24.06.2020
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës “E.” sh.p.k 27,050,972 “V.” sh.p.k 20,527,527 b) kualifikuar: “T” sh.p.k 23,851,028 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave znj. G. H. znj. M. A. z. T. Sh.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 23,851,028 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë nr. 39/17 prot datë 11.09.2020	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,937,214.7 lekë	12. Ankimime Ankesë drejtuar AK nga OE “L. B.” me Nr.1949 prot., datë 02.07.2020, APP ka rekomanduar ndryshime në specifikime teknike dhe kritere
13.Struktura për ndjekjen e kontratës z. B. A. z. F. M. z. A. O.	14. Fletë hyrja Mallra	15. Afati i kontratës 45 ditë
16.Vlera e kontratës me TVSH 28,621,233.6 lekë	17.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Fatura Nr.147 9,547,210 lekë datë 21.09.2020 ,Fatura Nr.150 4,266,816 lekë datë 22.09.2020, Fatura Nr.154 2,010,076 lekë datë 28.09.2020, Fatura Nr.171 3,575,529 lekë datë 16.10.2020, Fatura Nr.176 688,438 lekë datë 23.10.2020, Fatura Nr.189 1,294,494 lekë datë 06.11.2020, Fatura Nr.195 2,468,465 lekë datë 16.11.2020	

Për përlogaritjen e fondit limit është kryer testimi i tregut, ku janë marrë ofertat përkatëse sipas O.E. të mëposhtëm:

P.	30,102,104
V.	26,171,375
A. sh.p.k	30,091,250
Mesatarja e ofertave	28.788.242

Bazuar në listën e mësipërme, fondi limit është përlogaritur të jetë **28.788.242** lekë pa TVSH.

I. Kriteret

Në Formularin e njoftimit të fituesit datë 19.08.2020 Nr. 39/16 prot., K.V.O vendosi të kualifikojë O.E “T” shpk ku sipas K.V.O, kualifikohet pasi plotëson kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të përcaktuara nga AK.

K.V.O ka skualifikuar O.E “V.” sh.p.k ku sipas tyre Autorizimet e Prodhuesit janë të pa njësuar me origjinalin, në kundërshtim kjo me Dokumentet e Tenderit, Paragrafi 1 fundit tek Kriteret Teknike konkretisht: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për skualifikim.” Gjithashtu mungon Deklarimi sipas Shtojcës 8 në lidhje me Ortakun e shoqërisë për Gjendjen Gjyqësore.

Nga auditimi u konstatua se:

O.E “T” shpk ka paraqitur autorizim nga distributori “O-V.”, por në verifikimin e bërë në SPE konstatohet se O.E nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit që autorizon distributorin.

Në SPE u konstatua se të gjitha autorizimet nga prodhuesi të cilat i ka paraqitur O.E “V.” sh.p.k janë të përkthyer nga Notereja Znj. R. K..

Gjithashtu K.V.O ka vendosur për skualifikimin e këtij O.E mungesën e deklaramit së gjendjes gjyqësore në lidhje me ortakun e shoqërisë z. C. B., ku sipas shkresës me Nr.39/14 prot. Datë 07.08.2020 Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Prokurimeve Z.G. A., ka vënë në dijeni K.V.O se nuk u bë i mundur verifikimi i ortakut të shoqërisë “V.” sh.p.k Z. C. B.

2. Specifikimet teknike

A.K me anë të njësisë së Hartimit të Specifikimeve Teknike të përbërë nga ka z. D. M., z. G. J. dhe z. F. Z., ka përcaktuar specifikimet teknike të mallrave. A.K nuk ka krijuar hapësirë për konkurrin të produkteve nëpërmjet vendosjes së kriterëve të vecanta për kualifikim. Në lidhje me specifikimet teknike, vërejmë se specifikimet teknike janë përshtatur në shumë elemente me prodhuesit dhe modelet respektive të tyre. Në hartimin e specifikimeve teknike nuk është lënë hapësirë por janë vendosur vlera fikse, që pengojnë dhe dekurajojnë konkurrencën. A.K në hartimin e specifikimeve teknike i është referuar katalogut të disa produkteve specifike, gjithashtu ka specifikime të cilat nuk përbëjnë efekt për arritjen e qëllimit që ka për objekt kjo procedurë prokurimi. APP ka rekomanduar ndryshime në specifikime teknike në bazë të ankesës drejtuar A.K nga O.E “L. B.” me Nr.1949 prot. datë 02.07.2020. A.K ka pezulluar momentalisht procedurën duke bërë disa modifikime në specifikime teknike. A.K në disa specifikime teknike ka referencë indirekte tek prodhuesi duke vendosur kërkesa dhe vlera fikse is përshembull:

1. Specifikimet e transmetuesit valor (handheld) dhe Transmetuesi bodypack

-Të funksionojë me 2 bateri të llojit AA 1.5V me kohëzgjatje 8 orë

-Treguesi i baterisë të jetë me 4 gjendje

2. Koka e kamerës broadcast për përdorim në studio TV

-Madhësia efektive e sensorit të imazhit 2/3 inch kur perdoret lente 4K B4 mount (madhësia e sensorit eshte 13.056mm x 7.344mm)

-Ekрани të jetë i pajisur me ekran 4 inch LCD me prekje (touchscreen) për leximin dhe vendosjen e parametrave

3. Kufje profesionale komenti

-Pesha pa kabëll sinjali 240 g

4. Kodekët

-Apple ProRes

-Blackmagic RAË etj...

Hartimi i specifikimeve teknike si më sipër sjell orientimin e ofertës fituese drejt një O.E të caktuar ose tek një prodhues i caktuar.

Për sa më sipër këto veprime janë në mospërputhje me Ligjin “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, Nenin 23 për specifikimet teknike dhe nenin 20 “Mosdiskriminimi”.

1. Titulli i gjetjes	Në hartimin e specifikimeve teknike nuk është lënë hapësirë por janë vendosur vlera fikse, që pengojnë dhe dekurajojnë konkurrencën.
Situata:	A.K në hartimin e specifikimeve teknike i është referuar katalogut të disa produkteve specifike, gjithashtu ka specifikime të cilat nuk përbëjnë efekt për arritjen e qëllimit që ka për objekt kjo procedurë prokurimi. A.K në disa specifikime teknike ka vendosur kërkesa dhe vlera fikse.
Kriteri:	Ligji “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, Neni 23 për specifikimet teknike dhe Nenin 20 “Mosdiskriminimi”
Ndikimi/Efekti:	Diskriminimi i operatorëve të tjerë dhe orientimi i ofertës fituese drejt një O.E të caktuar ose tek një prodhues i caktuar.
Shkaku:	Mos respektim i Ligjit “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, Neni 23 për specifikimet teknike dhe Nenin 20 “Mosdiskriminimi”
Rëndësia:	E Lartë

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi, Z. D. M., Z. G. J. dhe Z. F. Z., në cilësinë e njësisë së Hartimit të Specifikimeve Teknike.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 32/5 prot, datë 30.01.2024 protokolluar në KLSH me Nr. 564/42 datë 31.01.2024 mbi Akt Konstatimin nr. 31 datë 14.11.2023.

Pretendimi i subjektit

..... Këto produkte mund të ofertojë secili nga operatorët ekonomik që janë të regjistruar dhe operojnë në Shqipëri.....

.....Të gjithë transmetuesit valor (handheld) dhe transmetuesit bodypack, pavarësisht markes funksionojnë me 2 bateri të llojit AA. Bashkelidhur po ju paraqesim marka, Sennheiser dhe Sony, por mund të konsultoni të gjitha markat që prodhojnë mikrofonë valor. Kohëzgjatja prej 8 orësh është minimalja që e plotësojnë të gjithë, pasi ka marka që kohezgjatjen e kanë edhe 16 ore. Po kështu mund të dalloni edhe treguesin e baterisë me 4 gjendje për markat e mësipërme.....

..... Lentja B4 mount 4k është standarti i përdorimit në këto lloje kamerash dhe të njëjtin standard kanë të gjitha këto kompani.....

....Pesha pa kabell sinjali 240g

Këto lloje kufjesh përdoren për të kryer komente sportive apo përkthime simultane dhe duke lënë se në një ndeshje futbolli do duhet të mbahen minimalisht 90min në koke....

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në zbatim të Ligjit "PËR PROKURIMIN PUBLIK", Neni 23 për specifikimet teknike dhe nenin 20 "Mosdiskriminimi" ku citon se specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime dhe nenin 20 "Mosdiskriminimi", Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre, nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se nuk jeni përmbajtur referimeve të ligjit të mësipërm. Pra sic e kemi cituar dhe në akt konstatimin e mbajtur me numer 31 konstatojmë që specifikimet teknike të hartuara nga ana juaj janë të tepërta dhe ngushtojnë konkurrencën.

Observacioni i sjellë nga na juaj në asnjë moment nuk vërteton që këto fakte dhe prova të sjella bien në kundërshtim me gjetjet e bëra nga ana jonë.

Prandaj ky koment nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

11. Procedura e prokurimit "Blerje video wall, televizor, dhe pajisje ndriçimi për studiot e RTSH-së", viti 2021.

1. Urdhër Prokurimi nr. 53/3 prot. datë 23.08.2021	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit - G. Y. -Drejtor/Drejtorja e Prodhimit -M. A. - Specialiste në drejtorinë e prokurimeve -N. M. - Specialiste në drejtorinë e prokurimeve	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 53/4 prot. datë 23.08.2021, me përbërje D. M. - Kryetar, -F. Z. –Anëtar -K. B. -Anëtar,
5. Fondi Limit (pa TVSH) 53,489,406	6. Oferta fituese (pa TVSH) 48,500,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 4,989,406
8. Data e hapjes së tenderit 24.09.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 34,800,000 Fond të ardhurat dytësore 18,689,406	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _4_OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar ___2 OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës 53/16 22.10.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 58,200,000	16. Afati i kontratës në dite Nga nënshkrimi me afat 60 ditë

NË LIDHJE ME PLANIFIKIMIN E INVESTIMIT

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore të institucionit, përkatësisht në vlerat si me poshtë:

Fonde nga buxheti i shtetit në vlerën 34,800,000 lekë.

Fonde nga të ardhurat dytësore 18,689,406 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

NË LIDHJE ME FONDIN LIMIT

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference të përcaktuar nga studimi i tregut nëpërmjet ofertave të operatoreve ekonomike dhe çmim manuali të ndërtimit për artikujt elektrikë. Në dosjen e administruar për këtë procedurë mungon ftesa për oferte dërguar operatoreve ekonomike, kjo në kundërshtim me nenin 2 të VKM-së 285 datë 19.05.2021, pika 1,

NË LIDHJE ME KRITERET

Sipas procesverbalit të datës 24.05.2021 është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike. Nga auditimi rezultojnë mangësi në lidhje me kriteret si më poshtë:

Kriteri 2.3.6:

“Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim i lëshuar nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar prej tij, për materialet e përcaktuara me yje tek numri rendor (nga numri rendor 1 deri në numrin rendor 11) në tabelën e vendosur në Shtojcën 6”.

Argumentimi i bërë për pikën 2.3.6 nuk qëndron dhe nuk justifikon vendosjen e kësaj kërkesë për kualifikim dhe është në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, neni 1, neni 20 dhe neni 36 pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite:

“Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 28, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

Për autorizimin e prodhuesit është shprehur dhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendim nr. 851, datë 03.12.2021 *“Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Nga vlerësimi i këtij rasti, rezulton se auditimi i kryer në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë DPPSH ka konstatuar mungesë të konkurrencës në procedurat prokuruese të mirëmbajtjes së disa aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të kufizimit në lëshimin e autorizimit të prodhuesit vetëm për një operator, konstatim i cili ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve në DST, të cilat vendosen nga vetë Autoriteti Kontraktor. Vendosja e këtyre kriterëve, në respektim të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet”.*

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II *“Parime të përgjithshme”*, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” apo “Super specifikimit” Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendim nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” apo “Super specifikimin” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit e mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Për sa i përket specifikimeve teknike Autoriteti Kontraktor ka bërë modifikimin e tyre pas hedhjes në sistem, sipas rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimeve Publike përmes shtojcës me nr. 53/11 prot., datë 08.09.2021.

Për specifikimet e vendosura për mallrat e kërkuara nuk ka asnjë reference në kundërshtim me nenin 41 të VKM-së 285/2021, neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”. I. “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet”.

Gjithashtu me shtojcën 53/8 datë 127.08.2021 Autoriteti Kontraktor ka modifikuar dokumentet standarde të tenderit duke ndryshuar llojin e procedurës së prokurimit sipas kufijve monetar të parashikuar në LPP-në për prokurimet publike. Me ndryshimin e llojit të procedurës së prokurimit Autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar vlerën limit të kontratës sipas përcaktimeve të nenit 12 të VKM-së 285 datë 19.05.2021 ku përcaktohet qartë se:

“Autoriteti/enti Kontraktor, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, konverton vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor vendos dhe kursin e këmbimit të përdorur prej tij.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit e përberë nga Z.G. Y., Znj.M. A., dhe Znj.N. M..

NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E OFERTAVE

Në raportin përmbledhës përshkruhet që anëtarët e KVO-së bënë hapjen e procedurës së prokurimit në orën dhe datën e përcaktuar në dst-të. Sipas raportit përmbledhës të datës 12.10.2021, si dhe sistemit elektronik të APP-së, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 4 (katër) operator ekonomik

I. & S. C. – 48,500,000

P. I. – 52,016,580
M. LTD – 52,500,000
P A. T. – 53,110,250

Sipas Raportit Përmbledhës, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka shpallur fitues bashkimin e operatorëve ekonomik I. & S. C., me ofertë 48,500,00 lekë pa TVSH. Në vijim është lidhur kontrata me nr. 53/16 prot., datë 22.10.2021, ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga z. M. L., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe bashkimit të operatoreve ekonomike I. & S. C. në vlerën 58,200,000 lekë me TVSh, me datë fillimi nënshkrimit e saj dhe me afat 60 ditë.

NË LIDHJE ME ZBATIMIN E KONTRATËS

Me urdhrin nr. 53/18 datë 27.10.2021 nga Titullari i AK është ngritur grupi i punës për zbatimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave sipas kontratës së sipërcituar përberë nga z. M. L., z. F. Z. dhe znj. N. M.. Grupi i marrjes në dorëzim ka mbajtur procesverbalin me nr. 53/19 datë 13.12.2021 për marrjen në dorëzim të një pjese të mallrave sipas kontratës 53/19 datë 22.10.2021. Në procesverbal citohet se mallrat e dorëzuara përmbushin specifikimet teknike dhe termat e referencës sipas kontratës.

Për pjesën e pa dorëzuar të mallrave operatori ekonomik I., me shkresën me nr. 4546 prot. të datës 16.12.2021, ka njoftuar Autoritetin Kontraktor se këto mallra janë të bllokuara në portin e Roterdamit për arsye të masave të ndërmarra nga shteti Holandez (me shfaqjen e variantit të Omicron të Covid 19) dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të kontratës deri në datë 28.12.2021. Autoriteti Kontraktor RTSH, pasi konfirmimit që mallrat e bllokuara në port janë të njëjtët me ato të kontratës së nënshkruar me operatorin ekonomik I., ka pranuar modifikimin e afatit të kontratës, gjendur në kushtet e forcës madhore. Me datë 20.12.2021 Autoriteti Kontraktor RTSH i përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm z. E. J. dhe bashkimi i operatoreve I. SH.P.K & S. C. përfaqësuar nga z. E. A., kanë nënshkruar amendimin e kontratës me nr. 4546/6 prot, për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e kontratës me nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021. Afati i amendimit të Kontratës është bërë nga data 20.12.2021 deri me datë 28.12.2021.

Neni 4 i amendimit të kontratës “Klauzolë shtesë” përcakton se: “Nëse me mbarimin e afatit të kontratës siç përcaktohet në nenin 4 të këtij amendimi nuk janë dorëzuar të gjitha mallrat sipas zërave objekt të kontratës nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021, në ambientet e RTSH-së, brenda orarit zyrtar të punës (ora 16:00), Autoriteti Kontraktor RTSH ka të drejtën për ta deklaruar kontratën të zgjidhur menjëherë”.

Operatori ekonomik I., me shkresën nr. 4701 prot. datë 24.12.2021 ka dërguar një njoftim tjetër që ndikon në ecurinë e kontratës për arsye të forcës madhore, ku lajmëron se ka të pamundur realizimin e kontratës sipas amendimit të sipërcituar dhe kërkon sërish shtyrje të afatit për ekzekutim kontratës. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 4701/1 datë 28.12.2021 ka bërë me dije operatorin ekonomik se procedura e prokurimit financohet nga të ardhurat e RTSH-së dhe fondet e buxhetit të shtetit dhe se shtyrja e afatit të kontratës nuk është e mundur për arsye se ndikohet nga udhëzimi i nr. 25 datë 09.12.2021 të Ministrisë së Financave “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore për buxhetin e vitit 2021”, dhe vendos zgjidhjen e kontratës.

Operatori ekonomik I., me shkresën nr. 298 prot., datë 20.01.2022 njofton mbërritjen e mallrave dhe kërkon të bëjë dorëzimin jashtë afateve të kontratës. Autoriteti Kontraktor refuzon marrjen në dorëzim të mallrave jashtë afateve të kontratës dhe për këtë ka bërë me dije OE nëpërmjet shkresës nr. 2981/1 datë 25.01.2022. Operatori ekonomik I., (pasi ka pranuar zgjidhjen e kontratës në rast mosdorëzimi të mallrave brenda afateve të përcaktuara në amendimin e kontratës), duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për mospranim të mallrave jashtë afateve të kontratës, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë-padinë objekt gjykimi.

Me vendimin 2508 datë 04.10.2022 Gjykata administrative e Shkalles së Parë, Tiranë, ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, Detyrimin e palës së paditur që të përmbushë detyrimin kontraktor ndaj paditësve në shumën 48,500,000 mijë lekë, Rrëzimin e kërimit për dhënie vendimi me ekzekutim të përkohshëm dhe Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbarimor gjyqësor.

Ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor të ekzekutojë plotësisht këtë detyrim nga dita që ky vendim të këtë marrë formë të prere.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Sipas urdhrin nr 321 prot. nr. 191 rregj.për vënien e sekuestros ekzekutive, tarifa e shërbimit përmbarimor me TVSH është 972,938.4 lekë.

Nga ana e RTSH-së janë marrë të gjitha masat për të ankimuar vendimin e gjykatës dhe kundërshtuar urdhrin përmbarimor, por gjendur në kushtet e bllokimit të llogarive financiare dhe pamundësisë për pagesë të gjithë shumës njëherësh, është lidhur një marrëveshje për pagesën me këste.

Nga Autoriteti Kontraktor RTSH, deri në këto momente janë paguar 3 këste, përkatësisht në muajin gusht, shtator dhe tetor, në vlerë të këstit 11,131,160 lekë në muaj.

Shumica e mallrave të bëra hyrje në magazinën e RTSH-së nga shoqëria I., (sipas vendimit gjykatës), janë akoma gjendje në magazinë dhe të papërdorura. Si konkluzion Autoriteti Kontraktor nuk ak qenë në kushtet e emergjencës për këto mallra dhe gjithë zhvillimi i procedurës e likuidimi është në kundërshtim me nenin 2 të prokurimeve publike. Autoriteti kontraktor duhet të merrte masa për planifikimin në kohë të nevojave dhe realizimin në kohe të procedurave të prokurimit.

Nisur nga sa më sipër vlera prej 49,472,938 lekë me TVSH përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit.

Nga ana e z. E. J., si dhe z. M. L., të dy këta në cilësinë e Titullarit të AK, dhe gjithë personat e tjerë të përfshirë në këtë procedurë, për sa trajtuam më sipër me veprimet dhe mosveprimet e tyre nuk kanë maksimizuar eficiencën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, duke i keq menaxhuar ato, veprim në kundërshtim me:

Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se Neni 2 “Qëllimi”

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

-Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

-Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b ku është shprehur në ligjëratë të

drejtë “Sigurimin e përdorimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike që ai menaxhon. Nëpunësi autorizues vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij”.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”:

- Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, ku është shprehur në ligjëratë të drejtë “Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.”

-Neni 2 “Qëllimi i ligjit” Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”.

Titulli i gjetjes nr. 4	Efekt financiar negativ në vlerën 49.472.938 lekë.
Situata:	<p>Me datë 22.10.2021 është lidhur kontrata me nr. 53/16 prot. ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga z. M. L., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe bashkimit të operatorëve ekonomik I. & S. C., në vlerën 58,200,000 lekë me TVSh, me datë fillimi nënshkrimin e saj dhe me afat 60 ditë.</p> <p>Me datë 20.12.2021 Autoriteti Kontraktor RTSH i përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm z. E. J. dhe bashkimi i operatoreve I. SH.P.K & S. C., përfaqësuar nga z. E. A., kanë nënshkruar amendimin e kontratës me nr. 4546/6 prot, për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e kontratës me nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021, me arsyen se mallrat objekt i kontratës janë bllokuar në port nga situata e Covid 19. Neni 4 i amendimit të kontratës “Klauzolë shtesë” përcakton se: “Nëse me mbarimin e afatit të kontratës siç përcaktohet në nenin 4 të këtij amendimi nuk janë dorëzuar të gjitha mallrat sipas zërave objekt të kontratës nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021, në ambientet e RTSH-së, brenda orarit zyrtar të punës (ora 16:00), Autoriteti Kontraktor RTSH ka të drejtën për ta deklaruar kontratën të zgjidhur menjëherë” Operatori ekonomik I., (pasi ka pranuar zgjidhjen e kontratës në rast mosdorëzimi të mallrave brenda afateve të përcaktuara në amendimin e kontratës), duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për mospranim të mallrave jashtë afateve të kontratës, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë-padinë objekt gjykimi.</p> <p>Me vendimin 2508 datë 04.10.2022 Gjykata administrative e Shkalles së Parë, Tiranë, ka vendosur:</p> <p>Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, Detyrimin e palës së paditur që të përmbushë detyrimin kontraktor ndaj paditësve në shumën 48,500,000 mijë lekë, rrëzimin e kërimit për dhënie vendimi me ekzekutim të përkohshëm dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbartimor gjyqësor,</p> <p>Vlera 48,500,000 lekë sipas vendimit gjyqësor nr.2508 datë</p>

	04.10.2022. Vlera 972,938.4 lekë për vënien e sekuestros ekzekutive ,tarifa e shërbimit përmbarimor. Vlera 49,472,938.4 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin shtetit dhe buxhetin e RTSH-së.
Kriteri:	Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 2,3. -Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale” Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1, ku është shprehur në ligjëratë të drejt “Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë. -Neni 2 “Qëllimi i ligjit” Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë”. Neni 52 “Kryerja e shpenzimeve” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësive të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik.
Ndikimi/Efekti:	Efekt ngetavi financiar
Shkaku:	Neglizhencë nga strukturat e prokurimit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Strukturat aktuale në RTSH, Drejtori dhe bordi drejtues të marrin në vlerësim dhe të analizojnë shkaqet dhe arsyet që kanë sjellë pasojat financiare në vlerën 49,472,938 lekë, duke nxjerrë përgjegjësinë ligjore dhe administrative të të gjitha strukturave drejtuese dhe zbatuese, referuar gjetjeve të grupit të auditimit. Vlera 48,500,000 lekë sipas vendimit gjyqësor nr.2508 datë 04.10.2022. Vlera 972,938 lekë për vënien e sekuestros ekzekutive, tarifa e shërbimit përmbarimor.

12. Procedura e prokurimit, procedurë e hapur “Mirëmbajtja e automjetëve të Radio Televizionit Shqiptar” me reference në SPE: REF:40394-09-01-2022, vlerë të pritshme të kontratave: 11,533,793 lekë pa TVSH dhe shumatorja e çmimit për njësi : 6,847,229 Lekë pa TVSH, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

1. Urdhër Prokurimi nr. 3218 prot. Datë 29.08.2022	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit - D. H., -Shofer/Drejtorja e shërbimeve mbështetëse -K. B. - Specialiste në drejtorinë e prokurimeve/juriste -N. M. - Specialiste ne drejtorinë e	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 3218/1 prot. datë 29.08.2022,me përbërje E. P. - Kryetar, Drejtori i drejtorisë se shërbimeve
---	--	--

	prokurimeve/ekonomiste	mbështetëse, -M. P. –Anëtare (Specialiste ne drejtorinë e prokurimeve/juriste -M. K. -Anëtar, specialist
5. Fondi Limit (pa tvsh) 11,533,973	6. Oferta fituese (pa tvsh) 7,779,920	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 3,754,053
8. Data e hapjes së tenderit 20.09.2022	9. Burimi Financimit Fond të ardhurat dytësore	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 6 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar ___4_ OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	16. Afati i kontratës në dite Nga nënshkrimi me afat 12muaj ditë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat dytësore të institucionit me vlerë 11.533.973 lekë.

Kjo procedurë prokurimi nuk është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike në kundërshtim nenin 3 të VKM-së 285/2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me kërkesën nr. 1711 Prot., datë 12.05.2022 drejtorja e shërbimeve mbështetëse i është drejtuar drejtorit të përgjithshëm, për të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurat.

1.Mirëmbajtje e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar”

2.Blerje vaj, goma, bateri dhe ad blue për automjetet e Radio Televizionit Shqiptar.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së nr. 1711/2 datë 12.05.2022, është ngritur komisioni për argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe nevojave, të cilët me anë të relacionit nr. 1711/18 Prot., datë 26.07.2022 i kanë përcjellë drejtorit të përgjithshëm të RTSH-së informacion mbi përlllogaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike.

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference të përcaktuar nga studimi i tregut nëpërmjet ofertave të operatoreve ekonomike të llogaritur ne vlerën 15,781,872 lekë pa tvsh.

Me relacionin nr. 1711/19 prot. datë 05.08.2022 grupi i ngritur për hartimin e fondit limit ka vlerësuar pa argumentuar se fondi limit i përcaktuar në baze të ofertave të operatoreve ekonomike është i lartë dhe kërkon ri-testim tregu.

Pas ritestimit të tregut, me anë të relacionit nr. 1711/29 Prot., datë 26.02.2023 i kanë përcjellë drejtorit të përgjithshëm të RTSH-së informacion mbi përlllogaritjen përfundimtare të fondit limit, specifikimeve teknike.

Për përcaktimin e vlerës që duhet të finançohej për riparimet dhe shërbimet që do i bëhen automjeteve (para llogaritjes së fondit limit) nuk është marrë parasysh vlera kontabël dhe norma e amortizimit të çdo mjeti motorik në përputhje me Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011,i ndryshuar.

III. REGJISTRI I AKTIVEVE DHE DOKUMENTIMI I LËVIZJES SË TYRE

Regjistri i aktiveve të njësisive të sektorit publik

26. “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në forme të sintetizuar”.

28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.

30. Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacioneve nga drejtoria e shërbimeve mbështetëse, nuk ka dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme për të argumentuar gjendjen reale të përdorimit dhe nivelin e amortizimit të çdo automjeti (mungojnë kartelat e mjeteve për periudhën), me qëllim identifikimin e saktë të nevojës për riparime dhe shërbim, mbi bazën e të cilave do të llogaritet dhe të kërkohej financimi për të vijuar më pas me llogaritjen e fondit limit sipas përcaktimeve të VKM nr. 285, datë 29.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo pasqyrohet dhe në ftesat për ofertë dërguar operatoreve ekonomik dhe në përlllogaritjen e fondit limit, zërat e përcaktuar janë të paqartë. Nuk është përcaktuar qartë lloji i shërbimit që do të kryhet, ka përsëritje zërash me emërtesa të ngjashme që ndikojnë tek vlera e ofertës, ka emërtesa riparimi që nuk ekzistojnë. Kjo jo vetëm që krijon konfuzion për operatorët ekonomikë ofertues, por ndikon në vlerën e fondit limit duke mos llogaritur një vlerë reale për kryerjen e shërbimit, kjo në kundërshtim me ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenin 36 “Specifikimet teknike” pika 1 e në vijim, ku përshkruhet: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorhet”

Në kundërshtim me nenin 12 të VKM-se 285/2021, e ndryshuar, “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Me shkresën me nr.3218 prot., me datë 29.02.2022 Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë urdhërin e prokurimit për procedurën e prokurimit- procedurë e hapur “Mirëmbajtja e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar” me reference në SEP: REF:40394-09-01-2022, vlerë të pritshme të kontratave: 11,533,793 lekë pa TVSH dhe shumatorja e çmimeve për njësi: 6,847,229_Lekë pa TVSH, me afat 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Hartimi i kërkesave për kualifikim

Nga NJHDT në DST “Aftësitë teknike dhe profesionale”, pika 2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera ambient për ushtrimin e aktivitetit të tij (lidhur me riparimin e automjeteve) brenda një rrezeje 20 km nga qyteti i Tiranës. Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Certifikata e pronësisë, e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose

- çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë huaje.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrje të gjerë dhe nuk siguron një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP-së 162/2020.

Lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike të cilat janë reflektuar edhe në DST, konstatohet, në mbështetje të parashikimeve të kuadrit ligjor që rregullon procedurën e prokurimit publik, për realizimin e kësaj Procedurë duhet të ishin përcaktuar qartë specifikimet teknike në formularin e specifikimeve teknike dhe të ishin përcaktuar qartë termat e referencës.

Në dokumentet standardë të tenderit nuk ka të dhëna të përcaktuara në lidhje me klasifikimin e riparimeve, nuk ka të dhëna teknike për agregatat, pajisjet, pjesët e këmbimit dhe kërkesat për to, dhe nuk ka asnjë kërkesë për certifikimin e tyre sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare kjo në kundërshtim me ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, në kundërshtim me VKM 285/2021 neni 44 “Kërkesat e cilësisë”.

Gjithashtu nuk ka të përcaktuar në formularin e specifikimeve teknike sesi do të trajtohen pjesët e ndërrimit/këmbimit të zëvendësuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi grupi i përlogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike dhe njësia e prokurimit të përberë nga D. H.,

K. B., N. M., E. P., M. P., M. K..

Zhvillimi i procedurës

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 20.09.2022, si dhe sistemit elektronik të APP, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 6 (gjashtë) operator ekonomik nga të cilët dy janë skualifikuar për mos përmbushjen e kërkesave për kualifikim:

OE “A. M. S.” me formular oferte 7,779,920 lekë pa tvsh,	Kualifikuar
OE “A.” me formular oferte 8,331,920 lekë pa tvsh	Kualifikuar
OE “V. M.” me formular oferte 8,641,370 lekë pa tvsh,	S’kualifikuar
OE “B. M.” me formular oferte 9,443,600 lekë pa tvsh	Kualifikuar
OE “T. 3A ” me formular oferte 10,373,375 lekë pa tvsh	Kualifikuar
OE “N.” me formular oferte 10,977,232 lekë pa tvsh	S’kualifikuar

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, ku është renditur në vend të parë operatorin ekonomik ”A. M. S. ”sh.p.k., si oferta me vlerën me të ulët, përkatësisht në vlerën 7,779,920 lekë pa TVSH.

Në vijim është lidhur marrëveshja kuadër me nr. 3218/5 prot., datë 17.10.2022, ndërmjet drejtorisë së përgjithshme të RTSH-së të përfaqësuar nga z. E. J., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe shoqërisë “A. M. S. ” SHPK të përfaqësuar nga A. M., më vlerë të pritshme të kontratave 11,533,973 lekë pa TVSH dhe 13,840,768 lekë me TVSH.

Në vijim të marrëveshjes kuadër janë lidhur kontratat e mëposhtme:

Kontratë shërbimi nr 1 nr. 3218/9 prot. dat 15/11/2022 ne vlerën 5,282,904 lekë me tvsh

Kontratë shërbimi nr 2 nr. 442/8 prot. datë 26/05/2023 ne vlerën 3,785,472 lekë me tvsh

Kontratë shërbimi nr 3 nr. 442/8 prot. datë /10/2023 ne vlerën 5,064,192 lekë me tvsh

Zbatimi i kontratës

Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Planifikimit Financiar, është Likuiduar sipas urdhër shpenzimeve vlera 6,885,048 lekë me TVSH.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar nuk është hartuar dhe nënshkruar procesverbal nga personi autorizuar në të cilin të shprehet se është bërë kthimi i tyre në magazinën e rekuperos, veprime këto në kundërshtim me, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Menaxhimi i aktiveve në njësite e sektorit publik".

Kjo ngarkon me përgjegjësi drejtorin e shërbimeve mbështetëse për periudhën E.P..

Titulli i gjetjes nr.1	Përlllogaritje jo saktë e fondit limit
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar” , përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke mos patur informacion të plote në lidhje me gjendjen e automjeteve, nuk është marrë parasysh vlera kontabël dhe norma e amortizimit të çdo mjeti motorik
Kriteri:	-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76, pika dhe 2. -Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të fondeve publike
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit për mirëmbajtjen e automjeteve, të kryhet pasi të jenë përcaktuar difektet konkrete dhe gjendja teknike e mjeteve në një servis të certifikuar.

13.Procedura e prokurimit, procedurë e hapur e thjeshtuar “Blerje vaj, goma, bateri dhe adblue për automjetet e Radio Televizionit Shqiptar me reference në SPE: REF:44905-10-10-2022, me fodn limit 3,551,600 lekë pa tvsh, me afat 45 ditë nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

1. Urdhër Prokurimi nr. 1711/36 prot. Datë 29.09.2022	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit - F. K. -Përgjegjës sektori Transportit/drejtoria e shërbimeve mbështetëse -N. M. - Specialiste në drejtorinë e prokurimeve/ekonomiste -K. B. - Specialiste në drejtorinë e prokurimeve/juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1711/37 prot. datë 29.09.2022,me përbërje E. P. - Kryetar, Drejtori i drejtorisë së shërbimeve mbështetëse, -H. C. -Anëtare((Specialiste në drejtorinë e prokurimeve/juriste -J. S. -Anëtar, specialist ekonomiste,sektori i kontabilitetit
5. Fondi Limit (pa tvsh) 3,551,600	6. Oferta fituese (pa tvsh) 3,298,000	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 253,600
8. Data e hapjes së tenderit 26.10.2022	9. Burimi Financimit Te ardhurat dytësore	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE,

		c) Kualifikuar ___1_ OE
11. Ankimime Pranë AK - ne SPE ka ankese	12. Përgjigje Ankesës nga AK - ndryshim i dst-ve pas shqyrtimit ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës 24.11.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 3,957,600	16. Afati i kontratës në dite Nga nënshkrimi me afat 45 ditë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat dytësore.

Kjo nuk është procedurë nuk është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike sipas përcaktimeve të VKM-së 285/2021,i ndryshuar, neni 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”.

Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik

1. Në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së.

2. Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimit në kohë të procedurave të prokurimit publik.

3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Në të njëjtën kërkesën si për procedurën “**Blerje vaj, goma, bateri dhe adblue për automjetet e Radio Televizionit Shqiptar**” nr. 1711 Prot., datë 12.05.2022, drejtoria e shërbimeve mbështetëse i është drejtuar drejtorit të përgjithshëm, për të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurat.

1.Mirembajtje e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar”

2.Blerje vaj, goma, bateri dhe ad blue për automjetet e Radio Televizionit Shqiptar

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së nr. 1711/1 prot. është ngritur komisioni për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike, i cili me anë të relacionit nr. 1711/35 Prot., datë 28.09.2022 i ka përcjellë drejtorit të përgjithshëm të RTSH-së informacion mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Autoriteti Kontraktor nuk justifikon nevojën për realizimin e kësaj Procedurë prokurimi veçmas asaj të shërbimit për “ **Mirëmbajtja e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar**” kjo në kundërshtim me Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 34, pika 2 ku përcaktohet qartë se :

2. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit e këtij ligji, përveçse kur kjo justifikohet nga arsye objektive.

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference të përcaktuar nga studimi i tregut nëpërmjet ofertave të operatoreve ekonomike të llogaritur në vlerën 3,551,600 lekë pa tvsh.

Me shkresën me nr.1711/36 prot., me datë 29.09.2022 Autoriteti Kontraktor ka nxjerrë urdhrin e prokurimit për procedurën e prokurimit- procedure e hapur e thjeshtuar “Blerje vaj,goma,bateri dhe ad blue për automjetet e RTSH-së” me fond limit 3,551,600_Lekë pa TVSH, me afat 45 dite nga nënshkrimi i kontratës.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për automjetet nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj., shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për ndjekjen e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre, si dhe për gjurmën standarte të auditimit, veprime të cilat janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik”, pikat 19, 26, 35, 121, 122.

Zhvillimi i procedurës

Sipas raportit përmbledhës të mbajtur për këtë Procedurë prokurimi dhe verifikimeve të bëra në SEP, në këtë procedurë prokurimi kane marrë pjesë 2 operatorë ekonomik

OE “S.” sh.p.k., që ska paraqitur asnjë ofertë ekonomike
OE “P.I.” Shpk me vlerën 3.298.000 lekë pa TVSH.

Komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me urdhër nr. 1711/37 prot., datë 29.09.2022, ka shqyrtuar ofertën e vetme që ka marrë pjesë në këtë procedurë dhe e ka kualifikuar atë si ofertë të vlefshme.

Në vijim është nënshkruar kontrata e furnizimit me nr 1711847 datë 24.11.2022 ndërmjet Autoriteti Kontraktor RTSH dhe shoqërisë P. I.” SHPK.

Nga drejtori i drejtorisë juridike është paraqitur kërkesa drejtorit të përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallrave.

Me urdhrin nr. 1711/50 datë 05.12.2022 u ngrit grupi i punës për marrjen në dorëzim të mallit.

Me procesverbalin nr 1711/52 të datës 13.12.2022 u morën në dorëzim materialet sipas faturës nr. 130/2022 në vlerën 3,957,600 lekë me TVSH.

Zbatimi i kontratës

Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse drejtuar Drejtorisë Ekonomike dokumentacioni që shërben për shlyerjen e faturës dhe që i bashkëlidhet urdhër transfertave përkatëse janë fatura elektronike, procesverbal i marrjes ne dorëzim dhe flete-hyrjet.

Likuiduar sipas faturës 130/2022 datë 12.12.2022:

-Urdhër transferte për vlerën 3,957,600 lekë me tvsh, nëpërmjet R. B., është likuiduar Shoqëria “P. I.” sh.p.k., me objekt shpenzimi “Blerje vaj,goma,bateri dhe ad blue për automjetet e RTSH. Dokumentacion vërtetues: fatura elektronike nr. 130/2022, datë 12.12.2022, procesverbal, fletë-hyrje.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtoria e shërbimeve mbështetëse shumica e artikujve të Procedurës “Blerje vaj, goma, bateri, adblue” janë gjëndje në magazine duke mos justifikuar nevojën e kryerjes së shpenzimeve urgjente për to, duke qenë se janë artikuj që mund të demtohen (si psh.baterite).Ndërkohe në rastin e indentifikimit të nevojave reale autoriteti kontraktor mund të zhvillonte procedurë marrëveshje kuadër dhe të kryente furnizime sipas nevojës.

Konkluzion:

-Autoriteti Kontraktor nuk ka parashikuar në rregjistrin e parashikimeve zhvillimin e këtyre procedurave.

-AK RTSH ka zhvilluar paralelisht dy procedura prokurimi për automjetet e insitutcionit, duke mos përcaktuar qartë nevojat për shërbime dhe mallra. Kjo ngarkon me përgjegjesi titullarin e Autoritetit Kontraktor E. J. dhe njësinë e prokurimit.

-Autoriteti Kontraktor RTSH nuk ka argumentuar nevojën e kryerjes veçmas të Procedurës së prokurimit “Blerje vaj, goma, bateri dhe abluje për automjetet e RTSH-së”, duke kryer kështu shpenzime pa efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet.

-Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtorja e shërbimeve mbështetëse shumica e artikujve të Procedurës “Blerje vaj, goma, bateri, adblue” janë gjëndje në magazine duke mos justifikuar nevojën e kryerjes së shpenzimeve urgjente për to, duke qenë se janë artikuj që mund të demtohen (si psh.baterite). Ndërkohë në momentin e indetifikimit të nevojave reale autoriteti kontraktor mund të zhvillonte procedurë marrëveshje kuadër dhe të kryente furnizime sipas nevojës.

- Konstatohet mungesë dokumentacioni justifikues për hartimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike në përlogaritjen e vlerës së marrëveshjes kuadër.

Titulli i gjetjes nr. 3	Mungesë të efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomicitet në përdorimin e fondeve publike
Situata:	Nga verifikimi i artikujve të blerë sipas procedurës “Blerje vaj, goma, bateri dhe adblue”, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se shumica nga e artikujt e furnizuar 12.12.2022 gjenden në magazinë të pa përdorura duke mos justifikuar blerjen e tyre.
Kriteri:	Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 2,3.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në menaxhimin dhe administrimin e shpenzimeve, duke sjellë për pasojë mungesë efektiviteti të shpenzimeve financiare publike.
Shkaku:	Neglizhencë nga strukturat e prokurimit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	RTSH, të marrin masa për argumentimin e saktë e nevojave të institucionit arrijen e një prokurimi me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike ,duke respektuar parimin e konkurrencës.

14. Procedura e prokurimit, procedurë e hapur “Led Wall, televizor, për nevoja të RTSH-së” me reference në SEP: REF-03636-08-24-2021, fond limit 11,100,330 lekë pa TVSH, me afat 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

1. Urdhër Prokurimi nr. 3174 prot. Datë 22.08.2022	3. Hartuesit e dokumenteve të tenderit - E. K., -Kryetar (Drejtor fotografie//Departamenti i Prodhimit) -L. Xh- Anëtare (Specialiste ekonomike/ drejtorja ekonomike). -H. C. – Specialiste juriste/ sektori i planifikimit dhe prokurimeve	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 3174/1 prot. datë 23.08.2022,me përbërje D. D. – Kryetare, Drejtor i drejtorisë juridike -V. B. –Anëtar (Teknik ndriçimi i dyte /njesia teknike) -M. K. -Anëtare, Specialiste Sektori i Planifikimit dhe kostifikimit
5. Fondi Limit (pa tvsh) 11,100,330	6. Oferta fituese (pa tvsh) 10,430,000	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 670,330
8. Data e hapjes së tenderit	9. Burimi Financimit Te ardhurat e insitucionit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër

21.10.2022		4 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar___2 OE
11. Ankimime Pranë AK - ka Ankesa nr.3334 prot datë 07.09.2022 Ankesa pas vlerësimit 4204 09.11.2022	12. Përgjigje Ankesës nga AK - ka pranon pjesërisht 4204/3 datë 15.11.2022	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - ka Vendim 976/2022 prot. datë 07.10.2022 refuzon Vendim nr 1156/2022 datë 24.11.2022 nuk pranon ankesën
b. Zbatimi i Kontratës të Shërbimeve		
14. Lidhja e kontratës 23.12.2022 nr 3174/13	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 12,516,000	16. Afati i kontratës në ditë Nga nënshkrimi me afat 45 ditë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e institucionit, përkatësisht në vlerat si me poshtë:

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me shkresën nr.2196/9 Prot., datë 01.07.2022 drejtori i departamentit të prodhimit i është drejtuar drejtorit të përgjithshëm, duke paraqitur kërkesat për artikujt e nevojshëm për krijimin e skenografisë se re për studion për realizmin e emisionit “You should know”

Me shkresën nr 2196/15 prot. datë 04.07.2022 njësia teknike paraqiti specifikimet teknike për ledwall të emisionit “You should know”

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së nr.68 datë 06.07.2022, është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe nevojave, të cilët me anë të relacionit nr.2195/55 prot. paraqiten sasinë e mallrave dhe specifikimet teknike.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së është ngritur grupi i punës për argumentimin e fondit limit, te cilët me ane të relacionit nr. 68 Prot., datë 06.07.2022 i kanë përcjellë drejtorit të përgjithshëm të RTSH-së informacion mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Lidhur me përlllogaritjen e fondit limit

Përlllogaritja e fondit limit është hartuar me çmim reference të përcaktuar nga studimi i tregut nëpërmjet ofertave të operatorëve ekonomik.

Me shkresën 3174 datë 22.08.2022 drejtori përgjithshëm ka nxjerre urdhërin e prokurimit për procedurën e hapur, ”Ledwall për nevoja të RTSH-së me fond limit 11,100,330 lekë pa TVSH.

Hartimi i kërkesave për kualifikim

Nga NJHDT në DST “Aftësitë teknike dhe profesionale”, pika 2.3.d “Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim i lëshuar nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar prej tij, për materialet e përcaktuara me yje tek numri rendor (nga numri rendor 1 deri në numrin rendor 11) në tabelën e vendosur në Shtojcën 6”.

Nga njësia e prokurimit dt. 24.08.2021 është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike. Argumentimi i bere për piken 2.3.6 nuk qëndron dhe nuk justifikon vendosjen e kësaj kërkesë për kualifikim.

Kjo kërkesë për kualifikim është “Super/specifikim ” në kundërshtim me :

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, neni 1, neni 20 dhe neni 23 pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Specifikimet teknike nuk

duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni neni 28, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Për autorizimin e prodhuesit është shprehur dhe Autoriteti i Konkurrencës me Vendim Nr. 851, datë 03.12.2021 “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Nga vlerësimi i këtij rasti, rezultoi se auditimi i kryer në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë DPPSH ka konstatuar mungesë të konkurrencës në procedurat prokuruese të mirëmbajtjes së disa aparaturave, kryesisht të Institutit të Policisë Shkencore, për shkak të **kufizimit në lëshimin e autorizimit të prodhuesit vetëm për një operator**, konstatim i cili ka të bëjë me përcaktimin e kriterëve kualifikues dhe specifikimeve në DST, të cilat vendosen nga vetë Autoriteti kontraktor. Vendosja e këtyre kriterëve, në respektim të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duhet të mirë argumentohet në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet”.

Me vendosjen e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike, nuk janë zbatuar gjithashtu dhe parimet e përgjithshme të së drejtës administrative sipas Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Duke qenë se specifikimet teknike përbëjnë rrezik potencial për krijimin e pengesave në konkurrencën, për shkak të “Specifikimit të tepërt” apo “Super specifikimit” Kolegji Administrativë i Gjykatës së Lartë me vendim Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015, është shprehur në lidhje me këtë çështje tepër të rëndësishme, pasi Autoritetet Kontraktore tentojnë të abuzojnë me “Specifikimin e tepërt” apo “Super specifikimin” në mënyrë që të mënjanojnë operatorët ekonomikë të caktuar në favor të operatorit të preferuar, çka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë.

Në opinionin e grupit të auditimit, autorizimi i prodhuesit nuk është gjë tjetër veçse diskriminim de facto kundrejt shoqërive që, për shkak të fuqisë së tyre më të vogël në treg, nuk kanë lidhje direkt me prodhuesit dhe nuk janë distributorë ekskluzivë, por i përftojnë produktet/shërbimet nëpërmjet distributoreve të tjerë ekskluzivë të prodhuesit dhe ofrojnë çmime më konkurruese për të njëjtin mal/shërbim, cilësia e të cilit mund të provohet shumë lehtë. Kurse nga ana tjetër, shoqëritë që kanë në dispozicion autorizimin e prodhuesit, kanë krijuar një oligopol të rrezikshëm dhe nuk shqetësohen të ofrojnë çmime konkurruese por abuzojnë me këtë fakt në dëm të fondeve publike dhe konsumatorëve.

Autorizimi nga prodhuesi” si kriter kualifikues, nuk mund të jete i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit të mallit/shërbimit. Ky kriter për kualifikim ka bërë që Autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, ç’ka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën

e Shqipërisë dhe nuk është në qasje të plotë dhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Drejtësisë.

Persa i përket specifikimeve teknike Autoriteti Kontraktor ka bërë modifikimin e tyre pas hedhjes në sistem, sipas rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimeve Publike, sipas shtojcës 53/11 datë 08.09.2021.

Për specifikimet e vendosura për mallrat e kërkuara nuk ka asnjë reference në kundërshtim me nenin 41 të VKM-së 285/2021, neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”.

Me shkresën nr. 3334 datë 07.09.2022 u paraqit pranë RTSH-së formulari i ankesës i operatorit ekonomik “S.&C.” sh.p.k.

Pretendimi 1 i operatorit ekonomik.

Objekti i kësaj kontrate ka të bëjë me mallra elektronik dhe ekrane vizualizim, dhe për këtë mallra, AK ka caktuar afat lëvrimi 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Nisur nga eksperiencia jone ëe këtë fushe, si dhe nga kontaktet si me kompanitë vendase ashtu dhe të huaja që merren me tregtimin apo prodhimin e këtyre lloj pajisjeve, asnjë kompani nuk mund të sigurojë lenden e pare për prodhim. Kjo për arsyen se specifikimet teknike janë të veçanta dhe përmbushja e tyre kërkon prodhim nga e para e pajisjeve.

Kjo ngre dyshime të forta që specifikimet teknike janë hartuar të tilla që të jene favorizuese për një operator ekonomik, që këto mallra dhe pajisje i ka të gjitha gjendje ne magazine, dhe janë gati për dorëzim.

Kërkojmë nga AK të bëjë zgjatjen e afatit të kontratës me të paktën 30 ditë të tjera.

Pretendimi 2.

Në specifikimet teknike AK nuk ka përcaktuar njësinë matëse të përmasave. Ak ka përcaktuar dimensionet e ekraneve duke rene ndesh me specifikimet teknike për parametrat e kasës, ku ka përcaktuar dimensionet me e (mm) ≤ 500x500.

Kërkojmë nga AK të përcaktoje njësinë matëse të përmasave, të përcaktoje modelin dhe të paraqesi skica ose vizatime rreth llojit të aksesoreve për varjen e ekraneve.

Pretendimi 3

Kërkojmë që AK të beje ndryshimet përkatëse duke hequr termin “skadencia e mallit”.

Si përfundim kërkojmë nga AK të rihartoje këto pika ne përputhje me nenin e sipërpërmendur dhe në kuadër të frymës së konkurrencës së lirë.

KSHA ka shqyrtuar ankesën dhe ka bërë modifikimin e dokumenteve të tenderit sipas shtojcës nr.3563/1 datë 10.10.2022.

Me vendim nr.976/2022 KPP ka vendosur :

Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “S.&C.”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi njësia e prokurimit e përberë nga E. K., L. Xh., H. C..

Zhvillimi i procedurës

Me urdhër të brendshëm nr. 3174/1 datë 23.08.2022 u ngrit komisioni i vlerësimit të ofertave.

Në raportin përmbledhës përshkruhet që anëtarët e KVO-së bënë hapjen e procedurës së prokurimit në orën dhe datën e përcaktuar në dst-të. Sipas raportit përmbledhës të datës 30.11.2022 me nr.3174/11 prot., si dhe sistemit elektronik të APP-së, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 4 (katër) operator ekonomik :

Operatori ekonomik “L.” shpk me oferte 8,966,000 lekë pa tvsh.

Operatoreve ekonomik “F. E.” me oferte 10,430,000 lekë pa tvsh.

Operatori ekonomik “A. A. I. G.” shpk me ofertë 10,531,000 lekë pa tvsh.

Sipas raportit përmbledhës raport i cili është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, janë kualifikuar operatorët ekonomike:

Operatoreve ekonomik “F. E.” me oferte 10,430,000 lekë pa tvsh.
 Operatori ekonomik “A. A. I. G.” shpk me ofertë 10,531,000 lekë pa tvsh.
 Eshte skualifikuar operatori ekonomik
 Operatori ekonomik “L.” shpk me oferte 8,966,000 lekë pa tvsh.
 Operatori ekonomik ka paraqitur formularin e ankesës pranë AK-së me nr.4204 prot. datë 09.11.2022.
 Komisioni i shqyrtimit të ankesave në vendimin e tij ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “L.” sh.p.k
 Me vendimin nr. 1156/2022 administruar pranë RTSH-së me nr.4417 prot. datë 24.11.2022 KPP ka vendosur:
 -Te mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “L.” sh.p.k
 -Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.
 Në vijim është lidhur kontrata me nr. 3174/13 prot., datë 23.12.2022, ndërmjet RTSH-së të përfaqësuar nga z. E. J., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit ekonomik “F. E.” shpk i përfaqësuar nga A. K., në vlerën 12,516,000 lekë me TVSh, me datë fillimi nënshkrimit e saj, me afat 45 ditë.
 Me shkresën nr.310/2 OE ka paraqitur kërkesën për shtyrje afati për realizimin e kontratës.
Zbatimi i kontratës
 Me urdhrin nr. 3174/15 datë 27.10.2021 nga titullari i AK-se është ngritur grupi i punës për zbatimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave sipas kontratës se sipërcituarit përberë nga: A. R., E. S., M. K..
 Grupi i marrjes në dorëzim ka mbajtur procesverbalin me nr.310/3 datë 07.02.2023 për marrjen dorëzim të mallrave sipas kontratës 3174/13 datë 23.12.2023. Në procesverbal citohet që mallrat e dorëzuara përmbushin specifikimet teknike dhe termat e referencës sipas kontratës.
 Nga ana e grupit t auditimit u bë verifikimi i mallit. Artikujt Led wall ishin të montuar në studion nr 4.

Titulli i gjetjes nr.2	Kufizim i konkurrencës nëpërmjet afatit për realizimin e kontratave
Situata:	Pavarësisht eksperiencave të këqija që AK ka patur në përcaktimin e një afati të shkurtër për realizimin e kontratave, në pjesën më të madhe të procedurave të prokurimit të realizuara AK ka vendosur si afat realizimi të kontratës një periudhe të shkurtër, duke mos e argumentuar këtë kërkesë.
Kriteri:	Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 2,3.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të fondeve publike
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur Institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që vendosja e afateve për realizimin kontratave të prokurimit publik, të mos ngushtojë në mënyre artificiale konkurrencën dhe të mos bëhet shkak për keqpërdorim të fondeve publike.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 32/3 prot., datë 29.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 564/38 prot., datë 30.01.2024, në lidhje me aktkonstatimin nr. 21, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

.....Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe riparimeve ne rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Ne këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz, ne treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Aksionarëve gjatë periudhës së auditimit Shtator 2018 – Tetor 2022 ka marrë në shqyrtim dhe analizuar raportin e ecurisë së shoqërisë të mbajtur kryesisht për periudha raportimi 6, 9 dhe 12 mujore. Analiza e treguesve tekniko-ekonomikë që përbën dhe raportin e ecurisë së shoqërisë ku evidentohet realizimi i objektivave nga strukturat ekzekutive të saj, është analizuar në mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Aksionarëve, në përmbushje të detyrimeve që këto organe kanë në zbatim të neneve 7 dhe 13 të Statutit të shoqërisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në akt konstatimin e mbajtur në lidhje me autorizimin e prodhuesit është sqaruar në mënyrë të detajuar sesi përcaktimi i këtij kriteri kufizon konkurrencën dhe vendos në kushte të pabarabarta konkurruese operatorët ekonomike. Në procesverbalin e mbajtur nga njëjësia e prokurimit për hartimin e kriterëve për procedurën e prokurimit “Led wall” për nevoja të RTSH-së”, nuk kanë një argumentim teknik në lidhje me domosdoshmërinë e autorizimit të prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi si kriter kualifikues, por është cituar baza ligjore, kjo në kundërshtim dhe me rekomandimet”.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 32/7 prot., datë 30.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 564/43 prot., datë 31.01.2024, në lidhje me aktkonstatimin nr. 24, datë 14.11.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

.....Për sa me sipër cituar nga grupi i punës për përgatitjen e argumentimit të fondit limit i është referuar studimit të tregut ku sipas pikës së sipërcituar e ka të drejtën të konsultohet me eksperte, autoritete të pavarura ose operatore ekonomike në treg me shkrim ose verbalisht.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në akt konstatimin e mbajtur në lidhje me këtë procedurë prokurimi janë sqaruar në detaje konstatimet në lidhje me hartimin e fondit limit.

Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin e dërguar dhe nga analiza e pretendimit tuaj bën me dije se observacioni juaj nuk qëndron.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.7. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).

Në qëllim të përmbushjes së pikës së mësipërme të programit, në bazë të riskut dhe kriterëve të për zgjedhjes, u morën në shqyrtim procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si më poshtë:

Objekti	Fondi limit	Data e zhvillimit	Operatori Ekonomik	Oferta
“Blerje mikrofone valor lavalier për nevoja të RTSH-së”	1091904.9	05/05/2022	E.	843150.00
Rikonceptim i Studios 5	985113.00	09/09/2022	N. H.	955800.00
"Blerje inverter dhe bateri inverteri per studion levizese SNG."	229529.00	16/02/2023	S. C	208800.00
Blerje materiale muzikore per Orkestren	800000.00	08/03/2021	L. B.	795000.00
Blerje sistem konference per RTSH-në	800000.00	08/07/2021	V.	760000.00

1. "Blerje mikrofona valor lavalier për nevoja të RTSH-së"

Me shkresën e datës 02.03.2022 z. G. Y., me detyrë Drejtor i Departamentit të Prodhimit ka kryer kërkesë për blerje urgjente për Mikrofona që do të perdoren nga sektori i kamerave dhe montazh audios. Kjo kërkesë i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm z. E. J..

Me procesverbalin e datës 11.04.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

"T." shpk me çmim 1.170.000 lekë pa tvsh

"E." shpk me çmim 1.186.965 lekë pa tvsh

"V." shpk me çmim 918.750 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **1.091.904.9** lekë pa tvsh.

KVO ka shpallur fitues OE "E." shpk ku sipas komisionit kjo ofertë ka qënë oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

2. "Blerje inverter dhe bateri inverteri per studion levizese SNG."

Me shkresën e datës 23.12.2022 z. H. M., me detyrë Drejtor i Njësisë Teknike ka kryer kërkesë për blerje urgjente për Bateri dhe Inverter. Kjo kërkesë i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm Z.E. J..

Me procesverbalin e datës 07.02.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

"T." shpk me çmim 250.000 lekë pa tvsh

"S. C." shpk me çmim 209.584 lekë pa tvsh

"J. G." shpk me çmim 229.003 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **229.529** lekë pa tvsh.

KVO ka shpallur fitues OE "S. C." shpk pasi OE "E. K. & T." skualifikohet sepse nuk janë paraqitur ose nuk ka njoftuar në sistemin elektronik të APP mospjesëmarrjen e tij. Si rrjedhojë komisioni ka shpallur fitues OE "S. C." shpk duke qënë se ky OE është renditur i dyti si oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

3. Rikonceptim i Studios 5

Me shkresën e datës 16.08.2022 z. G. Y., me detyrë Drejtor i Departamentit të Prodhimit ka kthyer përgjigje Drejtorit të Përgjithshëm z. E. J., për marrjen e masave për Rikonceptimin e Studios 5.

Me procesverbalin e datës 07.09.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

N. H. P.F me çmim 970.200 lekë pa tvsh

A. H. P.F me çmim 989.740 lekë pa tvsh

"N." shpk me çmim 995.400 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **229.529** lekë pa tvsh.

KVO ka shpallur fitues N.H. P.F pasi OE "R.N.M" shpk dhe OE XH. S. P.F skualifikohen sepse nuk janë paraqitur ose nuk kanë njoftuar në sistemin elektronik të APP mospjesëmarrjen e tyre. Si rrjedhojë komisioni ka shpallur fitues OE "N. H. P.F duke qënë se ky OE është renditur i treti si oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit së mësipërme u konstatua:

Shpenzimi për kryerjen e kësaj Procedurë nuk justifikon nevojën, pasi në verifikimin e kryer ky ambient ishte jashtë përdorimit për të cilën është kryer procedura pasi aktualisht ky ambient përdoret si vend për magazinimin e mallrave të ndryshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Pikën ç) në nenin 4 në Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

1.Titulli gjetjes	Shpenzimi për kryerjen e kësaj Procedurë nuk justifikon nevojën.
Situata:	Në verifikimin e kryer nga grupi i auditimit ky ambient ishte jashtë funksionit për të cilën është kryer procedura, aktualisht ky ambient përdoret si vend për magazinimin e mallrave të ndryshëm.
Kriteri:	Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” Neni 4 pika ç).
Ndikimi/Efekti:	Përdorimi i fondeve pa efektivitet, efizienzë dhe ekonomikitet.
Shkaku:	Mos zbatim i parimeve të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	RTSH të analizojë sic duhet nevojën për shpenzimet e saj me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, efizienzë dhe ekonomikitet.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm Z. E. J..

4. Blerje sistem konference për RTSH-në

Me shkresën e datës 07.04.2021 z. H. M., me detyrë Drejtor i Njesisë Teknike ka kryer kërkesë për blerje sistemi regjistrimi audio ku sipas tij sistemi i mëparshëm është i amortizuar. Kjo kërkesë i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm Z.Th. G..

Me procesverbalin e datës 07.02.2022, është përlllogaritur fondi limit nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla duke marrë parasysh 3 oferta të tregut përkatësisht:

“B. E.” shpk me çmim 811.450 lekë pa tvsh

“P. S.” shpk me çmim 803.500 lekë pa tvsh

“I.-P.” shpk me çmim 785.050 lekë pa tvsh.

Duke llogaritur vlerën mesatare të 3 operatorëve ekonomikë mesatarja e ofertave është **800.000** lekë pa tvsh.

KVO ka shpallur fitues OE “V.” shpk pasi operatorët e tjerë nuk kanë plotësuar kushtet dhe janë skualifikuar. “V.” shpk është oferta e tretë dhe si rrjedhojë komisioni ka kualifikuar këtë operator si oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit së mësipërme u konstatua:

Zërat e kërkuara nga AK nuk përputhen me faturën përfundimtare sjellë nga OE “V.” shpk. Në verifikimin e pajisjeve është vënë re se pajisjet janë të bashkuara pra nuk janë pajisje të ndara nga njëra tjetra. Si rrjedhojë ka parregullsi në faturë, këto veprime bien në kundërshtim me VENDIMIN Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK Nenin 56, pika 10 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” dhe UDHËZIMI Nr. 30 datë 27.12.2011 “PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK”.

1.Titulli i gjetjes	Zërat e përcaktuara në ftesën për ofertë janë të ndryshëm nga ato të likuiduar sipas faturës përfundimtare.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje sistem konference për RTSH-në”, për vlerën 760,000 lekë, të vitit 2021 u konstatua se në ftesën për ofertë ishte përcaktuar lista e mallrave për tu prokuruar nga ana e AK. Zërat e kërkuara nga AK nuk përputhen me faturën përfundimtare ku megjithëse janë mallra të bashkuara me njëri tjetrin, në faturën përfundimtare janë trajtuar si mallra të ndara nga njëri tjetri. Nga auditimi rezultoi se ka mospërputhje midis zërave të përcaktuara në ftesën për ofertë nga ato të faturës përfundimtare. Ky veprim nuk jep garanci të arsyeshme nëse mallrat e ofertuar sipas faturës përfundimtare janë në përputhje të plotë me ato të përcaktuara në ftesën për ofertë.
Kriteri:	-Vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Nenin 56, pika 10. -UMF Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, seksioni –Dokumentimi lëvizjes së aktiveve, “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”.
Ndikimi/Efekti:	Nuk jep garanci të arsyeshme nëse mallrat e ofertuar sipas faturës përfundimtare janë në përputhje me ato të përcaktuara në ftesën për ofertë.
Shkaku:	Mosnjohje e UMF Nr.30, datë 27.12.2011
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga ana e AK të merren masa që në procedurat e ardhshme lëvizja e aktiveve të bëhet duke qenë në përputhje të plotë zërat e hartuara në ftesën për ofertë me zërat e procesverbalit e marrjes në dorëzim si dhe faturës përfundimtare sipas ligjit.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. G. A., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Prokurimeve.

5. Blerje materiale muzikore për Orkestren

Me shkresën e datës 31.12.2020 z. A. P., me detyrë Drejtor Aritistik ka kryer kërkesë për blerje pajisje për nevojat e orkestrës simfonike. Kjo kërkesë i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm Z.Th. G..

Drejtori i Përgjithshëm ka pranuar pjesërisht kërkesën e Drejtorit Aritistik ku me anë të Urdhrit të Prokurimit Nr. 13/1 Prot, Datë 05.03.2021 ka shtruar për objekt prokurimi vetëm disa mallra nga sa kërkuar nga Drejtori Aritistik i RTSH z. A. P..

2.8. Mbi administrimin mbi bazueshmërinë ligjore të administrimit të pronës, lidhjes së kontratave për reklama, rregullshmërinë e dhënies me qira të godinave e kullave metalike, të transmetuesve, studiove dhe pajisjeve teknike etj.

A. Kontratat e qirave të lidhura për periudhën objekt auditimi, Informacionet e dërguara nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtoria e Marketingut, etj.

6. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të regjistrimit të aktiveve dhe inventarizimit të aseteve të RTSH.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për periudhën

	<p>objekt auditimi, RTSH nuk ka krijuar dhe përditësuar një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura.</p> <p>Nga RTSH nuk është kryer inventari fizik i aktiveve afatgjata materiale. Inventari kontabël i aktiveve afat gjata materiale nuk është i detajuar në toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.</p> <p>Nuk u bë e mundur të auditohet administrimi i bazueshmërisë ligjore të administrimit të pronës, e cila është përcaktuar në programin e auditimit nr. 564/1 prot., datë 26.07.2023 pika VIII. Për pasojë, kjo çështje do të auditohet me program të veçantë ose në auditimin e radhës.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;</p> <p>VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;</p> <p>UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.</p>
Ndikimi:	Mungesa e gjurmës së auditimit.
Shkaku:	Veprimet dhe mosveprimet e Titullarëve të institucionit ndër vite.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për krijimin dhe përditësimin e regjistrit kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura.
6.2 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për kryerjen e inventarit fizik të aktiveve afatgjata materiale si dhe për detajimin e inventarit kontabël të aktiveve afat gjata materiale në toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullarët e institucionit sipas periudhave respektive z. Th. G., 2020 – 20.05.2021), z. M. L., (21.05.2021 – 02.12.2021), z. E. J., (03.12.2021 – 12.04.2023) si dhe z. R. N., (13.04.2023 – 13.06.2023).

Sipas dokumentacionit të marrë nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Marketingut rezulton se në datën 30.06.2023 kontratat aktive në drejtim të qiradhënies nga ana e RTSH përmes të cilave institucioni siguron të ardhura është si më poshtë:

Tabela nr. 1

Allotmente	Subjekti	Euro	Kësti
1	TV P. Ch.	3,414	mujor
2	TV K. K.	1,196	mujor
3	Shoqëria "T. S. 7"	1,164	mujor
4	"Media +" Sha "T. Sh."	2,146	mujor
5	A. Sh.	775	mujor
6	Shoqëria F. M. N.	2,146	mujor
7	MTSC	10,841	mujor
8	Focus M. N.	5,079	mujor

9	Shoqëria M. N. Tv Ch. 1	1,113	mujor
10	Shoqëria M. M. Sha	1,113	mujor
11	Shoqëria Media B.	1,113	mujor
12	Shoqëria "S. N. R."	1,113	mujor
13	Shoqëria "S. N. R."	725	mujor
14	Televizioni T. K.	1,113	mujor
15	Shoqëria 3. & A. E.	2146	mujor
16	A. 2. TV A.	512	mujor
17	"Ch. ."	512	mujor
18	Shoqëria "6+1 V."	1,268	mujor
19	Shoqëria V.	598	mujor
20	One TV V.	1,268	mujor
21	Inter aktive Media "I. TV"	5,284	mujor
22	Televizioni K. "T. K."	2,871	mujor
23	Them Inf Bro Op" " T. K. "	1,473	mujor
24	E. 'C. T.'	4,783	mujor

Tabela nr. 2

Repetitore	Subjekti	Euro	USD	Lekë	Kësti
1	Dr. Vend. Policisë Elbasan			60,000	mujor
2	Dr. Përgjithshme Burgjeve			90,000	mujor
3	Banka e Shqipërisë			150,000	mujor
4	Reparti Ushtarak 6640			675,000	mujor
5	IEVP Korçë			30,000	mujor
6	Dr. Pol. Qarku Vlorë			30,000	mujor
7	IEVP Lezhe			30,000	mujor
8	Dr. Vend. Policisë Gjirokastër			30,000	mujor
9	DRKM Gjirokastër			30,000	mujor
10	SHISH			90,000	mujor
11	Komanda e Forcës Ajrore(Rep3001)			60,000	mujor
12	R.			30,000	mujor
13	Radio . (Dajt)			98,536	mujor
14	L. A. Taxi .			30,000	mujor
15	Radio M.			110,596	mujor
16	TV K.Dobrenje			67,500	mujor
17	Plus N. (Sopot)	100			mujor
18	Plus N. (Mide)	100			mujor
19	UNDP			120,000	mujor
20	B.B.C W. S.		36,000		Vjetore
21	O. C.			2,246,084	Vjetore
22	O. C.			2,913,623	Vjetore
23	O. C.			2,913,623	Vjetore
24	O. C.			2,913,623	Vjetore
25	O. C.			375,000	çdo 3 muaj
26	V. A.			900,000	çdo 6 muaj
27	V. A.			194,000	çdo 3 muaj
28	V. A.			62,500	çdo 3 muaj

29	A.			329,400	çdo 3 muaj
----	----	--	--	---------	------------

Tabela nr. 3

Qira automat	Subjekti	Euro	USD	Lekë	Kësti
1	T. M.			40,000	mujor
2	U. B.	300			mujor
3	T. B.	300			mujor
4	R. B.	300			mujor
Qira ndërtese					
1	A.T. SHQIPTARE.			120,000	mujor
Qira ambient					
	I. SHPK C..			870,000	vjetore

Sipas dokumentacionit rezulton se deri në datën 30.06.2023 gjendja e debitorëve ka qenë si më poshtë:

Tabela nr. 4

Nr.	Subjekti	Detyrim i prapambetur	Periodha e pashlyer	Kamatëvonesa
1	Media SHA T. Sh.	12,048,945	Prill'20 - Qershor '23	152,197
2	F. M. N.	7,966,770	Mars '21 - Qershor '23	125,403
3	M.	11,220,809	Janar - Qershor '23	336,624
4	3D. & A. E.	6,967,842	Nëntor '21 - Qershor '23	123,679
5	6+1 V. shpk	4,302,315	Dhjetor '22 - Qershor '23	127,533
6	F. M.	2,306,292	Shkurt - Qershor '23	69,189
7	M. M.	4,426,673	Nëntor '21 - Qershor '23	80,379
8	S. N. R.	1,398,454	Janar - Qershor '23	41,954
9	P. m.	1,813,003	Maj'23 - Qershor '23	188,099
10	TV S. 7	1,267,851	Shkurt - Qershor' 23	38,036
11	Ch. 7	1,968,504	Prill 21- Qershor '23	59,055
12	M. B.	2,383,695	Maj'22 - Qershor '23	71,511
13	O. T. V.	3,736,092	Tetor 21- Qershor '23	64,937
14	A. 2.	466,247	Gusht '22 - Maj'23	11,889
15	T. K.	2,787,114	Shkurt '22 - Qershor' 23	54,871
16	T.K.	1,236,343	Mars- Qershor' 23	37,090
17	T. K.	1,214,505	Dhjetor 22 - Qershor '23	36,435
18	A. Sh.	100,356	Qershor' 23	-
19	M. N.	1,365,125	Tetor '22 - Qershor '23	36,783
20	E. T. C. T.	1,036,686	Prill - Qershor '23	31,101
21	V.shpk	150,377	Maj - Qershor '23	4,511
22	Th. i.	715,484	Mars - Qershor '23	21,465
23	I. A. M. I. T.	2,999,041	Prill - Qershor '23	89,971
	TOTALI	73,878,523		1,802,711

7. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të arkëtimit të të ardhurave nga kontratat e qirave.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë Ekonomike, rezulton se nga ana e RTSH në vijimësi përgjatë periudhës 2020 deri 30.06.2023 janë favorizuar padrejtësisht qiramarrësit përmes mos arkëtimeve të shumave respektive të cilat arrijnë në total vlerën prej

	73,878,523 lekë , për 23 subjekte, si dhe duke mos marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për aplikimin e penaliteteve për vonesa në arkëtimin e shumave në vlerën totale prej 1,802,711 lekë . Kjo situatë paraqitet e tillë deri me datë 30.06.2023.
Kriteri:	Kontratat respektive të qirave.
Ndikimi:	Të ardhura të munguara në shumën prej 75,681,234 lekë, nga të cilat vlera prej 73,878,523 lekë këste mujore të papaguara nga ana e subjekteve qiramarrës si dhe shuma prej 1,802,711 lekë si penalitet i paaplikuar për mos respektim të kushteve kontraktuale.
Shkaku:	Mos veprimet e Titullarëve të institucionit sipas periudhave respektive.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të RTSH të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 73,878,523 lekë si këste mujore të papaguara nga ana e subjekteve qiramarrës si dhe shuma prej 1,802,711 lekë si penalitet i pa aplikuar ndaj 23 subjekteve sipas tabelës nr. 4, bashkëngjitur raportit përfundimtar të auditimit, për mos respektim të kushteve kontraktuale prej përdorimit të asetëve të RTSH, në kundërshtim me kontratat respektive.
7.2 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të RTSH, të merren masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për të ndaluar përdorimin e asetëve nga ana e këtyre subjekteve deri në kryerjen e pagesave.
7.3 Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për të mos lidhur kontrata të reja qiraje apo për të mos rinovuar ato ekzistuese me subjektet debitorë si më sipër me qëllim arkëtimin e shumave dhe përdorimin e tyre më pas për interesa të institucionit.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullarët e institucionit sipas periudhave respektive z. Th. G. 2020 – 20.05.2021), z. M. L.(21.05.2021 – 02.12.2021), z. E. J. (03.12.2021 – 12.04.2023) si dhe z. R. N. (13.04.2023 – 13.06.2023).

B. Veprime pa delegim kompetence, mos ruajtje/fshirje në arkivën numerike të RTSH të transmetimit të reklamave, mos përbushtje e detyrimeve kontraktore, si dhe faturim të operatorëve ekonomik pa pasur dokument justifikues për transmetimin e reklamave.

Në 7 kontrata për transmetim reklame, media planet e transmetimit firmosur nga E. K., me detyrë drejtor i shitjes dhe menaxhimit, pa delegim kompetence, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 43 “Njësia dhe nëpunësi përgjegjës” ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

1. Në një procedurë administrative, të filluar sipas parashikimeve të Nenit 41, të këtij Kodi, organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës, të përcaktuar sipas rregullave të këtij Neni.

2. Titullari i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënligjor, cakton paraprakisht një njësi përgjegjëse për çdo tip Procedurë administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimitarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm.

3. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse merr përsipër vetë ose cakton me akt të shkruar nëpunësin përgjegjës për zhvillimin e procedurës administrative. Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore. Nëse vendimi është i ndryshëm nga ai i propozuar, duhet të shoqërohet me arsyetimin përkatës.

4. Në rastet e parashikuara nga ligji nëpunësi përgjegjës, pasi zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen me vendim përfundimtar dhe e nënshkruan atë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.

5. Organi kolegjal mund të ngarkojë njërin nga anëtarët e tij të zhvillojë veprime procedurale administrative. Në këtë rast, anëtari i ngarkuar vë në dijeni mbi rezultatet e procedurës administrative organin kolegjal, i cili vendos për çështjen”.

Nga verifikimi në arkivën numerike u konstatua që ndeshjet janë të ruajtura bruto pa prerje dhe editime net. **Reklamat e transmetuara nuk janë të ruajtura, janë fshirë, janë shkëputur nga ndeshjet e transmetuara dhe të arkivuara.** Reklamat u verifikuan në (path-in) rrugën; rtsh data; Sporti Arkiv; 2022; Mars 2021.

Për kontratat për transmetim reklame të përshkuara si më sipër, nuk disponohen programet e transmetimit, dhe asnjë dokument tjetër justifikues për realizimin e kontratave (Media plani/ programet e transmetimit, grupi i punës për ndjekjen e kontratës, akt pranimi etj).

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 43, pika 1,2,4 4 dhe 5, VKM Nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë, Neni 6, Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, abc.

Koment i grupit të auditimit

Arkiva numerike është një sistem i ndërtuar për të ruajtur dhe menaxhuar materiale të prodhuara nga RTSH në format elektronike/numerike. Serveri ka hapësirë për të ruajtur materiale në hdd(hard disk). Ky sistem përdor servera fizikë të cilët janë të vendosur në një ambient të sigurt dhe të kontrolluar (server room – dhoma e serverit). Serveri ka materiale të rëndësishme të RTSH (Arkiva Sportit, Dokumentar Shqiptare, emision, futboll, lajme, materiale montazhi, filma artistik shqiptare dhe të huaj, capture (regjistrim i materialeve që transmetohen)”. Serverët janë të lidhur me një rrjet të brendshëm për të mundësuar qasjen dhe përdorimin e arkivës në mënyrë efektive.

Veprime në kundërshtim me:

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.“

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20.

Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 43.

-VKM Nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë Neni 6.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi E. J., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i RTSH për periudhën 03.12.2021-12.04.2023, E. K., me detyrë ish-drejtor i shitjes dhe menaxhimit për periudhën 2020-30.06.2023 dhe E. D., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Referuar dokumentacionit të cituar mësipër, grupi i auditimit nuk mund të jap një opinion të plotë dhe të saktë, mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin ka vepruar RTSH, për procesin e zbatimit të kontratave për transmetim të reklamave dhe të ardhurave të përfituara nga RTSH për shërbimin e kryer ndaj operatorëve ekonomik, si dhe përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, të: RTSH, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer mos përmbushjen të rregullt të detyrës, me pasojë prekjën e interesave të ligjshme të RTSH dhe të Shtetit.

Kontratë për bashkëpunimi/këmbimi reklame nr.1613 prot., datë 05.05.2022 “N.” shpk lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “N.” shpk për vlerën 3000 euro për 5 spote ***pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot***, në favor të “N.” shpk e firmosur për RTSH nga E. J., në cilësinë drejtorit të përgjithshëm dhe për “N.” shpk nga A. K., në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm. Kontrata ka objekt shkëmbimi sipas kërkesave të palëve për përfitim të materialeve.

Në Nenin 5 “Përshkrimi i sendeve objekt kontrate” pika 1, Shoqëria “N.” shpk në këmbim të publicitetit merr përsipër të vërë në dispozicion të RTSH, produktet që disponon pas kërkesave specifike të RTSH për produktet “N.” shpk.

Pika 2, Lista e produkteve do ti bashkëngjitet kësaj kontrate dhe do të jetë pjesë përbërëse e saj. Në fakt kontrata nuk ka listë të produkteve bashkëlidhur.

Realizimi i kontratës.

Me faturë elektronike nr. 134/2022, datë 30.05.2022, RTSH i faturon Shoqërisë “N.” shpk vlerën 3,180 euro.

Fatura elektronike nr. 15778/2022, datë 11.05.2022 për 3 PCHP Pro desk 400 G7 293Z4EA në vlerën 221,070 lekë: $120.61 = 1,832$ euro

Flet hyrje nr. 63, datë 11.05.2022 për 3 PCHP Pro desk 400 G7 293Z4EA për vlerën 184,225 lekë.

Flet dalje me nr. 325, datë 18.05.2022 për 1 PCHP Pro desk 400 G7 293Z4EA, Flet dalje me nr. 320, datë 17.05.2022 për 1 PCHP Pro desk 400 G7 293Z4EA, Flet dalje me nr. 312, datë 16.05.2022 për 1 PCHP Pro desk 400 G7 293Z4EA.

Nuk ka grup të ngritur nga drejtuesi i institucionit për të marrë në dorëzim mallrat, nuk ka llogaritje të kursit të këmbimit nga lekë në euro, fatura elektronike e Shoqërisë “N.” shpk nr. 15778/2022, datë 11.05.2022 RTSH, është para faturës elektronike të RTSH nr. 134/2022, datë 30.05.2022 RTSH me 19 ditë me përpara.

Fatura nr. 22027/2022 datë 29.06.2022 për vlerën 20,980 lek : 119.43 euro =175 euro.

Me urdhër nr. 76, datë 15.07.2022 E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm ka ngritur grupin e punës për marrjen në dorëzim të mallit sipas specifikave përkatëse hard disk 2 TB copë 2. Grupi përbëhet nga F. V., S. B. dhe B. A..

Me procesverbal nr. 2422/2 prot., datë 25.07.2022 grupi ka marr në dorëzim materialet përkatëse.

Mallrat janë bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 100 datë 25.07.2022

Me fletë dalje nr. 516, datë 01.08.2022 mallrat janë bërë dalje nga magazina.

Shuma euro = 1,832 euro + 119.43 euro = 2,008 euro.

Nga 3,180 euro detyrimi – 2,008 = 1,172 euro diferenca.

Vlera 1,172 euro, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Kontratë për bashkëpunimi/këmbimi reklame nr.1633 prot., datë 19.04.2022 Shoqëria “A. E. H. C.” shpk lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “A. E. H. C.,” shpk për vlerën 250,000 lekë për 8 spote ***pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot***, në favor të “A. E. H. C.,” e firmosur

për RTSH nga E. J., në cilësinë drejtorit të përgjithshëm dhe për “A. E. H. C.,” nga M. K., në cilësinë e adminstratores. Afati __03.05.2022-31.05.2022.

Neni 5 i kontratës përshkrimi i sendeve objekt kontrate përcakton H. C., në këmbim të publicitetit merr përsipër të vërë në dispozicion të RTSH, veshjet për drejtuesin e Prag Championis si më poshtë; Veshje për drejtuese 10 copë x 200 euro = 2000 euro, vlerë e cila është në kundërshtim me vlerën e përcaktuar në Nenin 4 të kontratës “Vlera e kontratës” që përcakton 250,000 lekë.

Realizimi i kontratës.

Faturë tatimore shitje e RTSH me nr. 0120, datë 11.05.2022 për klienti/blerësin M. K. Tiranë, për reklamë copë 1, vlera 250,000 lekë.

Fatura elektronike nr. 1/2022 datë 10.05.2022 lëshuar nga E. fashion me klient RTSH për vlerën 250,000 lekë.

Përveç faturës, nuk ka asnjë dokument tjetër që provon se është realizuar kontrata/shkëmbimi, psh, komisionin e marrjen në dorëzim të 10 veshjeve për drejtuese me vlerë 250,000 lekë, fletëhyrjen, fletë daljen etj. ***Vlera 250,000 lekë, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.***

Veprime në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690.

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.“

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi E. J., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i RTSH për periudhën 03.12.2021-12.04.2023, E. K., me detyrë ish-drejtor i shitjes dhe menaxhimit për periudhën 2020-30.06.2023 dhe E. D., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Titulli i gjetjes Nr. 1	Veprime pa delegim kompetence, mos ruatje/fshirje në arkivën numerike të RTSH të transmetimit të reklamave.
Situata:	Veprime pa delegim kompetence, mos ruatje/fshirje në arkivën numerike të RTSH të transmetimit të reklamave. Në 7 kontrata për transmetim reklame, media planet i transmetimit janë firmosur nga E. K., me detyrë drejtor i shitjes dhe menaxhimit, pa delegim kompetence. Nga verifikimi në arkivën numerike u konstatua që ndeshjet janë të ruajtura bruto pa prerje dhe editime net. Reklammat e transmetuara nuk janë të ruajtura, janë fshirë, janë shkëputur nga ndeshjet e transmetuara dhe të arkivuara. Reklammat u verifikuan në (path-in) rrugën; rtsh_data;Sporti Arkiv; 2022; Mars 2021. Për kontratat për transmetim reklame të përshkruara si më sipër, nuk disponohen programet e transmetimit, dhe asnjë dokument tjetër justifikues për realizimin e kontratave (Media plani/ programet e transmetimit, grupi i punës për ndjekjen e kontratës, akt pranimi etj).
Kriteri:	- Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 43, pika 1,2,4 4 dhe

	<p>5. -VKM Nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë Neni 6. -Udhëzimi Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, abc.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondit arkivor
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<p>-Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për administrimin e materialele në arkivën numerike të RTSH, duke ngritur Komisionin i Ekspertizës (KE) për përcaktimin e listës konkrete me afatet e ruajtjes së fondit arkivor, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla. -Nga drejtori i përgjithshëm të merren masa për administrimin dokumenteve justifikues për realizimin e kontratave (Media plani/ programet e transmetimit, grupi i punës për ndjekjen e kontratës, akt pranimi etj).</p>

Titulli i gjetjes Nr. 2	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktore
Situata:	<p>Në zbatimin e kontratës për bashkëpunimi/këmbimi reklame nr.1613 prot., datë 05.05.2022 të lidhur me shoqërinë “N.” shpk për vlerën 3000 euro për 5 spote pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, në favor të “N.” shpk u konstatuar një mos realizim në vlerën 1,172 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me diferencën ndërmjet faturës elektronike të RTSH me nr. 134/2022, datë 30.05.2022 për vlerën 3,180 euro dhe furnizimeve të bëra nga shoqëria “N.” shpk që kapin vlerën 2,008 euro. Vlera 1,172 euro, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690. -Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35. -Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.“ -Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mos vëmendje e duhur institucionale
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e

	gjkimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 1,172 euro lekë nga shoqëria “N.” sh.p.k. Kjo vlerë ka të bëjë me mos përmbushje e detyrimeve kontraktore për bashkëpunim/këmbimi reklame.
--	---

Titulli i gjetjes Nr. 3	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktore
Situata:	Në zbatimin e kontratës për bashkëpunimi/këmbimi reklame nr.1633 prot., datë 19.04.2022 të lidhur me shoqërinë “A. E. H. C.,” shpk për vlerën 250,000 lekë për 8 spote pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, në favor të “A. E. H. C.,” u konstatuar një mos realizim në vlerën 250,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me mos përmbushjen e detyrimeve kontraktore, pasi përveç faturës elektronike nr. 1/2022 datë 10.05.2022 nuk ka asnjë dokument tjetër që provon se është realizuar kontrata/shkëmbimi, psh, komisionin e marrjen në dorëzim të 10 veshjeve për drejtuese me vlerë 250,000 lekë, fletëhyrjen, fletë daljen etj. Vlera 250,000 lekë, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.
Kriteri:	-Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690. -Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35. -Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52. -Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20.
Ndikimi/Efekti:	Mos vëmendje e duhur institucionale
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	
Rekomandime:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 250,000 lekë nga shoqëria “A. E. H. C.,” shpk. Kjo vlerë ka të bëjë me mos përmbushjen e detyrimeve kontraktore për bashkëpunim/këmbim reklame.

2.9. Mbi auditimin e projekteve artistike dhe filmimeve.

RTSH si një ofrues i shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) është person juridik publik, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Në funksion të përmbushjes së deklaratës së qëllimit, “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”, me ndryshime (këtu e më poshtë “rregullorja”) miratuar me Vendimin nr. 10, datë 23.08.2018 me ndryshime të Këshillit Drejtues të RTSH (KDRTSH) përcakton rregulla për procedurat e paraqitjes, miratimit dhe të zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave në RTSH, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e transmetuesit publik, si ligji nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” me

ndryshime dhe Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 98/2016, datë 22.12.2016 “Për miratimin e Statutit të RTSH-së”.

Projektet artistike dhe filmike të realizuara ndahen në kategori si më poshtë:

1. Prodhimet e RTSH;
2. Prodhime të porositura nga fondi i prodhimit të pavarur;
3. Bashkëprodhime me RTSH;
4. Blerje e të drejtave;

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 – 30.06.2023 u përzgjedhën në bazë të vlerës më të lartë dhe indicieve në total 11 projekte nga të cilat në mënyrë të zgjeruar rezultoi si më poshtë trajtuar.

Për vitin 2021

Auditimi i dosjes “Koha dhe artisti” i financuar nga fondi i prodhimit të pavarur në vlerën 5,000,000 lekë.

Me anë të shkresës nr. 1371 prot., datë 20.04.2021 RTSH ka bërë shpalljen e projekteve për llojin e prodhimit të pavarur audioviziv “Cikël dokumentarësh (natyra :social, kulturor, historik, turistik, infrastrukturor, urbanistik, shkencor, teknologjik)”. Me anë të shkresës nr. 1514 prot., datë 05.05.2021 janë përcjellë pranë RTSH aplikimet e mëposhtme:

Personi fizik “E. R., (T. studio)” me NUIS M., regjistruar në QKB me datë 13.04.2021 ka paraqitur dokumentacionin për ciklin e dokumentareve “Koha dhe artisti”, cikël dokumentarësh me 10 episode. Me anë të shkresës nr. 1686 prot., datë 17.05.2021 komisioni i vlerësimit të projekteve për llojin e prodhimit të pavarur ka paraqitur raportin e vlerësimit për fondin e prodhimit të pavarur “Cikël dokumentarësh”. Komisioni i vlerësimit të projekteve pas shqyrtimit të dokumentacionit ka kualifikuar subjektin e interesuar. Me shkresën nr. 1660 prot., Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe /projekteve z. A. H., i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, duke e informuar për kualifikimin e projektit në bazë të vlerësimit të komisionit të vlerësimit të projekteve duke kërkuar edhe dërgimin e projekteve për miratim nga ana e Bordit Artistik. Me shkresën nr. 1702 prot., datë 17.05.2021 Drejtori i Përgjithshëm z. Th. G., i është drejtuar Bordit Artistik për miratimin e projekteve sipas rregullores për përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur, i cili sipas shkresës nr. 1730 datë 19.05.2021 ka miratuar nga pikëpamja artistike dhe profesionale projektin me titull (Koha dhe artisti). Referuar Vendimit, në pjesën arsyetuese të tij, rezultoi se Bordi Artistik nuk është shprehur mbi vlerësimin nga pikëpamja artistike e projektit dhe përshtatjen me natyrën e programeve në RTSH, pra nuk ka dhënë një argumentim mbi miratimin e projektit por është shprehur vetëm për “Miratimi nga pikëpamja artistike dhe profesionale”, duke lënë hapësirë për hartimin në mënyrë formale të vendimit, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e “Rregullores” neni 5, pika.

Përmes vendimit nr. 33, Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar projektin me titull “Koha dhe artisti”, në mbështetje të pikës 2 të nenit 8 të rregullores për përdorimin e fondit të pavarur, “Projektet vlera e të cilëve është deri në 1% të buxhetit vjetor të RTSH, miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH”. Me datë 20.05.2021 është nënshkruar kontrata me nr. 1740 prot, midis palëve RTSH, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Th. G. dhe personit fizik E., mbajtës i emrit tregtar “T. S.”, përfaqësuar nga znj. E. R.. Me datë 16.08.2021 është bërë modifikimi i afatit të dorëzimit të lëndës nga 90 ditë që ishte në kontratën fillestare deri me datë 07.01.2022. Ky ndryshim ka ardhur pas kërkesës së personit fizik i cili ka kërkuar zgjatjen e afatit për dorëzim të lëndës, për shkaqe që lidhen me COVID-19. Sipas nenit 5 të kontratës, pika 2 citohet se:

“Pagesa e vlerës së përgjithshme të fondit financiar do të kryhet pranë personit fizik në rrugë bankare në këste sipas mënyrës vijuese:

Kësti i parë i barabartë me 70% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet me nënshkrimin e kontratës;

Kësti i dytë i barabartë me 20% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet me dorëzimin në RTSH të lëndës së 10 dokumentareve të veprës;

Kësti i tretë i barabartë me 10% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet me dorëzimin në RTSH të dokumentacionit financiar justifikues të projektit, përmes të cilit personi fizik vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjate realizimit të prodhimit të veprës.”

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike personi fizik E. R., është likuiduar:

-sipas urdhër pagesës 21411209 të datës 02.06.2021 për vlerën 3,500,000 lekë, ose 70% e vlerës së përgjithshme të fondit financiar sipas përcaktimeve të nenit 5 të kontratës;

-sipas urdhër pagesës 21411209 të datës 02.04.2022 për vlerën 1,000,000 lekë, ose 20% e vlerës së përgjithshme të fondit financiar, që duhej lëvruar me dorëzimin në RTSH të lëndës;

Sipas materialit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Arkivave episodi i ciklit të dokumentareve “Koha dhe artisti” gjendej i ruajtur në sistemin ETER/MAM 8 episode dhe në hard disc 2 episode. Përmbajtja e lëndës së 10 dokumentareve përbërës të veprës nuk ishte e njëjtë me përshkrimin sipas sinopsit të projektit për të cilin personi fizik “E. R.” është kualifikuar nga Bordi Artistik i RTSH. Sipas sinopsit titulli i episodit është si më poshtë:

A. O./pikturë; E. H./pikturë; Sh. K./pikturë; P. H./instalacion; L. K./Instalacion; A. B./Skulpturë; E. Gj./pikturë; D. Z./videoart; P. Xh./Instalacion; E. Z./Pikturë.

Sipas materialit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Arkivave lënda e dorëzuar nuk përputhet me atë të miratuar dhe përkatësisht janë dorëzuar në arkivat e RTSH nga cikli i dokumentarëve “Koha dhe artisti” dokumentaret e mëposhtëm:

D. C.; E. Gj.; E. Z.; E. B.; R. P.; S. S.; Sh. K.; M. O.; A. I.

Gjendur në këto kushte autoriteti përkatës në RTSH në zbatim të detyrimeve kontraktuale sipas kontratës së sipërcituar duhet të refuzonte pranimin në arkivë të lëndës së ciklit të dokumentareve “Koha dhe artisti” duke mos përmbushur përcaktimet sipas sinopsit të veprës audio vizuale, për të cilat shoqëria është kontraktuar. Përveç kësaj RTSH në zbatim të nenit 10, pika e 3 të kontratës ku parashikohet se:

“Personi fizik deklaron dhe garanton RTSH se, nëse lënda e plotë e secilit prej dokumentarëve përbërës të veprës nuk do të dorëzohet në RTSH brenda afatit të prodhimit dhe dorëzimit të përcaktuar në nenin 2 të kontratës, atëherë RTSH ka të drejtë të zgjidhe këtë kontratë dhe personi fizik është i detyruar që të dëmshpërblejë RTSH-në dhe të kthejë të RTSH çdo shume të paguar nga RTSH në bazë të kësaj kontrate”, duhet të kërkonte nga shoqëria që ti kthehej shuma në lekë që RTSH i ka paguar shoqërisë.

Vlera prej 4,500,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së dhe si e tillë duhet të dëmshpërblehet në zbatim të nenit 640, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

3. Titulli i gjetjes:	Mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1740 prot. datë 20.05.2021 në vlerën 4,500,000 lekë (Personi fizik E. R., me emrin tregtar T. S.);
Situata:	Mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1740 prot. datë 20.05.2021 për vlerën 4,500,000 lekë , ku vlera totale e kontratës ka qenë 5,000,000 lekë e nënshkruar ndërmjet personit fizik E. R., me emrin tregtar “T. S.” dhe RTSH-së, për prodhimin e porositur të ciklit të dokumentareve “Koha dhe artisti”

	Sipas materialit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Arkivave episodi i ciklit të dokumentareve “Koha dhe artisti” gjendej i ruajtur në sistemin ETER/MAM 8 episode dhe në hard disc 2 episode. Përmbajtja e lëndës së 10 dokumentareve përbërës të veprës nuk ishte e njëjtë me përshkrimin sipas sinopsit të projektit për të cilin personi fizik “E. R.” është kualifikuar nga Bordi Artistik i RTSH dhe nuk është dorëzuar dokumentacioni justifikues sipas përcaktimeve të kontratës që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës.
Kriteri:	-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore). -Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1740 prot. datë 20.05.2021 e nënshkruar ndërmjet Personit Fizik E. R. dhe RTSH-së.
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve artistike dhe filmike gjatë gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimi i vlerës 4,500,000 lekë nga subjekti E. R., (me emrin tregtar T. S.) për projektin artistik “Koha dhe artisti”. Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1740 prot. datë 20.05.2021, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Titullarët z. Th. G. dhe z. E. J., Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve, z. M. H., Drejtori si dhe ish Drejtori i Drejtorisë ekonomike z. E. D..

Pretendimi i subjektit

.....Persa i përket projektit artistik “Koha dhe artisti”, duke marrë parasysh periudhën në të cilën është zhvilluar kjo kontrate në kushtet e pandemisë dhe përcaktimeve të kontratës, edhe pse ne mund të mbroheshim duke u shkarkuar nga çdo lloj përgjegjësie sipas nenit 11 të kontratës jo vetëm e kemi realizuar kontratën por kemi marrë rrisqe që kane të bëjnë me jetën njerëzore dhe si profesioniste të fushës kemi bere detyrën tone duke e dorëzuar materialin brenda afateve me cilësi dhe profesionalizëm. Persa me sipër kërkojmë të merrni të rishikoni vendimmarrjen tuaj të cilën ne e cilësojmë të pabazuar në fakte dhe provë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Sipas dokumentacionit bashkëngjitur observacionit tuaj nuk ka fakte dhe argumente mbështetës për atë që ju pretendoni.

Pika 4 e nenit 5 të kontratës parashikon se: “Në rast se personi fizik nuk dorëzon pranë RTSH-së dokumentacionin financiar justifikues ose në rast se dokumentacioni financiar justifikues nuk është i plote, atëherë personi fizik është i detyruar që të kthejë të gjitha shumat e kësteve të paguara nga RTSH në përputhje me këtë kontrate, si dhe detyrohet të dëmshpërbleje RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara”.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Viti 2022

Auditimi i dosjes “Bota Arbërore” i financiar nga fondi i prodhimit të pavarur në vlerën 5,000,000 lekë.

RTSH ka bërë shpalljen e projekteve për llojin e prodhimit të pavarur audioviziv “*Cikël dokumentarësh (natyra: social, kulturor, historik, turistik, infrastrukturor, urbanistik, shkencor, teknologjik)*”. Me anë të postës elektronike më datë 25.11.2022 janë përcjellë pranë RTSH-së aplikimet e mëposhtme:

Personi fizik O. I. me NUIS M., regjistruar në QKB me datë 17.10.2022 për ciklin e dokumentareve “*Diktatura e propagandës*” me 10 episode.

Personi fizik E. R., (T. S.) me NUIS M., regjistruar në QKB me datë 13.04.2021 e cila ka paraqitur dokumentacionin për ciklin e dokumentareve “*Bota arbërore*”, me 10 episode.

Me anë të shkresës nr. 4347/2 prot., datë 01.12.2022 Komisioni i Vlerësimit të Projekteve për llojin e prodhimit të pavarur ka paraqitur raportin e vlerësimit nga ana e të cilit, pas shqyrtimit të dokumentacionit, janë kualifikuar të dy subjektet e interesuara. Me shkresën nr. 4347/4 prot., Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve z. M. H., i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH duke e informuar për kualifikimin e projekteve në bazë të vlerësimit të komisionit të vlerësimit të projekteve dhe duke kërkuar dërgimin e projekteve të prodhimeve të pavarura për miratim në Bordin Artistik. Me shkresën nr. 4347/5 Drejtori i Përgjithshëm z. E. J. i është drejtuar Bordit Artistik për miratimin e projekteve sipas rregullores për përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur. Me shkresën nr. 4347/7 datë 19.12.2022 është vendosur të miratohet nga pikëpamja artistike dhe profesionale projekti me titull “*Bota arbërore*”. Procesverbali i mbledhjes së Bordit Artistik i mbajtur me datë 19.12.2022 me nr. 4347/6 prot., është i firmosur vetëm nga dy anëtar të bordit, pavarësisht se në procesverbal përshkruhet se morën pjesë 3 anëtarë. Referuar Vendimit të Bordit, në pjesën arsyetuese të tij, nuk shprehet mbi vlerësimin nga pikëpamja artistike e projektit, pra nuk jep një argumentim mbi miratimin e projektit dhe nëse përputhet apo jo me strukturën programore të RTSH, por shprehet vetëm për “*Miratimni nga pikëpamja artistike dhe profesionale*”, duke lënë hapësirë për hartimin në mënyrë formale të vendimit, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e “*Rregullores*” neni 5. Me shkresën nr. 4347/9 datë 30.12.2022 përmes vendimit nr. 766, Drejtori i Përgjithshëm ka miratuar projektin me titull “*Bota arbërore*”, në mbështetje të pikës 2 të nenit 8 të rregullores për përdorimin e fondit të pavarur, “*Projektet vlera e të cilëve është deri në 1% të buxhetit vjetor të RTSH-së, miratohen nga drejtori i përgjithshëm i RTSH-së*”. Me datë 25.03.2023 është nënshkruar kontrata me nr. 753 prot., midis palëve, RTSH e përfaqësuar nga ish Drejtori i Përgjithshëm z. E. J. dhe personit fizik E. R., mbajtës i emrit tregtar “*T. S.*”, përfaqësuar nga znj. E. R.. Sipas nenit 5 të kontratës, pika 2, “*... pagesa e vlerës së përgjithshme të fondit financiar do të kryhet pranë personit fizik në rrugë bankare në këste sipas mënyrës vijuese:*

Kësti i parë i barabarte me 40% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës;

Kësti i dytë i barabarte me 30% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet 30 ditë nga data e dorëzimit në RTSH të kopjes së parë standarde të episodit të parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë veprës audiovizuale;

Kësti i tretë i barabartë me 30% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet 30 ditë nga data e dorëzimit në RTSH, të kopjes së parë standarde të episodit të gjashtë, të shtatë, të tetë, të nëntë dhe të dhjetë të veprës audiovizuale.”

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit nga drejtorja e arkivave, nga cikli i dokumentarëve “*Bota arbërore*” është prodhuar vetëm një episod, seria 1 “*Arbëreshet e Italisë*”, episodi 1 “*Përpara nisjes*”. Sipas materialit të vënë në dispozicion nga Drejtorja e Arkivave episodi i ciklit të dokumentareve “*Bota arbërore*” gjendej i ruajtur në formatin hard disc. Sipas kontratës nr. 753 prot., datë 28.03.2023, personi fizik E. R., është porositur që të realizojë për llogari të RTSH dhe përmes financimit prej RTSH prodhimin brenda afatit kohor

prej 8 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës. Në arkivat e RTSH-së është dorëzuar vetëm kopja e parë standarde vetëm për një episod, e cila nuk është transmetuar asnjëherë, veprim ky në kundërshtim me nenin 3 të kontratës 753 datë 28.03.2023. Sipas materialit të vënë në dispozicion përmbajtja e materialit në hard disc nuk ishte e njëjtë me përshkrimin sipas sinopsit të projektit për të cilin personi fizik E. R., është kualifikuar nga Bordi Artistik i RTSH. Sipas sinopsit titulli i episodit të parë është Villa Badessa/Badhesa-Abruzzo. Materiali i gjendur në arkivat e RTSH-së titullohet “Përpara nisjes”. Me shkresën nr. 753/1 prot., datë 29.03.2023 Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve i është drejtuar Drejtorit Ekonomik z. E. D., duke kërkuar kryerjen e pagesës në shumën 2,000,000 lekë sipas nenit 5 kontratës.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike personi fizik “E. R.,” është likuiduar datë 29.03.2023 në vlerën 2,000,000 lekë, pra është paguar nga RTSH vetëm kësti i parë, i barabartë me 40% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar sipas nenit 5 të kontratës nr. 753 prot., datë 25.03.2023, pika 2. Në zbatim të nenit 11 të kontratës ku citohet se *“RTSH ka të drejtë që të zgjidhe këtë kontratë, nëse personi fizik nuk e realizon prodhimin e secilit prej episodeve përbërës të veprës audiovizuale ose nëse personi fizik nuk e realizon prodhimin e secilit prej episodeve përbërës të veprës audiovizuale në numrin e plotë të tyre të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 1 të kësaj kontrate. Personi fizik është i detyruar që të dëmshpërblejë RTSH dhe të kthejë të RTSH çdo shumë të paguar nga RTSH në bazë të kësaj kontrate.”*

RTSH nuk ka monitoruar realizimin e projektit, sipas nenit 9 “Procedura e zbatimit të projekteve të miratuar” të Rregullores së miratuar sipas shkresës me nr. 3611 prot., datë 07.11.2016 me Vendim të Këshillit Drejtues, ku përcaktohet se:

“RTSH ka të drejtë të caktojë një person përgjegjës për të monitoruar realizimin e prodhimit të secilit prej episodeve përbërëse të veprës audiovizuale dhe personi fizik është i detyruar që t’i krijojë të gjitha kushtet për kryerjen e prodhimit”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, informacioneve nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve dhe nga Drejtoria e Arkivave, personi fizik E. R., me emrin tregtar “T. S.,” nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale sipas kontratës nr. 753 prot., datë 28.03.2023 të nënshkruar me Radio Televizionin Shqiptar, duke mos dorëzuar në arkivin e RTSH prodhimin e secilit prej episodeve përbërës të veprës audiovizuale në numrin e plotë të tyre, deri në datën 14.11.2023, datë kur është mbajtur ky akt konstatim.

Vlera 2,000,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH dhe si e tillë duhet të dëmshpërblehet në zbatim të nenit 640, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Rregulloren e RTSH e miratuar sipas vendimit nr. 66 datë 07.11.2016 të Këshillit Drejtues, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 2, 4 dhe 8.

2. Titulli i gjetjes:	Mos përmbushja e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 753 prot., datë 25.03.2023 në vlerën 3,500,000 lekë të personit fizik E. R., me emrin tregtar T. S.;
Situata:	Mos përmbushja e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 753 prot., datë 25.03.2023 për vlerën 3,500,000 lekë , ku vlera totale e kontratës ka qenë 5,000,000 lekë, e nënshkruar ndërmjet personit fizik E. R., me emrin tregtar “T. studio” dhe RTSH-së. Në arkivat e RTSH-së për prodhimin e porositur të ciklit të dokumentareve “Bota arbërore deri me dt.14.11.2023, është dorëzuar vetëm kopja e parë standarde vetëm për një episod. Sipas dokumentacionit të

	<p>vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike personi fizik “E. R.,” shoqëria “T. S.” është likuiduar sipas faturës nr. 760 datë 29.03.2023 në vlerën 2,000,000 lekë, pra është paguar nga RTSH vetëm kësti i parë, i barabarte me 40 % të vlerës së përgjithshme të fondit financiar.</p> <p>Pas konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit për këtë projekt artistik dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e RTSH-së, personi fizik “E. R.,” ka dorëzuar në përmbushjen e afatit për realizim të kontratës lëndën objekt i kontratës për veprën audiovizuale “Bota arbërore” dhe është likuiduar për vlerën 1,500,000 lekë sipas faturës 13/23 datë 14.12.2023 (kësti i dyte sipas pikës 2(ii) të nenit 5 të kontratës). Me dorëzimin e të gjithë episodeve personi fizik “E. R.,” duhet të dorëzonte edhe dokumentacionin justifikues të projektit sipas pikës 2(iii)b të kontratës.</p> <p>Personi fizik “E. R.,” nuk ka dorëzuar pranë RTSH-së dokumentacionin financiar justifikues sipas parashikimeve të kontratës që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës.</p> <p>Pika 4 e nenit 5 të kontratës parashikon se: <i>“Në rast se personi fizik nuk dorëzon pranë RTSH-së dokumentacionin financiar justifikues ose në rast se dokumentacioni financiar justifikues nuk është i plote, atëherë personi fizik është i detyruar që të kthejë të gjitha shumat e kësteve të paguara nga RTSH në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara.</i></p> <p><i>Gjithashtu nga ana e RTSH nuk është verifikuar nëse lënda e dorëzuar përmbush përshkrimet sipas sinopsit të veprës së përcaktuar për prodhim.</i></p> <p>RTSH nuk ka monitoruar realizimin e projektit, sipas nenit 9 “Procedura e zbatimit të projekteve të miratuar” të Rregullores së miratuar sipas shkresës me nr. 3611 prot. datë 07.11.2016 me Vendim të Këshillit Drejtues.</p> <p>Personi fizik “E. R.,” është likuiduar në total për vlerën 3,500,000 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së.</p>
Kriteri:	<p>-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore).</p> <p>-Kontrata e bashkëprodhimit nr. 753 prot., datë 25.03.2023 e nënshkruar ndërmjet Personit Fizik E. R., dhe RTSH-së.</p>
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik.
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve gjate gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 3,500,000 lekë nga subjekti E. R., (me emrin tregtar T. S.) për projektin artistik “Bota Arbërore”. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 753 prot. datë 25.03.2023, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi ish Drejtori i Përgjithshëm z. E. J., ish Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve M. H., si dhe Drejtor i Drejtorisë Ekonomike z. E. D..

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga personi fizik “E. R.,” është paraqitur observacioni me shkresën nr. 21074/1 prot., datë 06.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 564/38 prot., datë 30.01.2024, në lidhje me aktkonstatimin nr. 20, datë 30.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

.....Duke marrë parasysh periudhën në të cilën është zhvilluar kjo kontrate në kushtet e pandemisë dhe përcaktimeve të kontratës, edhe pse ne mund të mbroheshim duke u shkarkuar nga çdo lloj përgjegjësie sipas nenit 11 të kontratës jo vetëm e kemi realizuar kontratën por kemi marrë rrisqe që kane të bëjnë me jetën njerëzore dhe si profesioniste të fushës kemi bere detyrën tone duke e dorëzuar materialin brenda afateve me cilësi dhe profesionalizëm. Persa me sipër kërkojmë të merrni të rishikoni vendimmarrjen tuaj të cilën ne e cilësojmë të pabazuar në fakte dhe provë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Neni 12 i kontratës nr. 753 prot. datë 28.03.2023 parashikon qarte se: “Pala që preket nga forca madhore duhet ta njoftojë me shkrim palën tjetër pas ndodhjes së forcës madhore sa më shpejt të jetë e mundur,por brenda afatit të detyrimeve të saj mbi natyrën e forcës madhore,për pasojat e mundshme dhe për shkaqet e saj.”

Neni 5. pika 2 parashikon se “Pagesa e vlerës se përgjithshme të fondit financiar do të kryhet pranë Personit fizik në rrugë bankare në këste sipas mënyrës vijuese:

(i) Kësti i parë i barabarte me 40% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

(ii) Kësti i dytë i barabartë me 30% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet 30 ditë nga data e dorëzimit në RTSH të kopjes së parë standarde të episodit të pare, të dyte, të tretë, të katërt dhe të pestë të veprës audiovizuale.

(iii) Kësti i tretë i barabartë me 30% të vlerës së përgjithshme të fondit financiar, lëvrohet 30 dite nga data e dorëzimit ne RTSH :a) të kopjes parë standarde të episodit të gjashtë, të shtatë, të tetë, të nënte, të dhjetë, të veprës audiovizuale dhe b) të dokumentacionit financiar justifikues të projektit, përmes të cilit personi fizik vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës audiovizuale të përbëre nga episodet me fondet e lëvruara nga RTSH në baze të kësaj kontrate.

Pas konstatimeve nga grupi i auditimit, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e RTSH personi fizik “E. R.,”ka dorëzuar në përmbushjen e afatit për realizim të kontratës lëndën objekt i kontratës për veprën audiovizuale “Bota arbërore”dhe është likuiduar për vlerën 1,500,000 lekë sipas faturës 13/23 datë 14.12.2023(kësti i dytë sipas pikës 2(ii) të nenit 5 të kontratës). Me dorëzimin e të gjithë episodeve personi fizik “E. R.,” duhet të dorëzonte edhe dokumentacionin justifikues të projektit sipas pikës 2(iii)b të kontratës.

Personi fizik “E. R.,”nuk ka dorëzuar pranë RTSH-së dokumentacionin financiar justifikues sipas parashikimeve të kontratës.

Pika 4 e nenit 5 të kontratës parashikon se: “Në rast se personi fizik nuk dorëzon pranë RTSH-së dokumentacionin financiar justifikues ose ne rast se dokumentacioni financiar justifikues nuk është i plote, atëherë personi fizik është i detyruar që të kthejë të gjitha shumat e kësteve të paguara nga RTSH në përputhje me këtë kontrate, si dhe detyrohet të dëmshpërbleje RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara”.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Projekti filmik “Light falls” bashkëprodhim kinematografik me metrazh të gjatë në vlerën 2,990,000 lekë.

Shoqëria S. e përfaqësuar nga znj. E. R., me shkresën me nr. 2113 datë 22.06.2020 ka paraqitur kërkesën për bashkëprodhimin e filmit kinematografik “Light falls” për vlerën 2,990,000 lekë. Me shkresën nr. 2147 prot., datë 16.07.2020 z. A. H., nga ana e Sektorit të Projekteve dhe të Administrimit të Drejtave i është kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të dërgojë projektin filmik për miratim në Bordin Artistik i cili me shkresën nr. 2168, me 3 vota pro ka vendosur të miratojë nga pikëpamja artistike projektin me titullin “Light falls”, një film kinematografik me metrazh të gjatë, më ngjyra, më autor të skenarit zotin z. S. D. dhe autor të regjisë z. S. D. dhe z. P. P., një bashkëprodhim midis shoqërisë tregtare S. dhe RTSH. Me vendimin nr. 20, datë 23.07.2020 Bordi i Administrimit ka vendosur të japë pëlqimin mbi kërkesën shoqërisë tregtare S. ndaj RTSH për realizimin e filmit, përkundrejt vlerës 2,990,000 lekë sipas projekt preventivit (ku tarifat janë sipas sistemit tarifor të RTSH). Me datë 24.07.2020 është nënshkruar kontrata me nr. 2262 prot., ndërmjet shoqërisë tregtare S. e njohur si person juridik, e përfaqësuar nga znj. E. R., dhe Radio Televizionit Shqiptar përfaqësuar nga z. Th. G., me afat realizmi të kontratës data 15 maj 2021. Buxheti i përgjithshëm i bashkëprodhimit është parashikuar në shumën 70,689,400 lekë. RTSH ka parashikuar të financojë fondin prej 2,990,000 lekë kurse Shoqëria do të financojë fondin me vlerë 67,699,400 lekë. Referuar nenit 4 të kontratës parashikohet se:

“Fondi financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit do të lëvrohet në llogarinë bankare të shoqërisë sipas mënyrës vijuese:

(i) 80% e vlerës së fondit financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit lëvrohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës;

(ii) 20% e vlerës së fondit financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit lëvrohet pas dorëzimit në RTSH:

- a) të dokumentacionit justifikues për shpenzimet sipas zërave të preventivit;

- b) të lëndës së filmit në përputhje me parametrat teknike;

Pjesa e mbetur e fondit financiar sipas pikës (ii) të këtij paragrafi do të paguhet vetëm pas bërjes së relacionit nga specialisti ekonomist në sektorin e projekteve.”

Sipas faturës nr. 17151842 është likuiduar shoqëria S. me përfaqësues znj. E. R., për vlerën 2,392,000 lekë, pra 80% e vlerës së kontratës.

Me shkresën nr. 2597 datë 04.08.2021 shoqëria S. ka kërkuar shtyrjen e afatit për ekzekutimin e detyrimeve sipas kontratës së sipërcituar (si zbatim i masave për mbrojtjen nga pandemia Covid-19). Me datë 16.08.2021 është nënshkruar shtyrja e afatit të realizimit të, për amendimin e kontratës me nr. 2674 datë 16.04.2021:

“Neni 1

Paragrafi 2 i nenit 7 të kontratës nr. 2262 prot., datë 24.07.2020 të nënshkruar midis RTSH-së shoqërisë ndryshohet sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH së menjëherë me përfundimin e filmit, do të dorëzojë në RTSH kopjen e parë standarde të filmit. Filmi konsiderohet i përfunduar kur kopja e parë standarde, ku është materializuar versioni përfundimtar i filmit, është realizuar. Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH se kopja e parë standarde e filmit do të realizohet jo më vonë se data 1 dhjetor 2021 dhe se do të dorëzohet në RTSH jo më vonë se data 15 dhjetor 2021. Në rast të mosrespektimit të afatit të përcaktuar në këtë paragraf nga ana e shoqërisë, shoqëria detyrohet ti kthejë RTSH-së çdo shume në lekë që RTSH ka paguar në mospërputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH në vlerën e dëmit të shkaktuar dhe të fitimeve të munguara. Shoqëria është e detyruar të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit.”

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga përfaqësuesit e subjektit, kopja e parë standarde e filmit “Light falls” është dorëzuar pranë RTSH me datë 26.10.2022, pra 10 muaj pas përfundimit të kontratës, kjo në kundërshtim me kontratën nr. 2674 prot., datë 16.08.2021 ku sipas nenit 1 shoqëria S. duhet të dorëzonte kopjen e parë standarde të filmit me datë 15.12.2021. Gjendur në këto kushte Autoriteti përkatës në RTSH në zbatim të detyrimeve kontraktuale sipas kontratës së sipërcituar duhet të refuzonte pranimin e lëndës së filmit kinematografik jashtë afateve të kontratës dhe të kërkonte nga shoqëria që ti kthehej çdo shumë në lekë që RTSH i ka paguar shoqërisë sipas përcaktimeve kontratës.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish Drejtori i Përgjithshëm z. E. J., Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve z. M. H.

Në nenin 5, pika 6 të kontratës parashikohet se:

“Shfrytëzimi i filmit dhe i secilës prej pjesëve të veçanta të filmit në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë midis RTSH dhe Shoqërisë. RTSH dhe Shoqëria do të njoftojnë rregullisht njëra-tjetra për çdo rast që lidhet me shfrytëzimin e filmit dhe të secilës prej pjesëve të veçanta të filmit në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, duke njohur njëra tjetrën me të gjitha kushtet e marrëveshjeve me palët e treta. RTSH dhe Shoqëria do të njohin njëra-tjetrën çdo tre muaj me të ardhurat neto të përfituara prej shfrytëzimeve të të drejtave të përcaktuara në çdo tre muaj me të ardhurat neto të përfituara prej shfrytëzimeve të të drejtave të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe do ti paguajnë njëra tjetrës pjesën takuese, jo me vonë se 7 (shtatë) ditë pune nga data që secila prej palëve ka pranuar se ka marrë informacion me të ardhurat e përfituara.”

Sipas rregullores së miratuar me vendimin nr. 10 datë 26.03.2018 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 8, strukturat përkatëse në RTSH duhet të mbikëqyrnin realizimin e projektit filmik. Nga ana e përfaqësuesve të RTSH nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë dokumentacion që të vërtetojë faktin se RTSH ka mbikëqyruar realizimin e kontratës.

Gjithashtu sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, veprim ky në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5, pika 6. Shoqëria “S.” ka shfrytëzuar 80% të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Light falls” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës duke mos përmbushur kështu detyrimet kontraktuale.

Në kushte të tilla, shoqëria “S.” është përgjegjëse për përfitimin e padrejtë të shumës prej 2,392,000 lekë, e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar të RTSH, si dhe njëkohësisht përgjegjëse për fitimet e munguara të RTSH si bashkëprodhuese e Projektit “Light falls”.

4. Titulli i gjetjes:	Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2262 prot. ndatë 24.07.2020, e ndryshuar me amendimin e kontratës me nr. 2674 prot. të datës 16.04.2021 për vlerën 2,392,000 lekë (shoqëria “S.” e përfaqësuar nga znj. E. R.)
Situata:	Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2262 prot., datë 24.07.2020, e ndryshuar me amendimin e kontratës me nr. 2674 prot., të datës 16.04.2021 për vlerën 2,392,000 lekë , ku vlera totale e kontratës së bashkëpunimit ka qenë 2,990,000 lekë e nënshkruar ndërmjet shoqërisë “S”e përfaqësuar nga znj. E. R., dhe RTSH-së, për bashkëprodhimin filmik “Light Falls”. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga përfaqësuesit e subjektit, kopja e parë standarde e filmit “Light falls” është dorëzuar pranë RTSH me datë 26.10.2022, pra 10 muaj pas përfundimit të kontratës, kjo në

	<p>kundërshtim me kontratën nr. 2674 prot., datë 16.08.2021, ku sipas nenit 1 shoqëria “S.” duhet të dorëzonte kopjen e parë standarde të filmit me datë 15.12.2021.</p> <p>Sipas faturës nr. 17151842 është likuiduar shoqëria “S” me përfaqësues znj. E. R., për vlerën 2,392,000 lekë, pra 80 % e vlerës së kontratës, mungon dokumentacioni justifikues që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës sipas përcaktimeve të kontratës.</p> <p>Gjithashtu sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, veprim ky në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5, pika 6. Shoqëria “S” ka shfrytëzuar 80 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Light falls” në kundërshtim me kontratën nr 2262 prot datë 24.07.2020 e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës duke mos përmbushur kështu detyrimet kontraktuale. Në kundërshtim me rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore) dhe kontratën e bashkëpunimit.</p>
Kriteri:	<p>-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore).</p> <p>-Kontrata e bashkëprodhimit nr. 2262 prot. datë 24.07.2020 e nënshkruar ndërmjet shoqërisë “S.” e përfaqësuar nga E. R. dhe RTSH-së.</p>
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik dhe fitime të munguara.
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve artistike dhe filmike gjatë gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 2,392,000 lekë nga shoqëria “S.”. Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 2262 prot. datë 24.07.2020, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga shoqëria “S.”, është paraqitur observacioni me shkresën me datë 30.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 564/33 prot., datë 30.01.2024, në lidhje me aktkonstatimin nr. 20, datë 30.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

.....Persa i përket projektit filmik “Light falls” subjekti ynë,pavarësisht kushteve të vështira ka dorëzuar ne kohë materialet ne RTSH sipas marrëveshjes. Pretendimi i KLSH-së se materiali nuk është dorëzuar në kohë nuk është i vërtetë dhe nuk korrespondon me faktet pasi kopja e filmit është dorëzuar brenda afatit të parashikuar ne drejtorinë e projekteve në RTSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e RTSH-së dhe dokumentacionit bashkëngjitur observacionit tuaj nuk ka fakte dhe argumente mbështetës për atë që ju pretendoni.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Auditimi i dosjes “Violinisti” i financuar në vlerën 1,500,000 lekë.

Me shkresën nr 3199, datë 27.09.2021 shoqëria “S.” sh.p.k ka paraqitur pranë RTSH-së kërkesën ne lidhje me bashkëprodhimin e filmit me titullin “Violinisti”. Shuma e përgjithshme e buxhetit të prodhimit të filmit kinematografik është në vlerën 4,525,000 lekë.

Me shkresën me nr. 3211 prot. datë 28.09.2021 përgjegjësi i sektorit të projekteve dhe administrimit të drejtave A. H., i kërkon drejtorit të përgjithshëm të dërgoje për shqyrtimin, vlerësimi dhe miratimin nga pikëpamja artistike tek Bordi Artistik të projektit filmik “Violinisti” Me shkresën nr.3259 datë 30.09.2021 drejtori i përgjithshëm paraqet për shqyrtim dhe miratim tek Bordi Artistik projektin filmik “Violinisti”.

Me shkresën nr. 3295 prot. datë 30.09.2021 Bordi artistik vendosi të miratojë nga pikëpamja artistike projektin me titull “Violinisti”, Një film kinematografik me autorë të skenarit dhe regjisë S. B., me kohëzgjatje 40 min, një bashkëprodhim midis shoqërisë tregtare “S.” sh.p.k dhe RTSH-së.

Me shkresën nr. 3426 prot. datë 11.10.2021 drejtori i përgjithshëm i drejtohet bordit të administrimit të RTSH-së, ku kërkon shqyrtimin dhe realizimin e projektit filmik me titull “Violinisti”

Me shkresën nr. 3464 prot. datë 13.10.2021 bordi i administrimit ka vendosur që të japë pëlqimin mbi kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë “S.” sh.p.k me RTSH për realizimin e projektit filmik “Violinisti”.Vendimi bordit të administrimit është i paargumentuar nga pikëpamja ekonomike.

Bordi administrimit këshillon drejtorin e përgjithshëm të RTSH të ndjekë procedurat e mëtejshme ligjore për miratimin e projektit ne Këshillin drejtues të RTSH-së.

Mungon vendimi Këshillit Drejtues sipas rregullores së projekteve.

Me datën 27.10.2021 është nënshkruar kontrata me nr. 3690 prot. ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga zv/drejtori i përgjithshëm M. L. dhe shoqërisë “S.” e përfaqësuar nga administratori E. R..

Neni 4 i kontratës përcakton se :

“Buxheti i përgjithshëm i bashkëprodhimit është në shumën me vlerë 4,525,000, ku RTSH do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerën 1,500,000 lekë dhe shoqëria do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerë 3,025,000 lekë.

“Fondi financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit do të lëvrohet në llogarinë bankare të shoqërisë sipas mënyrës vijuese :

(i)70% e vlerës se fondit financiar do të lëvrohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

(ii)30% e vlerës se fondit financiar do të lëvrohet pas dorëzimit në RTSH a) të dokumentacionit justifikues për shpenzimet sipas zërave të preventivit financiar të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit të filmit, që RTSH merr përsipër. b)të lëndës së filmit në përputhje me parametrat teknike të përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 7 të kësaj kontratë.

Sipas faturës, më datë 08.03.2022, është likuiduar shoqëria “S.” për vlerën 1,050,000 lekë, pra 70% e vlerës së kontratës,

Neni 5, pika 4 a e kontratës parashikon se: “Të ardhurat që Shoqëria përfiton nga shfrytëzimi i të drejtave ekskluzive të përcaktuara në këtë paragraf do të ndahen midis RTSH-së dhe shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në bashkëprodhimin e filmit. Shoqëria do të njohë RTSH-në

çdo 3 muaj me të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimeve të të drejtave ekskluzive të përcaktuar në këtë paragraf dhe do të paguajë RTSH-së pjesën takuese jo më vonë se 7 ditë pune nga data që RTSH ka pranuar se ka marrë prej shoqërisë informacionin me të ardhurat që shoqëria ka përfituar”.

Gjithashtu sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, kjo në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5, pika 4.

Neni 7 pika 2 e kontratës parashikon se : “Shoqëria deklaron dhe garanton se menjëherë me përfundimin e filmit, do të dorëzojë në RTSH kopjen e parë standarde të filmit. Filmi konsiderohet i përfunduar, kur kopja e parë standarde, ku është materializuar versioni përfundimtar i filmit, është realizuar. Shoqëria deklaron dhe “Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH-në se kopja e para standarde e filmit do të realizohet jo më vonë se data 21 shkurt 2022 dhe do të dorëzohet në RTSH jo më vonë se data 28.02.2022. Në rast mosrespektimi të afatit të përcaktuar në këtë paragraf nga ana e shoqërisë, shoqëria detyrohet t’i kthejë RTSH-së çdo shumë në lekë që RTSH ka paguar në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara. Shoqëria është e detyruar që të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit”.

Shoqëria “S.” ka shfrytëzuar 70% të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Violinisti” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, “S.” është përgjegjëse për dëmin ekonomik të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.

Sipas rregullores të miratuar me vendimin nr.10 datë 26.03.2018 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 8, strukturat përkatëse në RTSH duhet të mbikëqyrnin realizimin e projektit filmik.

Nga ana e përfaqësuesve të RTSH-së nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë dokumentacion që të vërtetojë faktin, që RTSH ka mbikëqyrur realizimin e kontratës.

Kjo ngarkon me përgjegjësi përgjegjësën e sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave për vitin A. H., ish zv/ drejtorin e përgjithshëm M. L..

Nga sektori i transcoding dhe arkivave u raportua verbalisht dhe nëpërmjet postës elektronike që filmi Violinisti nuk është arkivuar në arkivat e RTSH-së.

Nga sektori i raportimit dhe nga drejtoria e arkivave u raportua se filmi violinisti nuk është transmetuar asnjëherë në asnjë nga kanalet e RTSH-së.

Në mungesë të dokumentacionit justifikues për dorëzimin e projektit “Violinisti” të shoqërisë “S.”, në kundërshtim me kontratën, likuiduar për vlerën 1,050, 000 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi ish zv/ drejtorin e përgjithshëm M. L., përgjegjësën e sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave A. H..

Vlera 1,050,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së dhe duhet të dëmshpërblehet në zbatim të nenit 640, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

5. Titulli i gjetjes:	Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr.3690 prot. datë 27.10.2021, për vlerën 1,050,000 lekë (shoqëria S. e përfaqësuar nga znj. E. R.)
Situata:	Shoqëria “S.” ka shfrytëzuar 70 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Violinisti” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka dorëzuar fare lëndën e projektit filmik në RTSH ,nuk ka raportuar për të ardhurat nga

	administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Shoqëria “S.” është likuiduar vetëm për 70% të vlerës se kontratës sepse nuk ka dorëzuar dokumentacionin justifikues që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës sipas përcaktimeve të kontratës. Shoqëria “S.” është përgjegjëse për dëmin ekonomik të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.
Kriteri:	-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore). -Kontrata e bashkëprodhimit nr. 3690 prot., datë 27.10.2021 e nënshkruar ndërmjet Personit Fizik E. R. dhe RTSH-së.
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik dhe fitime të munguara
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve artistike dhe filmike gjatë gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimi i vlerës 1,050,000 lekë nga shoqëria “S.”. Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 3690 prot. datë 24.07.2020, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga shoqëria “S.”, është paraqitur observacioni me shkresën me datë 30.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 564/33 prot., datë 30.01.2024, në lidhje me aktkonstatimin nr. 20, datë 30.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

.....Për projektin artistik “Violinisti” Duke marrë parasysh periudhën në të cilën është zhvilluar kjo kontratë në kushtet e pandemisë dhe përcaktimeve të kontratës, edhe pse ne mund të mbroheshim duke u shkarkuar nga çdo lloj përgjegjësie sipas nenit 8 të kontratës jo vetëm e kemi realizuar kontratën por kemi marrë rrisqe që kanë të bëjnë me jetën njerëzore dhe si profesioniste të fushës kemi bërë detyrën tonë duke e dorëzuar materialin brenda afateve me cilësi dhe profesionalizëm. Persa me sipër kërkojmë të merrni të rishikoni vendimmarrjen tuaj të cilën ne e cilësojmë të pabazuar në fakte dhe provë.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Siç është cituar dhe në aktkonstatmin nr. 20 datë 14.11.2023, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga RTSH rezulton që lënda projekti artistik “Violinisti” nuk është dorëzuar pranë RTSH-së sipas përcaktimeve të kontratës së bashkëpunimit.

Neni 8 pika 2 e kontratës e parashikon qartë “Pala që preket nga forca madhore duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër pas ndodhjes së forcës madhore sa më shpejt të jetë e mundur ,por brenda afatit të detyrimeve të saj mbi natyrën e forcës madhore, për pasojat e mundshme dhe për shkaqet e saj”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e RTSH-së dhe dokumentacionit bashkëngjitur observacionit tuaj nuk ka fakte dhe argumente mbështetës për atë që ju pretendoni.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Konkluzione

-Nga ana e Personit fizik E. R. dhe shoqërisë S., përfaqësuar nga znj. E. R., kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të RTSH-së në vlerën **11,442,000 lekë**, përkatësisht:

- Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 753 prot., datë 25.03.2023 në vlerën **3,500,000 lekë** (Personi fizik E. R., me emrin tregtar T. S.);

- Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1740 prot., datë 20.05.2021 në vlerën **4,500,000 lekë** (Personi fizik E. R., me emrin tregtar T. S.);

- Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2262 prot., datë 24.07.2020, e ndryshuar me amendimin e kontratës me nr. 2674 prot., të datës 16.04.2021 për vlerën **2,392,000 lekë** (shoqëria S. e përfaqësuar nga znj. E. R.);

-Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr.3690 prot., datë 27.10.2021, për vlerën **1,050,000 lekë** (shoqëria S. e përfaqësuar nga znj. E. R.);

-Në të gjitha kontratat e nënshkruara me RTSH të auditura nga grupi i auditimit, sipas dokumentacionit të venë në dispozicion, personi fizik E. R. dhe personi juridik S. i përfaqësuar nga znj. E. R., nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktuale përkatëse, duke mos dorëzuar në kohë lëndën sipas kontratës, duke mos raportuar mbi të ardhurat e realizuara nga administrimi i të drejtave për bashkëprodhimet, duke mos ndarë fitimet me RTSH, sipas përcaktimeve të kontratave përkatëse, duke dorëzuar në arkivin e RTSH, materiale të ndryshme nga ato për të cilat shoqëria është kontraktuar apo duke mos dorëzuar fare lëndën sipas detyrimeve ligjore të kontratës;

-Personi fizik znj. E. R. dhe personi juridik S. i përfaqësuar nga znj. E. R., është përgjegjëse për të gjitha fitimet e munguara të RTSH në bazë të detyrimeve që lindin nga kontratat e nënshkruara ndërmjet subjekteve;

-RTSH nuk ka marrë masat e nevojshme për ndjekje dhe realizimin e projekteve sipas përcaktimeve të rregullores “Për miratimin dhe zbatimin e projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”;

-RTSH është përgjegjëse për pranimin e lëndës së dorëzuar nga shoqëria jashtë afateve të përcaktuara në kontratë për projektin “Light falls” dhe për faktin që nuk ka kërkuar dëmshpërblimin sipas nenit 6, pika 3 të kontratës nr. 2262 prot., datë 24.07.2020;

-RTSH është përgjegjëse për pranimin e lëndës së ciklit të dokumentareve “Koha dhe artisti” me përmbajtje të ndryshme nga ajo për të cilën shoqëria është kualifikuar nga Bordi Artistik dhe më pas kontraktuar;

Auditimi i dosjes “Edhe një ditë” bashkëprodhim në vlerën 2,890,000 lekë për RTSH-në

Me shkresën nr. 1705 prot., datë 17.05.2021 shoqëria “S.&N.” sh.p.k ka paraqitur pranë RTSH-së kërkesën në lidhje me bashkëprodhimin e filmit me titullin “Edhe një ditë”. Shuma e përgjithshme e buxhetit të prodhimit do të jetë në vlerën 8,967,000 lekë.

Me shkresën me nr. 1706 prot. datë 17.05.2021 përgjegjësi i sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave kërkon drejtorit të përgjithshëm të dërgojë për shqyrtim, vlerësim dhe miratimin nga pikëpamja artistike tek Bordi Artistik të projektit filmik “Edhe një ditë”.

Me shkresën nr 1707 datë 18.05.2021 drejtori i përgjithshëm paraqet për shqyrtim dhe miratim tek Bordi Artistik projektin filmik me titullin “Edhe një ditë”.

Me shkresën nr 1729 prot. datë 19.05.2021, Bordi artistik vendosi të miratojë nga pikëpamja artistike projektin me titull “Edhe një ditë”, një film kinematografik me autor të skenarit dhe regjisë E. C., me kohëzgjatje 75 minuta, me ngjyra dhe në gjuhën shqipe, një bashkëprodhim midis shoqërisë “S.&N.” sh.p.k dhe RTSH-së.

Referuar Vendimit të Bordit, në pjesën arsyetuese të tij, nuk shprehet mbi vlerësimin nga pikëpamja artistike e projektit, pra nuk jep një argumentim mbi miratimin e projektit dhe nëse përputhet me strukturën programore të RTSH-së, por shprehet vetëm për *“miratimin nga pikëpamja artistike dhe profesionale”*, duke lënë shkak për hartimin në mënyrë fiktive të vendimit, jo në përputhje me kërkesat e “Rregullores” neni 5.

Me shkresën nr 1235 datë 20.05.2021 drejtori i përgjithshëm i drejtohet bordit të administrimit të RTSH-së, ku kërkon shqyrtimin dhe realizimin e projektit filmik me titull “Edhe një ditë”

Me shkresën nr. 1731 prot. datë 20.05.2021 bordi i administrimit ka vendosur që të japë pëlqimin mbi kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë “S.&N.”sh.p.k me RTSH për realizimin e projektit filmik “Edhe një ditë”

Bordi i administrimit, këshillon drejtorin e përgjithshëm të RTSH-së që drejtoria e marketingut dhe njësia e programeve të marrë masa për thithjen e publicitetit përgjatë transmetimit të projektit filmik.

Me datën 20.05.2021 është nënshkruar kontrata 1731/1 datë 20.05.2021 ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Th. G. dhe shoqërisë “S.&N.” e përfaqësuar nga administratori J. Sh..

Neni 4 i kontratës përcakton se :

“Buxheti i përgjithshëm i bashkëprodhimit është në shumën me vlerë 8,967,000 lekë, ku RTSH do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerën 2,890,000 lekë dhe shoqëria do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerë 6,077,000 lekë”.

“Fondi financiar me të cilin RTSH merr pjese në bashkëprodhimin e filmit do të lëvrohet në llogarinë bankare të shoqërisë sipas mënyrës vijuese :

(i)80% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

(ii)20% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet pas dorëzimit në RTSH a)të dokumentacionit justifikues për shpenzimet sipas zërave të preventivit financiar të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit të filmit, që RTSH merr përsipër. b)të lëndës së filmit në përputhje me parametrat teknike të përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 7 të kësaj kontrate.

Sipas faturës nr. 2/2021, është likuiduar shoqëria “S.&N.” me përfaqësues J. Sh., për vlerën 2,312,000 lekë, pra 80% e vlerës së kontratës.

Neni 5, pika 4 a e kontratës parashikon se: *“...Të ardhurat që Shoqëria përfiton nga shfrytëzimi i të drejtave ekskluzive të përcaktuara në këtë paragraf do të ndahen midis RTSH-së dhe shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në bashkëprodhimin e filmit. Shoqëria do të njohëRTSH-në çdo 3 muaj me të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimeve të të drejtave ekskluzive të përcaktuar në këtë paragraf dhe do ti paguaje RTSH-së pjesën takuese jo me vone se 7 ditë pune nga data që RTSH ka pranuar se ka marrë prej shoqërisë informacionin me të ardhurat që shoqëria ka përfituar”*

Gjithashtu sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, kjo në referencë:

Neni 7 pika 2 e kontratës parashikon se :“Shoqëria deklaron dhe garanton se menjëherë me përfundimin e filmit, do të dorëzoje në RTSH kopjen e pare standarde të filmit. Filmi konsiderohet i përfunduar, kur kopja e pare standarde, ku është materializuar versioni përfundimtar i filmit, është realizuar. “Shoqëria deklaron

dhe garanton RTSH-në se kopja e para standarde e filmit do të realizohet jo me vone se data 1 tetor 2021 dhe do të dorëzohet në RTSH jo me vone se data 18.05.2021. Në rast mosrespektimi të afatit të përcaktuar në këtë paragraf nga ana e shoqërisë, shoqëria detyrohet t'i kthejë RTSH-së çdo shumë në lekë që RTSH ka paguar në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të

dëmshpërbleje RTSH-në në vlerën e dëmit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara. Shoqëria është e detyruar që të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit”.

Në hartimin e kontratës është bërë një lapsus në përcaktimin e afatit të dorëzimit të lëndës, ku periudha e dorëzimit është vendosur 5 muaj para periudhës së realizimit të projektit. Në, kushte të tilla kur nga stafi i RTSH-së nuk u argumentua lapsusi në kontratë. Grupi i auditimit duke vlerësuar gjitha kontratat e audituara dhe mënyrën e tyre të hartimit, vlerëson si afat dorëzimi të lëndës objekt i kësaj kontrate datën 18.10.2021.

Me shkresën nr. 1702 datë 11.05.2022 përgjegjësi i sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave dërgon tek drejtorja ekonomike E. D., ka paraqitur dokumentacionin financiar justifikues të projektit filmik, ku kërkon pagesën e 20% të vlerës së fondit financiar me të cilin RTSH merr pjesën në bashkëprodhimin e filmit kinematografik “Edhe një ditë”

Sipas faturës nr 5/2022, është likuiduar shoqëria “S.&N.” me përfaqësues J. Sh., për vlerën 578,000 lekë, pra 20% e vlerës së kontratës. Kryerja e kësaj pagese është në kundërshtim me kontratën e bashkëpunimit, sipas nenit 7, pika 2.

Me shkresën nr. 1770 prot. datë 18.05.2022 përgjegjësi i sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave i drejtohet drejtorit të arkivës për pranimin e lëndës në arkive, ku citohet se sektori i transcoding dhe i kontrollit të kualitetit në njësinë teknike në RTSH, ka kryer kontrollin e lëndës me dt. 16.05.2022.

Shoqëria “S.&N.” ka shfrytëzuar 100% të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Edhe një ditë” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5,pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Shoqëria “S.&N.” me përfaqësues J. Sh., është përgjegjës për dëmin ekonomik të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion lënda objekt i kontratës ka ardhur në RTSH jashtë afateve të përcaktuara në kontratë. Për vonesën në dorëzimin e lëndës nuk ka dokumentacion justifikues nga ana e shoqërisë. Pranimi i lëndës jashtë aftave të kontratës dhe pa argumentuar vonesën në dorëzim ngarkon me përgjegjësi sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave A. H..

Pranimi i bashkëprodhimit filmik “Edhe një ditë” i shoqërisë S.&N., jashtë afateve të kontratës në dhe në kundërshtim me kontratën, likuiduar për vlerën 2,890,000 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së.

Vlera 2,890,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së dhe duhet të dëmshpërblehet në zbatim të nenit 640, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

6. Titulli i gjetjes:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me 1731/1 prot.,datë 20.05.2021, për vlerën 2,890,000 lekë nga shoqëria “S.&N.”
Situata:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me 1731/1 prot.,datë 20.05.2021, për vlerën 2,890,000 lekë , ku vlera totale e kontratës ka qenë 2,890,000 lekë e nënshkruar me shoqërinë “S.&N.”, për bashkëprodhimin filmik “Edhe një ditë Shoqëria “S.&N.” ka shfrytëzuar 100 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Edhe një ditë” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, duke

	<p>dorëzuar jashtë afateve të kontratës lëndën objekt i kontratës, në kundërshtim me rregulloren: “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore).</p> <p>-Kontratën e bashkëprodhimit nr. 1731/1 prot.,datë 20.05.2021 e nënshkruar ndërmjet Personit Fizik E. R. dhe RTSH-së.</p>
Kriteri:	<p>-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore).</p> <p>-Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1731/1 prot.,datë 20.05.2021 e nënshkruar ndërmjet Personit Fizik E. R. dhe RTSH-së.</p>
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik dhe fitime të munguara.
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve artistike dhe filmike gjatë gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore ,duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit , arkëtimin i vlerës 2,890,000 lekë nga shoqëria “S.&N.”.Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, ne kundërshti me kontratën 1705 prot.,datë 17.05.2021,ndërmejt RTSH-së dhe shoqërisë S.&N., për vlerën 2,890,000 lekë.

Auditimi i dosjes “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur” bashkëprodhim, në vlerën 3,000,000 lekë për RTSH-në.

Me shkresën nr. 931, datë 26.03.2020 shoqëria “A. F. P.” sh.p.k ka paraqitur pranë RTSH-së kërkesën ne lidhje me bashkëprodhimin e filmit me titullin “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”. Shuma e përgjithshme e buxhetit të prodhimit të filmit kinematografik është në vlerën 93,750,000 lekë.

Me shkresën me nr. 1511 prot. datë 17.05.2021 përgjegjësi i sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave A. H., i kërkon drejtorit të përgjithshëm të dërgojë për shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin nga pikëpamja artistike tek Bordi Artistik të projektit filmik “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”.

Me shkresën nr.1512 datë 27.05.2020 drejtori i përgjithshëm paraqet për shqyrtim dhe miratim tek Bordi Artistik projektin filmik “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”.

Me shkresën nr. 1526 prot., datë 28.05.2020 Bordi artistik vendosi të miratojë nga pikëpamja artistike projektin me titull “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”, nje film kinematografik me autor të skenarit dhe regjisë G. K., më metrazh të gjatë, një bashkëprodhim midis shoqërisë tregtare “A. F. P.” sh.p.k dhe RTSH-së.

Me shkresën nr. 2104 prot. datë 14.0.2020 drejtori i përgjithshëm i drejtohet bordit të administrimit të RTSH-së, ku kërkon shqyrtimin dhe realizimin e projektit filmik me titull “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”.

Me shkresën nr. 2228 prot. datë 23.07.2020 bordi i administrimit ka vendosur që të japë pëlqimin mbi kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë “A. F. P.” sh.p.k me RTSH për realizimin e projektit filmik “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”

Bordi administrimit këshillon drejtorin e përgjithshëm të RTSH të ndjekë procedurat e mëtejshme ligjore për miratimin e projektit ne Këshillin drejtues të RTSH-së.

Në vijimësi të vendimit të bordit të administrimit, Me shkresën me nr. 2507 prot., datë 31.08.2020 drejtori i përgjithshëm dërgon për shqyrtim dhe miratim projektin filmim me titull “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”

Me shkresën nr.2517 prot, datë 31.08.2020 Këshilli Drejtues me vendimin me nr 22, vendosi të miratojë kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë tregtare “A. F. P.” sh.p.k me RTSH-në për realizimin e filmit kinematografik me metrazh të gjate me titull “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”

Me datën 26.03.2021 është nënshkruar kontrata me nr. 1008 prot. ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Th. G. dhe shoqërisë “A. F. P.” e përfaqësuar nga administratori G. K..

Neni 4 i kontratës përcakton se :

“Buxheti i përgjithshëm i bashkëprodhimit është në shumën me vlerë 93,750,000, ku RTSH do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerë 3,000,000 lekë dhe shoqëria do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerë 90,750,000 lekë.

“Fondi financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit do të lëvrohet në llogarinë bankare të shoqërisë sipas mënyrës vijuese :

(i)80% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

(ii)20% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet pas dorëzimit në RTSH a)te dokumentacionit justifikues për shpenzimet sipas zërave të preventivit financiar të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit të filmit, që RTSH merr përsipër. b)të lëndës së filmit në përputhje me parametrat teknike të përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 7 të kësaj kontrate.

Sipas faturës nr 388, është likuiduar shoqëria “A. F. P.” me për vlerën 2,400,000 lekë, pra 80% e vlerës së kontratës.

Neni 5, pika 4 a e kontratës parashikon se: “...Të ardhurat që Shoqëria përfiton nga shfrytëzimi i të drejtave ekskluzive të përcaktuara në këtë paragraf do të ndahen midis RTSH-së dhe shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në bashkëprodhimin e filmit. Shoqëria do të njohë RTSH-në çdo 3 muaj me të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimeve të të drejtave ekskluzive të përcaktuar në këtë paragraf dhe do ti paguajë RTSH-së pjesën takuese jo me vone se 7 ditë pune nga data që RTSH ka pranuar se ka marrë prej shoqërisë informacionin me të ardhurat që shoqëria ka përfituar”.

Gjithashtu sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, kjo në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5,pika 4.

Neni 7 pika 2 e kontratës parashikon se :“Shoqëria deklaron dhe garanton se menjëherë me përfundimin e filmit, do të dorëzojë në RTSH kopjen e pare standarde të filmit. Filmi konsiderohet i përfunduar, kur kopja e pare standarde, ku është materializuar versioni përfundimtar i filmit, është realizuar. Shoqëria deklaron dhe “Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH-në se kopja e para standarde e filmit do të realizohet jo me vone se data 10 dhjetor 2021 dhe do të dorëzohet në RTSH jo me vone se data 15.12.2021. Ne rast mosrespektimi të afatit të përcaktuar në këtë paragraf nga ana e shoqërisë, shoqëria detyrohet t'i kthejë RTSH-së çdo shumë në lekë që RTSH ka paguar në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara. Shoqëria është e detyruar që të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit”.

Shoqëria “A. F. P.” ka shfrytëzuar 80% të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5,pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet

kontraktuale, “A. F. P.” është përgjegjëse për dëmin ekonomik të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.

Sipas rregullores të miratuar me vendimin nr. 10 datë 26.03.2018 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 8, strukturat përkatëse në RTSH duhet të mbikëqyrnin realizimin e projektit filmik.

Nga ana e përfaqësuesve të RTSH-së nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë dokumentacion që të vërtetojë faktin, që RTSH ka mbikëqyrur realizimin e kontratës.

Kjo ngarkon me përgjegjësi përgjegjësën e sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave për vitin A. H., ish drejtorin e përgjithshëm Th. G..

Me shkresën nr. 4048 datë 28.10.2022 drejtori i drejtorisë së marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve i drejtohet drejtorit të arkivës D. Xh. për pranimin e lëndës në arkive, ku citohet se sektori i transcoding dhe i kontrollit të kualiteti në njësinë teknike në RTSH ka kryer kontrollin e lëndës me dt. 28.09.2022.

Gjendur në këto kushte Autoriteti përkatës në RTSH në zbatim të detyrimeve kontraktuale sipas kontratës së sipërcituar duhet të refuzonte pranimin e në arkivë të lëndës së filmit kinematografik me titullin “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur” jashtë afateve të kontratës dhe të kërkonte nga shoqëria që ti kthehej çdo shumë në lekë që RTSH i ka paguar shoqërisë sipas përcaktimeve të kontratës.

Pranimi i projektit “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur” i shoqërisë “A. F. P”, jashtë afateve të kontratës në kundërshtim me kontratën, likuiduar për vlerën 2,400, 000 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së.

Per veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi ish drejtori i përgjithshëm Th. G., përgjegjësën e sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave për vitin A. H., drejtorin e drejtorisë së projekteve M. H..

Vlera 2,400,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së dhe duhet të dëmshpërblehet në zbatim të nenit 640, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

7. Titulli i gjetjes:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1008 prot., datë 26.03.2021, për vlerën 2,400,000 lekë nga shoqëria “A. F. P”
Situata:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1008 prot., datë 26.03.2021, për vlerën 2,400,000 lekë , ku vlera totale e kontratës ka qenë 3,000,000 lekë, e nënshkruar ndërmjet “ A. F. P. ” dhe RTSH-së, për bashkëprodhimin filmik “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”. Shoqëria “A. F. P.” ka shfrytëzuar 80 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”, në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, duke dorëzuar jashtë afateve lëndën objekt i kontratës. Shoqëria “A. F. P.” është likuiduar vetëm për 80% të vlerës së kontratës sepse nuk ka dorëzuar dokumentacionin justifikues që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës sipas përcaktimeve të kontratës. Shoqëria “A. F. P.” është përgjegjëse për dëmin ekonomik të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.
Kriteri:	-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore). -Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1008 prot., datë 26.03.2021.

Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik dhe fitime të munguara
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve artistike dhe filmike gjatë gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit , arkëtimin i vlerës 2,400,000 lekë nga shoqëria “A. F. P”. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1008 prot. datë 26.03.2021, ndërmjet RTSH-së dhe shoqërisë, “A. F. P”.

Auditimi i dosjes “Love” bashkëprodhim në vlerën 3,000,000 lekë

Me shkresën nr 247, datë 27.01.2020 shoqëria “P. F. P.” sh.p.k ka paraqitur pranë RTSH-së kërkesën në lidhje me bashkëprodhimin e filmit me titullin “**Love**”. Shuma e përgjithshme e buxhetit të prodhimit të filmit kinematografik e përshkruar në kërkesë është në vlerën 19,100,000 lekë.

Me shkresën me nr. 311 prot. datë 31.01.2021 përgjegjësi i sektorit të projekteve dhe administrimit të drejtave A. H., i kërkon drejtorit të përgjithshëm të dërgoje për shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin nga pikëpamja artistike tek Bordi Artistik të projektit filmik “**Love**”

Me shkresën nr. 315 datë 31.01.2020 drejtori i përgjithshëm paraqet për shqyrtim dhe miratim tek Bordi Artistik projektin filmik “**Love**”.

Me shkresën nr. 326 prot. datë 31.01.2020 Bordi artistik vendosi të miratojë nga pikëpamja artistike projektin me titull “**Love**”, një film kinematografik me autor të skenarit dhe regjisë D. P., me metrazh të gjatë, një bashkëprodhim midis shoqërisë tregtare “P. F. P.” sh.p.k dhe RTSH-së.

Me shkresën nr. 342 datë 03.02.2020 drejtori i përgjithshëm i drejtohet bordit të administrimit të RTSH-së, ku kërkon shqyrtimin dhe realizimin e projektit filmik me titull “**Love**”.

Me shkresën nr. 394 prot. datë 06.02.2020 bordi i administrimit vendosi që të japë pëlqimin mbi kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë “P. F. P.” sh.p.k me RTSH për realizimin e projektit filmik “**Love**”.

Këshillon drejtorin e përgjithshëm të RTSH të ndjekë procedurat e mëtejshme ligjore për miratimin e projektit në Këshillin drejtues të RTSH-së.

Në vijimësi të vendimit të bordit të administrimit, Me shkresën me nr. 407 datë 07.02.2020 drejtori i përgjithshëm dërgon për shqyrtim dhe miratim projektin filmim me titull “**Love**”.

Me shkresën nr.785 prot, datë 06.03.2020 Këshilli Drejtues me vendimin me nr 3, vendosi të miratojë kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë tregtare “P. F. P.” sh.p.k me RTSH-në për realizimin e filmit kinematografik me metrazh të gjatë me titull “**Love**”

Me datën 27.04.2020 është nënshkruar kontrata me nr. 1297 prot, ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Th. G. dhe shoqërisë “P. F. P.” e përfaqësuar nga administratori D. P..

Neni 4 i kontratës përcakton se :

“Buxheti i përgjithshëm i bashkëprodhimit është në shumën me vlerë 47,730,000, ku RTSH do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerën 3,000,000 lekë dhe shoqëria do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerë 44,750,000 lekë.

“Fondi financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit do të lëvrohet në llogarinë bankare të shoqërisë sipas mënyrës vijuese :

(i)80% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

(ii)20% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet pas dorëzimit në RTSH a)të dokumentacionit justifikues për shpenzimet sipas zërave të preventivit financiar të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit të filmit, që RTSH merr përsipër. b)të lëndës së filmit në përputhje me parametrat teknike të përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 7 të kësaj kontrate.

Pjesa e mbetur e fondit financiar sipas pikës (ii) të këtij paragrafi do të paguhet vetëm pas bërjes së relacionit nga specialisti ekonomist në sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave.

Sipas faturës, datë 19.06.2020 nëpërmjet bankës C. është likuiduar shoqëria “P. F. P.” me përfaqësues Dionis Papadhimitri për vlerën 2,400,000 lekë, pra 80% e vlerës së kontratës.

Sipas faturës, datë 13.04.2021 është likuiduar shoqëria “P. F. P.” me përfaqësues D. P., për vlerën 600,000 lekë, pra 20% e vlerës së kontratës.

Likuidimi për kështu e dytë sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion është bërë pa asnjë dokumentacioni justifikues.

Neni 5, pika 4 a të kontratës parashikon se: “...Të ardhurat që Shoqëria përfiton nga shfrytëzimi i të drejtave ekskluzive të përcaktuara në këtë paragraf do të ndahen midis RTSH-së dhe shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në bashkëprodhimin e filmit. Shoqëria do të njohë RTSH-në çdo 3 muaj me të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimeve të të drejtave ekskluzive të përcaktuar në këtë paragraf dhe do ti paguajë RTSH-së pjesën takuese jo më vonë se 7 ditë pune nga data që RTSH ka pranuar se ka marrë prej shoqërisë informacionin me të ardhurat që shoqëria ka përfituar” .

Gjithashtu sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuara nga zbatimi i këtij projekti, kjo në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5, pika 4.

Neni 7 pika 2 e kontratës parashikon se : “Shoqëria deklaron dhe garanton se menjëherë me përfundimin e filmit, do të dorëzojë në RTSH kopjen e pare standarde të filmit. Filmi konsiderohet i përfunduar, kur kopja e pare standarde, ku është materializuar versioni përfundimtar i filmit, është realizuar. Shoqëria deklaron dhe “Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH-në se kopja e para standarde e filmit do të realizohet jo më vonë se data 01 dhjetor 2020 dhe do të dorëzohet në RTSH jo më vonë se data 28.12.2020. Në rast mosrespektimi të afatit të përcaktuar në këtë paragraf nga ana e shoqërisë, shoqëria detyrohet t'i kthejë RTSH-së çdo shumë në lekë që RTSH ka paguar në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara. Shoqëria është e detyruar që të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit”.

Sipas rregullores të miratuar me vendimin nr. 10 datë 26.03.2018 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 8, strukturat përkatëse në RTSH duhet të mbikëqyrnin realizimin e projektit filmik.

Nga ana e përfaqësuesve të RTSH-së nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit asnjë dokumentacion që të vërtetojë faktin, që RTSH ka mbikëqyrur realizimin e kontratës.

Kjo ngarkon me përgjegjësi përgjegjësin e sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave për vitin A. H..

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtoria e arkiva dhe sektori i transcoding Shoqëria “P. F. P” nuk ka dorëzuar fare lëndën për bashkëprodhimin filmik “Love”

Shoqëria “P. F. P” ka shfrytëzuar 100% të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Light falls” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5,pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, Shoqëria “P. F. P.” me përfaqësues D. P., është përgjegjëse për dëmin ekonomik në vlerën 3,000,000 lekë të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.

Vlera 3,000,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-së dhe duhet të dëmshpërblehet në zbatim të nenit 640, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

8 Titulli i gjetjes:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1297 prot. datë 27.04.2020, për vlerën 3,000,000 lekë nga shoqëria “P. F. P.”
Situata:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1297 prot., datë 27.04.2020, për vlerën 3,000,000 lekë nënshkruar me shoqërinë “P. F. P.”,për bashkëprodhimin filmik “Love”. Shoqëria “P. F. P.” ka shfrytëzuar 100 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Love” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale duke mos dorëzuar në RTSH lëndën objekt i kontratës.
Kriteri:	“Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore). Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1297 prot. datë 27.04.2020.
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik dhe fitime të munguara.
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve artistike dhe filmike gjatë gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Te kërkohet në rrugë ligjore ,duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin i vlerës 3,000,000 lekë nga shoqëria “P. F. P”. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1297 prot. datë 27.04.2020, ndërmjet RTSH-së dhe shoqërisë, “P. F. P”, me vlerë totale 3,000,000 lekë.

Auditimi i dosjes “Luanët drejt Venecias” bashkëprodhim, në vlerën 3,000,000 lekë

Me shkresën nr. 721,datë 03.02.2020 shoqëria “E. P.”sh.p.k ka paraqitur pranë RTSH-së kërkesën ne lidhje me bashkëprodhimin e filmit me titullin “Luanët drejt Venecias”. Shuma e përgjithshme e buxhetit të prodhimit të filmit kinematografik e përshkruar ne kërkesë është ne vlerën 31,085,000 lekë.

Me shkresën me nr. 2102 prot. datë 14.07.2020 përgjegjësi i sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave A. H. i kërkon drejtorit të përgjithshëm të dërgojë për shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin nga pikëpamja artistike tek Bordi Artistik të projektit filmik “Luanët drejt Venecias”

Me shkresën nr. 1515 datë 27.05.2020 drejtori i përgjithshëm paraqet për shqyrtim dhe miratim tek Bordi Artistik projektin filmik “Luanët drejt Venecias”.

Me shkresën nr. 1532 prot. datë 28.05.2020 Bordi artistik vendosi të miratojë nga pikëpamja artistike projektin me titull “Luanët drejt Venecias”, një film kinematografik me autor të skenarit dhe regjisë J. J., me metrazh të gjatë, një bashkëprodhim midis shoqërisë tregtare “E. P.”sh.p.k dhe RTSH-së.

Me shkresën nr 2105 datë 14.07.2020 drejtori i përgjithshëm i drejtohet bordit të administrimit të RTSH-së, ku kërkon shqyrtimin dhe realizimin e projektit filmik me titull “Luanët drejt Venecias”.

Me shkresën nr. 2230 prot. datë 23.07.2020 bordi i administrimit vendosi që të japë pëlqimin mbi kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë “E. P.” sh.p.k me RTSH për realizimin e projektit filmik “Luanët drejt Venecias” përkundrejt vlerës prej 3,000,000 lekë.

Këshillon drejtorin e përgjithshëm të RTSH-së të ndjekë procedurat e mëtejshme ligjore për miratimin e projektit në Këshillin drejtues të RTSH-së.

Ne vijimësi të vendimit të bordit të administrimit, Me shkresën me nr. 2508 datë 31.08.2020 drejtori i përgjithshëm dërgon për shqyrtim dhe miratim projektin filmim me titull “Luanët drejt Venecias”

Me shkresën nr.2518 prot, datë 31.08.2020 Këshilli Drejtues me vendimin me nr. 24, vendosi të miratojë kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë tregtare “E. P.”sh.p.k me RTSH-në për realizimin e filmit kinematografik me metrazh të gjatë me titull “Luanët drejt Venecias”

Me datën 09.09.2020 është nënshkruar kontrata me nr. 2588 prot, ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Th. G. dhe shoqërisë “E. P.” e përfaqësuar nga administratori J. J..

Neni 4 i kontratës përcakton se :

“Buxheti i përgjithshëm i bashkëprodhimit është në shumën me vlerë 31,085,000, ku RTSH do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerën 3,000,000 lekë dhe shoqëria do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerë 28,085,000 lekë.

“Fondi financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit do të lëvrohet në llogarinë bankare të shoqërisë sipas mënyrës vijuese :

(i)80% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

(ii)20% e vlerës së fondit financiar do të lëvrohet pas dorëzimit në RTSH a)te dokumentacionit justifikues për shpenzimet sipas zërave të preventivit financiar të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit të filmit, që RTSH merr përsipër. b)të lëndës së filmit në përputhje me parametrat teknike të përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 7 të kësaj kontrate.

Pjesa e mbetur e fondit financiar sipas pikës (ii) të këtij paragrafi do të paguhet vetëm pas bërjes së relacionit nga specialisti ekonomist në sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave.

Sipas faturës është likuiduar shoqëria “E. P.”me datën 05.10.2020 për vlerën 2,400,000 lekë, pra 80% e vlerës së kontratës.

Neni 5, pika 4 a e kontratës parashikon se: “...Te ardhurat që Shoqëria përfiton nga shfrytëzimi i të drejtave ekskluzive të përcaktuara në këtë paragraf do të ndahen midis RTSH-së dhe shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në bashkëprodhimin e filmit. Shoqëria do të njohëRTSH-në çdo 3 muaj me të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimeve të të drejtave ekskluzive të përcaktuar në këtë paragraf dhe do ti paguaje RTSH-së pjesën takuese jo më vonë se 7 dite pune nga data që RTSH ka pranuar se ka marrë prej shoqërisë informacionin me të ardhurat që shoqëria ka përfituar”.

Sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, kjo në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5,pika.

Neni 7 pika 2 e kontratës parashikon se : “Shoqëria deklaron dhe garanton se menjëherë me përfundimin e filmit, do të dorëzojë në RTSH kopjen e parë standarde të filmit. Filmi konsiderohet i përfunduar, kur kopja e parë standarde, ku është materializuar versioni përfundimtar i filmit, është realizuar. Shoqëria deklaron dhe “Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH-në se kopja e parë standarde e filmit do të realizohet jo më vonë se data 30 tetor 2020 dhe do të dorëzohet në RTSH jo më vonë se data 05.11.2020. Në rast mosrespektimi të afatit të përcaktuar në këtë paragraf nga ana e shoqërisë, shoqëria detyrohet t'i kthejë RTSH-së çdo shumë në lekë që RTSH ka paguar në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të

dëmshpërbleje RTSH-në ne vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara. Shoqëria është e detyruar që të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit”.

Sipas dokumentacionit të vënë ne dispozicion nga drejtoria e arkiva dhe sektori i transcoding Shoqëria “E. P.” nuk ka dorëzuar fare lëndën për bashkëprodhimin filmik “Luanët drejt Venecias”

Shoqëria “E. P.” ka shfrytëzuar 80% të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Luanët drejt Venecias” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 4 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Shoqëria “E. P.” me përfaqësues është përgjegjëse për dëmin ekonomik ne vlerën 2,400,000 lekë të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.

Vlera 2,400,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së dhe duhet të dëmshpërblehet në zbatim të nenit 640, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

9. Titulli i gjetjes:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2588 prot. datë 09.09.2020, për vlerën 2,400,000 lekë “E.P.”
Situata:	Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2588 prot., datë 09.09.2020, për vlerën 2,400,000 lekë , ku vlera totale e kontratës ka qenë 3,000,000 lekë nënshkruar me shoqërinë “E. P.”, për bashkëprodhimin filmik “Luanët drejt Venecias”. Shoqëria “E. P.” ka shfrytëzuar 80 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Luanët drejt Venecias” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 4 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale duke mos dorëzuar lëndën objekt i kontratës . Shoqëria “E. P.” është përgjegjëse për dëmin ekonomik në vlerën 2,400,000 lekë të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.
Kriteri:	-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore). -Kontrata e bashkëprodhimit nr.2588 prot. datë 09.09.2020.
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik dhe fitime të munguara
Shkaku	Mos përmbushja e detyrimeve të “Rregullores” për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të projekteve artistike dhe filmike gjatë gjithë periudhës së prodhimit ose bashkëprodhimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Të kërkohet në rrugë ligjore ,duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin i vlerës 2,400,000 lekë nga shoqëria “E. P.”. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1297 prot. datë 27.04.2020, ndërmjet RTSH-se dhe shoqërisë, “E. P.”.

Auditimi i dosjes “Sahatcia” bashkëprodhim, në vlerën 8,400,000 lekë

Me shkresën nr. 27 prot. Datë 30.09.2021 nga shoqëria “B. G. P.” është paraqitur kërkesa për bashkëprodhimin e filmit kinematografik me metrazh të mesëm me titullin “Sahatcia”.

Me shkresën nr. 3285 datë 30.09.2021 bordi artistik ka vendosur miratimin nga pikëpamja artistike të projektit filmik “Sahatcia”.

Me shkresën me nr. 3463 datë 13.10.2021 bordi administrimit ka miratuar kërkesën për bashkëprodhim të shoqërisë “B. G. P.” përkundrejt vlerës 8,400,000 lekë.

Me shkresën nr. 3916.prot datë 09.11.2021 këshilli drejtues vendosi të miratojë zërat e preventivit për realizimin e filmit.

Me dt 24.03.2022 u nënshkrua kontrata me nr 1176 prot. e bashkëpunimit ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm E. J., dhe shoqërisë B. G. P. përfaqësuar nga B. B..

Sipas faturave të vena në dispozicion shoqëria B. G. P. u financua nga RTSH në vlerën 7,560,000 lekë, Për pjesën e mbetur të vlerës se miratuar për financim nuk ka as dokumentacion as fature.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion vërehet se RTSH nuk ka patur asnjë përfitim monetar nga realizimi i këtij projekti filmik, ku sipas kontratës, neni 5 RTSH citohet se “RTSH përfiton të gjitha të ardhurat që krijohen nga shfrytëzimi i të drejtës ekskluzive”

Neni 4 i kontratës përcakton se :

“Ne buxhetin i përgjithshëm i bashkëprodhimit RTSH do të marrë pjesë me fondin financiar me shumën me vlerën 8,400,000 lekë dhe shoqëria.

“Fondi financiar me të cilin RTSH merr pjesë në bashkëprodhimin e filmit do të lëvrohet në llogarinë bankare të shoqërisë sipas mënyrës vijuese :

(i)40% e vlerës se fondit financiar do të lëvrohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

(ii)50% e vlerës se fondit financiar do të lëvrohet pas dorëzimit në RTSH të dokumentacionit justifikues për shpenzimet sipas zërave të preventivit financiar të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit të filmit, që RTSH merr përsipër. b)të lëndës së filmit në përputhje me parametrat teknike të përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 7 të kësaj kontrate.

(iii)10% Pjesa e mbetur e fondit financiar sipas pikës (ii) të këtij paragrafi do të paguhet vetëm pas bërjes se relacionit nga specialisti ekonomist në sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave.

Sipas faturës është likuiduar shoqëria “B. G. P.” për vlerën 7,560,000 lekë, pra 90% e vlerës se kontratës.

Neni 5, pika 4 a e kontratës parashikon se: “....Të ardhurat që Shoqëria përfiton nga shfrytëzimi i të drejtave ekskluzive të përcaktuara në këtë paragraf do të ndahen midis RTSH-së dhe shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në bashkëprodhimin e filmit. Shoqëria do të njohë RTSH-në çdo 3 muaj me të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimeve të të drejtave ekskluzive të përcaktuar në këtë paragraf dhe do të paguajë RTSH-së pjesën takuese jo më vonë se 7 ditë pune nga data që RTSH ka pranuar se ka marrë prej shoqërisë informacionin me të ardhurat që shoqëria ka përfituar”.

Sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, kjo në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5, pika 6.

Shoqëria “B. G. P.” ka shfrytëzuar 90% të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Sahatcia” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5,pika 4 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Shoqëria” B. G. P.” është përgjegjëse për fitimet e munguara të RTSH-së.

Neni 7 pika 2 e kontratës parashikon se : “Shoqëria deklaron dhe garanton se menjëherë me përfundimin e filmit, do të dorëzojë në RTSH kopjen e pare standarde të filmit. Filmi konsiderohet i përfunduar, kur kopja e pare standarde, ku është materializuar versioni përfundimtar i filmit, është realizuar. Shoqëria deklaron dhe garanton RTSH-në se kopja e para standarde e filmit do të realizohet jo më vonë se data 30 tetor 2020 dhe do të dorëzohet në RTSH

jo me vone se data 05.11.2020. Në rast mosrespektimi të afatit të përcaktuar ne këtë paragraf nga ana e shoqërisë, shoqëria detyrohet t'i ktheje RTSH-së çdo shumë në lekë që RTSH ka paguar në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH-në në vlerën e dëmit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara. Shoqëria është e detyruar që të njoftojë RTSH-në për përfundimin e filmit”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtorja e arkiva dhe sektori i transcoding Shoqëria “B. G. P.” ka dorëzuar në kohë lëndën për bashkëprodhimin filmik “Sahatcia” por nuk është bërë relacioni nga specialisti ekonomist në sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave.

Titulli gjetjes:	i Shoqëria “B. G. P.” nuk ka raportuar sipas përcaktimeve të kontratës, për të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimeve të të drejtave ekskluzive të bashkëprodhimit filmik “Sahatcia”.
Situata:	Shoqëria “B. G. P.” nuk ka raportuar sipas përcaktimeve të kontratës, për të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimit të të drejtave ekskluzive të bashkëprodhimit filmik “Sahatcia”. Nga ana RTSH-së nuk është kryer monitorimi i zbatimit të kontratës në kundërshtim me rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” për kontratën nr. 1176 datë 24.03.2022 ndërmjet shoqërisë “B. G. P.” dhe RTSH-së që është nënshkruar për vlerën 8,400,000 lekë. Sipas faturave të vëna në dispozicion shoqëria “B. G. P.” u likuidua nga RTSH në vlerën 7,560,000 lekë pra 90% të vlerës së kontratës,, ndërsa për pjesën e mbetur të vlerës së miratuar për financim që nuk iu likuidua shoqërisë nuk është bërë relacioni nga specialisti ekonomist në sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave sipas përcaktimeve të kontratës, neni 4. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, kjo në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5, pika 6. Sipas të dhënave vërehet se RTSH nuk ka patur asnjë përfitim monetar nga realizimi i këtij projekti filmik, ku sipas kontratës së bashkëpunimit, neni 5 citohet se “RTSH përfiton të gjitha të ardhurat që krijohen nga shfrytëzimi i të drejtës ekskluzive”, kjo në kundërshtim me rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”. -Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1176 prot., datë 24.03.2022 nënshkruar ndërmjet RTSH-së dhe shoqërisë “B. G. P.”
Kriteri:	-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”. -Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1176 prot. datë 24.03.2022.
Ndikimi:	Risk për Fitime të munguara
Shkaku	Mos vëmendja e duhur institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- RTSH të marrë masa për eliminimin e veprimeve dhe mosveprimeve të strukturave gjatë hartimit dhe zbatimit të projekteve artistike dhe filmike për të shmangur keqpërdorimin e fondeve publike, duke përcaktuar personat përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e kontratave. -Strukturat aktuale në RTSH, Drejtori, të marrin masa për vlerësim të situatës, të kërkojnë nga ana e shoqërisë “B. G. P.” për raportim të të ardhurve të

	realizuara nga bashkëprodhimi filmik “Sahtacia” dhe në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të kërkohet arkëtim i vlerës sipas përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit nr. 1176 datë 24.03.2022 për të ardhurat që RTSH duhet të përfitonte nga shfrytëzimi i të drejtës ekskluzive.
--	--

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi ish drejtori i përgjithshëm E. J., drejtori i drejtorisë së projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë M. H., përgjegjësi i sektorit të projekteve A. H..

Konkluzion

-Përsa i përket realizimit të bashkëprodhimeve për projekte filmike, janë keqpërdorur fondet e vëna në dispozicion.

-Pothuajse të gjitha kontratat e nënshkruara për bashkëprodhimet filmike janë realizuar në masën 80%,për pjesën tjetër të fondit(20)shoqëritë nuk janë likuiduar sepse nuk kanë paraqitur dokumentacionin justifikues.

-Në të gjitha kontratat e nënshkruara me RTSH-në, të auditura nga grupi i auditimit, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, shoqëritë që kanë fituar të drejtën e bashkëprodhimit, nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktuale sipas kontratave përkatëse, duke mos dorëzuar në kohe lenden sipas kontratës,duke mos raportuar mbi të ardhurat e realizuara nga administrimi i të drejtave për bashkëprodhimet, për mos ndarjen e fitimeve me RTSH, sipas përcaktimeve të kontratave përkatëse, apo duke mos dorëzuar fare lëndën sipas detyrimeve ligjore të kontratës.

- RTSH nuk ka ndjekur realizimin e projekteve sipas përcaktimeve të rregullores “Për miratimin dhe zbatimin e projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”, neni 9 i rregullores.

-Shoqëritë e mëposhtme sipas përcaktimeve të kontratës duhet të dëmshpërblejnë RSTH-në siç është përshkruar në këtë akt-konstatim dhe sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 640, 419, 420, 476, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur “...Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësive juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerim e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar”.

Shoqëria “S. N. vlerën 2,890,000 lekë

Shoqëria “A. F. P.” vlerën 2,400,000 lekë

Shoqëria “P. F. P.” vlerën 3,000,000 lekë

Shoqëria “E. P.”vlerën 2,400,000 lekë

Auditimi i dosjes “Blerje e të drejtave ekskluzive të transmetimit audioviziv(audioviziv) të filmave artistike kinematografik dhe serialeve televizive në vlerën 112,010 euro.

Në sektorin e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë nuk ekzistonte asnjë dosje me dokumentacionin përkatës sipas rregullores për këtë procedurë dhe sipas komunikimeve dosja kishte qënë në zyrën e ish drejtorit të drejtorisë së projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë M. H.. Nga grupi i auditimit u kërkua që të lajmërohej ish drejtori. Sipas raportimeve stafi nuk arrin ta kontaktojë, numri i telefonit deli i padisponueshëm.

Grupi i auditimit mori në shqyrtim dokumentacionin që gjendej në zyrat e protokollit. Sipas dokumentacioni që na u vu në dispozicion konstatohet që :

Me shkresën me nr.29 prot datë 17.10.2022, administruar pranë RTSH-së me nr.3868 datë 17.10.2022, shoqëria “I.” ka paraqitur pranë RTSH-së ofertën për blerje e të drejtave ekskluzive të transmetimit audioviziv (televiziv) të filmave artistikë kinematografike dhe serialeve televizive.

Me shkresën me nr. 3083 datë 17.08.2022 drejtuesja e njësisë së programeve M. Q. i drejtohet drejtorit të përgjithshëm ku kërkon vlerësimin e njësisë së programeve për blerje filmash dhe seriale televizive.

Me shkresën nr. 20.09.2022 drejtori i marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve M. H., kërkon autorizim për të kryer veprimet e përkthimit të shoqërisë I. L..

Me shkresën me nr.3868 prot. datë 21.11.2022 drejtuesja e njësisë së programeve ka paraqitur pranë drejtorisë një relacion mbi paketën e filmave dhe serialeve ku shprehet se pas negociemeve ka arritur të ulë vlerën e ofertës fillestarë nga 148.200 euro në 107.500 euro.

Me vendimin me nr 3868/9 datë 18.11.2022 bordi artistik ka vendosur të miratojë nga pikëpamja artistike blerjen e të drejtave dhe të serialeve televizive, pa specifikuar shoqërinë nga e cila do të blihen.

Me shkresën me nr 3868/12 datë 22.11.2022 drejtori i përgjithshëm vendosi të miratojë blerjen prej shoqërisë “I.”, me seli ne adresën U. 117, O. M., P. S., P.O. B. V., M., Republic of Seychelles, në shumën 112,010 euro, të të drejtave ekskluzive të transmetimit audioviziv të filmave artistik kinematografik dhe të serialeve televizivë.

Me datë 30.11.2022 u nënshkrua kontrata me nr 3868/13 prot. ndërmjet RTSH-së e përfaqësua nga drejtori i përgjithshëm E. J., si dhe shoqërisë tregtare “I.” përfaqësuar nga drejtori A. P..

Sipas nenit 8 të kontratës:pika 1“RTSH për blerjen e të drejtave ekskluzive të transmetimit audioviz(televiziv) të filmave artistike dhe serialeve televizive do ti paguaje I., vlerën 112.010 euro.

2.Shuma e përgjithshme e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, do ti paguhet shoqërisë kundrej faturës në rrugë bankare,e ndare në dy këste me vlera të barabarta, si vijon:

-56,005 euro jo me vone se data 31.12.2022

-56,005 euro jo me vone se data 31.12.2023

Sipas formularit të urdhër transfertes të firmosur nga drejtori i përgjithshëm E. J. dhe drejtori idrejtorise ekonomike E. D., shoqëria I., është likuiduar sipas faturës nr 0635 datë 07.12.2022 për shumën në vlerën 56,005 euro.

Sipas certifikatës së përcaktimit të detyrës të panoteriazuar, konfirmohet që kompania I., prej datës 15 nëntor 2021

-është në gjendje të shëndoshë ligjore sipas ligjeve të Seishell

-drejtori aktual i kompanisë është A. P..

-Aksioneri kryesor është A. P..

-për sa mund të përcaktohet nga dokumentet e përfituara nga zyra e regjistrimit të kompanisë kapital i autorizuar është 100.000\$.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë Procedurë konstatohet mungesë e dokumentacioni sipas rregullores së projekteve filmike dhe artistike Vendim i Këshillit drejtues nr. 10, datë 26.03.2018, neni 10,12.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion për blerjen e të drejtave nga shoqëria I., është i pavlefshëm sipas Ligjit Nr. 110/2018 për noterinë neni 62, 99, 100,129 ku citohet që:

Neni 62 “Kompetencat e noterit”,pika dh)harton akte noteriale, projekte për veprime të tjera juridike e dokumente, jep kopje dokumentesh ose shkurtime të tyre”pika i; vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara;pika j)bën ose vërteton përkthime nga një gjuhë në një tjetër, vetë ose nëpërmjet një përkthyesi të licencuar, të pranuar nga palët ose kërkuesi;ll) harton akte noteriale, prokura, kontrata, marrëveshje, deklarata e dokumente të tjera të kërkuar nga personat e interesuar, si dhe akte e veprime të tjera, që sipas ligjit janë në kompetencën lëndore të noterit;

Neni 99

HARTIMI I AKTEVE NOTERIALE

Mënyra e hartimit të akteve noteriale

1. Aktet noteriale hartohen në bazë të vullnetit të lirë, të plotë dhe të pavesuar të palëve pjesëmarrëse në aktin noterial, si dhe referuar qëllimit që synon të rregullojë dhe/ose të sjellë aktin noterial. Aktet noteriale hartohen pastër, qartë dhe në mënyrë që të mos lënë vend për moskuptime ose keqinterpretime.

2. Aktet noteriale që kanë për objekt përfaqësimin nëpërmjet prokurës, pavarësisht tagrave të përfaqësimit, duhet të specifikojnë në mënyrë të posaçme: datën e lëshimit të prokurës, objektin e saj, rrethanat juridike të përfaqësimit, vlefshmërinë e saj, afatin, si dhe rastet kur mund të mbarojë prokura, si dhe çdo element tjetër të parashikuar në Kodin Civil.

Neni 100

Gjuha e hartimit të akteve noteriale

1. Në hartimin e akteve dhe në veprimtarinë noteriale përdoret gjuha shqipe.

2. Kur i interesuari, njëra ose të dyja palët, nuk dinë gjuhën shqipe, noteri, kryesisht, nëse pranohet prej palëve, ose nëpërmjet një përkthyesi që pranohet prej tij dhe palëve, përkthen të gjithë përmbajtjen e aktit, ku shënohet edhe deklarimi i palës ose palëve se e kanë kuptuar dhe pranuar përmbajtjen e tij. Në rastin kur akti noterial përkthehet kryesisht nga noteri i certifikuar dhe përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë, noteri përgjigjet personalisht për përkthimin e aktit.

Neni 129

Vërtetimi i njësisë me origjinalin

1. Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, të dokumenteve të publikuara, si dhe të çdo dokumenti tjetër, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre.

2. Noteri duhet të përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja ose shkurtimi, nëse është nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër e njësuar me origjinalin.

3. Kur dokumenti i paraqitur ka shënime, korrigjime, shtesa, fshirje ose shenja të tjera të veçanta, noteri bën njësimin dhe i pasqyron ato në vërtetim. Në vërtetim pasqyrohet edhe nëse dokumenti origjinal është grisur, dëmtuar apo në ndonjë formë tjetër duket i dyshimtë në pamjen e tij, përveç kur kjo duket qartë nga kopja e dokumentit origjinal.

4. Në rastin e kopjeve të shkurtuara, noteri sqaron nëse pjesët e hequra kanë ndonjë lidhje për pjesët e paraqitura të aktit.

5. Në rastin kur dokumenti është në gjuhë të huaj noteri bën vërtetimin e njësisë me origjinalin, duke kërkuar ndihmën e një përkthyesi, ose duke e bërë vetë kryesisht, sipas parashikimeve të nenit 100 të këtij ligji.

Gjendur ne këto, kur nuk ka dokumentacion të vlefshëm për nënshkrimin e kontratës(marrëveshjes), vlera 56,005 euro likuiduar shoqërisë I., përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe buxhetin e RTSH-së.

Audtimi i dosjes “Blerja e të drejtave nga shoqëria “A. I.” për emisionin “You should know” për vlerën 24,000 euro.

“Ti duhet ta dish” një quiz show televiziv në llojin e spektaklit televiziv, me karakter edukues dhe argëtues, patentuar nga Armoza Formats dhe prodhim ekskluziv i RTSH-së, për periudhën kohore 7 janar 2023-1 korrik 2023, me kohëzgjatje 70-80 minuta për një emision televiziv. Lloji i transmetimit të emisioneve televizive është me regjistrim audioviziv, emisionet televizive transmetohen njëherë në javë, çdo ditë të shtunë, ora 21:00 deri në orën 22:20 në kanalin televiziv “RTSH” të platformës transmetuese të RTSH-së.

U konstatua që marrëveshje ndërmjet drejtorit të përgjithshëm E. J. dhe shoqërisë “A. I.” ,është nënshkruar pa miratimin e bordit artistik, kjo në kundërshtim me rregulloren e RTSH-së për miratimin dhe zbatimin e projekteve filmike.

2 muaji pasi është firmosur marrëveshja ka marrë miratimin nga bordi (ku duhet theksuar se anëtarët e bordit emërohen nga drejtori i përgjithshëm).

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, RTSH prodhoi emisionin në zbatim të kushteve të marrëveshjes dhe e nxori në transmetim.

Shoqëria A. I., u likujdua nga RTSH në vlerën 26400 euro, 24 mijë euro blerje e të drejtave e 2400 euro të ardhura të tjera për shoqërinë sipas marrëveshjes.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe intervistimeve RTSH nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur për realizimin e këtij projekti, ku në kontratën e marrëveshjes mes dy palëve janë përcaktuar qarte të drejtat e RTSH-së në lidhje me përfitimet dhe të ardhurat.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish drejtori i përgjithshëm E. J., anëtarët e bordit artistik, drejtori drejtorisë projekteve M. H..

11. Titulli i gjetjes:	Nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e të drejtave me shoqërinë “A. I.”, në kundërshtim me rregulloren për “Miratimin dhe zbatimin e projekteve”
Situata:	Nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e të drejtave me shoqërinë “A. I.”, në kundërshtim me “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”. Nga auditimi i marrëveshjes “Për blerjen e të drejtave” me shoqërinë “A. I.” ,është konstatuar se, nënshkrimi i saj nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH nuk ka marrë paraprakisht miratimin e Bordit artistik, si dhe veprimet nga sektori i projekteve janë kryer pas nënshkrimit të marrëveshjes, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me rregulloren “Mbi miratimin dhe e zbatimin e projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion RTSH nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur për realizimin e këtij projekti, kur në kontratën e marrëveshjes mes dy palëve janë përcaktuar qartë të drejtat e RTSH-së në lidhje me përfitimet dhe të ardhurat”.
Kriteri:	“Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”. Kontrata e marrëveshjes se blerjes se të drejtave e me dt të hyrjes në fuqi të kontrates 30 qershor 2022, protokolluar me dt 25.08.2022, pas vendimit të bordit artistik.
Ndikimi:	Mungesë performance institucionale dhe financiare në menaxhimin e shpenzimeve publike.
Shkaku	Mos vëmendja e duhur institucionale
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Të merren masa nga Titullarët e RTSH-së, që në të ardhmen të mos nënshkruhen kontrata për projektet artistike/filmike që bien në kundërshtim me rregulloren dhe çënojnë procesin.

12. Titulli i gjetjes:	Nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e të drejtave me shoqërinë “I., pa dokumentacion të vlefshëm.
Situata:	Nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e të drejtave me shoqërinë “I., pa

	<p>dokumentacion të vlefshëm. Më datë 30.11.2022 është nënshkruar kontrata me nr. 3868/13 prot., ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm E. J., si dhe shoqërisë tregtare “I.”, përfaqësuar nga drejtori A. P., me seli në adresën UNIT 117, Orion Mall, Palm Sdotreet, P.O. Box 828.Vitoria, Mahe, Republic of Seychelles, në shumën 112,010 euro, për blerjen e të drejtave ekskluzive të transmetimit audioviziv të filmave artistik kinematografik dhe të serialëve televizivë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë Procedurë konstatohet dokumentacion i pavlefshëm i paraqitur nga shoqëria I., Ltd ne kudnershtim me rregulloren e projekteve filmike dhe artistike Vendim i Këshillit drejtues nr. 10, datë 26.03.2018, neni 10, 12 . Dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit auditues për kryerjen e procedurës për blerjen e të drejtave nga shoqëria I., është i pavlefshëm sipas Ligjit Nr. 110/2018 për noterinë neni 62 ,99, 100, 129. Gjendur në këto kushte, kur nuk ka dokumentacion të vlefshëm për nënshkrimin e kontratës (dokumentacion të vënë në dispozicion të grupit auditues), vlera 56,005 euro likuiduar shoqërisë I., përbën dëm ekonomik për buxhetin shtetit dhe RTSH-së.</p>
Kriteri:	<p>-Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore). -Kontrata e bashkëprodhimit nr.3868/13 prot.30.11.2022 -Ligji Nr. 110/2018 për noterinë neni 62, 99, 100,129.</p>
Ndikimi:	Keq menaxhim të parave publike me pasojë dëm ekonomik
Shkaku	Mos vëmendje e duhur institucionale
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha të procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin i vlerës 56,005 euro, përfituar padrejtësisht nga shoqëria I.. Deri më 31.10.2024</p>

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish drejtori i përgjithshëm E. J., anëtarët e bordit artistik, drejtori drejtorisë projekteve M. H..

1. Titulli i gjetjes:	Mos përcaktimi i një Procedurë të qartë për dorëzimin e lëndës nga palët e kontraktuara dhe pranimit nga RTSH, për projektet artistike dhe filmike.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që në asnjërën nga rregulloret e miratuara për projektet filmike dhe artistike nuk është përcaktuar qartë se si do të bëhet dorëzimi i lëndës për bashkëprodhimet filmike dhe prodhimet e porositura pjesë e projekteve artistike dhe filmike.
Kriteri:	“Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore).
Ndikimi:	Parregullsi dhe mungesa në dokumentacionin shoqëruar në procedurën e paraqitjes së projektit.
Shkaku	Mungesa e përcaktimit të kriterëve në “Rregullore” për procedurën e dorëzimit të lëndës nga palët e kontraktuara dhe pranimit nga RTSH, për bashkëprodhimet dhe prodhimet e porositura nga njësitë zbatuese
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	RTSH të marrë masa për përmirësimin e “Rregullores”, duke përcaktuar procedurën për dorëzimin e lëndës në RTSH nga palët e kontraktuara për

	bashkëprodhimet dhe prodhimet e porositura, pjesë e projekteve filmike dhe artistike.
--	---

11. Titulli i gjetjes:	RTSH për të gjitha projektet artistike dhe filmike nuk ka marrë masat e nevojshme për ndjekje dhe realizimin e kontratave të projekteve sipas përcaktimeve të rregullores të miratuar nga Këshilli Drejtues
Situata:	Për të gjitha projektet artistike dhe filmike RTSH nuk ka marrë masat e nevojshme për ndjekje dhe realizimin e kontratave të projekteve sipas përcaktimeve të rregullores Në të gjitha kontratat e nënshkruara me RTSH dhe të auditura nga grupi i auditimit, sipas dokumentacionit të venë në dispozicion ka problematika në lidhje me administrimin e dokumentacionit dhe dorëzimin e lëndës objekt i kontratave.
Kriteri:	“Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore). -Kontratat e nënshkruara ndërmjet RTSH-së dhe shoqërive të ndryshme për projektet filmike dhe artistike (te sipërcituara)
Ndikimi:	Mungesë performance institucionale
Shkaku	Neglizhencë nga strukturat përgjegjëse
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Strukturat përkatëse të ngarkuara me zbatimin e projekteve të marrin masa për dokumentimin e plotësimin të kriterëve për personelin që aktivizohet në realizimin e projekteve, si dhe respektimin rigoroz të zbatimit të kontratave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish drejtori i përgjithshëm Th. G., ish drejtori i përgjithshëm E. J., drejtori drejtorisë projekteve M. H..

Projektit artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022.

Me vendim nr. 25, datë 01.12.2022 Bordi i administrimit ka vendosur të jap pëlqimin mbi preventivin për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH” përkundrejt vlerës financiare 47,323,800 lekë.

Me shkresën nr. 4446/3 prot., datë 02.12.2022 E. J., me detyrë drejtor i përgjithshëm i dërgon Këshillit drejtues për shqyrtim dhe miratim projektin artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH” përkundrejt vlerës financiare 47,323,800 lekë.

Me vendim nr. 32, datë 07.12.2022 Këshilli drejtues ka vendosur miratimin e preventivit për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH” përkundrejt vlerës financiare 47,323,800 lekë.

Me urdhër nr. 32, datë 2.04.2022 të drejtorit të përgjithshëm E. J., është emëruar R. N., drejtor i Festivalit 61 të këngës në RTSH.

Me autorizim nr. 1465/3 prot., datë 14.10.2022 drejtori i përgjithshëm E. J., ka autorizuar R. N., në cilësinë e drejtuesit të festivalit të nënshkruaj kontratat me autorët e festivalit, me personat fizik dhe juridik për llogari të festivalit.

Me shkresën nr. 1465/27 prot., datë 17.11.2022 E. J., i dërgon Bordit artistik projektin “Festivali i 61 i këngës në RTSH”. Bordi artistik me përbërje: O. A., L. V., S. G., J. P., D. D..

Bordi artistik me vendim nr. 1465/34 prot., 18.11.2022 ka miratuar nga pikëpamja artistike. Me e-mailin e fundit datë 30.11.2022 R. N., në cilësinë e drejtorit të festivalit i dërgon K. M., preventivin e festivalit të 61 të këngës.

Në këtë preventiv është vendosur dhe vlera 300,000 lekë për drejtorin e festivalit. Pra drejtori artistik i emëruar me nr. 32, datë 2.04.2022 të drejtorit të përgjithshëm E. J., ka vendosur të marrë 300,000 lekë si drejtues festivali, edhe pse është zv/titullari i RTSH. Vlerë të cilën nuk e miratoi Këshilli drejtues me vendim nr. 32, datë 07.12.2022.

Preventivi është i pa argumentuar për të gjitha zërat e tij, si në ana sasiore po ashtu dhe për çmimet e vendosura për çdo zë, çmime të cilat nuk janë në librin tarifor të miratuar me vendim të Këshilli drejtues nr. 38, datë 01.07.2004. Nuk ka procedurë të përcaktimit të çmimeve për asnjë zë të preventivit, si është bërë përzgjedhja e personave dhe e subjekteve tregtare. Nuk ka të ardhura të planifikuara, nga biletat, reklamat, sponsorizimet, nuk ka situacion të shpenzimeve sa ka kushtuar festivali i këngës 61, nuk ka situacion të të ardhurave etj.

Për këtë festival RTSH, ka shpenzuar për punonjësit e saj, mbi pagesën mujore të tyre, vlerën **3,153,001 lekë**.

Me vendim të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004, për miratimin e sistemit tarifor të shërbimeve që ofron RTSH, në pikën 1 është përcaktuar: Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti. Pra nuk do të merrej paga për punën e përditshme referuar kontratës së punës. Baza ligjore e këtij vendimi të këshillit drejtues: Ligji Nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radio televizionin publik dhe privat në RTSH, VKM nr. 440, datë 01.06.2000 “Për miratimin e statutit të RTSH” Neni 54 Neni 99/8.

Me vendim të këshillit drejtues nr. 85, datë 21.12.2007, është vendosur ç fuqizimi i paragrafit të par të pikës 1 “Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti., të vendimit nr. 38, datë 01.07.2004. Pra punonjësit do të marrin pagën sipas kontratës së punës dhe pagën e përfutur nga projektet(do të marrin dy paga)

Referuar sa më sipër në RTSH për projektin artistik “Festivali i 61 i këngës është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, por tashmë të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas Kontratave individuale të punës.

Duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115.

Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës, parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimi i drejtësisë dhe i paanshmërisë, parimi i objektivitetit dhe parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të përcaktuara KREU II “Parime të përgjithshme”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.

Standarti i dyfishi arrin deri atje, sa:

1. Në kontraktimin e personave të jashtëm përzgjedhja është bërë e tillë sa për një familje me emrat AO dhe EG janë kontraktuar për 5 pozicione; drejtor artistik; Autor skenari; prezantues dhe anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngës, me vlerë të kontraktuar 1,915,000 lekë.

2. Në mjetet me qira pika 4 zëri Regji HD me qira, që në fakt është studio lëvizëse, Marrje me qira Studio televizive lëvizëse transmetuese OB Van Broadcast –Regjia HD, likuiduar Urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2023 nëpërmjet R. B. është likuiduar shoqëria “N. P.,” shpk në vlerën 2,400,000 lekë”, edhe pse në organikën e RTSH dy mjete televizivë të llojit “Studio televizive lëvizëse transmetuese me vlerë kontabël 93,180,371 lekë. Trajtuar më gjerësisht në aktkonsatimin nr. 9, datë 31.10.2023.

3.Për Festivalin i 61 i këngës në RTSH” nuk ka situacion përfundimtar të shpenzimeve dhe të të ardhurave.

Me vendim nr. 51, datë 15.12.2021 Këshilli drejtues ka vendosur miratimin e preventivit për realizimin e projektit artistik “Festivali i 60 i këngës në RTSH” përkundrejt vlerës financiare 42,989,960 lekë.

Urdhër transfertë pa nr, datë 13.01.2023 nëpërmjet R. B. është likuiduar A. O shpk në vlerën 1,627,750 lekë për projektin artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”. Dokument vërtetues: Kontrata nr. 563/140 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e drejtorit artistik për vlerën 700,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e z/drejtorit të RTSH dhe A.O..

Kontrata nr. 563/168 prot., datë 19.12.2022 në cilësinë e skenaristit “Autor skenari” për vlerën 200,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zh/drejtorit të RTSH dhe A.O..

Kontrata nr. 563/143 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e prezantuesit për vlerën 1,000,000 lekë, me afat nga datë e nënshkrimit deri në përfundimit e festivalit, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zh/drejtorit të RTSH dhe A.O..

Kontrata nr. 542/7 prot., datë 09.12.2022 në cilësinë anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngëve për vlerën 15,000 lekë, me afat nga datë e nënshkrimit deri në përfundimit e festivalit, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të RTSH dhe A.O..

Shuma totale 1,915,000 lekë për; drejtor artistik; Autor skenari; prezantues dhe anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngës.

E. G., është likuiduar në vlerën 425,000 lekë. Për këtë është lidhur kontrata nr. 563/138 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e regjisorit për vlerën 500,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të RTSH dhe E. G..

Vlera e kontraktuar për një familje 2,415,000 lekë në 5 funksione: drejtor artistik; autor skenari; prezantues; anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngëve dhe regjisor.

Vlera 3,153,001 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe buxhetin e shteti dhe duhet të dëmshpërblehet referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.

Veprim në kundërshtim me:

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19.

-Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52.“

-Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b.

Për mos maksimizimi dhe efikasitet dhe efikasitet në përdorimin e fondeve publike, ngarkohet me përgjegjësi E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm, R. N., me detyrë ish-zv/drejtorit të përgjithshëm & drejtor i festivalit, M. H. Y., me detyrë ish-drejtor i marrëdhënieje me jashtë dhe projekteve, A. H., me detyrë ish-përgjegjësi sektorit të projekteve dhe administrimit të të drejtave dhe E. D., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Titulli i gjetjes Nr. 1	Keq administrim i fondeve të RTSH, për projektit artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022.
Situata:	<p>Me vendim nr. 25, datë 01.12.2022, Bordi i administrimit ka vendosur të jap pëlqimin mbi preventivin për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61” i këngës në RTSH përkundrejt vlerës financiare 47,323,800 lekë.</p> <p>Në këtë preventiv është vendosur dhe vlera 300,000 lekë për drejtorin artistik të festivalit. Drejtori artistik i emëruar me urdhër nr. 32, datë 2.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm E. J., ka vendosur të marrë 300,000 lekë si drejtues artistik i festivalit, edhe pse është zv/titullari i RTSH. Vlerë të cilën nuk është miratuar nga këshilli drejtues me vendim nr. 32, datë 07.12.2022.</p> <p>Preventivi është i pa argumentuar për të gjitha zërat e tij, si në ana sasiore po ashtu dhe për çmimet e vendosura për çdo zë, çmime të cilat nuk janë në librin tarifor të miratuar me vendim të Këshilli Drejtues nr. 38, datë 01.07.2004. Nuk ka procedurë të përcaktimit të çmimeve për asnjë zë të preventivit, si është bërë përzgjedhja e personave dhe e subjekteve tregtare. Nuk ka të ardhura të planifikuara nga biletat, reklamat, sponsorizimet, nuk ka situacion të shpenzimeve sa ka kushtuar “Festivali 61 i këngës”, nuk ka situacion të të ardhurave etj.</p> <p>Për këtë festival RTSH, ka shpenzuar për punonjësit e saj, mbi pagesën mujore të tyre, vlerën 3,153,001 lekë.</p> <p>Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur ç fuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimin e paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhet me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH”. Referuar sa më sipër në RTSH për projektin artistik “Festivali i 61 i këngës”, është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës, duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave me punonjësit e RTSH.</p> <p>Vlera 3,153,001 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77,78, 80,81 dhe 115.</p> <p>-Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 4,5,11,13,14 dhe 17.</p>
Ndikimi/Efekti:	Keq administrim i fondeve të RTSH
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Këshilli drejtues të rishqyrtohet vlera 3,153,001 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e punonjësve të RTSH për realizimin e projektit

	<p>artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022, mbi pagesën mujore të tyre në vlerën 3,153,001 lekë, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e RTSH. RTSH nuk duhet të miratonte këtë fond që në planin e biznesit të vitit 2022, pasi menaxhimi nuk ka përcaktuar qartë domosdoshmërinë e planifikimin e këtij fondi dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike etj. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.</p>
--	---

Titulli i gjetjes Nr. 2	Në projektin artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022, 5 funksione i përkasin dy personave nga një familje.
Situata:	<p>Në projektin artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022 pesë funksione i përkasin dy personave nga një familje: Konkretisht drejtor artistik; autor skenari; prezantues; anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngëve dhe regjisor.</p> <p>Me urdhër transfertë pa nr, datë 13.01.2023 nëpërmjet R. B., është likuiduar “A. O.” shpk në vlerën 1,627,750 lekë për projektin artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”. Dokument vërtetues: Kontrata nr. 563/140 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e drejtorit artistik për vlerën 700,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e z/drejtorit të RTSH dhe A. O..</p> <p>Kontrata nr. 563/168 prot., datë 19.12.2022 në cilësinë e skenaristit “Autor skenari” për vlerën 200,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të RTSH dhe A. O..</p> <p>Kontrata nr. 563/143 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e prezantuesit për vlerën 1,000,000 lekë, me afat nga datë e nënshkrimit deri në përfundimit e festivalit, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të RTSH dhe A. O..</p> <p>Kontrata nr. 542/7 prot., datë 09.12.2022 në cilësinë anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngëve për vlerën 15,000 lekë, me afat nga datë e nënshkrimit deri në përfundimit e festivalit, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zh/drejtorit të RTSH dhe A. O..</p> <p>Shuma totale 1,915,000 lekë për; drejtor artistik; Autor skenari; prezantues dhe anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngës.</p> <p>E. G., është likuiduar në vlerën 425,000 lekë. Për këtë është lidhur kontrata nr. 563/138 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e regjisorit për vlerën 50,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të RTSH dhe E. G..</p> <p>Vlera e kontraktuar për një familje është 2,415,000 lekë në pesë funksione: drejtor artistik; autor skenari; prezantues; anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngëve dhe regjisor.</p> <p>Nga RTSH nuk ka procedurë përzgjedhje për drejtorin artistik; autorin e skenarit; prezantuesit; anëtarët e komisionit të përzgjedhjes së këngëve dhe regjizorët.</p>
Kriteri:	Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

	Shqipërisë”, nenet 13,14 dhe 17.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mosmeritokraci
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të merren masa për të korigjuar këtë praktikë në shpenzimet për projektet artistike të këngës në RTSH, duke ngritur grupe pune për përzgjedhjen me kritere të mirë përcaktuara të të gjithë stafit të domosdoshëm për realizimin e festivalit .

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga E. J., me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike është paraqitur observacioni me nr. 32/4 prot., datë 29.01.2024 administruar në KLSH me nr. 564/34 prot., datë 30.01.2024 për Projekt Raportin e Auditimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Gjithashtu edhe në rekomandimin 8.1, pika b “Masa për shpërblim dëmi për pagesën e punonjësve të RTSH për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022, mbi pagesën mujore në vlerën 3,153,001 lekë, theksojmë se pagesat e honorarëve janë kryer referuar vendimeve të këshillit drejtues.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi nuk qëndron. Arsyetimi pse nuk qëndron është dhënë në aktkonstatimin nr. 10, datë 14.11.2023 dhe në projektraport.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.10 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhim dhe kontrollit.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, ka të bëjë me forcimin e performancës së shoqërisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në RTSH nuk ka funksionuar në nivelin e duhur. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është implementuar plotësisht dhe për pasojë nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë, duke mos bërë të mundur që drejtuesi të bëjë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Kjo argumentohet për sa më poshtë vijon:

-Nuk disponohet një procedurë e veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave;

-RTSH e ka zhvilluar veprimtarinë ekonomike dhe financiare në mungesë të planit të biznesit, pasi nuk është miratuar;

-Strategjia e Riskut e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut pavarësisht ndryshimeve të shpeshta në menaxhim dhe ndryshimeve në strukturë nuk është analizuar dhe përditësuar;

-Regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi;

- Nuk janë miratuar, hartuar dhe arkivuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogla, shpenzime për konsumin e karburantit, dhe operacione të tjera specifike;
- Dobësitë e identifikuar në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me realizimin e shpenzimeve jo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollit, pranimin me dokumentacion justifikues jo të plotë (si p.sh. zbatimi të kontratave);
- Ka dobësi në ushtrimin e kontrolleve para faktit dhe atyre mbas faktit;
- Motivimi në punë nuk është bërë sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës madje duke diskriminuar punonjësit në pagë;
- Strukturat pjesë e RTSH nuk kanë harta dhe manuale të proceseve të punës, mungojnë rregullat e qarta të lëvizjes së dokumentacionit justifikues.

1.1. Mjedisi i Kontrollit:

Meqenëse menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm i jep menaxhimit garanci të arsyeshme se misioni i njësisë do të përmbushet, menaxhimi duhet të ketë një qëndrim mbështetës ndaj kontrollit të brendshëm që përshkon të gjithë njësinë. Përgjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se në përgjithësi ka mangësi në kuptimin e kontrollit të brendshëm dhe rolit të secilit pozicion në këtë sistem dhe për këtë arsye nevojitet edukim i vazhdueshëm për të garantuar, se të gjithë punonjësit e kuptojnë sistemin e kontrollit të brendshëm dhe rolin që kanë në të. Për periudhën e marrë në shqyrtim vihet re se Institucioni nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikim të shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21 pika 1 dhe 3, si dhe Kapitulli II, “Monitorimi”, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. 3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësisë publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive. “Monitorimi”. Për të mbështetur monitorimin e rregullt, titullarët e njësisë duhet të ngrenë një sistem për raportimin e brendshëm të risqeve të identifikuar, sipas udhëzimeve të Koordinatorit të Riskut duke garantuar një raportim në afat, të shpeshtë (p.sh. çdo tremujor) dhe të detajuar.....”*

Politikat e burimeve njerëzore që lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore dhe që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm shfaqin dobësi. Marrëdhëniet e punës në këtë Institucion janë rregulluar me anë të Kodit të Punës si dhe kontratat individuale. Me ndryshimet strukturore miratuar me VKD nr. 9 datë 15.03.2022 *“Për miratimin e strukturës së RTSH”*, nuk janë reflektuar ndryshimet pasi:

- Nuk janë hartuar strukturat analitike (Situatë e cila ka ndikuar dhe në lëvizjet, largimet e punonjësve);
- Nuk janë harmonizuar dhe përditësuar detyrat e punonjësve, përshkrimet e punës sipas strukturës duke mos përcaktuar saktë përgjegjësitë dhe linjat e raportimit midis specialistëve përgjegjësve, drejtorit si dhe raporti me Drejtorin e Përgjithshëm.

Në mënyrën e funksionimit dhe organizimit, Institucioni ka një manual të vitit 2004 për shpalljet e vendeve vakante, procedurat, rekrutimin e stafit etj., i cili nuk ka gjetur zbatim në praktikë, si

dhe nuk është përditësuar bazuar ndryshimeve të Kodit të Punës, politikave dhe praktikave të reja të menaxhimit të burimeve njerëzore.

-Për periudhën objekt auditimi, vihet re që për punonjësit e RTSH janë zhvilluar pak trajnime për zhvillimin e kompetencave profesionale si dhe trajnimet mbi riskun janë shumë të pakta, në veçanti punonjësit e Drejtorisë së Financës nuk janë trajnuar mbi ligjshmërinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimet këto në mospërputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, *“3.1. Mjedisi i kontrollit, Trajnimi dhe ndërgjegjësimi: Trajnimi i përshtatshëm dhe ngritja e përgjegjshmërisë së menaxherëve dhe stafit në fushën e zbatimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, është çelësi i suksesit në këtë fushë. Aktivitetet e trajnimit duhet të përfshijnë sa më poshtë...”*.

Për sa i përket gjurmës së auditimit, mungon hartimi, miratimi dhe arkivimi të kësaj gjurmë, që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, neni 16 pikat 2 dhe 3 si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, *“2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmën e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. 3.2. Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme...”*

Për çdo vit është bërë edhe vlerësimi i performancës nga drejtuesit e njësive për funksionet e varësisë së tyre.

1.2. Menaxhimi i Riskut:

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizmin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Për periudhën e audituar nga data 01.01.2020 deri në datën 22.07.2022, u konstatua se menaxhimi nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe koordinatorit të riskut. Me Urdhrin e brendshëm nr. 86, datë 22.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm z. E. J., është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe koordinatorit të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura por që deri më sot nuk ka asnjë raportim nga ana e tij.

Referuar nenit 11 pika 2 të ligjit 10296 dhe manualit në zbatim të tij, si dhe referuar udhëzimit 16/2016 pika 3.2.3, duke qenë se nuk ka rregulla të qarta të proceseve të punës në formë të shkruar për çdo sistem, nuk ka të përcaktuar një procedurë për matjen e riskut mbi aktivitetin e

kryer, për rrjedhojë, nuk realizohet mënyra e identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit mbi ngjarjet që ndikojnë në punën e secilit dhe që rrezikojnë realizimin e objektivave. Gjatë vitit 2021 janë hartuar “Strategjia dhe regjistri i riskut 2021- 2023” e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Konstatohet se mbas kësaj periudhe pavarësisht ndryshimeve të shpeshta të menaxhimit dhe ndryshimit të strukturës në muajin Mars 2022, regjistrat nuk janë përditësuar. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 21 pika 2, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II pika 2.5.2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “2. Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. 2.5.2. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes...”.

Nenin 11 pikat 2 dhe 3, , ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, “2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrat të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. 3. Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar”.

Nga sa paraqitëm më lart mund të themi se vlerësimi dhe kontrolli i risqeve nuk është në nivelin e duhur, dhe mund të vënë në rrezik arritjen e objektivave që kanë të bëjnë me menaxhimin e riskut.

1.3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Nga auditimi mbi transaksionet financiare të kryera konstatohet se mungojnë procedura të shkruara në lidhje me procedurat dhe autoritetin për delegim, transferim dhe regjistrim të autorizimeve në raste të veçanta. Nga ana e Drejtorit Ekonomik ka munguar ndarja e detyrave në mënyrë të atillë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për vendimmarrje, zbatim, kontabilitet dhe kontroll në mospërputhje me ligjin 10296. Ka munguar sistemi i dy nënshkrimeve. Mungojnë rregulla për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe veprimtarive që lidhen me mbarëvajtjen e procesit para faktit, përpara përfundimit të të gjithë procesit. Shfaqen mangësi në mbajtjen e dokumentacioni justifikues ligjor, në shumë raste mungojnë kontratat, faturat për likuidim të transaksioneve. Ka kalime me vlera të konsiderueshme me arkë si paradhënie për dieta, hotele e bileta dhe nuk rezulton të jenë mbyllur paradhëniet me dokumentacion, totalisht në mospërputhje me Ligjin 10296 udhëzimin 30 pika 61, 62. Janë shfaqur dobësi në ushtrimin e kontrolleve përpara faktit dhe atyre mbas faktit si dhe janë realizuar veprime me efekt financiar pa një vendimmarrje të titullarit.

1.4. Komunikimi

Titullarët e njësisë publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet. Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare.

Me ndryshimet strukturore me vendim të KD nr. 9 datë 15.03.2022 ende në disa Drejtori/Njësi nuk janë miratuar rregulloret e reja, kriteret dhe përshkrimet e punës me anë të së cilët funksionojnë këto struktura. Sistemi aktual i komunikimit të shkruar hap pas hapi dhe në formë zinxhiri horizontal në të gjitha nivelet ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Nga ana tjetër vihet re që nuk ka një komunikim shkresor të rregullt me RTSH (Drejtorinë e Përgjithshme), dhe me QVA-të. Ekzistenca e komunikimit me adresë e-mail personal, ka qenë një mangësi në punë, pasi shkakton mos shpërndarje të informacionit dhe për pasojë dhe moszbatim. Mund të themi që aktualisht kjo procedurë është në proces.

Për shkak të mungesës së manualeve dhe proceseve të punës mungojnë akt rakordime midis sektorëve si dhe me palët e treta në lidhje me dorëzimin siç duhet të dokumentacionit në kohë dhe në formatet e parashikuara në udhëzim, mungon mbikëqyrja e herëpashershme e mbarëvajtjes së të gjithë procesit si dhe raportimi për tek Titullari është i përgjithshëm pa analizuar problematikat dhe kontrollet.

1.5. Monitorimi

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetëtorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm. Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

RTSH për periudhën objekt auditimi nuk ka hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave, deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Pra themi që sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe fushave të tij, funksionon pjesërisht dhe ka vend për përmirësime, duke hartuar metoda standarde, manuale të proceseve të punës, zbatim më rigorozitet të legjislacionit të përmendur, për një mbarëvajtje sa më efikase, dhe të realizojë objektivat e punës së saj.

1.6. Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm të RTSH

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka në përbërjen e saj strukturore një drejtues dhe dy specialistë auditues, të certifikuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, gjithashtu janë dhe pjesë e strukturës në varësi të ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm kryen analiza dhe raportime 3 mujore dhe 1 vjeçare për punën e kryer dhe i dërgon pranë Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe realizon raportime 1 vjeçare për MEF. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në bazë të nenit 14 të ligjit 114/2015, harton planin strategjik dhe vjetor dhe ndryshimet që mund të pësojnë planet vjetore dhe i dërgon për miratim në Këshillin Drejtues. Ky plan Vjetor së bashku me vetëvlerësimet dërgohet dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresë përcjellëse. Në MEF dërgohen gjithashtu edhe ndryshimet e planeve të arsyetuara.

Me Vendim të Këshillit Drejtues, kjo Drejtori ka miratuar kriteret dhe përshkrimet e punës për punonjësit e Drejtorisë Auditimit të Brendshëm. Ndërkohë, është bërë edhe përditësimi i kriterëve të reja në lidhje me pozicionet e punës. Përditësimi është bërë referuar dhe ndryshimeve të fundit në Ligjin 12/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 114/2015 Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Për vitin 2020 kjo Drejtori kishte parashikuar për të audituar 5 misione auditimi ndërsa janë audituar 4 njësi/drejtori në fushat e: vendimmarrjes dhe qeverisjes, planifikim dhe buxhetim, prokurimet, menaxhimi i burimeve njerëzore, pagat dhe shpërblimet, raportimi financiar, aktivet. Janë dhënë gjithsej 35 rekomandime:

Gjatë vitit 2021, ishin parashikuar për t'u audituar 5 misione auditimi, ndërsa janë realizuar 7 misione, pra ka patur ndryshime të planit i cili është reflektuar edhe në ndryshimin e planit dhe është dërguar për në MEF. Janë dhënë gjithsej 32 rekomandime.

Për vitin 2022 ishin parashikuar për tu audituar 6 njësi/drejtori, ndërsa janë realizuar 7 angazhime, pra ka patur ndryshime të planit të cilat janë reflektuar edhe në ndryshimet e planit dhe janë dërguar në MEF. Janë dhënë gjithsej 28 rekomandime.

Në opinionin e grupit të auditimit, Sektori i Auditit të Brendshëm duhet të konsiderohet si niveli më i lartë i specialistëve dhe të shpërblehet në pagë si i tillë për vetë natyrën dhe vështirësinë e punës që bën.

Sipas strukturës organike të RTSH-së, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka varësi nga Drejtori i Përgjithshëm. Ndërkohë, që sipas ligjit për auditin e brendshëm, kjo drejtori varet nga një organ vendimmarrës kolegjal, që do të ishte Këshilli Drejtues në këtë rast. (Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 4, pika 19, ku shprehet në mënyrë eksplicite se: “Titullar i njësisë publike është kreu i organit qendror të njësisë publike. Në kuptim të këtij ligji, titullar i njësisë publike që drejtohet me organ vendimmarrës kolegjal, por që nuk organizohet si shoqëri tregtare, konsiderohet ky organ”).

1. Titulli i gjetjes:	Drejtoria e Auditit të Brendshëm nuk ka zhvilluar auditim të brendshëm një herë në vit për secilën nga njësitë përbërëse të RTSH.
Situata	Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se kjo strukturë nuk ka realizuar një nga detyrat kryesore të përcaktuara në Rregullores së Drejtorisë së Auditimit në RTSH, e cila është: të zhvillojë auditim të brendshëm një herë në vit ku të përfshihen të gjitha njësitë përbërëse të RTSH. Një nga arsyet kryesore për mosrealizimin e kësaj, është mungesa e stafit të Drejtorisë së auditit të brendshëm, e cila nuk ka qënë e plotë: me një drejtor dhe dy specialistë, por ka pasur mungesa dhe vende vakante gjatë gjithë periudhës së auditimit.
Kriteri:	Neni 18 “Detyrat e Drejtorisë së Auditimit” të Rregullores së Drejtorisë së Auditimit në RTSH, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 41, datë 07.11.2018, i protokolluar me nr. 3703 prot.
Ndikimi:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për RTSH.
Shkaku	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm.
Rëndësia:	E lartë.
1.1Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të RTSH-së të merren masa për realizimin e të gjithë auditimeve të brendshme një herë në vit, ku të përfshihen të gjitha njësitë përbërëse të RTSH dhe të plotësohet numri i vendeve vakante në këtë drejtori.

2. Titulli i gjetjes:	Nga data 01.01.2020 deri në datën 22.07.2022, u konstatua se menaxhimi nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe koordinitorit të riskut.
Situata	Nga data 01.01.2020 deri në datën 22.07.2022, u konstatua se menaxhimi nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe koordinitorit të

	riskut. Me Urdhrin e brendshëm nr.86, datë 22.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm z. E. J., është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe koordinatorit të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura por që deri më sot nuk ka asnjë raportim nga ana e tij.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
Ndikimi:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për RTSH.
Shkaku	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm.
Rëndësia:	E lartë.
2.1Rekomandimi:	Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të mbikqyrë risqet që rrëzikojnë realizimin e objektivave të institucionit dhe të përgatisë raporte periodike dhe vjetore për organet drejtuese, me qëllim njohjen e situatës prej tyre dhe marrjen e masave për minimizimin e riskut.

Konkluzione:

Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm në RTSH nuk ka funksionuar në nivelin e duhur. Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është implementuar plotësisht dhe për pasojë nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë, duke mos bërë të mundur që drejtuesi të bëjë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Nuk disponohet një procedurë e veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave;

-Strategjia e Riskut e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut pavarësisht ndryshimeve të shpeshta në menaxhim dhe ndryshimeve në strukturë nuk është analizuar dhe përditësuar;

-Regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi;

-Nuk janë miratuar, hartuar dhe arkivuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogla, shpenzime për konsumin e karburantit, dhe operacione të tjera specifike;

-Dobësitë e identifikuar në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me realizimin e shpenzimeve jo në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollit, pranimin me dokumentacion justifikues jo të plotë (si p.sh. zbatimi të kontratave);

-Ka dobësi në ushtrimin e kontroleve para faktit dhe atyre mbas faktit;

-Motivimi në punë nuk është bërë sipas shkallës së vështirësisë së pozicionit të punës dhe kontributit të secilit punonjës madje duke diskriminuar punonjësit në pagë;

-Strukturat pjesë e RTSH nuk kanë harta dhe manuale të proceseve të punës, mungojnë rregullat e qarta të lëvizjes së dokumentacionit justifikues.

-Menaxhimi nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe koordinatorit të riskut përfshirë periudhën nga data 01.01.2020 deri në datën 22.07.2022. Drejtorit të Përgjithshëm z. E. J., me Urdhrin e brendshëm nr. 86, datë 22.07.2022 ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe koordinatorit të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike,

si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura por që deri më sot nuk ka asnjë raportim nga ana e tij.

-Gjatë periudhës së auditimit, në RTSH nuk është rishikuar rregullorja e brendshme për secilën njësi/drejtori në përputhje me ndryshimet strukturore.

-Nuk janë hartuar strukturat analitike (Situatë e cila ka ndikuar dhe në lëvizjet, largimet e punonjësve);

-Nuk janë harmonizuar dhe përditësuar detyrat e punonjësve, përshkrimet e punës sipas strukturës duke mos përcaktuar saktë përgjegjësitë dhe linjat e raportimit midis specialistëve përgjegjësve, drejtorit si dhe raporti me Drejtorin e Përgjithshëm.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020 me vlerë 7,330,000 euro pa TVSh, viti 2021 kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “R. & Sch, O, G,” , nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë. Konkretisht:

-Në pikën 3.3.2 “*Kapaciteti teknik*” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë siguruar jo më pak se 10 punonjës inxhinier në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Kërkesa për 10 punonjës (Inxhinier) është e përgjithshme nuk është e specifikuar në përputhje me objektin e kontratës konkretisht ing. elektronik/mekanik etj, veprimin në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Rregullat e Prokurimit*”, i ndryshuar, Neni 28 “*Kontrata e shërbimeve*”, pika 5. Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi Kompania “R. & Sch, O, G,” , nuk provohet/nuk ka paraqitur asnjë dokument që të ketë siguruar jo më pak se 10 punonjës inxhinier në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Dokumentacioni i paraqitur është në gjuhën angleze, në kundërshtim me:

-kërkesat për kualifikim të përcaktuara me procesverbal datë 26.10.2020 të njësisë së prokurimit, ku në këtë procesverbal është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Nëse certifikatat dhe dëshmitë janë në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*”.

-Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14 pika 1.

-Dokumentacioni i paraqitur në gjuhën angleze është pa vulë apostile të lëshuar nga zyra kompetente Austriake, veprim në kundërshtim me VKM nr. 134, datë 07.03.2003, “*Për verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuar në Republikën e Shqipërisë, për përdorimin jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit*”, i ndryshuar, për pasojë është dokument i pavlefshëm për tu marrë në konsideratë.

Referuar sa më sipër shpallja fitues e operatorit ekonomik si dhe lidhja e kontratës është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Neni 46, Neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Rregullat e Prokurimit*”, i ndryshuar, Neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” nenet 108-118 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje karburanti viti 2021 për vlerën 32,415,472 lekë, kualifikimi, shpallja fitues e bashkimit të operatorëve ekonomik “O.” shpk & “P. R. O.” sh.a, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë. Konkretisht: Kontrata e bashkëpunimit lidhur datë 16.04.2021 ndërmjet shoqërisë “P. R. O.” (P.) sh.a dhe shoqërisë “O.” shpk, për blerje karburanti, në pikën 1/c ka të përcaktuar: Shoqëria “P. R. O.” (P.) sh.a do të ofrojë 20 % të sasisë së furnizimit me karburant të parashikuar në grafikun e lëvrimit.

Kjo kontratë në pikën 1/K dhe 1/M është në kundërshtim me:

Objektin e aktivitetit të Shoqërisë “P. R. O.” (P.), objekt i cili referuar, ekstraktit të regjistrit tregtar të kësaj shoqërie është “Import-Eksport, tranzit, përpunim, transport, tregti me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve”. Pra kjo shoqëri nuk ka të drejtë të tregtojë me pakicë naftë.

-Licencës së dhënë nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë (Qendra Kombëtare e Biznesit) LN-5558-08-212 me objekt “Tregtim me shumicë i produkteve, benzinë kateg II/A, gazoil kat. III/A, solar kat. IV/B, Mazut kat. V/B , naftë bruto kat. 0/A.

Objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik “P. R. O.” (P.), është në kundërshtim me kërkesat për kualifikim pika 2.3.3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë furnizimin me karburant sipas standardeve shtetërore në fuqi SSH EN 590:2013 + A1:2017 për gazoil (10 ppm ULSD) me tollona (bileta)/ karta elektronike të vlefshme në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës), të vendosura në qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Peqin, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Elbasan, Pogradec, Korçë, Ersekë, Tepelenë, Gjirokastër, Sarandë, Shkodër, Burrel, Kukës. (Jo më pak se 3(tre) pika në Tiranë).

Deri më datë 16.07.2023, datë që ka përfunduar kontrata operatori ekonomik “P. R. O.” (PRO), nuk ka furnizuar asnjë litër naftë RTSH-së.

Referuar sa më sipër, kualifikimi, shpallja fitues e bashkimit të operatorëve/e shoqërive “O.” Shpk dhe Shoqërisë “P. R. O.” (P.) Sh.a, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77, 87, 89, 90, 92, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Neni 66 pika 3, Neni 74, pika 1 dhe 2, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1/1.2/1. Rekomandimi: Nga RTSH t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit blerje “Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH” për vlerën 14,314,505 lekë, viti 2023, në specifikimet teknike janë vendosur parametra teknik fiks të cilat nuk sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë ofertuesit si: Përmasa dhe peshë fiks e ndriçuesve (psh; ndriçues të lëvizshëm led spot; peshë: 16 kg; përmasat: 312 x 222 x 590 mm, etj), parametra që kanë orientuar operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi/ofertuesi në treg, që është Shoqëria “F. E.”Shpk. Për pasojë operatori ekonomik që pajisjet i ka me këto parametra, është fitues i tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 Neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 2 dhe Neni 93, Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor, në vijimësi në hartimin e specifikime teknike të shmang vendosjen e parametrave specifik fiks (apo me intervale të ngushta), pasi këto përcaktime orientojnë ofertuesit drejt markave specifike prodhuese, drejt distributorëve specifik të mallrave, sjellin kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik, të cilët ofertojnë pajisje me parametra më të “lartë” se ato të kërkuar (apo dhe vlera të ngjashme) dhe që plotësojnë kërkesat që pajisja duhet të ketë për të përmbushur qëllimin e kontratës.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja te RTSH, viti 2023, në kërkesat për kualifikim, pikën 2.1 “Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale”, është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

-ISO 9001:2015, certifikatë për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente me to, lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim.

-Certifikatë ISO/IEC 27001:2013 ose ekuivalente e tij për “Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit”.

Nuk është kërkuar asnjë licencë profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar, edhe pse kjo kontratë shërbimi është në vlerën 15,000,000 lekë. Si p.sh ISO 20000-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve IT) etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3 Neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 2 dhe Neni 93, Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020 me vlerë 7,330,000 euro pa TVSh, në kërkesat për kualifikim, pikën 3.3.4 “Kapaciteti teknik” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

-ISO 9001: 2015, certifikatë për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente me to, lëshuar nga Institucionet e Akredituara për këtë qëllim.

-ISO 14001: 2015, certifikatë për sistemin e menaxhimit mjedisor ose ekuivalente me to, lëshuar nga Institucionet e Akredituara për këtë qëllim”.

Këto janë ISO të përgjithshme. Nga Autoriteti Kontraktor nuk është kërkuar asnjë licencë profesionale ose ISO specifike për shërbimin e kërkuar, edhe pse kjo kontratë shërbimi është në vlerën 908,187,000 lekë. Si p.sh ISO 20000-1:2011 (Për menaxhimin e shërbimeve IT), ISO 27001-2013 (Për sigurinë e informacionit) etj. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 , datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Neni 20 dhe Neni 23 pika 5, Neni 28, pika 2, Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1/5.1. Rekomandimi: Nga Njësia e prokurimit, Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që në kërkesat për kualifikim në procedura e prokurimit për shërbimet dhe pajisjet të parashikojnë paraqitjen nga operatorët e ekonomikë të licencave profesionale/ISO specifike në përputhje me vlerën dhe natyrën e kontratës.

6. Gjetje nga auditimi: Në dy procedura prokurimi komisionet e vlerësimit të ofertave (KVO) dhe njësitë e prokurimit (NJP), janë pa specialist të fushës. Konkretisht:

-Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje karburanti viti 2021 për vlerën 32,415,472 lekë, me urdhër të titullarit Nr. 8/3 prot., datë 23.03.2021, është emëruar komisioni i vlerësimit i cili në përbërjen e tij nuk ka asnjë specialist të hidrokarbureve, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Rregullat e Prokurimit*”, i ndryshuar, Neni 58, pika 2.

Me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor nr. 8/2 prot., datë 19.03.2021 është emëruar njësia e prokurimit i cila në përbërjen e saj nuk ka asnjë specialist të hidrokarbureve. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Rregullat e Prokurimit*”, i ndryshuar, Neni 57 pika 2.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020, me urdhër nr. 54/2, datë 28.09.2020 të titullarit të autoritetit kontraktor është emëruar komisioni i vlerësimit të ofertave i cili në përbërjen e tij nuk ka asnjë specialist (ing. elektronik), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Rregullat e Prokurimit*”, i ndryshuar, Neni 58, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për plotësimin e njërive të prokurimit dhe komisioneve të vlerësimit të ofertave me specialist të fushës që prokurohet për të garantuar vendosjen e kritereve në përputhje me vlerën dhe natyrën e kontratë dhe të sigurojë një vlerësim të drejtë dhe profesional të ofertave të paraqitura.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Janë vendosur në kërkesat për kualifikim kriteri: autorizim nga prodhuesit, në 5 procedurat si më poshtë vijon:

-Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2020 për vlerën 7,330,000 euro, viti 2020.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH për vlerën 14,314,505, viti 2023.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH për vlerën 22,231,737 lekë, viti 2023.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje video wall, televizor, dhe pajisje ndriçimi për studiot e RTSH-së për vlerën 53,489,406, viti 2021.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: Blerje “Led wall, televizor, për nevoja të RTSH-së për vlerën 11,100,330 lekë, viti 2022.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, ka orientuar operatorët ekonomik drejtë për drejtë një prodhuesi të caktuar në treg. Për pasojë, operatori ekonomik që disponon këtë autorizim dhe ka suportin teknik është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme ulin në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar vetëm operatorët ekonomikë të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën. Veprime në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*” me ndryshimet vijuese të tij, Neni 1, Neni 20 dhe Neni 23 pika 5, Neni 28, pika 2,

-Rekomandimin Nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore”, rekomandim i cili është përforcuar

me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), Nr. 7988 prot., datë 24.12.2021, pika 12.

-Ligjin Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 3/1 dhe 77, VKM Nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 93.

-Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 851, datë 03.12.2021, “Dhënie rekomandimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe DPPSH për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”, pika 2.

-Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” nenet 4/1, 5, 11/a;b, 13, 14 dhe 17/1;2.

-Vendimin Nr.00-2015-315, datë 23.01.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Autoriteti kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH në vlerën 14,314,505 lekë viti 2023, blerje karburanti me vlerë 32,415,472 lekë, viti 2021, furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH me vlerë 22,231,737, viti 2023, mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent me vlerë 20,880,000 lekë, Mirëmbajtja e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar” me vlerë 11,533,973 lekë viti 2022, përlllogaritja e vlerës së kontratës nuk është bërë duke testuar plotësisht tregun, pasi nuk ka një argumentim përse nuk i është referuar edhe alternativave të tjera/televizioneve private etj.

Veprime në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 59, pika 2, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76, pik 1 dhe 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga Autoriteti kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlerë, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në dokumentet e tenderit dhe në marrëveshjen kuadër me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2021 të lidhur me nr. 54/18 prot., datë 26.02.2021 neni 16, pika 3 është përcaktuar “Ofertuesi i shërbimit organizon trajnime teknike për operimin në mënyrë të pa pavarur të rrjetit DVB-T2, ose përditësimeve teknologjike për personelin tekniko-inxhinierik të RTSH-së, sipas kërkesave të bëra me shkrim jo më shumë se një herë në vit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk u provua përmbushja e kësaj kërkesë kontraktuale, pasi as RTSH ka bërë kërkesë për trajnim as operatori ekonomik ka bërë trajnime (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa që për kontratën marrëveshje kuadër me objekt: Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, viti 2021

të lidhur me nr. 54/18 prot., datë 26.02.2021, nga kontraktori të përmbushet detyrimi kontraktual për trajnimin e personelit tekniko-inxhinierik të RTSH për çdo komponent të sistemit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Kontrata me operatorin ekonomik “F. E.”Shpk, për blerje “Pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH” për vlerën 16,676,880 lekë, viti 2023, është lidhur me Nr. 558/9 prot., datë 21.04.2023 për vlerën 16,676,880 lekë, me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës, me garanci 2 vite nga dorëzimi i mallit pranë RTSH. Nuk është përcaktuar asnjë vlerë/shumë për garancinë e kontratës.

Autoriteti Kontraktor nuk ka hartuar planin e zbatimit të kontratës, veprim në kundërshtim me: Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, pika 3, dhe Neni 125, pika 1.

- Udhëzimin e APP nr. 8, datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”.

-Rekomandimin APP “Drejtorja e Koordinimit dhe Monitorimit”, nr. 7212 prot., datë 19.11.2021 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që për çdo kontratë të lidhur të bëhet sigurimi i kontratës duke përcaktuar vlerën e garancisë së kontratës, me qëllim garantimin e autoritetit kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Gjithashtu të hartohet plani për zbatimin e kontratës, me qëllim për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, me cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste kontratat për blerje pajisje/shërbimi nuk kanë të përcaktuar se pajisjet do të jenë të shoqëruara me certifikatën e origjinës së pajisjeve dhe test raport fabrike (raportet e testeve). Konkretisht:

-Në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023, me operatorin ekonomik “TBS-96” për furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për: Rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, për vlerën 15,000,000 lekë, viti 2023.

-Në kontratën e furnizimit Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023 me operatorin ekonomik “F. E.”Shpk për: Blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH” për vlerën 16,676,880 lekë, viti 2023.

-Në kontratën e shërbimit Nr. 41/11 prot., më datë 13.03.2023 me operatorin ekonomik “S. T. A.”shpk për: Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent, për vlerën 13.03.2023 lekë, viti 2023.

Veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2106 prot., datë 24.03.2021 “Rekomandime të veçanta; Për kontratat tip malli”, pika 1 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në përcaktimin në kontratë të dokumentacionin që shoqëron pajisjet, raportimin në APP për çdo fazë të realizimit të kontratave, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Veprime pa delegim kompetence, mos ruajte/fshirje në arkivën numerike të RTSH të transmetimit të reklamave.

Në 7 kontrata për transmetim reklame, media planet e transmetimit janë firmosur nga E. K., me detyrë ish-drejtor i shitjes dhe menaxhimit, pa delegim kompetence. Nga verifikimi në arkivën

numerike u konstatua që ndeshjet janë të ruajtura bruto pa prerje dhe editime net. Reklamat e transmetuara nuk janë të ruajtura, janë fshirë, janë shkëputur nga ndeshjet e transmetuara dhe të arkivuara. Reklamat u verifikuan në (path-in) rrugën; rtsh_data; Sporti Arkiv; 2022; Mars 2021.

Për kontratat për transmetim reklame të përshkuara si më sipër, nuk disponohen programet e transmetimit, dhe asnjë dokument tjetër justifikues për realizimin e kontratave (Media plani/ programet e transmetimit, grupi i punës për ndjekjen e kontratës, akt pranimi etj).

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 43, pika 1, 2, 4 dhe 5, VKM Nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, Neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, a, b, c (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 220-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për administrimin e materialeve në arkivën numerike të RTSH, duke ngritur Komisionin i Ekspertizës (KE) për përcaktimin e listës konkrete me afatet e ruajtjes së fondit arkivor, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë

12.2. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për administrimin dokumenteve justifikues për realizimin e kontratave (Media plani/ programet e transmetimit, grupi i punës për ndjekjen e kontratës, akt pranimi etj).

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në projektin artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022 pesë funksione i përkasin dy personave nga një familje: Konkretisht drejtor artistik; autor skenari; prezantues; anëtar të komisionit të përzgjedhjes së këngëve dhe regjisor.

Me urdhër transfertë pa numër, datë 13.01.2023 nëpërmjet R. B., është likuiduar “A. O.” në vlerën 1,627,750 lekë për projekti artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”. Dokument vërtetues: Kontrata nr. 563/140 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e drejtorit artistik për vlerën 700,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e z/drejtorit të përgjithshëm të RTSH dhe A. O..

Kontrata nr. 563/168 prot., datë 19.12.2022 në cilësinë e skenaristit “Autor skenari” për vlerën 200,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të RTSH dhe A. O..

Kontrata nr. 563/143 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e prezantuesit për vlerën 1,000,000 lekë, me afat nga data e nënshkrimit deri në përfundimit e festivalit, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit përgjithshëm të RTSH dhe A. O..

Kontrata nr. 542/7 prot., datë 09.12.2022 në cilësinë anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngëve për vlerën 15,000 lekë, me afat nga data e nënshkrimit deri në përfundimit e festivalit, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit të RTSH dhe A. O.. Shuma totale 1,915,000 lekë për; drejtor artistik; autor skenari; prezantues dhe anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngës.

E. G., është likuiduar në vlerën 425,000 lekë. Për këtë është lidhur kontrata nr. 563/138 prot., datë 16.12.2022 në cilësinë e regjisorit për vlerën 500,000 lekë, kontratë e firmosur për RTSH nga R. N., në cilësinë e zv/drejtorit përgjithshëm të RTSH dhe E. G..

Vlera e kontraktuar për një familje është 2,415,000 lekë në pesë funksione: drejtor artistik; autor skenari; prezantues; anëtarit të komisionit të përzgjedhjes së këngëve dhe regjisor.

Nga RTSH nuk ka procedurë përzgjedhje për drejtorin artistik; autorin e skenarit; prezantuesit; anëtarët e komisionit të përzgjedhjes së këngëve dhe regjisorët. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 13, 14 dhe 17 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 229-266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në shpenzimet për projektet artistike të këngës në RTSH, duke ngritur grupe pune për përzgjedhjen me kritere të mirë përcaktuara të të gjithë stafit të domosdoshëm për realizimin e festivalit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, për periudhën 01.01.2022-30.06.2023 nuk vërtetohet kryerja e shpenzimeve për karburantin, për automjetin me targë A. T.dhe A. B., për sasinë 2805 litra me vlerë 553,895 lekë, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi.

Konkretisht për harxhimin e kësaj sasive karburanti nuk ka fletë udhëtimi si dokumentacion justifikues bazë, për pasojë nuk ka rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2 dhe Neni 8/1, Ligjin Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6, 7 dhe 8, Udhëzimin i Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35/a, b, c, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 86-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa që të ndërpritet praktika e shpenzimeve për karburant për automjetet e RTSH-së, në mungesë të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm justifikues që kërkon procedura e shpenzimit të këtij malli.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Me udhëheqësin artistik të orkestrës simfonike A. A. Z., është lidhur kontratë shërbimi me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, me objekt: RTSH dhe A. A. Z., vendosin të bashkëpunojnë së bashku për ofrimin e shërbimit në pozicionin e udhëheqësit artistik të OSRTSH me pagë 240,000 lekë në muaj.

Kjo kontratë është miratuar në draft me vendim të këshillit drejtues nr. 16, datë 14.07.2022, ky vendim bie ndesh me:

-Vendimin e këshillit drejtues nr. 28, datë 22.07.2021, “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, klas XII, i cili përcakton pagën e udhëheqësit artistik të OSRTSH 0-5 vjet 98,000 lekë, 5-15 vjet = 101,000 lekë dhe mbi 15 vjet 104,000 lekë.

-Vendimin e këshillit drejtues nr. 34, datë 07.12.2022, “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH, klas XIII, i cili përcakton pagën 135,000 lekë. Referuar të dy vendimeve si më sipër, dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me A. A. Z., duhet të ishte lidhur kontratë individuale pune.

-Këshilli drejtues është kontradiktor në tre vendimmarrjet e tij të cituara si më sipër.

-Statutin, i miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016, “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”, Neni 28.

- Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77, 78, 80, 81 dhe 115.

-VKM Nr. 286, datë 21.5.2018, “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për të shfuqizuar kontratën e shërbimit nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022 me drejtorin artistik Orkestrës Simfonike A. A. Z. dhe të lidhet kontratë individuale pune.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga A. A. Z., nuk është zbatuar neni 5 i kontratës së shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022, ku është përcaktuar: Udhëheqësi artistik i Orkestrës Simfonike i RTSH, duhet ti paraqesë drejtorit të përgjithshëm të gjithë:

-a. Riprodhimin e veprave muzikore shqiptare e të huaja dhe prodhimin e regjistrimeve të muzikës së lehtë dhe popullore.

-b. Promovimin e trashëgimisë së vërtet muzikore shqiptare dhe krijimtarisë bashkëkohore.

-c. Përgatitjen dhe shfaqjen e koncerteve dhe të shkaqeve të tjera publike.

-d. Regjistrimin e krijimeve artistike të vendit dhe të huaj.

Pasi A. A. Z., nuk provohet/dokumentohet të ketë paraqitur tek drejtori i përgjithshëm ose në RTSH, asnjë produkt të përcaktuar në kontratë, në zbatim të pikave a, b, c dhe d. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshimet vijuese të tij, Neni 419, 420, 476, Neni 659, 698 dhe Neni 690, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b, Kontratën e shërbimit me nr. 3351/1 prot., datë 07.09.2022 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në zbatimin e kontratave të shërbimit, duke ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim me qëllim jo vetëm pranimit dhe marrjen në dorëzim me specialist të fushave, por për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga RTSH nuk provohet/dokumentohet që drejtori artistik A. A. Z., të ketë qenë në Shqipëri, duke ushtruar detyrën e udhëheqësit artistik të OSRTSH, për datat 26 shtator 2022; 7 tetor 2022; 1 nëntor 2022; 22 nëntor 2022; 9. nëntor 2022; 30 dhjetor 2022; 17 janar 2023; 15 janar 2023; 6 shkurt 2023; 8 shkurt.2023; 17 shkurt 2023; 27 shkurt 2023; 2 prill 2023; 4 prill 2023; 7 prill 2023; 12 prill 2023; 7 prill 2023; 19 prill 2023; 28 prill 2023; 4 maj 2023; 18 maj 2023; 22 nëntor 2023; 19 maj 2023; 29 maj 2023; 13 qershor 2023 dhe 27 qershor 2023, duke mos argumentuar dhe dokumentuar për saktësinë dhe vërtetësinë e shpërblimit të marr nga drejtori artistik A. A. Z., për periudhën 07.09.2022 deri më 30.06.2023.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 286, datë 21.5.2018, “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52, Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21, Neni 76, 77, 78, 80, 81 dhe 115, Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës

së Shqipërisë”, KREU II nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në drejtimin e orkestrës simfonike/por jo vetëm, duke eliminuar trajtimin me standard të dyfishtë të punonjësve të RTSH-së, si dhe të saktësohet periodha e pa dokumentuar për të cilën është përfituar edhe pagesa përkatëse.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Në 18 shkresa përcjellëse hartuar nga drejtori artistik A. A. Z., drejtuar E. D. dhe titullarëve për likuidim honorarësh për koncerte etj., shkresat nuk janë dokumente zyrtare, pasi emri dhe mbiemri i nënshkruarit dhe firma janë fotokopje, shkresa të cilat edhe pse nuk janë sipas kërkesave ligjore, janë protokolluar në Institucion, për më tepër pa qenë prezent përpiluesi i tyre. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, Neni 6, VKM Nr. 4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, neni 4, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për administrimin e dokumenteve zyrtare të protokolluara, me qëllim që pagesa për honorare, koncerte etj. të bëhet me dokumentacion të protokolluar, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, duke evidentuar përgjegjësinë për krijimin e kësaj praktike

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i nivelit të pagave të miratuar nga këshilli drejtues me vendim nr. 28, datë 22.07.2021 dhe nr. 34, datë 07.12.2022 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH”, u konstatua që klasifikimi nuk është bërë duke vendosur kriteret specifike për çdo pozicion pune siç janë: Niveli i diplomës, arsimimi/kualifikimi, natyra e punës, kushtet e punës, formimi profesional, vjetërsia në punë, vështirësia, përvoja dhe përgjegjësitë, njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet si kusht për të garantuar barazinë në vendosjen e pagave.

Këto kriteret nuk janë specifikuar për secilin pozicion pune në tabelën e pagave për të bërë diferencën mes niveleve të pagave. Konkretisht:

-Në Njësienë e Programeve, Radio Tirana (përshkrimi i punës është i njëjtë), gazetar I klasa VII dhe gazetar II klasa VI pra ka një ndarje të gazetarëve në dy nivele.

-Sektori Programacionit, në përshkrimet e detyrave nuk ka ndarje të redaktorëve të parë apo të dytë, ndërkohë që redaktor I klasa VII dhe redaktor II klasa VI.

-Në Drejtorinë Juridike (kriteret dhe përshkrimi i punës është i njëjtë), specialist klasa VII dhe specialist klasa VIII.

-Sektori Projekteve dhe Administrimit të Drejtave, specialist klasa VIII dhe specialist klasa VII, me të njëjtët kriteret dhe përshkrime pune.

-Në Njësienë e Emisioneve Tematike dhe Lajmeve: Redaksia e Gazetarëve të Gjuhëve të huaja, gazetar përkthyes i parë klasa IX, gazetar përkthyes i dytë klasa VIII dhe gazetar përkthyes i tretë klasa VII; me të njëjtët kriteret dhe përshkrime pune.

-Departamenti i Sportit, gazetar I klasa X dhe gazetar II Klasa VII (me të njëjtët kriteret dhe përshkrime pune).

-Për Njësienë Teknike- Sektori IT, në përshkrimet e punës nuk ka ndarje të specialistëve të parë apo të dytë, referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 23/2018, specialist IT i I, klasa VIII dhe specialist IT i II klasa VII’. Pra specialistët paguhen me paga të ndryshme pa një unifikim dhe pa

vendosur kriteret objektive siç janë natyra e punës, cilësia dhe sasia e saj, kushtet e punës, formimi profesional dhe vjetërsia në punë, përvoja dhe përgjegjësitë.

-Departamenti Teknikës TV, sektori i regjistrimit – transmetimit, teknik figure I klasa VI dhe teknik figure II klasa IV; teknik zëri I Klasa VI dhe teknik zëri II Klasa IV; teknik ndriçimi I klasa VI dhe teknik ndriçimi II klasa IV; titriste I klasa VI dhe titriste II klasa IV; Departamenti Teknik dhe Radio, teknik regjistrim dhe montazh I klasa VII dhe teknik regjistrim dhe montazh klasa VI.

-Departamenti Prodhimit, Sektori i Studiove, grimior i parë klasa IX dhe grimior klasa V dhe kostumograf i I klasa IX dhe kostumograf klasa VII.

-Në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm ka diferencime në pagë, kur përshkrimet e punës janë të njëjta, referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 23/2018, nuk ka të specifikuar specialist i parë apo i dytë, ndërkohë specialist i parë sipas strukturës është me klasën X dhe specialist i dytë (ka përfunduar studimet master shkencor) me klasën VIII. Për këto ndarje nuk janë vendosur kriteret që duhet të plotësojë një punonjës që të paguhet si i tillë. Ndërkohë që një punonjës të kategorizohet si “*Specialist i parë*” duhet minimalisht të ketë përfunduar master shkencor, për nivelin e “*Specialist i dytë*” duhet që punonjësi të ketë përfunduar master profesional. Një ndarje e tillë është e pambështetur as në klasifikimin e pagave të RTSH, as në Ligjin e posaçëm nr 114/2015, “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” apo në akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Diferencimet e pagave si më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 9 dhe 115, Ligjin Nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17, Ligjin nr. 114/2015, “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, Ligjin Nr.10221/2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 57-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të RTSH të rishikohen dhe llogariten nivelet e pagave të punonjësve duke u bazuar në kriteret të mirë përcaktuar si arsimimi (niveli i diplomës si: master shkencor, master profesional, bachelor apo diplomë e shkollës së mesme), kualifikimi (njohuritë nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet etj) përgjegjësia (shkalla e përgjegjësisë dhe vështirësisë në funksion të riskut që mund të ketë puna që kryhet) etj, duke shmangur pagesat me diferenca të konsiderueshme për punonjësit me natyrë të njëjtë pune dhe duke synuar motivimin e tyre.

Brenda datës 31.03.2025

20. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje Shërbimi për Platformën OTT*”, viti 2020 marrëveshje kuadër me një OE rezultoi se me shkresën nr. 74 prot., datë 25.06.2019 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit me përbërje të grupit z. I. V., z. G.N. dhe z. A. D.. Ky grup pune është ndryshuar me shkresën nr. 30 prot., datë 02.03.2020 me Urdhër të ish Titullarit z. Th. G., grupi i punës me përbërje të grupit z. G. N., z. E. T. dhe znj. G. H.. Me shkresën nr. 30/1 prot., datë 11.05.2020 grupi i punës si më sipër ka hartuar specifikimet teknike dhe ka përlllogaritur fondin limit mbështetur në ofertat e marra nga 3 OE:

A. T., – 0.45 lekë/ për 8,000,000 gb/muaj

E. D. – 0.47 lekë/ për 8,000,000 gb/muaj

M. N. – 0.41 lekë/ për 8,000,000 gb/muaj

Për afatin prej 24 muaj ka rezultuar një vlerë prej 85,113,600 lekë pa TVSH. Kjo vlerë është përdorur edhe për vlerën e fondit limit të procedurës. Nga auditimi nuk rezultoi asnjë gjurmë dokumentare për të vërtetuar se këta OE, mbi të cilët ky komision është mbështetur, kanë një

eksperiencë të tillë aq sa të justifikojë marrjen e ofertës për këtë lloj shërbimi. Mungesa e disponimit të eksperiencës së këtyre tre ofertuesve, 2 nga të cilët janë bashkuar për të krijuar edhe bashkimin e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, konfirmohet edhe nga dokumentacioni që secili nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh ka ngarkuar në sistem si punë e ngjashme, ku asnjë prej tyre nuk ka eksperiencë në hartimin e këtyre aplikacioneve. Komisioni i ngritur për përcaktimin e vlerës së fondit limit duhet të kishte dokumentuar, si pjesë e gjurmës së auditimit, eksperiencën e këtyre OE përpara se të merrte ofertat. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2 i dhe me Rregulloren e Përgjithshme të Punës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 116 – 220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të AK, Personit Përgjegjës për prokurimin dhe në kryesisht nga ana e komisioneve të ngritura për përcaktimin e fondit limit të investimeve, të merren masat e nevojshme për dokumentimin e plotë të eksperiencës së mjaftueshme të operatorëve ekonomikë sipas natyrës së investimit, tek të cilët AK mbështetet për të përlllogaritur vlerën limit të kontratës që do të prokurojë. Kjo e fundit duhet të jetë sa më reale dhe të përfaqësojë me objektivitet dhe siguri të mjaftueshme çmimin e tregut.

Në vijimësi

21. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *Blerje Shërbimi për Platformën OTT*, viti 2020 marrëveshje kuadër me një OE rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm një OE i cili është bashkimi i operatorëve ekonomikë “A. T. & M. N”, me vlerë të ofertës 84,858,280 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës i procedurës i administruar në RTSH me nr. 30/8 prot., datë 05.08.2020 ka shpallur fitues këtë bashkim operatorësh. Në përfundim të procedurës është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit nr. 30/10 prot., datë 17.08.2020 me vlerë të kontratës 101,829,936 lekë me TVSH për 24 muaj shërbim, ose 4,242,914 lekë pa TVSH në muaj. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se OE A. T., nuk plotëson kriterin në lidhje me punët e ngjashme për vlerën përkatëse sipas përqindjes së marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Konkretisht, sipas kontratës së bashkëpunimit O. M. N., ka marrë përsipër të kryejë 75 % të vlerës së kontratës (ose 63,835,200 lekë pa TVSH¹³) dhe OE A. T., ka marrë përsipër të kryejë 25 % të vlerës së kontratës (ose 21,278,400 lekë pa TVSH¹⁴). Nga të dhënat e ngarkuara në SPE rezulton se BOE në tërësi nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme, pasi konkretisht OE A. T., nuk ka dëshmuar për një kontratë për punë të ngjashme në masën prej 40 % të vlerës takuese, ose shumë prej 8,511,360 lekë pa TVSH (*21,278,400 lekë pa TVSH x 0.4*), por si dëshmi ka sjellë një kontratë të lidhur mes RTSH dhe B. A., & E. F. me nr. 183/5 prot., datë 24.11.2017. Në fakt kjo kontratë, sikundër është përmendur edhe në auditimin e mëparshëm, nuk ka diktuar qartë se cilat kanë qenë punët konkrete të marra përsipër nga secili prej tyre, kjo pasi të dyja palët kanë marrë përsipër furnizimin dhe i vetmi OE i cili ka pretenduar për marrjen përsipër të plotësimin të të gjitha kërkesave specifike të kërkuara në procedurën e tenderit për stafin dhe dokumentacione fakti ka qenë OE E. F.. Pra, në një situatë të tillë pjesa e furnizimit është marrë përsipër nga të dy OE dhe pjesa e stafit dhe kërkesave për dokumentacion është marrë përsipër nga ana e OE E. F. dhe nuk ka një dëshmi të qartë të punës së kryer. Por pavarësisht kësaj rezulton se vlera totale e

¹³ Referuar vlerës së fondit limit prej 85,113,600 lekë pa TVSH.

¹⁴ Referuar vlerës së fondit limit prej 85,113,600 lekë pa TVSH.

kontratës së paraqitur si dëshmi është në masën 7,777,900 lekë pa TVSH nga 8,511,360 lekë pa TVSH që duhet të ishte, **pra 733,460 lekë pa TVSH** më pak. Për sa më sipër ky BOE nuk duhet të ishte shpallur fitues i procedurës së prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 germa c, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 3, neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1, 2 dhe 3 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 116 – 220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të AK si dhe personave të angazhuar në komisionet e vlerësimit të ofertave të merren masat e nevojshme për kualifikimin e OE vetëm pas përmbushjes së të gjitha kriterëve të kualifikimit me qëllim sigurimin e përdorimit me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Në vijimësi

22. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për periudhën objekt auditimi, RTSH nuk ka krijuar dhe përditësuar një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura.

Nga RTSH nuk është kryer inventari fizik i aktiveve afatgjata materiale. Inventari kontabël i aktiveve afat gjata materiale nuk është i detajuar në toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.

Nuk u bë e mundur të auditohet administrimi i bazueshmërisë ligjore të administrimit të pronës, e cila është përcaktuar në programin e auditimit nr. 564/1 prot., datë 26.07.2023 pika VIII. Për pasojë, kjo çështje do të auditohet me program të veçantë ose në auditimin e radhës. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si ndryshuar si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet nr. 220– 229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për krijimin dhe përditësimin e regjistrit kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura.

Menjëherë

22.2. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për kryerjen e inventarit fizik të aktiveve afatgjata materiale si dhe për detajimin e inventarit kontabël të aktiveve afat gjata materiale në toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj.

Menjëherë

23. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje pajisje elektronike për nevojat e transmetimit” të vitit 2020 në hartimin e specifikimeve teknike nuk është lënë hapësirë por janë vendosur vlera fikse në specifikimet teknike të mallrave, që pengojnë dhe ulin konkurrencën. AK në hartimin e specifikimeve teknike i është referuar katalogut të disa produkteve specifike, gjithashtu ka hartuar specifikime të cilat nuk përbëjnë efekt për arritjen e qëllimit që ka për objekt kjo procedurë prokurimi. Për sa më sipër nuk është zbatuar siç duhet

Ligji “Për prokurimin publik”, Neni 23 për specifikimet teknike dhe Neni 20 “Mosdiskriminimi” ((Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 45 – 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24. Gjetje nga Auditimi: Këshilli Drejtues nuk është mbledhur sipas përcaktimeve ligjore. Konkretisht Këshilli Drejtues nuk është mbledhur në periudhën janar-shkurt dhe qershor-gusht (31.08.2020) të vitit 2020. Për sa më sipër nuk është zbatuar Ligji nr. 97/2013, datë 04.03.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Neni 99, pika 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 45 – 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Këshilli Drejtues të vazhdojë të mblidhet sa herë është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta por jo më pak se një herë në 2 muaj për të realizuar plotësisht performancën/objektivat.

Në vijimësi

25. Gjetje nga Auditimi: Për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit të Administrimit Z. A. B., Këshilli Drejtues nuk i është përmbajtur plotësisht Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, pasi Z. A. B., ka përfunduar arsimin e lartë për Inxhinieri Mekanike dhe nuk ka një eksperiencë të lidhur ngushtë në fushën e financave dhe ekonomisë. Duke pasur në vëmendje se kandidatët për tu bërë pjesë e Bordit të Administrimit duhet të kenë njohuri ekonomiko-financiare sipas Nenit 107 pika 2 të Ligjit 97/2013 dhe për të përmbushur siç duhet detyrimet e Nenit 111 të Ligjit 97/2013, Këshilli Drejtues duhet të kishte përzgjedhur ata kandidatë të cilët plotësojnë tërësisht kushtet (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 45 – 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Këshilli Drejtues të marrë masa që anëtarë të Bordit të Administrimit të përzgjidhen persona të cilët plotësojnë kriteret e duhura arsimore, me qëllim përmbushjen si duhet prej tyre të detyrave funksionale.

Në vijimësi

26. Gjetje nga Auditimi: Emërimi i Drejtuesit të RTSH-së për qytetin e Korçës Z. S. Y., është bërë në kushtet kur nuk ka paraqitur platformën dhe strukturën programore e organizative për vendin e punës ku ai kandidon, konkretisht si drejtues i njësisë administrative të RTSH në qytetin e Korçës. Paraqitja e platformës dhe strukturës programore vlerësohet nga Drejtori i Përgjithshëm E. J., kompetencë referuar Statutit të RTSH konkretisht Neni 13 pika 2 dhe Neni 14 pika 1.a. Shpallja fitues e këtij kandidati mbart sjell risk për mos realizimin e objektivave dhe besueshmërisë për drejtuesit e njësisë administrative në përbërje të RTSH (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 45 – 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në përzgjedhjen, emërimin e drejtuesve të njësisë administrative të RTSH-së, si dhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Në vijimësi

27. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Rikonceptim i Studios 5” e cila është kryer si procedurë në vitin 2022, për vlerën 955,800 lekë rezultoi se: Nga verifikimi i kryer në terren ky ambient ishte jashtë funksionit duke mos justifikuar arsyet e zhvillimit të procedurës. Pra në ambientet ku është kryer ky rikonstruktion/rikonceptim për nevojat e transmetimit të emisioneve të RTSH, ky ambiente përdorej për magazinimin e mallrave të ndryshëm, prandaj kjo procedurë nuk justifikon nevojat mbi të cilat është kryer. Veprime këto me kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin “Për

menaxhimin financiar dhe kontrollin” nr. 10 296 datë 08.07.2010 i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 45 – 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1. Rekomandimi: RTSH në të ardhmen të marrë masa me qëllim që të analizojë siç duhet nevojën për shpenzimet e saj me qëllim shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

28. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt “*Blerje sistem konference për RTSH-në*”, për vlerën 760,000 lekë, të vitit 2021 u konstatua se në ftesën për ofertë ishte përcaktuar lista e mallrave për tu prokuruar nga ana e AK. Zërat e kërkuara nga AK nuk përputhen me faturën përfundimtare ku megjithëse janë mallra të bashkuara me njëri tjetrin, në faturën përfundimtare janë trajtuar si mallra të ndara nga njëri tjetri. Nga auditimi rezultoi se ka mospërputhje midis zërave të përcaktuar në ftesën për ofertë nga ato të faturës përfundimtare. Këto veprime bien në kundërshtim me UMF Nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, seksioni –Dokumentimi lëvizjes së aktiveve, Vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Nenin 56, pika 10 “*Procedura e prokurimit me vlerë të vogël*”. Ky veprim nuk jep garanci të arsyeshme nëse mallrat e ofertuar sipas faturës përfundimtare janë në përputhje të plotë me ato të përcaktuar në ftesën për ofertë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet nr. 45 – 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28.1. Rekomandimi: Nga ana e AK të merren masa që në procedurat e ardhshme lëvizja e aktiveve të bëhet duke qenë në përputhje të plotë zërat e hartuara në ftesën për ofertë me zërat e procesverbalit të marrjes në dorëzim si dhe faturës përfundimtare sipas ligjit.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: RTSH e ka zhvilluar veprimtarinë ekonomike dhe financiare në mungesë të një plan biznesi të miratuar. Sipas të dhënave nga RTSH, lidhur me të ardhurat e saj, financimi nga buxheti për vitin 2020 ishte planifikuar në vlerën 634,000,000 lekë, për vitin 2021 në vlerën 606,000,000 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 567,600,000 lekë. Të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv për vitin 2020 ishin planifikuar në vlerën 1,420,000,000 lekë, për vitin 2021 në vlerën 1,450,000,000 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 1,429,190,000 lekë. Të ardhurat e institucionit për vitin 2020 ishin planifikuar në vlerën 346,000,000 lekë, për vitin 2021 në vlerën 400,000,000 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 346,250,000 lekë.

Rrjedhimisht, ka prirje të planifikimit në rënie të të ardhurave vjetore për vitet e fundit, ka mangësi në planifikim, mungesë të mekanizmave kontrollues dhe verifikues për tarifën e aparatit televiziv, nuk ka hartuar dhe ndjekur një strategji të caktuar në lidhje me strukturën e të ardhurave nga reklamat në cash dhe me klering, ka një nivel të konsiderueshëm të detyrimeve të debitorëve ndaj RTSH, nuk ka pasur fond për prodhimin e pavarur etj. Konkretisht, detyrime të pritshme të arkëtohen në datë 31.12.2020 janë në vlerën 62,941,280 lekë, në datën 31.12.2021 në vlerën 64,470,497 lekë, në datën 31.12.2022 në vlerën 171,638,098 lekë, në datën 30.06.2023 në vlerën 122,889,687 lekë. Detyrime në kontrata shërbimi në datë 31.12.2020 janë në vlerën 7,917,817 lekë, në datën 31.12.2021 në vlerën 19,333,854 lekë, në datën 31.12.2022 në vlerën 24,230,918 lekë, në datën 30.06.2023 në vlerën 37,082,173 lekë. Detyrime në proces gjyqësor të pritshme në datë 31.12.2020 janë në vlerën 17,337,546 lekë, në datën 31.12.2021 në vlerën 16,648,931 lekë, në datën 31.12.2022 në vlerën 12,329,693 lekë, në datën 30.06.2023 në vlerën 8,052,794 lekë. Detyrime pa shpresë arkëtimi janë në vlerën 41,758,291 lekë.

Ky veprim është në mospërputhje me: Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 123; Statuti i RTSH, neni 52, pika 2; neni 53 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese dhe Bordi i Administrimit të RTSH-së të marrin masa për hartimin e planit të biznesit, planifikimit të të ardhurave në bashkërendim dhe koordinim midis tyre, për hartimin e një strategjie për strukturën e të ardhurave nga reklamat në cash dhe me klering, për bashkëpunimin më efikas midis Njësisë Teknike, Drejtorisë së Marketingut, Drejtorisë Ekonomike dhe asaj Juridike për uljen e detyrimeve të debitorëve ndaj RTSH, si dhe krijimin e fondit për prodhimin e pavarur.

Në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste apo tejkalim në disa raste. Gjithashtu, u konstatua mungesa e një analize të mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament/drejtori/sector dhe mungesa e një udhëzuesi mbi mënyrën e planifikimit të buxhetit dhe programit ekonomik financiar të RTSH.

Nga auditimi u konstatua, mungesa e një analize të mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore të secilit departament/drejtori/sector.

Nga auditimi konstatohet se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në rastin e të ardhurave të RTSH dhe më konkretisht për zërat “*të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv*” dhe “*të ardhura të institucionit*”.

Në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe RTSH, me nr. 29, datë 18.12.2014 “*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*”, konstatohet se, ka mosrealizim të planit për këtë zë për shkak të mos mbledhjes së tarifës nga O.SH.E.E për përdoruesit familjar e jofamiljarë. Gjatë vitit 2020, niveli i arkëtimeve është 280.5 milionë lekë më pak nga parashikimi. Pra, të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv janë realizuar në masën 80.25%. Gjatë vitit 2021, niveli i arkëtimeve është 86.7 milionë lekë më pak se planifikimi. Pra, të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv janë realizuar në masën 94%. Gjatë vitit 2022, niveli i arkëtimeve është 146.7 milionë lekë më pak se planifikimi. Pra, të ardhurat nga tarifa e aparatit televiziv janë realizuar në masën 89.7%, për pasojë janë arkëtuar më pak para sesa duhej të ishin arkëtuar realisht.

Lidhur me zërin tjetër “*të ardhurat e institucionit*”, për vitin 2020, realizimi i tyre është në masën 65.24%. Për vitin 2021 të ardhurat e institucionit janë realizuar në masën 74.24% dhe për vitin 2022 në masën 109.6% duke e tejkaluar kështu vlerën e planifikuar për këtë zë.

Të ardhurat për vitin 2020 në total për RTSH-në janë realizuar në masën 83.26% në krahasim me planifikimin, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 401,648,000 lekë. Të ardhurat për vitin 2021 janë realizuar në masën 90.96% në krahasim me planifikimin, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 222,064,000 lekë. Të ardhurat për vitin 2022 janë realizuar në masën 95.15% në krahasim me planifikimin, me një mosrealizim në vlerë absolute prej 113,589,539 lekë. Ndërsa për vitin 2023 të ardhurat janë planifikuar në masën 2,728,055,000 lekë.

Ky veprim është në mospërputhje me: *Ligjin nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, neni 3, pika 29 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

30.1. Rekomandimi: Me qëllim që të mos ketë diferenca të dukshme midis zërave të planifikimit dhe realizimit të buxhetit, nga ana e Drejtorisë Ekonomike dhe personave përgjegjës të merren masa, për të kryer planifikim të studiuar e të mbështetur në nevojat reale, mbi bazën e kërkesave konkrete të të gjitha niveleve të strukturës së RTSH-së.

Në vijimësi

30.2. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të RTSH-së të merren masa që strukturat që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të kryejnë analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatës, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor. Për përmirësimin e situatës dhe minimizimin e risqeve rekomandohet të ndërmerren aktivitete kontrolli shtesë, si dhe të hartohet ndonjë udhëzues për mënyrën, afateve, personat përgjegjës, strukturat, procedurat etj, elementë të cilët duhet të përfshihen në një programim buxhetor.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: RTSH nuk ka përmbushur detyrimin për të dërguar/raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të paktën 3 herë në vit, Raportet e Monitorimit të Buxhetit. Ky veprim është në mospërputhje me: Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kapitulli I, pika 45 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 48 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1. Rekomandimi: Nga ana e Organeve Drejtuese të merren masa për përmbushjen e detyrimit për raportim të paktën 3 herë në vit lidhur me Raportet e Monitorimit të Buxhetit.

Në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Bordi i Administrimit nuk i ka paraqitur Këshillit Drejtues raportimin për shpenzimet dhe të ardhurat në formë raportesh financiare mujore, pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga sektorët e RTSH, duke bërë që Këshilli Drejtues të mos njohë situatën konkrete lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet. Ky veprim është në mospërputhje me nenin 20, pikën “ç”, të Statutit të RTSH-së (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 48 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1. Rekomandimi: Bordi i Administrimit të marrë masa që të paraqesë në Këshillin Drejtues çdo muaj raportet financiare për shpenzimet dhe të ardhurat.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Këshilli Drejtues i RTSH-së nuk ka respektuar afatin për raportimin dhe njoftimin publik për rezultatet e analizës financiare për vitin 2022.

Me shkresën e Bordit të Administrimit me nr. 09/3 prot., datë 16.05.2023, drejtuar Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm, është dërguar analiza për realizimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të RTSH-së për vitin 2022 (janar-dhjetor), e cila është dërguar jashtë afatit të përcaktuar. Ky veprim është në mospërputhje me nenin 17, pika “ç”, të Statutit të RTSH-së, ku shprehet: “Këshilli Drejtues i RTSH-së, përveç kompetencave të përcaktuara në nenin 102 të ligjit nr. 97, datë 4.3.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka edhe këto kompetenca: “Në çdo fillim viti, por jo më vonë se data 31 mars, në bazë të raportit të Bordit të Administrimit analizon Raportin Financiar të RTSH. Jep njoftimin publik për rezultatet e analizës financiare”. Pra raporti vjetor/realizimi i treguesve ekonomikë-financiar për vitin 2022 nuk është publikuar në faqen zyrtare të RTSH-së. Ky veprim është në mospërputhje me: Nenin 35, pika 2 dhe pika 3, të Statutit të RTSH-së (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 48 – 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për respektimin e afateve për raportimin dhe njoftimin publik për rezultatet e analizës financiare, në mënyrë që të mos pengohen proceset e punës dhe për t’ju siguruar publikut transparencë në përputhje me kuadrin ligjor.

Në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Në RTSH nuk janë rishikuar rregulloret e brendshme për secilën njësi/drejtori në përputhje me ndryshimet strukturore (shtesat e pozicioneve të reja në organikë), edhe pse në RTSH kanë ndodhur ndryshime në mënyrë të vazhdueshme të strukturës organike.

Gjatë periudhës së auditimit, në RTSH nuk është rishikuar rregullorja e brendshme për secilën njësi/drejtori në përputhje me ndryshimet strukturore. Rregulloret e brendshme të RTSH-së nuk janë në përputhje me strukturat analitike të RTSH, pasi nuk është bërë përditësim i tyre dhe shumë pozicione të reja nuk janë pasqyruar në rregulloren përkatëse. Konkretisht, në Rregulloren e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore janë 4 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor Drejtorie dhe 3 specialistë. Ndërkohë, në strukturën analitike të RTSH-së janë gjithsej 9 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor Drejtorie, 1 Përgjegjës Sektori i Burimeve Njerëzore dhe 4 specialistë të I-rë të Sektorit të Burimeve Njerëzore, 1 Përgjegjës Sektori i Akademisë dhe 2 specialistë të Sektorit të Akademisë. Për rrjedhojë, nuk janë pasqyruar as detyrat për pozicionet e shtuara në strukturë. Gjithashtu, në Rregulloren e Drejtorisë Juridike janë 5 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor dhe 4 juristë. Ndërkohë, në strukturën analitike të RTSH-së janë gjithsej 13 punonjës, nga të cilët: 1 Drejtor Drejtorie, 1 Përgjegjës Sektori i Marrëdhënieve Ligjore dhe 4 jurist/specialistë të Sektorit të Marrëdhënieve Ligjore, 1 Përgjegjës Sektori i Prokurimeve dhe 4 specialistë të Sektorit të Prokurimeve, 1 Përgjegjës Sektori GIS (regjistrimin dhe administrimin e pronave) dhe 1 specialist i Sektorit GIS. Për rrjedhojë, nuk janë pasqyruar as detyrat për pozicionet e shtuara në strukturë. Shtesat e pozicioneve të reja në organikë nuk janë pasqyruar në rregullore, pasi përdoret ende rregullorja e vjetër. Konkretisht është shtuar pozicioni Përgjegjës Sektori në Sektorin e Arkivës me klasën IX me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 9, datë 17.03.2022, ndërkohë që detyrat e tij nuk gjenden të përcaktuara në rregulloren e RTSH. Gjithashtu, në rregullore nuk ka të përcaktuar nivelin e arsimimit për secilin pozicion pune.

Në RTSH nuk është miratuar një rregullore e re, ku të përcaktohen detyrat e pozicionit të ri të krijuar si: Përgjegjës Sektori në Sektorin e Arkivës me klasën IX. Konkretisht, në Rregulloren e Drejtorisë së Administratës në RTSH, nenin 13 “*Punonjësit e arkivit dhe protokollit*”, nuk është e përcaktuar nëse ka një përgjegjës për këtë sektor dhe për rrjedhojë nuk janë përcaktuar as detyrat për këtë pozicion. Ky veprim është në mospërputhje me: Kodin e Punës, statutin e RTSH-së, rregulloret e brendshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

34.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i RTSH dhe strukturat përkatëse, të marrin masa për rishikimin/ndryshimin e rregulloreve të brendshme për secilën drejtori/departament/njësi, në përputhje me ndryshimet në organikë, të përcaktojnë detyrat dhe nivelin e arsimimit për secilin pozicion pune dhe të nxjerrë përgjegjësinë ndaj personave përkatës.

Në vijimësi

35. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se RTSH nuk ka hartuar kritere të pranimit në punë të punonjësve, vlerësimit të punës dhe nuk ka ngritur komision Ad-Hoc për përzgjedhjen e punonjësve deri më datë 27 shkurt 2023. Konkretisht, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 27.02.2023, të protokolluar me nr. 32/3 prot., datë 27.02.2023 janë miratuar kriteret e marrjes në punë për punonjësit në sistemin e RTSH-së dhe komisionet Ad-Hoc. Ky veprim është

në mospërputhje me: Nenin 29, pikën 2 të Statutit të RTSH; Nenin 102, pika 12 “Kompetencat e Këshillit Drejtues” të Ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

35.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për mos përsëritjen e rasteve të tilla në RTSH, si dhe ti kushtohet rëndësi e veçantë përzgjedhjes së punonjësve në mënyrë që të rritet performanca e RTSH-së në të ardhmen dhe të nxjerrin përgjegjësinë ndaj personave përkatës.

Në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Politikat e burimeve njerëzore që lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore shfaqin dobësi. Në mënyrën e funksionimit dhe organizimit, Institucioni ka një manual të vitit 2004 për shpalljet e vendeve vakante, procedurat, rekrutimin e stafit etj., i cili nuk ka gjetur zbatim në praktikë, si dhe nuk është përditësuar bazuar ndryshimeve të Kodit të Punës, politikave dhe praktikave të reja të menaxhimit të burimeve njerëzore. Marrëdhëniet e punës në këtë Institucion janë rregulluar me anë të Kodit të Punës si dhe kontratat individuale. Me ndryshimet strukturore miratuar me VKD nr. 9 datë 15.03.2022, “Për miratimin e strukturës së RTSH”, nuk janë reflektuar ndryshimet. Gjithashtu, nuk janë hartuar strukturat analitike (Situatë e cila ka ndikuar dhe në lëvizjet, largimet e punonjësve). Nuk janë harmonizuar dhe përditësuar detyrat e punonjësve, përshkrimet e punës sipas strukturës duke mos përcaktuar saktë përgjegjësitë dhe linjat e raportimit midis specialistëve përgjegjësve, drejtorit si dhe raporti me Drejtorin e Përgjithshëm. Ky veprim është në mospërputhje me: Statuti i RTSH dhe Ligji nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për krijimin e politikave të burimeve njerëzore lidhur me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore, si dhe ti kushtohet rëndësi e veçantë përzgjedhjes së punonjësve në mënyrë që të rritet performanca e RTSH-së në të ardhmen.

Në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Në kontratën individuale të punës mungojnë çështjet e afatit dhe të mënyrës së pagesës, në kundërshtim me Kodin e punës, neni 115, pika 4.

- Sipas nenit 29, pika 1 e Statutit, marrëdhëniet e punës rregullohen me kontrata pune:

a) individuale; b) kolektive; c) me kohë të pjesshme, ku parashikohet garantimi i sigurimeve shoqërore nga institucioni dhe ç) me projekte, ku detyrimet financiare mbulohen nga vetë projekti. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratën individuale dhe kontratën me projekte. Në këtë mënyrë, në rregullimin e marrëdhënieve të punës në RTSH mungon kontrata kolektive dhe kontrata me kohë të pjesshme. Kontrata me kohë të pjesshme krahas mbrojtjes në punë ka të bëjë dhe me pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore për dy degë të tjera që nuk përfshihen në këtë lloj kontrate.

- Në kontratën e punës tip nuk janë përfshirë çështjet e afatit dhe të mënyrës së pagesës së pagës për punëmarrësit, të përcaktuar këto në Kodin e Punës, neni 116 dhe 118., si dhe në të nuk është përfshirë rasti i ndryshimit të kontratës, i cili referuar Kodit të Punës, neni 23/2 duhet që: “Ndryshimi i kontratës bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve”. Gjithashtu, kontrata individuale nuk ka të përcaktuar periudhën e provës, në kundërshtim me germën “gj”, pika 3 e nenit 21 të Kodit të sipërcituar. Ky veprim është në mospërputhje me: Kodin e Punës, neni 116 dhe 118; neni 23/2; neni 21, pika 3, germën “gj”; Udhëzimi i MFE nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e

kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, pika 3.2.1 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

37.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa për rishikimin e kontratës individuale të punës, për të përfshirë të gjithë elementët përkatës, si dhe të diferencojë kontratat e punës me kohë të pjesshme.

Në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në RTSH nuk janë të unifikuara pagat brenda të njëjtit grup. Konkretisht, në lidhje me klasifikimin e pagave për montazhierët, regjisorët, moderatorët, paga brenda të njëjtit grup ka një diferencë page prej 3 nivelesh. Duke qenë se shpërndarja e punës dhe ngarkesa janë njësoj për të gjithë punonjësit brenda të njëjtit grup pavarësisht emërtesës, atëherë edhe paga duhet të jetë e njëjtë. Në lidhje me klasifikimin e pagave për montazhierët dhe regjisorët u konstatua se ka dy lloje klasifikimi page për pozicionet montazhier lajme: sporti/emisioneve në studio, që janë klasifikuar në klasë VII, ndërsa për montazhierë spektaklesh dhe reportazhier/montazhierë filmi dhe dokumentarësh, janë klasifikuar në klasë IX. Gjithashtu, dallime në pagë konstatohen dhe për regjisorët. Regjisorët e lajmeve/sportit janë klasifikuar me pagë të klasës IX, ndërkohë që regjisorët e spektakleve/eventeve kulturore, janë të klasifikuara me klasë X. Klasifikimet e pagave në RTSH, janë të miratuara me Vendim të Këshillit Drejtues respektivisht për çdo pozicion pune. Në lidhje me moderatorët u konstatua se, ka dy lloje klasifikimi page për këtë pozicion, respektivisht moderatorë TV, të cilët janë klasifikuar në klasë XII, ndërsa për moderatorë dhe redaktorë, të cilët janë klasifikuar në klasë X. Klasifikimet e pagave në RTSH, janë të miratuara me Vendim të Këshillit Drejtues respektivisht për çdo pozicion pune. Sa më sipër është në mospërputhje me Kodin e punës. Ky veprim është në mospërputhje me: Kodin e Punës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

38.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për të bërë unifikimin e pagave brenda të njëjtit grup, pasi kjo mund të sjellë rritjen e pakënaqësive midis punonjësve dhe në uljen e performancës së tyre në punë.

Brenda datës 31.03.2025

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se janë 14 punonjës që kanë plotësuar moshën e pensionit dhe nuk iu janë shkëputur marrëdhëniet e punës dhe nuk disponohet dokumentacion justifikues për punën/detyrat që kanë kryer gjatë kësaj periudhe kohore që janë paguar. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 478, datë 16.06.2010, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie*”, pika 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

39.1. Rekomandimi: Këshilli Drejtues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë në lidhje me mbajtjen në punë të punonjësve të cilët kanë plotësuar moshën e pensionit, si dhe të marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënieve të tyre të punës.

Brenda datës 31.03.2025

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se kjo strukturë nuk ka realizuar një nga detyrat kryesore të përcaktuara në Rregullores së Drejtorisë së Auditimit në RTSH, e cila është: të zhvillojë auditim të brendshëm një herë në vit ku të përfshihen të gjitha njësitë përbërëse të RTSH. Një nga arsyet kryesore për mosrealizimin e kësaj, është mungesa e stafit të Drejtorisë së auditit të brendshëm, e cila nuk ka

qenë e plotë: me një drejtor dhe dy specialistë, por ka pasur mungesa dhe vende vakante gjatë gjithë periudhës së auditimit.

Ky veprim është në mospërputhje me: Nenin 18 “Detyrat e Drejtorisë së Auditimit” të Rregullores së Drejtorisë së Auditimit në RTSH, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 41, datë 07.11.2018, i protokolluar me nr. 3703 prot (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqet 266 – 274 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

40.1. Rekomandim: Nga Organet Drejtuese të RTSH-së të merren masa për realizimin e të gjithë auditimeve të brendshëm një herë në vit, ku të përfshihen të gjitha njësitë përbërëse të RTSH dhe të plotësohet numri i vendeve vakante në këtë drejtori.

Në vijimësi

41. Gjetje nga auditimi: Nga data 01.01.2020 deri në datën 22.07.2022, u konstatua se menaxhimi nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe koordinatorit të riskut. Me Urdhrin e brendshëm nr. 86, datë 22.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm z. E. J., është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe koordinatorit të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura por që deri më sot nuk ka asnjë raportim nga ana e tij. Ky veprim është në mospërputhje me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10, faqet 266 – 274 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

41.1. Rekomandim: Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të mbikëqyrë risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit dhe të përgatisë raporte periodike dhe vjetore për organet drejtuese, me qëllim njohjen e situatës prej tyre dhe marrjen e masave për minimizimin e riskut.

Në vijimësi

42. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mos përcaktimi i një Procedurë të qartë për dorëzimin e lëndës nga palët e kontraktuara dhe pranimit nga ana RTSH-së, për projektet artistike dhe filmike.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që në asnjërin nga rregulloret e miratuara për projektet filmike dhe artistike nuk është përcaktuar qartë se si do të bëhet dorëzimi i lëndës për bashkëprodhimet filmike dhe prodhimet e porositura, pjesë e projekteve artistike dhe filmike. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

42.1. Rekomandimi: RTSH të marrë masa për përmirësimin e “Rregullores”, duke përcaktuar procedurën për dorëzimin e lëndës në RTSH nga palët e kontraktuara për bashkëprodhimet dhe prodhimet e porositura, pjesë e projekteve filmike dhe artistike.

Menjëherë

43. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “B. G. P.”, nuk ka raportuar sipas përcaktimeve të kontratës, për të ardhurat që shoqëria ka përfituar prej shfrytëzimit të të drejtave ekskluzive të bashkëprodhimit filmik “Sahatcia”. Nga ana RTSH-së nuk është kryer monitorimi i zbatimit të kontratës në kundërshtim me rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” për kontratën nr. 1176 datë 24.03.2022 ndërmjet shoqërisë “B. G. P.” dhe RTSH-së që është nënshkruar për vlerën 8,400,000 lekë.

Sipas faturave të vëna në dispozicion shoqëria “B. G. P.” u likuidua nga RTSH në vlerën 7,560,000 lekë pra 90% të vlerës së kontratës, ndërsa për pjesën e mbetur të vlerës së miratuar

për financim që nuk iu likuidua shoqërisë. Nuk është bërë relacioni nga specialisti ekonomist në sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave sipas përcaktimeve të kontratës, neni 4.

Sipas dokumentacionit të vënë dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, kjo në kundërshtim me kontratën e sipërcituar neni 5, pika 6. Sipas të dhënave vërehet se RTSH nuk ka patur asnjë përfitim monetar nga realizimi i këtij projekti filmik, ku sipas kontratës së bashkëpunimit, neni 5 citohet se “RTSH përfiton të gjitha të ardhurat që krijohen nga shfrytëzimi i të drejtës ekskluzive”, kjo në kundërshtim me rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”.

-Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1176 prot., datë 24.03.2022 nënshkruar ndërmjet RTSH-së dhe shoqërisë “B. G. P.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

43.1. Rekomandimi: RTSH të marrë masa për eliminimin e veprimeve dhe mosveprimeve të strukturave gjatë hartimit dhe zbatimit të projekteve artistike dhe filmike për të shmangur keqpërdorimin e fondeve publike, duke përcaktuar personat përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e kontratave.

43.2. Rekomandimi: Strukturat aktuale në RTSH, Drejtori, të marrin masa për vlerësim të situatës, të kërkojnë nga ana e shoqërisë “B. G. P.” për raportim të të ardhurve të realizuara nga bashkëprodhimi filmik “Sahtacia” dhe në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, të kërkohet arkëtim i vlerës sipas përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit nr. 1176 datë 24.03.2022 për të ardhurat që RTSH duhet të përfitonte nga shfrytëzimi i të drejtës ekskluzive.

Deri më 30.04.2025

44. Gjetje nga auditimi: Nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e të drejtave me shoqërinë “A. I.”, në kundërshtim me “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”.

Nga auditimi i marrëveshjes “Për blerjen e të drejtave” me shoqërinë “A. I.”, është konstatuar se, nënshkrimi i saj nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH nuk ka marrë paraprakisht miratimin e Bordit artistik, si dhe veprimet nga sektori i projekteve janë kryer pas nënshkrimit të marrëveshjes, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me rregulloren “Mbi miratimin dhe e zbatimin e projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, RTSH nuk ka arkëtuar asnjë të ardhur për realizimin e këtij projekti, kur në kontratën e marrëveshjes mes dy palëve janë përcaktuar qartë të drejtat e RTSH-së në lidhje me përfitimet dhe të ardhurat” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

44.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Titullarët e RTSH-së, që në të ardhmen të mos nënshkruhen kontrata për projektet artistike/filmike që bien në kundërshtim me rregulloren dhe cënojnë procesin.

Në vijimësi

45. Gjetje nga auditimi: Përlllogaritje jo e saktë e fondit limit. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtja e automjeteve të Radio Televizionit Shqiptar”, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke mos patur informacion të plotë në lidhje me gjendjen e automjeteve, nuk është marrë parasysh vlera kontabël dhe norma e amortizimit të çdo mjeti motorik. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 76, pika

dhe 2, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011,i ndryshuar *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

45.1. Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit për mirëmbajtjen e automjeteve, të kryhet pasi të jenë përcaktuar difektet konkrete dhe gjendja teknike e mjeteve në një servis të certifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

46. Gjetje nga auditimi: Kufizim i konkurrencës nëpërmjet afatit për realizimin e kontratave. Pavarësisht eksperiencave të këqija që Autoriteti Kontraktor ka patur në përcaktimin e një afati të shkurtër për realizimin e kontratave të furnizimit për mallra, në pjesën më të madhe të procedurave të prokurimit të realizuara Autoriteti kontraktor ka vendosur si afat realizimi të kontratës një periudhë të shkurtër disa ditore duke mos qene në kushtet e emergjencës dhe duke mos e argumentuar këtë kërkesë për kualifikim te vendosur në dst. Kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 2,3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

46.1. Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që vendosja e afateve për realizimin kontratave të prokurimit publik, të mos ngushtojë në mënyrë artificiale konkurrencën dhe të mos bëhet shkak për keqpërdorim të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

47. Gjetje nga auditimi: Mungesë të efijencës, efektivitetit dhe ekonomikitetit në përdorimin e fondeve. Nga verifikimi i artikujve të blerë sipas procedurës “Blerje vaj, goma, bateri dhe adblue”, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se shumica nga e artikujt e furnizuar në 12.12.2022 gjenden në magazinë të papërdorur duke mos justifikuar blerjen e tyre. Në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” neni 2,3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

47.1. Rekomandimi: RTSH, të marrë masa për argumentimin e saktë e nevojave të institucionit arritjen e një prokurimi me efektivitet, efijencë dhe ekonomikitet të fondeve publike ,duke respektuar parimin e konkurrencës.

Në vijimësi

48. Gjetje nga auditimi: RTSH për të gjitha projektet artistike dhe filmike nuk ka marrë masat e nevojshme për ndjekje dhe realizimin e kontratave të projekteve sipas përcaktimeve të rregullores të miratuar nga Këshilli Drejtues “*Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave*” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

48.1. Rekomandimi: Strukturat përkatëse të ngarkuara me zbatimin e projekteve të marrin masa për dokumentimin e plotësimit të kriterëve për personelin që aktivizohet në realizimin e projekteve, si dhe respektimin rigoroz të zbatimit të kontratave.

Në vijimësi

49. Gjetje nga auditimi: Për blerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, ndërmjet RTSH dhe operatorit/e Kompanisë “R. & S. Os. G.”,A., është lidhur marrëveshja kuadër me 54/18 prot., datë 26.02.2021 për vlerën 7,329,968 euro me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj.

Për periudhën 01.03.2021 deri 30.06.2023 është likuiduar për vlerën 6,007,626 euro.

Dokumentacioni i likuidimit: Urdhër transfertat, fatura elektronike, raport SLA të realizuar për çdo muaj drejtuar drejtuesit të njësisë teknike të RTSH, i firmosur nga grupet e punës/komisionet e ngritura me urdhër të drejtorit të përgjithshëm për vlerësimin e disponueshmërisë së rrjetit DVB-T2, në mënyrë të njëanshme pa firmosur nga “R. & S. Os. G.”, Austri. Shkresat muaj për muaj drejtuar drejtorit të përgjithshëm nga drejtori i njësisë teknike, për dërgimin e raporteve/procesverbaleve për shpërblim të kompanisë R. & Sch. O. G.”, Austri.

Pagesat janë bërë/kryer :

- Pa mbajtur akt-kolaudim ndërmjet palëve.

-Raportet mbi SLA e realizuara, janë të përgjithshme jo të detajuara, ashtu siç është përcaktuar në specifikimet teknike.

- Raportet nuk janë sipas aneksit nr. 4 “Formati i raportit periodik për stacionet e RTSH. konkretisht nuk pasqyrohen personat e ngarkuar, data, tipi i stacionit, 4 “Kulla”, 5 “Rrethimi”: a. përshkrimi, b. rezultati i kontrollit, nuk është kontrolluar, c. aktivitete korrektive, shënime; komente; personat e ngarkuar; firma; data.

Veprime në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, Neni 21, Neni 5, pika 3, Neni 6, pika 4, Li9jin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

49.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa për të rinegociuar me Kompaninë “R. & S. Os. G.”, Austri, Marrëveshjen Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, për të bërë amendimet përkatëse me qëllim që kopjet në anglisht të akt kolaudimeve/procesverbaleve të pranimit/akt pranimeve në zbatim të kontratës të jenë të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët, referuar: Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 14/1; Ligjit nr. 10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, Kreu VII “Detyrimet dhe kontratat”, Neni 45 “Liria e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm”; Rregullores (EC) nr. 593/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore”, Neni 11, pika 1,2,3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Brenda datës 31.03.2025

49.2. Rekomandimi: Marrja në dorëzim e shërbimeve të kryera nga Kompania “R. & S. Os. G.”, Austri të bëhet konform specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë dhe anekseve përkatëse, me akt kolaudime/procesverbale të pranimit/akt pranime të përkthyer dhe në shqip dhe të firmosura nga të dyja palët.

Menjëherë dhe në vijimësi

50. Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 295, datë 19.07.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, I. B. është komanduar me detyrë Drejtore e Auditit të Brendshëm me pagë klasa XII. Me vendim nr. 540, datë 03.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm është bërë zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës, me arsyetimin se I. B., në momentin e komandimit nuk ka pasur eksperiencën e nevojshme për këtë pozicion dhe as certifikatën e audituesit të brendshëm, në mospërputhje me nenin 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, pika 2/b, të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Deri në datë14.11.2023, datë që përfundoi auditimi nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rekrutimi për këtë pozicion pune (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

50.1. Rekomandimi: Nga drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për emërimin e Drejtorit të Auditit të Brendshëm me qëllim që emërimi të bëhet me “Auditues të

brendshëm në sektorin publik” të licensuar nga Ministria e Financave, por edhe me përvojë 5-vjeçare në profesion.

Menjëherë

51. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “T” shpk, me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH në vlerën 13,860,000 lekë, viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me çertifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, duke mos garantuar vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “T” ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Grupi i auditimit i kërkoi RTSH që kontraktori duke qenë brenda afatit të kontratës të paraqesë në RTSH: Certifikatën e origjinës, raportet e testeve, dokumentacion të cilin nuk u paraqit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshimet vijuese të tij, neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe neni 690, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “T” Shpk, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

51.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfashtuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolauditimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Brenda datës 31.03.2025

52. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “F. E.”Shpk, me objekt: “Blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH”, për vlerën prej 15,409,437 lekë viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, duke mos garantuar saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “F. E.”Shpk ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2, Neni 21, pika 5, neni 122, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshimet vijuese të tij, neni 419, 420, 476 659, 698 dhe neni 690, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “F. E.”Shpk, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr.

9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

52.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfashtuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “F. E.”, Shpk nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 15,409,437 lekë nga Shoqëria “F. E.”Shpk.

Brenda datës 31.03.2025

53. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “S. T. A.”shpk, me objekt: Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent, në vlerën 3,097,546 lekë, viti 2023, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “S. T. A.” ka fituar procedurën e prokurimit dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” , Neni 2 Neni 21, pika 5, neni 122, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshimet vijuese të tij, neni 419, 420, 476, neni 659, 698 dhe neni 690, Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe të termave të referencës nga operatori ekonomik “S. T. A.” Shpk, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

53.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfashtuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “S. T. A.”shpk nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 3,097,546 lekë nga Shoqëria “S. T. A.”Shpk.

Brenda datës 31.03.2025

54. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, RTSH nuk ka tregues konkretë lidhur me mënyrën e matjes së punës së mirë të punonjësve, mbi bazën e të cilëve të jenë dhënë

shpërblimet. Lidhur me shpërblimet për punë të mirë, në vitin 2020 është shpenzuar vlera 1,990,000 lekë. Në vitin 2021 janë dhënë shpërblime për punë të mirë në vlerën 2,033,000 lekë. Ndërsa për periudhën nga data 01.01.2023-30.06.2023 është dhënë shpërblim për punë të mirë në vlerën 104,000 lekë për një punonjësit. Pra, vlera totale e shpërblimeve për punë të mirë përgjatë periudhës së auditimit (nga data 01.01.2020-30.06.2023) është 5,127,000 lekë. Kjo gjë ndikon në pakësimin e buxhetit të RTSH-së dhe në lindjen e pakënaqësive midis stafit të punonjësve të RTSH-së, pasi supozohet të ketë meritokraci dhe transparencë gjatë dhënies së shpërblimeve. Këto veprime janë në mospërputhje me Kodin e Punës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 57 – 88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

54.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa për vendosjen e treguesve konkretë lidhur me mënyrën e matjes së punës së mirë të punonjësve, në mënyrë që punonjësit e shpërblyer të zgjidhen mbi bazë meritokracie, pasi lindin pakënaqësitë midis stafit të punonjësve të RTSH.

Brenda datës 30.04.2025

55. Gjetje nga Auditimi: RTSH nuk ka zbatuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH. Auditim mbi veprimtarinë dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve në RTSH, në zbatim të programit nr. Nr. 564/1Prot. datë 26.07.2023. Me program auditimi nr.600/22 prot., datë 21.06.2021 me objekt “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në RTSH, Tiranë*”.

RTSH ka marrë Raportin Përfundimtar të auditimit të KLSH-së “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në RTSH*” me nr. 947/1 prot., datë 28.09.2020, administruar në RTSH me nr. 947/49 prot., datë 06.08.2021. Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, RTSH, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH duke mos respektuar afatin 20 ditor. Nga ana e RTSH nuk është respektuar afati ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore janë lënë 0 rekomandime; b. Janë rekomanduar 58 masa organizative nga të cilat janë pranuar 58 masa ose 100% dhe statusi i zbatimit të tyre është 13 masa janë zbatuar plotësisht, 25 masa janë në proces zbatimi, 4 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 16 masa nuk janë zbatuar; c. Janë rekomanduar 16 masa për shpërblim dëmi në vlerën 23,761,927 lekë të cilat janë pranuar 16 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 6 masa të pa zbatuara në vlerën 23,761,927 lekë; d. Janë rekomanduar 2 masa shpërblimi dëmi me kusht në vlerën 38,278,500 lekë të cilat janë pranuar 2 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 0 masa të zbatuara ose 2 masa të pa zbatuara në vlerën 38,278,500 lekë; e. Është rekomanduar 1 masë në drejtim të të ardhurave të munguara në shumën 20,992,259 lekë e cila është pranuar dhe zbatuar; f. Janë rekomanduar 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitetin në shumën 29,770,126 lekë të cilat janë pranuar 6 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 2 masa të zbatuara në vlerën 1,319,460 lekë, 3 masa në proces zbatimi dhe 1 masë e pa zbatuar; e. Janë rekomanduar 29 masa disiplinore të cilat janë pranuar 29 masa dhe statusi i zbatimit të tyre është 27 masa të zbatuara dhe 2 masa në proces zbatimi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 29 – 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

52.1. Rekomandimi: Nga RTSH të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nga ky auditim rezultuan të pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin dhe shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 60,713,285 lekë dhe 66,760 euro, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 RTSH ka zhvilluar 17 emisione, janë angazhuar 56 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 15,187,939 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 14,754,400 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 29,942,339 lekë. Për 6-mujorin e parë të vitit 2023 RTSH ka zhvilluar 10 emisione janë angazhuar 35 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 12,961,997 lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 12,780,660 lekë, totali i shpenzimit në vlerën 25,742,657 lekë. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 38, datë 01.07.2004, “Për miratimin e sistemit tarifor të shërbimeve që ofron RTSH”, në pikën 1 është përcaktuar: Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti.

Me vendim të këshillit drejtues nr. 85, datë 21.12.2007, është vendosur shfuqizimi i paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Për punonjësit që fitojnë projekte në RTSH paga e tyre mujore do të paguhet nga projekti”.

Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimin e paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhet me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH”. Referuar sa më sipër në RTSH për 27 emisione me angazhim 91 punonjës, është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës. Duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave me punonjësit e RTSH.

Vlera 27,535,060 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Nenet 12, 21, 76, 77, 78, 80,81 dhe 115, Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Nenet 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 19, 20 dhe 52 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 229-266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 27,535,060 lekë nga E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm dhe E. D., me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Ekonomike. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Brenda datës 30.04.2025

1.2. Rekomandimi: Këshilli Drejtues brenda kompetencave ligjore, statusore dhe rregullatore të tij, të analizojë mënyrën e pagesës/shpërblimit të punonjësve të angazhuar në projekte artistike dhe filmike në RTSH, dhe të merret vendimi përkatës me argument shterues për të shmangur keqinterpretimet e zbatimit të vendimmarrjeve të mëparshme nga drejtoria në lidhje me këtë çështje.

Brenda datës 30.04.2025

2. Gjetje nga auditimi: Me urdhër nr. 218 prot, datë 17.01.2023 të E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm është urdhëruar prokurimi me mjete elektronike me fond limit 22,231,737 lekë me objekt: Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH, procedurë e hapur-mallra, me mjete elektronike.

Në vitin 2020, RTSH ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: Furnizim-vendosje, pajisje dhe programeve për shtimin e arkivës numerike për nevoja të RTSH, për vlerën 32,154,035 lekë. Kontrata me operatorin ekonomik “S. T. A.”shpk, është lidhur Nr. 35/16 prot., më datë 01.07.2020 ndërmjet RTSH të përfaqësuar nga Th. G., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe operatorit/e shoqërisë “S. T. A.”shpk përfaqësuar nga administrator K. P. për vlerën 32,154,035 lekë.

-RTSH nuk ka kryer një vlerësim kosto-përfitim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për ruajtjen e të dhënave video. Aktualisht, RTSH ka në pronësi dhe përdorim: Sistemin Storeasy; Sistemin Mam me Storage (hapësirë ruajtjeje e të dhënave) Isilon dhe Backup Veam+ LTO9; Sistemin QSAN. Këto sisteme janë prokuruar për të njëjtin qëllim, ruajtjen dhe arkivimin e videove të RTSH.

RTSH nuk ka justifikuar nevojën e një investimi sistem+Storage, pasi ka pasur në pronësi edhe sistemin MAM me Storage Isilon dhe Kasetat LTO9.

RTSH duke pasur një sistem ka prokuruar edhe një tjetër, pa kërkuar shtesë të kapacitetit të sistemit ekzistues, kur duhet të shpenzonte vetëm për shtim të kapaciteteve të sistemit ekzistues dhe jo për sistem dhe storage.

Me urdhër tranfertën pa nr. datë 28.06.2023 për vlerën 13,860,000 lekë, është likuiduar Shoqëria “T.” Shpk. Ky shpenzim (likuidim) ka të bëjë me Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH”, në zbatim të kontratës Nr. 218/11 prot., më datë 15.05.2023 ndërmjet RTSH.

Referuar sa më sipër vlera 13,860,000 lekë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga B. M., me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit dhe E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm. Dëmshpërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2 dhe Neni 21, pika 5, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 2, 4 dhe 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 13,860,000 lekë nga B. M., me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit dhe E. J., me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm. Dëmspërblimi mbështetet në Nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Brenda datës 30.04.2025

3. Gjetje nga auditimi: Me urdhër transfertë pa nr. datë 13.06.2023 nëpërmjet B. është likuiduar Shoqëria “T.” shpk në vlerën 252,000 lekë. Dokument vërtetues: Fatura nr. 96/2023 datë 30.05.2023 për vlerën 252,000 lekë. Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 456/43 prot., datë 30.05.2022 i firmosur nga F. M., E. F. dhe D. R.. Kontratë shërbimi nr. 456/33 port., datë 11.05.2023 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.” për vlerën 252,000 lekë. Raport teknik nr. 456/44 prot., datë 30.05.2023 i mbajtur nga “T.” Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”.

RTSH ka lidhur kontratë shërbimi nr. 68/16 prot., datë 14.04.2021, ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.” për vlerën 389.200 lekë/muaj me TVSH, për 36 muaj me vlerë totale 14,011,200 lekë. Kjo kontratë është me objekt: Shërbim mirëmbajtje për Head-End-In Satelitor”, sipas çmimit të deklaruar në ofertë, specifikimeve teknike, afateve të përcaktuara në këtë kontratë si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor.

Zhvillimi i procedurës blerje me vlera të vogla ”Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”, me urdhër prokurim nr. 456/28 prot., datë 27.04.2023 firmosur nga R. N., në cilësinë zv/Drejtorit të Përgjithshëm shkaktonte mbivendosje, (pra është pagesë e dubluar), në kundërshtim me kontratën e shërbimit nr. 68/16 prot., datë 14.04.2021 e lidhur ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.” për 36 muaj me vlerë totale 14,011,200 lekë.

Siç pasqyrohet në të dy kontratat është i njëjti operator ekonomik fituesi i të dy shërbimeve “T.” shpk .

Për veprimin e mësipërm është shkelur koncepti i “Bëgatimit pa shkak”, i ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të personave të përfshirë në këtë proces me përfitues padrejtësisht Shoqërinë “T.” sh.p.k në vlerën 252,000 lekë. Referuar Ligjit Nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 655, “Bëgatimi pa shkak”, vlera 252,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shteti dhe duhet të dëmspërblehet nga Shoqëria “T.” sh.p.k.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, pika 23/f, g, Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Neni 2, Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 21, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 116-220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 252,000 lekë nga Shoqëria “T.” sh.p.k. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, pasi shkaktonte mbivendosje (pra është pagesë e dubluar), në

kundërshtim me kontratën nr. 68/16 prot., datë 14.04.2021, ndërmjet RTSH dhe operatorit ekonomik “T.”, për 36 muaj me vlerë totale 14,011,200 lekë.

Brenda datës 30.04.2025

4. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës për bashkëpunim/këmbim reklame nr.1613 prot., datë 05.05.2022 të lidhur me Shoqërinë “N.” shpk për vlerën 3000 euro për 5 spote pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, në favor të “N.” shpk u konstatuar një mos realizim në vlerën 1,172 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me diferencën ndërmjet faturës elektronike të RTSH me nr. 134/2022, datë 30.05.2022 për vlerën 3,180 euro dhe furnizimeve të bëra nga Shoqëria “N.” shpk që kapin vlerën 2,008 euro. Vlera 1,172 euro, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshimet vijuese të tij, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe Neni 690, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52 dhe Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 220-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 1,172 euro lekë nga Shoqëria “N.” sh.p.k. Kjo vlerë ka të bëjë me mos përmbushje e detyrimeve kontraktore për bashkëpunim/këmbimi reklame.

Brenda datës 30.04.2025

5. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e kontratës për bashkëpunim/këmbim reklame nr.1633 prot., datë 19.04.2022 të lidhur me Shoqërinë “A. E. H. C.,” shpk për vlerën 250,000 lekë për 8 spote, pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, në favor të Shoqërisë “A. E. H. C.,” u konstatua një mos realizim në vlerën 250,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me mos përmbushjen e detyrimeve kontraktore, pasi përveç faturës elektronike nr. 1/2022, datë 10.05.2022, nuk ka asnjë dokument tjetër që provon se është realizuar kontrata/shkëmbimi, p.sh, komisionin e marrjen në dorëzim të 10 veshjeve për drejtuese me vlerë 250,000 lekë, fletëhyrjen, fletë daljen etj. Vlera 250,000 lekë, përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe Neni 690, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 dhe 20 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 220-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 250,000 lekë nga Shoqëria “A. E. H. C.,” shpk.

Brenda datës 30.04.2025

6. Gjetje nga auditimi: Me vendim nr. 25, datë 01.12.2022, Bordi i administrimit ka vendosur të jap pëlqimin mbi preventivin për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61” i këngës në RTSH përkundrejt vlerës financiare 47,323,800 lekë.

Në këtë preventiv është vendosur dhe vlera 300,000 lekë për drejtorin artistik të festivalit. Drejtori artistik i emëruar me urdhër nr. 32, datë 2.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm E. J., ka vendosur të marrë 300,000 lekë si drejtues artistik i festivalit, edhe pse është zv/titullari i RTSH. Vlerë e cila nuk është miratuar nga këshilli drejtues me vendim nr. 32, datë 07.12.2022.

Preventivi është i pa argumentuar për të gjitha zërat e tij, si në ana sasiore po ashtu dhe për çmimet e vendosura për çdo zë, çmime të cilat nuk janë në librin tarifor të miratuar me vendim të Këshilli Drejtues nr. 38, datë 01.07.2004. Nuk ka procedurë të përcaktimit të çmimeve për asnjë zë të preventivit, si është bërë përzgjedhja e personave dhe e subjekteve tregtare. Nuk ka të ardhura të planifikuara nga biletat, reklamat, sponsorizimet, nuk ka situacion të shpenzimeve sa ka kushtuar “*Festivali 61 i këngës*”, nuk ka situacion të të ardhurave etj.

Për këtë festival RTSH, ka shpenzuar për punonjësit e saj, mbi pagesën mujore të tyre, vlerën 3,153,001 lekë.

Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 3, datë 09.01.2014, është vendosur ç’fuqizimi i vendimit nr. 85, datë 21.12.2007, si dhe ndryshimin e paragrafit të parë të pikës 1 të vendimit të këshillit drejtues nr. 38, datë 01.07.2004 “*Drejtuesit e RTSH që zgjidhen nga këshilli drejtues i RTSH nuk duhen të paguhet me honorare për angazhime të tyre në projektet filmike dhe artistike të RTSH*”. Referuar sa më sipër në RTSH për projektin artistik “Festivali i 61 i këngës”, është krijuar një marrëdhënie juridike e shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave individuale të punës, duke krijuar në këtë mënyrë një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH.

Vlera 3,153,001 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 12, Neni 21 Neni 76, 77, 78, 80, 81 dhe 115, Ligjin Nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 4, 5, 11, 13, 14 dhe 17 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 229-266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Nga këshilli drejtues të rishqyrtohet vlera 3,153,001 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e punonjësve të RTSH për realizimin e projektit artistik “Festivali i 61 i këngës në RTSH”, viti 2022, mbi pagesën mujore të tyre, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e RTSH. RTSH nuk duhet të miratonte këtë fond që në planin e biznesit të vitit 2022, pasi menaxhimi nuk ka përcaktuar qartë domosdoshmërinë e planifikimin e këtij fondi dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike etj. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëmin ekonomik.

Brenda datës 31.03.2025

7. Gjetje nga auditimi: Nga V. L., me detyrë ish-shefe kontabiliteti është prerë mandat pagesa, pa numër, datë 10.01.2022 për vlerën 2,850 euro, për pagesë M. M., gazetar i RTSH, për udhëtim dhe dieta, por mandat pagesa nuk është firmosur nga marrësi i kësaj shume, si dhe nga arkëtari.

Mandatpagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, si dhe nga punonjësit M. M., E. V. dhe H. M.. Mandatpagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në

librin e arkës. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, pika 15 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi me specialistë të fushës (përfashtuar ata që kanë qenë pjesë e mbajtjes së kontabilitetit financiar dhe administrimit të mjeteve monetare), i cili të kryejë verifikimet përkatëse për vlerën 2,850 euro të shpenzuar për udhëtim dhe dieta pasqyruar në mandat pagesën, pa numër, datë 10.01.2022.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se vlera 2,850 euro e shpenzuar për udhëtim dhe dieta nuk është përfituar nga M. M., E. V. dhe H. M., konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 2,850 euro nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa, pa numër, për vlerën 4,150 euro, për pagesë A. Ç., për udhëtim dhe dieta me detyrë shofer gazetar i RTSH, por mandat pagesa nuk është firmosur nga marrësi i kësaj shume, si dhe nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.

Mandatpagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, mandatpagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi me specialistë të fushës (përfashtuar ata që kanë qenë pjesë e mbajtjes së kontabilitetit financiar dhe administrimit të mjeteve monetare), i cili të kryejë verifikimet përkatëse për vlerën 4,150 euro të shpenzuar për udhëtim dhe dieta pasqyruar në mandat pagesën, pa numër, datë 15.02.2022. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se vlera 4,150 euro e shpenzuar për udhëtim dhe dieta nuk është përfituar nga A. Ç. dhe G. Gj., konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 4,150 euro nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa nr. datë 21.01.2022, pa nr. serie për vlerën 1,650 euro, për pagesë G. Gj., me detyrë operator, mandat pagesa e firmosur nga G. Gj., dhe jo nga B. C., me detyrë gazetar e RTSH dhe A. C., me detyrë shofer, si dhe jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar. Urdhër shërbimet nuk janë firmosur nga nëpunësi zbatues por nga V. L., në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin”, Neni 12 pika 1 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, paragrafi i fundit.

Mandatpagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit dhe arkëtari, në urdhër shërbim nëpunësi zbatues cilësohet V. L.. Mandat pagesa nuk është regjistruar në librin e arkës.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi me specialistë të fushës (përrjashtuar ata që kanë qenë pjesë e mbajtjes së kontabilitetit financiar dhe administrimit të mjeteve monetare), i cili të kryejë verifikimet përkatëse për vlerën 1,650 euro të shpenzuar për udhëtim dhe dieta pasqyruar në mandat pagesën, pa numër, datë 21.01.2022. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se vlera 1,100 euro e shpenzuar për udhëtim dhe dieta nuk është përfituar nga A. Ç. dhe B. C., konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit, arkëtimi në vlerën 1,100 euro nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit. Vlera 1100 euro është përlllogaritur si diferencë (1650 :3= 550 x2 =1100).

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër datë 04.02.2022, pa nr. serie për vlerën 1,040 euro, për pagesë C. G., shtetas nga Franca, mandat pagesa e firmosur me firmë të sigluar në këtë mënyrë pa dalluar saktësisht se kush është marrësi i parave. Urdhër shërbimet për jashtë vendit për llogari të C., firmosur me firmë të mbyllur, i pa dallueshëm se kush ka udhëtuar.

Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit dhe arkëtari. Mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës. Vlera 445 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a. e, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Ligjin nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera 445 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime udhëtim dhe dieta për C. G., solist nga Franca, i cili ka marrë pjesë në koncertin e

Kameratës të orkestrës simfonike datë 05.02.2022. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.03.2025

11. Gjetje nga auditimi: Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër, datë 16.02.2022 pa nr. serie për vlerën 1,539 euro, për pagesë P. F., shtetas Francez, mandat pagesa e firmosur nga ky shtetas, por jo nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.

Në kontratë nuk është përcaktuar në asnjë nen të saj që RTSH do ti paguaj biletën e avionit për 359 euro, si dhe udhëtim dhe dieta 160 euro. Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të ishte punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, arkëtari. Mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës. Vlera 519 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Ligji nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera 519 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime, udhëtim dhe dieta për P. F., solist nga Franca, i cili ka marrë pjesë në koncertin e orkestrës simfonike të RTSH më datën 16.02.2022. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.03.2025

12. Gjetje nga auditimi: Nga V. L., me detyrë ish-shefe e kontabilitetit është prerë mandat pagesa pa numër, datë 16.02.2022 pa nr. serie për vlerën 1,114 euro, për pagesë N. B., shtetas Francez, mandat pagesa e firmosur me firmë të mbyllur, për pasojë nuk mund të provohet saktësisht se kush është marrësi i parave, nuk është firmosur nga arkëtari, pasi nuk ka arkëtar.

Në kontratë nuk është përcaktuar në asnjë nen të saj që RTSH do ti paguajë biletën e avionit për 359 euro, e shpenzime udhëtim dhe dietë 160 euro.

Për këtë solist, është hartuar urdhër shërbimi sikur të qe punonjës i RTSH që dërgohet me shërbim jashtë vendit, por jo që është solist që vjen nga jashtë shtetit.

Nuk ka situacion ose një dokument të barasvlevshëm me të për realizimin e koncertit të orkestrës simfonike të RTSH më datën 19.01.2022.

Vlera 519 euro përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Mandat pagesa nuk është firmosur nga drejtuesi i institucionit, arkëtari, mandat pagesa është pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk është regjistruar në librin e arkës. Veprime në

kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Ligjin nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjin nr. 10296 dt. 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, pika 15 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera 519 euro. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime udhëtim dhe dieta për N. B., solist nga Franca, i cili ka marrë pjesë në koncertin e orkestrës simfonike të RTSH më datën 19.01.2022. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.03.2025

13. Gjetje nga auditimi: Me urdhër transfertën pa nr. datë 12.12.2023 nëpërmjet Raiffeisen Bank është likuiduar Shoqëria “P.” shpk në vlerën 2,033,208 lekë për emisionin “Ti duhet ta dish”, për marrjen me qira të pajisjeve: Nriçues profile led copë 14, ndriçues led RGBV me zom copë 9, ndriçues të lëvizshëm led spot copë 10, ndriçues të lëvizshëm ledwash copë 10, ndriçues efekti televiziv 2 modele copë 10, pajisje komandimi ndriçimi copë 1, filtra të ndryshëm për ndriçuesit, frost, minus green, cosmetic nga 1 set copë 2, artnet node copë 1, splitera ndriçimi copë 2, ledëall m² 17.

RTSH nuk ka të dokumentuar inventarin e aparaturave të marra me qira, përcaktimin dhe referencat e çmimit dhe personat që i kanë përcaktuar, miratuar këto çmime. Nuk ka vendim të bordit artistik për këtë emision. Vlera 2,033,208 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera 2,033,208 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me marrje me qira ndriçues etj nga Shoqëria “P.” shpk, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e RTSH. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.03.2025

14. Gjetje nga auditimi: Me urdhër transfertën pa nr. datë 30.12.2022 nëpërmjet R. B. është likuiduar Shoqëria “P.” shpk në vlerën 72,000 lekë për koncertin e datës 9 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Qendrën Kulturorë të Katedrales Ortodokse. Me urdhër transfertë pa nr. datë 22.12.2022 nëpërmjet R. B. është likuiduar Shoqëria “P.” shpk në vlerën 72,000 lekë për koncertin e orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin e Operës dhe të Baletit më datë 13.10.2022. Me urdhër transfertë pa nr. datë 30.12.2022 nëpërmjet R.B. është likuiduar

Shoqëria “P.” shpk në vlerën 102,000 lekë për koncertin e datës 1 nëntor 2022 të orkestrës simfonike të RTSH në Teatrin Petro Marko.

RTSH për 3 koncerte datë 13.10.2022, 01.11.2022 dhe 9.11.2022, ka paguar vlerën 246,000 lekë për marrje qira aparatura pa argumentuar pse kjo orkestër ka marrë me qira këto aparatura, çfarë aparaturash janë, a ka në inventar aparaturat e marra me qira, si është përcaktuar çmimi, kush është personi përgjegjës që e ka përcaktuar, referenca e çmimit, kush është personi që e ka miratuar, pse i njëjti operator ekonomik etj.

Orkestra simfonike e RTSH nuk ka qenë në gjendje për vitin 2022 të japë tre koncerte, edhe pse në stafin e saj ka 62 persona me një pagesë mujore 5,109,814 lekë dhe vjetore 61,317,769 lekë, por duhet të merrte me qira aparatura për vlerën 246,000 lekë.

Vlera 246,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH-në dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8 dhe Neni 52, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera 246,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me marrje me qira aparatura nga Shoqëria “P.” shpk, për dhënie 3 koncerte të Orkestrës Simfonike datë 13.10.2022, 1.11.2022 dhe 9.11.2022 vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e RTSH. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 31.03.2025

15. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *Blerje Shërbimi për Platformën OTT*, viti 2020 marrëveshje kuadër me një OE rezulton se sipas aktit me nr. 30/10 prot., datë 17.09.2020 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me BOE fitues M. N. & A. T., me afat të zbatimit të marrëveshjes 24 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton si më poshtë:

- Referuar pagesave të bëra ndaj ofruesit të shërbimit për periudhën 27.01.2021 – 26.02.2021, grupi i punës ka mbajtur procesverbalin e datës 31.08.2020 sipas të cilës ka cituar faktin se trafiku në total që është konsumuar për këtë periudhë për platformën OTT është 8,758,675 GB. Në fakt fatura tatimore nr. 380 datë 11.03.2021 bashkëlidhur ka një sasi GB prej 9,051,450.26 GB me një vlerë prej 4,800,563.33 lekë me TVSH. Duke bërë korrigjimet përkatëse për sasinë e vërtetuar me relacionin e grupit të punës rezulton se janë përfituar tepër nga ana e ofruesit të shërbimit sasia prej 292,775.26 GB, ose vlera prej **155,277 lekë me TVSH;**

- Referuar pagesave të bëra ndaj ofruesit të shërbimit për periudhën 27.07.2021 – 26.08.2021, grupi i punës ka mbajtur procesverbalin e datës 31.08.2020 sipas të cilës ka cituar faktin se trafiku në total që është konsumuar për këtë periudhë për platformën OTT është 1,118,540 GB. Në fakt fatura tatimore nr. 560/2021 datë 10.09.2021 bashkëlidhur ka një sasi fluksi prej 7,952,645.26 GB me një vlerë prej 4,217,797.2 lekë pa TVSH. Duke bërë korrigjimet përkatëse për sasinë e vërtetuar me relacionin e grupit të punës rezulton se janë përfituar tepër nga ana e ofruesit të shërbimit sasia prej 6,834,105.13 GB, ose vlera prej **3,624,563.33 lekë me TVSH;**

- Për periudhën 27.12.2020 – 26.01.2021 shërbimi nga ana e B. M. N. & A. T., nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale pasi sipas verifikimeve të bëra nga grupi i monitorimit të kontratës me shkresën nr. 438/1 prot., datë 19.09.2020 disponueshmëria e shërbimit ka qenë nën

99.5 %, e konkretisht 99.0 %. Në lidhje me këtë situatë nga ana e Drejtorit të Njesisë Teknike z. H. M., nuk janë marrë masa për raportimin në Drejtorinë Ekonomike të kësaj mospërputhjeje me qëllim aplikimin e penaliteteve për mos përmbushje të nenit 14 të kontratës së lidhur sipas aktit me nr. 30/10 prot., datë 17.09.2020. Duke bërë reflektimet përkatëse rezultoi se është favorizuar padrejtësisht sipërmarrësi B. M. N. & A. T., duke mos aplikuar ndaj tij penaltetin e përlogaritur në shumën prej **3,054,898 lekë** si më poshtë nga ana e Grupit të Auditimit:

Shërbimi/mallrat e ofruara	Vlera	25 % e vlerës së kontratës	Nr. i ditëve	Tarifa Ditore	Shuma e Dëmeve
(a)	(b)	(c)	(d)	(e)	(f=c x d x e)
Shërbimi OTT	4,596,662	25,457,484	30	0.004	3,054,898

Si përfundim, rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e B. M. N. & A. T.,t epër në vlerë për shërbime të pakryera dhe penalitete të pa aplikuar në total në shumën prej **6,834,738 lekë**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të arkëtohet ndaj BOE. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën e shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 17.10.2020, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 116– 218 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të AK të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **6,834,738 lekë** ndaj **B M N & A. T.**, për shërbime të likuiduara por të porealizuara si dhe për penalitete të pa aplikuar për dorëzimin me vonesë të shërbimeve në kontratën me objekt “Blerje Shërbimi për Platformën OTT” të lidhur sipas aktit me nr. 30/10 prot., datë 17.10.2020.

Menjëherë

16. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”, viti 2022, rezultoi se sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me OE fitues V. A., me afat të zbatimit të kontratës 12 muaj. Me urdhër nr. 320/1 prot., datë 31.05.2022 të ish Titullarit z. E. J., është ngritur Grupi i Punës për ndjekjen e zbatimit të kontratës me përbërje të grupit z. S. M., z. O. H. dhe z. S. B.. Referuar dokumentacionit të pagesave konstatohet se janë përfituar tepër shumat për pagesat respektive si më poshtë:

Për periudhën e faturimit 11.05.2022 – 31.05.2022, rezultoi se është përfituar tepër vlera prej **4,640 lekë pa TVSH**, prej mos paraqitjes së ditëve të sakta në të cilat ka nisur shërbimi;

Për periudhën e faturimit 01.06.2022 – 30.06.2022, rezultoi se është përfituar tepër vlera prej **38,000 lekë pa TVSH**, prej përfshirjes në faturën tatimore të shërbimit në pikat Stadiumi “Arena Kombëtare” dhe “Elbasan Arena”, pika në të cilat, sipas procesverbalit të datës 05.07.2022 ky shërbim nuk është ofruar;

Për muajin tetor 2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH, kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.11.2022 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezultoi se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin nëntor/2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.12.2022 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezultoi se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH**;

Për muajin dhjetor/2022 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.01.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH;**

Për muajin janar/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.02.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH;**

Për muajin shkurt/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.03.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH;**

Për muajin mars/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.04.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH;**

Për muajin prill/2023 është faturuar shuma prej 654,216 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 01.05.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 636,816 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 18,000 lekë me TVSH, ose **15,000 lekë pa TVSH;**

Për muajin maj/2023 është faturuar shuma prej 239,879 lekë me TVSH kur në fakt referuar procesverbalit të datës 19.05.2023 ky shërbim është ofruar për 23 pika, ose për vlerën prej 225,754 lekë me TVSH. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej 14,125 lekë me TVSH, ose **11,771 lekë pa TVSH;**

Për periudhën maj 2022 – maj 2023 rezulton se nga ana e ofruesit të shërbimit për pikën e emërtuar si “*Pallati i Sportit Goga Baket*” nuk është ofruar internet i llojit Dark Fiber me çmim 23,000 lekë pa TVSH por është ofruar me transmetim oIP, me një çmim prej 15,000 lekë. Për rrjedhojë rezulton se i është paguar tepër ofruesit të shërbimit shuma prej **96,000 lekë pa TVSH** [12 muaj x (23,000 – 15,000)];

Nga verifikimi i pagesave mujore konstatohet se në pikat “*Pallati i Brigadave*”, “*Stadiumi Shijak*”, dhe “*Hotel Tirana*” nuk është ofruar shërbim për të gjithë afatin e kontratës, për 12 muaj AK Radio Televizioni Shqiptar nuk ka marrë shërbimi për të cilin OE V. A., është kontraktuar sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022 me vlerë 8,512,992 lekë me TVSH. Për sa më sipër nga ana e grupit të monitorimit të kontratës, zyrës së financës si dhe Titullari nuk janë marrë masat e nevojshme për aplikimin e penalteteve për mos realizim të kontratës përmes aplikimit të penalteteve. Kjo shumë e pa aplikuar rezulton të jetë në masën prej **44,530 lekë pa TVSH;**

Si përfundim, rezulton se janë përfituar vlera financiare tepër nga ana e OE V. A., për shërbime të pakryera dhe penaltete të pa aplikuar, në total në shumën prej 299,941 lekë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të arkëtohet ndaj OE.

Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën e shërbimit të lidhur sipas aktit me nr. 17.10.2020, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar dhe me

Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 116– 220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të AK të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **299,941 lekë** ndaj **OE V. A.**, për shërbime të likuiduara por të porealizuara si dhe për penalitete të pa aplikuar për dorëzimin me vonesë të shërbimeve në kontratën me objekt *“Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”* të lidhur sipas aktit me nr. 1241/11 prot., datë 11.05.2022.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Mos përmbushja e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 753 prot., datë 25.03.2023 për vlerën **3,500,000 lekë**, ku vlera totale e kontratës ka qenë 5,000,000 lekë, e nënshkruar ndërmjet personit fizik E. R., me emrin tregtar “T. S.” dhe RTSH-së. Në arkivat e RTSH-së për prodhimin e porositur të ciklit të dokumentareve “Bota arbërore deri me dt.14.11.2023”, është dorëzuar vetëm kopja e parë standarde vetëm për një episod. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike personi fizik “E. R.,” shoqëria “T. S.,” është likuiduar sipas faturës nr. 760 datë 29.03.2023 në vlerën 2,000,000 lekë, pra është paguar nga RTSH vetëm kësti i parë, i barabartë me 40 % të vlerës së përgjithshme të fondit financiar.

Pas konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit për këtë projekt artistik dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e RTSH-së, personi fizik “E. R.,” ka dorëzuar në përmbushjen e afatit për realizim të kontratës lëndën objekt i kontratës për veprën audiovizuale “Bota arbërore” dhe është likuiduar për vlerën 1,500,000 lekë sipas faturës 13/23 datë 14.12.2023 (kësti i dyte sipas pikës 2(ii) të nenit 5 të kontratës). Me dorëzimin e të gjithë episodeve personi fizik “E. R.,” duhet të dorëzonte edhe dokumentacionin justifikues të projektit sipas pikës 2(iii)b të kontratës. Personi fizik “E. R.,” nuk ka dorëzuar pranë RTSH-së dokumentacionin financiar justifikues sipas parashikimeve të kontratës që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës.

Pika 4 e nenit 5 të kontratës parashikon se: *“Në rast se personi fizik nuk dorëzon pranë RTSH-së dokumentacionin financiar justifikues ose në rast se dokumentacioni financiar justifikues nuk është i plotë, atëherë personi fizik është i detyruar që të kthejë të gjitha shumat e kësteve të paguara nga RTSH në përputhje me këtë kontratë, si dhe detyrohet të dëmshpërblejë RTSH-në në vlerën e demit të shkaktuar dhe fitimeve të munguara.*

Gjithashtu nga ana e RTSH nuk është verifikuar nëse lënda e dorëzuar përmbush përshkrimet sipas sinopsit të veprës së përcaktuar për prodhim.

RTSH nuk ka monitoruar realizimin e projektit, sipas nenit 9 *“Procedura e zbatimit të projekteve te miratuar”* të Rregullores së miratuar sipas shkresës me nr. 3611 prot. datë 07.11.2016 me Vendim të Këshillit Drejtues.

Personi fizik “E. R.” është likuiduar në total për vlerën 3,500,000 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e RTSH-së.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229– 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **3,500,000 lekë** nga subjekti E. R., (me emrin tregtar T. S.), për projektin artistik *“Bota Arbërore”*. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 753 prot. datë 25.03.2023, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Deri më 30.04.2025

18. Gjetje nga auditimi: Mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1740 prot. datë 20.05.2021 për vlerën **4,500,000 lekë**, ku vlera totale e kontratës ka qenë 5,000,000 lekë e nënshkruar ndërmjet personit fizik E. R., me emrin tregtar “T. S.,” dhe RTSH-së, për prodhimin e porositur të ciklit të dokumentareve “*Koha dhe artisti*”

Sipas materialit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Arkivave episodi i ciklit të dokumentareve “*Koha dhe artisti*” gjendej i ruajtur në sistemin ETER/MAM 8 episode dhe në hard disc 2 episode. Përmbajtja e lëndës së 10 dokumentareve përbërës të veprës nuk ishte e njëjtë me përshkrimin sipas sinopsit të projektit për të cilin personi fizik “E. R.,” është kualifikuar nga Bordi Artistik i RTSH dhe nuk është dorëzuar dokumentacioni justifikues sipas përcaktimeve të kontratës që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjate realizimit të prodhimit të veprës.

Kjo në kundërshtim me rregulloren për “*Projektet artistike dhe filmike*” dhe në kundërshtim me kontratën e bashkëpunimit nr. 1740, datë 20.05.2021 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandimi : Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **4,500,000 lekë** nga subjekti E. R., (me emrin tregtar T. S.) për projektin artistik “*Koha dhe artisti*”. Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1740 prot. datë 20.05.2021, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Deri më 30.04.2025

19. Gjetje nga auditimi: Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2262 prot., datë 24.07.2020, e ndryshuar me amendimin e kontratës me nr. 2674 prot., të datës 16.04.2021 për vlerën **2,392,000 lekë**, ku vlera totale e kontratës së bashkëpunimit ka qenë 2,990,000 lekë e nënshkruar ndërmjet shoqërisë “S.,” e përfaqësuar nga znj. E. R. dhe RTSH-së, për bashkëprodhimin filmik “*Light Falls*”. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga përfaqësuesit e subjektit, kopja e parë standarde e filmit “*Light falls*” është dorëzuar pranë RTSH me datë 26.10.2022, pra 10 muaj pas përfundimit të kontratës, kjo në kundërshtim me kontratën nr. 2674 prot., datë 16.08.2021, ku sipas nenit 1 shoqëria “S.” duhet të dorëzonte kopjen e parë standarde të filmit me datë 15.12.2021.

Sipas faturës nr. 17151842 është likuiduar shoqëria “S.” me përfaqësues znj. E. R., për vlerën **2,392,000 lekë**, pra 80 % e vlerës së kontratës, mungon dokumentacioni justifikues që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjate realizimit të prodhimit të veprës sipas përcaktimeve të kontratës.

Gjithashtu sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit auditues, nuk ka informacion për veprimtarinë e shoqërisë dhe të ardhurat e realizuar nga zbatimi i këtij projekti, veprim ky në kundërshtim me kontratën e sipërcituar nën 5, pika 6. Shoqëria S., ka shfrytëzuar 80 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “*Light falls*” në kundërshtim me kontratën nr. 2262 prot datë 24.07.2020 e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës duke mos përmbushur kështu detyrimet kontraktuale. Në kundërshtim me rregulloren “*Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave*” (Rregullore) dhe kontratën e bashkëpunimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **2,392,000 lekë** nga shoqëria “S..” Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 2262 prot. datë 24.07.2020, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Deri më 30.04.2025

20. Gjetje nga auditimi: Për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr.3690 prot. datë 27.10.2021, për vlerën **1,050,000 lekë**, ku vlera totale e kontratës ka qenë 1,500,000 lekë e nënshkruar ndërmjet shoqërisë “S.,” e përfaqësuar nga znj. E. R. dhe RTSH-së, për bashkëprodhimin filmik “*Violinisti*”.

Shoqëria “S.,” ka shfrytëzuar 70 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “*Violinisti*” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka dorëzuar fare lënden e projektit filmik në RTSH, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale. Shoqëria “S.,” është likuiduar vetëm për 70% të vlerës së kontratës sepse nuk ka dorëzuar dokumentacionin justifikues që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës sipas përcaktimeve të kontratës. Shoqëria “S.” është përgjegjëse për dëmin ekonomik të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara.

Në kundërshtim me rregulloren “*Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave*” (Rregullore) dhe kontratën e bashkëpunimit nr. 3690 datë 27.10.2021 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **1,050,000 lekë** nga shoqëria “S..” Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 3690 prot. datë 24.07.2020, ndërmjet RTSH-së dhe personit fizik E. R..

Deri më 30.04.2025

21. Gjetje nga auditimi: Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me 1731/1 prot., datë 20.05.2021, për vlerën **2,890,000 lekë**, ku vlera totale e kontratës ka qenë 2,890,000 lekë e nënshkruar me shoqërinë “S.&N.”, për bashkëprodhimin filmik “*Edhe një ditë*” Shoqëria “S.&N.” ka shfrytëzuar 100 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “*Edhe një ditë*” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, duke dorëzuar jashtë afateve të kontratës lëndën objekt i kontratës, në kundërshtim me rregulloren: “*Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave*” (Rregullore). -Kontratën e bashkëprodhimit nr. 1731/1 prot., datë 20.05.2021 e nënshkruar ndërmjet Personit Fizik E. R. dhe RTSH-së. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore ,duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit , arkëtimin e vlerës **2,890,000 lekë** nga shoqëria “S.&N.”. Kjo vlerë është e përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën 1705 prot., datë 17.05.2021, ndërmjet RTSH-së dhe shoqërisë S.&N., për vlerën 2,890,000 lekë.

Deri më 30.04.2025

22. Gjetje nga auditimi: Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1008 prot., datë 26.03.2021, për vlerën **2,400,000 lekë**, ku vlera totale e kontratës ka qenë 3,000,000 lekë, e nënshkruar ndërmjet “A. F. P.” dhe RTSH-së, për bashkëprodhimin filmik “*Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur*”. Shoqëria “A. F. P.” ka shfrytëzuar 80 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “*Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur*”, në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika 6 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale, duke dorëzuar jashtë afateve lëndën objekt i kontratës.

Shoqëria “A. F. P.” është likuiduar vetëm për 80% të vlerës së kontratës sepse nuk ka dorëzuar dokumentacionin justifikues që vërteton kryerjen e shpenzimeve financiare të kryera nga personi fizik gjatë realizimit të prodhimit të veprës sipas përcaktimeve të kontratës. Shoqëria “A. F. P.” është përgjegjëse për dëmin ekonomik të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin i vlerës **2,400,000 lekë** nga shoqëria “A. F. P”. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1008 prot. datë 26.03.2021, ndërmjet RTSH-së dhe shoqërisë, “A. F. P”.

Deri më 30.04.2025

23. Gjetje nga auditimi: Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 1297 prot., datë 27.04.2020, për vlerën **3,000,000 lekë** nënshkruar me shoqërinë “P. F. P.”, për bashkëprodhimin filmik “Love”. Shoqëria “P. F. P”, ka shfrytëzuar 100 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “Love” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të drejtave sipas nenit 5, pika e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale duke mos dorëzuar në RTSH lëndën objekt i kontratës. Në kundërshtim me: Rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore), Kontrata e bashkëprodhimit nr. 1297 prot., datë 27.04.2020 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin i vlerës **3,000,000 lekë** nga shoqëria “P. F. P”. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1297 prot. datë 27.04.2020, ndërmjet RTSH-së dhe shoqërisë, “P. F. P”, me vlerë totale 3,000,000 lekë.

Deri më 30.04.2025

24. Gjetje nga auditimi: Mos përmbushje e detyrimeve kontraktuale për kontratën me nr. 2588 prot., datë 09.09.2020, për vlerën **2,400,000 lekë**, ku vlera totale e kontratës ka qenë 3,000,000 lekë nënshkruar me shoqërinë “E. P.”, për bashkëprodhimin filmik “*Luanët drejt Venecias*”.

Shoqëria “E. P.” ka shfrytëzuar 80 % të fondit të bashkëprodhimit filmik, ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për administrimin e projektit, filmik “*Luanët drejt Venecias*” në kundërshtim me kontratën e nënshkruar me RTSH-në, nuk ka raportuar për të ardhurat nga administrimi i të

drejtave sipas nenit 5, pika 4 e kontratës, nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale duke mos dorëzuar lëndën objekt i kontratës. Shoqëria “E. P.,” është përgjegjëse për dëmin ekonomik në vlerën 2,400,000 lekë të shkaktuar buxhetit të RTSH-së dhe fitimet e munguara. Në kundërshtim me: Rregulloren “Rregullore e miratimit dhe e zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave” (Rregullore).

-Kontrata e bashkëprodhimit nr. 2588 prot., datë 09.09.2020 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229– 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin i vlerës **2,400,000 lekë** nga shoqëria “E. P.”. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht nga kjo shoqëri, në kundërshtim me kontratën nr. 1297 prot. datë 27.04.2020, ndërmjet RTSH-se dhe shoqërisë, “E. P.”.

Deri më 30.04.2025

25. Gjetje nga auditimi: Nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e të drejtave me shoqërinë “I., Ltd, pa dokumentacion të vlefshëm. Më datë 30.11.2022 është nënshkruar kontrata me nr. 3868/13 prot., ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm E. J., si dhe shoqërisë tregtare “I.,” Ltd, përfaqësuar nga drejtori A. P., me seli në adresën UNIT 117, Orion Mall, Palm Sdotreet, P.O. Box 828.Vitoria, Mahe, Republic of Seychelles, në shumën 112,010 euro, për blerjen e të drejtave ekskluzive të transmetimit audioviziv të filmave artistik kinematografik dhe të serialëve televizivë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë Procedurë konstatohet dokumentacion i pavlefshëm i paraqitur nga shoqëria I., Ltd në kundërshtim me rregulloren e projekteve filmike dhe artistike Vendim i Këshillit drejtues nr. 10, datë 26.03.2018, neni 10, 12.

Dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit auditues për kryerjen e procedurës për blerjen e të drejtave nga shoqëria I., është i pavlefshëm sipas Ligjit Nr. 110/2018 për noterinë neni 62 ,99, 100, 129. Gjendur në këto kushte, kur nuk ka dokumentacion të vlefshëm për nënshkrimin e kontratës (dokumentacion të vënë në dispozicion të grupit auditues), vlera 56,005 euro likuiduar shoqërisë I., përbën dëm ekonomik për buxhetin shtetit dhe RTSH-së (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 229 – 266 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25.1. Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **56,005 euro**, përfituar padrejtësisht nga shoqëria I. Ltd.

Deri më 30.04.2025

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *Blerje Shërbimi për Platformën OTT*, viti 2020 marrëveshje kuadër me një OE rezulton se ky investim ka parashikuar krijimin e një aplikacioni “RTSH Tani” të aksesueshëm në të gjitha platformat si Android, IOS dhe pajisjet Smart TV përmes të cilit të mund të shihen kanalet TV dhe Radio të RTSH. Procedura është iniciuar me shkresën e administruar në Njësinë Teknike me nr. 436 prot., datë 21.06.2019 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH me nr. 1912 prot., datë 21.06.2019 është bërë kërkesë nga ana e Drejtorit

të NJT për zhvillimin e mëtejshëm të platformës OTT. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është hartuar një relacion sqarues mbi leverdinë e investimit, pra nuk ka një studim fizibiliteti mbi përfitimet që i sjell ky investim RTSH. Aktualisht shërbimi nuk është më funksional pasi kontrata me vlerë 101,829,936 lekë me TVSH ka përfunduar në shtator të vitit 2021 dhe RTSH nuk ka asnjë akses në këtë aplikacion. Për rrjedhojë nga sa më sipër rezulton se nuk ka asnjë indikator vlerësues të dobishmërisë së investimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi” si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të Punës (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 116 – 220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, të kërkohet për çdo investim të parashikuar për tu kryer nga institucioni në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, një studim i qartë fizibiliteti me indikatorë konkretë e të matshëm, kjo më qëllim vlerësimin real të impaktit të investimeve dhe shmangien kështu të praktikave të kryerjes së investimeve të panevojshme dhe përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me Fibër Optike”, viti 2023, rezulton se me shkresën nr. 54/5 prot., datë 30.01.2023 është ngritur grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit me përbërje të grupit znj. B. M., z. M. M. dhe znj. K. B.. Përcaktimi i vlerës së fondit limit është bërë në bazë të ofertave të kërkuara ndaj OE V. A., O. A., A., A. S. C., D., T. dhe T..

Pas marrjes së ofertave, sipas shkresës me nr. 54/24 prot., datë 01.03.2023 është bërë përcaktimi i vlerës së fondit limit si një mesatare e ofertave të marra duke përcaktuar shumën prej 37,265,708.33 lekë pa TVSH. Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në momentin e nxjerrjes së Urdhrit me nr. 54/5 prot., datë 30.01.2023, për përgatitjen e specifikimeve teknike me argumentimin e fondit limit, RTSH ka patur në proces një kontratë të lidhur me OE V. A., me të njëjtin objekt prokurimi e konkretisht “Blerje Shërbimi për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”. Në këtë procedurë është konstatuar se operatori ekonomik i shpallur fitues ka rezultuar me një ofertë fituese, e cila ka një ulje në vlerë prej 4,292,040 lekë pa TVSH nga fondi limit, ose në masën prej 37.7 %. Pra, procedura e mëparshme ka rezultuar e suksesshme me çmime shumë më të ulëta nga ato të parashikuara nga AK në procedurën e aktuale. Për rrjedhojë, në këtë rast AK nuk duhet ti ishte referuar mesatareve të marra nga ofertat e operatorëve ekonomikë V. A., A., A. S. C., A. T. U. O. A., por të merrte në konsideratë edhe çmimet e kontratës së parë. Nga përllogaritjet rezulton se nëse vlera e fondit do të ishte përllogaritur me vlerën e kontratës së vitit 2022, do të ishte në masën 17,861,930 lekë pa TVSH, ose 19,403,778 lekë pa TVSH më pak nga vlera prej 37,265,708 lekë pa TVSH që ka parashikuar AK për vitin 2023. Gjithashtu, konstatohet se as ulja e realizuar nga ana e operatori ekonomik fitues O. A., si rezultat i diferencës midis vlerës së ofertës me vlerën e fondit limit, nuk e ka korrigjuar një efekt të tillë i cili ka bërë që AK të lidh një kontratë për ofrim shërbimi me vlerë **1,139,296 lekë pa TVSH**, më tepër mbi vlerë e duhur të fondit limit¹⁵, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin 162/2020 Për Prokurimin Publik neni 34 Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit, pika 3, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

¹⁵ Nëse vlera e fondit limit do të ishte sipas çmimeve të kontratës së mëparshme.

Publik”, neni 12 Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës, pika 4, neni 13 Studimi paraprak i tregut, pika 2, neni 76 Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, pika 1 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 116 – 220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga ana e RTSH të merren masat e nevojshme për një vlerësim objektiv të mundësive që ofron kuadri ligjor e rregullator i prokurimit publik në përcaktimin e vlerës së fondit limit, duke përzgjedhur mes tyre variantin më të përshtatshëm i cili siguron përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, është lidhur kontratë shërbimi me punonjësin V. Xh., për pozicionin Menaxher i Orkestrës Simfonike, ndërkohë që ky pozicion ka qenë vend vakant në strukturën organike të RTSH. Ky punonjës është paguar me shpërblim mujor me një vlerë më të lartë sesa paga e përcaktuar në librin e pagave për këtë pozicion pune. Kjo gjë ka sjellë efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH-së, pasi shpërblimi është më i lartë sesa paga e përcaktuar në librin e pagave për këtë pozicion pune.

Gjithashtu nuk disponohej dokumentacion justifikues lidhur me relatimin me eprorin direkt për punën e kryer nga ky punonjës dhe prezencën e tij në punë në mospërputhje me kontratën e shërbimit. Nga auditimi u konstatua se nga data 01.09.2022 deri më 30.12.2022 punonjësi z. V. Xh., ka marrë një shpërblim bruto mujor prej 91,765 lekë, vlerë e cila rezulton të jetë më e lartë se paga e përcaktuar për këtë pozicion në librin e pagave, e cila është konkretisht klasa e X^{-të} e pagës. Diferenca midis shpërblimit bruto (91,765 lekë) dhe pagës bazë të përcaktuar në librin e pagave për këtë pozicion, (81,000 lekë, nëse: z. Xh., ka pasur eksperiencë mbi 15 vjet, por duke qenë se punonjësi është larguar nuk ishte e mundur verifikimi i praktikës, pasi ky punonjës nuk ka qenë në strukturë, ndaj nuk ka dorëzuar dokumentacion për vjetërsi në punë) është 10,765 lekë në muaj. Në total janë katër muaj gjatë të cilëve z. Xh., është paguar 10,765 lekë më tepër për çdo muaj, se vlera e përcaktuar në tabelën e pagave. Pra, 10,765 lekë * 4 muaj = 43,060 lekë më tepër. Pra, sipas llogaritjeve tona, z. Xh., ka marrë një vlerë prej 43,060 lekë mbi pagesën bruto që i takonte sipas librit të pagave për këtë pozicion nëse do të ishte emëruar në këtë pozicion vakant. Gjithashtu, duke qenë se sipas të dhënave të marra nga RTSH, struktura e miratuar nga struktura faktike nuk është e plotësuar 100% në asnjë muaj përgjatë periudhës së auditimit, konkludojmë se marrja në punë e punonjësit z. Xh., me kontratë shërbimi ka një efekt negativ për financat e RTSH-së. Vlera **43,060 lekë** përbën efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH-së.

Ky veprim është në mospërputhje me Kontratën e Shërbimit, pika 4, neni 6; Vendim të Këshillit Drejtues të RTSH nr. 28, datë 22.07.2021 të protokolluar me nr. 2447 prot.; Vendim të Këshillit Drejtues të RTSH nr. 34, datë 07.12.2022 të protokolluar me nr.130/3 prot., (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet nr. 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së në bashkëpunim me Drejtorin Ekonomik të marrë masa për rishikimin e kontratës së shërbimit me këtë punonjës dhe gjithë procedurës, për të mos i përsëritur më raste të tilla, të cilat përbëjnë efekt negativ financiar për buxhetin e RTSH-së.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: RTSH për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt "Dëmshpërblim page" për largime nga puna të punonjësve, cilësuar nga gjykata pa shkaqe të arsyeshme, për 6 raste, ka paguar vlerën **9,955,078 lekë**, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

Vendimet gjyqësore i përkasin periudhës së auditimit dhe përpara saj (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 57 – 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të analizohen të gjitha rastet e largimeve nga puna të punonjësve, të cilat kanë rezultuar me ndëshkim financiar nga ana e gjykatave, duke evidentuar përgjegjësitë dhe duke marrë masa për eliminimin e tyre në të ardhmen.

Brenda datës 30.04.2025

5. Gjetje nga auditimi: Efekt financiar negativ në vlerën 49.472.938.4 lekë për procedurën e prokurimit “*Blerje video wall, televizor, dhe pajisje ndriçimi për studiot e RTSH-së*”. Me datë 22.10.2021 është lidhur kontrata me nr. 53/16 prot. ndërmjet RTSH-së e përfaqësuar nga z. M. L., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe bashkimit të operatoreve ekonomike I. & S. C., në vlerën 58,200,000 lekë me TVSh, me datë fillimi nënshkrimin e saj dhe me afat 60 ditë.

Me datë 20.12.2021 Autoriteti Kontraktor RTSH i përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm z. E. J. dhe bashkimi i operatoreve I. SHPK & S. C. përfaqësuar nga z. E. A., kanë nënshkruar amendimin e kontratës me nr. 4546/6 prot, për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e kontratës me nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021, me arsyen se mallrat objekt i kontratës janë bllokuar në port nga situata e Covid 19. Neni 4 i amendimit të kontratës “*Klauzolë shtesë*” përcakton se: “*Nëse me mbarimin e afatit të kontratës siç përcaktohet në nenin 4 të këtij amendimi nuk janë dorëzuar të gjitha mallrat sipas zërave objekt të kontratës nr. prot. 53/16 datë 21.10.2021, në ambientet e RTSH-së, brenda orarit zyrtar të punës (ora 16:00), Autoriteti Kontraktor RTSH ka të drejtën për ta deklaruar kontratën të zgjidhur menjëherë*” Operatori ekonomik I. (pasi ka pranuar zgjidhjen e kontratës në rast mosdorëzimi të mallrave brenda afateve të përcaktuara në amendimin e kontratës), duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për mospranim të mallrave jashtë afateve të kontratës, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë-padinë objekt gjykimi.

Me vendimin 2508 datë 04.10.2022 Gjykata administrative e Shkalles së Parë, Tiranë, ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, Detyrimin e palës së paditur që të përmbushë detyrimin kontraktor ndaj paditësve në shumën 48,500,000 mijë lekë, rrëzimin e kërimit për dhënie vendimi me ekzekutim të përkohshëm dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur. Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbarimor gjyqësor,

Vlera 48,500,000 lekë sipas vendimit gjyqësor nr.2508 datë 04.10.2022. Vlera 972,938.4 lekë për vënien e sekuestros ekzekutive, tarifa e shërbimit përmbarimor.

Vlera 49,472,938.4 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin shtetit dhe buxhetin e RTSH-së.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*” neni 2,3.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, me ndryshimet vijuese të tij, KREU II “*Përgjegjshmëria menaxheriale*”, neni 8 ,neni 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet nr. 116 – 220 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Strukturat aktuale në RTSH, Drejtori dhe bordi drejtues të marrin në vlerësim dhe të analizojnë shkaqet dhe arsyet që kanë sjellë pasojat financiare në vlerën **49,472,938** lekë, duke nxjerrë përgjegjësinë ligjore dhe administrative të të gjitha strukturave drejtuese dhe zbatuese, referuar gjetjeve të grupit të auditimit.

Vlera 48,500,000 lekë sipas vendimit gjyqësor nr.2508 datë 04.10.2022. Vlera 972,938 lekë për vënien e sekuestros ekzekutive, tarifa e shërbimit përmbarimor.

Deri më 31.03.2025

6. Gjetje nga auditimi: Marrje me qira studio televizive lëvizëse transmetuese OB Van Broadcast –Regjia HD (në vijim regjia HD).

Me urdhër transfertë pa nr, datë 30.12.2023 nëpërmjet R. B. është likuiduar Shoqëria “N. P.,” shpk në vlerën 2,400,000 lekë.

Për 4 netët RTSH ka shpenzuar për marrjen me qira të studiove lëvizëse në vlerën 2,400,000 lekë ose 600,000 lekë/natë, vlerë e cila nuk është zë i preventivit të “Festivalit të 61 të këngës” në RTSH, i miratuar me vendim të këshillit drejtues dhe të bordit të administrimit edhe pse në inventarin e RTSH ka dy mjet televizivë të llojit “Studio televizive lëvizëse transmetuese” me vlerë kontabël 93,180,371 lekë.

Vlera 2,400,000 lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 19, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 2, Neni 8, Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19 “Nëpunësi autorizues”, pika b (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 87-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet marrja me qira e studiove televizive lëvizëse transmetuese OB Van Broadcast –Regjia HD (në vijim regjia HD), në vlerën 2,400,000 lekë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për përdorimin pa ekonomicitet të burimeve financiare publike kur RTSH ka në inventarin e saj dy mjete televizivë të llojit “Studio televizive lëvizëse transmetuese” me vlerë kontabël 93,180,371 lekë.

Brenda datës 31.03.2025

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë Ekonomike, rezulton se nga ana e RTSH në vijimësi përgjatë periudhës 2020 deri 30.06.2023 janë favorizuar padrejtësisht qiramarrësit përmes mos arkëtimeve të shumave respektive të cilat arrijnë në total vlerën prej **73,878,523 lekë**, për 23 subjekte, si dhe duke mos marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për aplikimin e penalteteve për vonesa në arkëtimin e shumave në vlerën totale prej **1,802,711 lekë**. Kjo situatë paraqitet e tillë deri me datë 30.06.2023. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratat respektive të qirave (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqet 220 – 229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të RTSH të merren të gjithë masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej **73,878,523 lekë** si këste mujore të papaguara nga ana e subjekteve qiramarrës si dhe shuma prej **1,802,711 lekë** si penaltet i pa aplikuar ndaj 23 subjekteve sipas tabelës nr. 4, bashkëngjitur raportit përfundimtar të auditimit, për mos respektim të kushteve kontraktuale prej përdorimit të aseteve të RTSH, në kundërshtim me kontratat respektive.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të RTSH, të merren masat e nevojshme për të ndjekur në rrugë administrative e duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për të ndaluar përdorimin e aseteve nga ana e këtyre subjekteve deri në kryerjen e pagesave.

Menjëherë

1.3. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të RTSH të merren masat e nevojshme për të mos lidhur kontrata të reja qiraje apo për të mos rinovuar ato ekzistuese me subjektet debitorë si më sipër me qëllim arkëtimin e shumave dhe përdorimin e tyre më pas për interesa të institucionit.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 19, pika 3, kontratave individuale të punës, neni 13, kërkohet të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

E. 1. “Vërejte me paralajmërim për pushim nga puna” për:

1. H. M., me detyrë drejtor i njësisë teknike;

2. B. M., me detyrë përgjegjës i departamentit të stacioneve transmetuese tokësore në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit të shpërndarjes DVB-T2;

Për mos zbatimin e Marrëveshjes Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, Nenin 21, Neni 5, pika 3, Neni 6, pika 4, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, Neni 419, 420, 476, 659, 698, 690 në lidhje me:

Blerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, ndërmjet RTSH dhe operatorit/e shoqërisë “R. & S. Os. G.”, është lidhur marrëveshja kuadër me 54/18 prot., datë 26.02.2021 për vlerën 7,329,968 euro me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj. Për periudhën 01.03.2021 deri 30.06.2023 është likuiduar për vlerën 6,007,626 euro.

Dokumentacioni i likuidimit: Urdhër transfertat, fatura elektronike, raport SLA të kryera për çdo muaj drejtuar drejtuesit të njësisë teknike të RTSH, i firmosur nga grupet e punës/komisionet e ngritura me urdhër të drejtorit të përgjithshëm për vlerësimin e disponueshmërisë së rrjetit DVB-T2, në mënyrë të njëanshme pa firmosur nga “R. & Sch. O. G.”. Shkresat muaj për muaj drejtuar drejtorit të përgjithshëm nga drejtori i njësisë teknike, për dërgimin e raporteve/procesverbaleve për shpërblim të kompanisë R. & Sch. O. G.”.

Pagesat janë bërë/kryer :

- Pa mbajtur akt-kolaudim ndërmjet palëve.

-Raportet mbi SLA e kryera, janë të përgjithshme jo të detajuar, ashtu siç është përcaktuar në specifikimet teknike.

3. V. L., me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit dhe kostifikimit, në cilësinë e ish-shefes së kontabilitetit.

a. Për mos zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 12 pika 3/a.e, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Për zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Ligjit nr. 57/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhim-in e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 pika a dhe b, Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2, Neni 4 dhe 8, Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Neni 98/1 dhe 99/1/2 Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35 dhe 15, Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet

vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, në lidhje me shpenzimet për udhëtim dhe dieta të kryera me anë të arkës në 6 raste për vlerën 10209 euro viti 2022.

b. Për mos zbatim të Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35, në lidhje me pagesat me anë të arkës me mandatpagesat të pa firmosura nga drejtuesi i institucionit, arkëtari, pa numër serie dhe numër rendor, si dhe nuk janë është regjistruar në librin e arkës.

c. Për mos zbatim të Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35 , pika 15, në lidhje me funksionimin e arkës deri më muajin shkurt të vitit 2022.

d. Lidhur me mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratës me objekt “Blerje Shërbimi për Platformën OTT” ku nga auditimi rezultoi se i janë paguar kontraktorit shuma prej **3,624,563.33 lekë me TVSH** për shërbime të pakryera në fakt dhe të pakonfirmuara nga ana e grupit të ndjekjes dhe monitorimit të kontratës si dhe njëkohësisht nuk i janë aplikuar penaltetet për vonesat në ofrimin e shërbimit në shumën prej **3,054,898 lekë**.

4. E. K., me detyrë drejtor fotografie, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

Për mos zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Neni 36 “Specifikimet teknike”, pika 2 në lidhje me procedurën e prokurimit blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH, viti 2023. Në specifikimet teknike ka përcaktuar parametra teknik (përmasat dhe pesha) fiks të ndriçuesve, duke orientuar në këtë mënyrë operatorët ekonomik drejtpërdrejtë një prodhuesi/ofertuesi në treg, që është Shoqëria “F. E.” Shpk. Për pasojë operatori ekonomik që pajisjet i ka me këto parametra, është fitues i tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

5. M. D., me detyrë specialist në sektorin e marrëdhënieve ligjore, drejtoria juridike, në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit të shpërndarjes DVB-T2;

6. E. B., me detyrë specialist në njësinë teknike, në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit të shpërndarjes DVB-T2;

7. E. M., me detyrë përgjegjëse turni në Qendrën e Operimit & Kontrollit të Rrjetit në njësinë teknike, në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit të shpërndarjes DVB-T2,

Për mos zbatim të Marrëveshjes Kuadër të lidhur me 54/18 prot., datë 26.02.2021, Neni 21, Neni 5, pika 3, Neni 6, pika 4, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij Neni 419, 420, 476, 659, 698 dhe 690, në lidhje me blerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, ndërmjet RTSH dhe operatorit/e shoqërisë “R. & S. Os. G.”, është lidhur marrëveshja kuadër me 54/18 prot., datë 26.02.2021 për vlerën 7,329,968 euro me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj.

Për periudhën 01.03.2021 deri 30.06.2023 është likuiduar për vlerën 6,007,626 euro.

Dokumentacioni i likuidimit: Urdhër transfertat, fatura elektronike, raport SLA të kryera për çdo muaj drejtuar drejtuesit të njësisë teknike të RTSH, i firmosur nga grupet e punës/komisionet e ngritura me urdhër të drejtorit të përgjithshëm për vlerësimin e disponueshmërisë së rrjetit DVB-T2, në mënyrë të njëanshme pa firmosur nga “R. & Sch. O. G.”. Shkresat muaj për muaj drejtuar drejtorit të përgjithshëm nga drejtori i njësisë teknike, për dërgimin e raporteve/procesverbaleve për shpërbllim të kompanisë R. & Sch. O. G.”.

Pagesat janë bërë/kryer :

- Pa mbajtur akt-kolaudim ndërmjet palëve.

-Raportet mbi SLA e kryera, janë të përgjithshme jo të detajuar, ashtu siç është përcaktuar në specifikimet teknike.

- Raportet nuk janë sipas aneksit nr. 4 “*Formati i raportit periodik për stacionet e RTSH*”.

8. D. M., me detyrë përgjegjës departamenti i teknikës TV, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “*Blerje pajisje elektronike për nevojat e transmetimit*” të vitit 2020.

a. Për mos zbatim të Ligjit “*Për prokurimin publik*”, Neni 23 për specifikimet teknike dhe Neni 20 “*Mosdiskriminimi*”.

Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është lënë hapësirë por janë vendosur vlera fikse, që pengojnë dhe dekurajojnë konkurrencën.

9. G. J., me detyrë përgjegjës në sektorin e profilaksisë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “*Blerje pajisje elektronike për nevojat e transmetimit*” të vitit 2020.

a. Për mos zbatim të Ligjit “*Për prokurimin publik*”, Neni 23 për specifikimet teknike dhe Neni 20 “*Mosdiskriminimi*”.

Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është lënë hapësirë por janë vendosur vlera fikse, që pengojnë dhe dekurajojnë konkurrencën.

E. 2. “Vërejtje” për:

1. E. P., me detyrë përgjegjëse e sektorit të pagave në cilësinë e ish-drejtores së drejtorisë ekonomike.

a. Për mos zbatim të Ligjit nr. 25/2018, “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, me ndryshimet vijuese të tij, Neni 6 dhe 7, Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” pika 35 , pika 15, në lidhje me funksionimin e arkës deri më muajin shkurt të vitit 2022.

b. Lidhur me mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratës me objekt Blerje Shërbimi për Platformën OTT ku nga auditimi rezultoi se i janë paguar kontraktorit shuma prej **3,624,563.33 lekë me TVSH** për shërbime të pakryera në fakt dhe të pakonfirmuara nga ana e grupit të ndjekjes dhe monitorimit të kontratës si dhe njëkohësisht nuk i janë aplikuar penalitetet për vonesat në ofrimin e shërbimit në shumën prej **3,054,898 lekë**.

2. F. V., me detyrë inxhinier IT, në cilësinë e anëtarit të komisionit të ndjekjes dhe monitorimit të kontratës, lidhur me mangësitë e konstatuara në kontratën me objekt “*Blerje Shërbimi për Platformën OTT*” ku nga auditimi rezultoi se i janë paguar kontraktorit shuma prej **3,624,563.33 lekë me TVSH** për shërbime të pakryera në fakt dhe të pakonfirmuara nga ana e grupit të ndjekjes dhe monitorimit të kontratës si dhe njëkohësisht nuk i janë aplikuar penalitetet për vonesat në ofrimin e shërbimit në shumën prej **3,054,898 lekë**.

3. H. K., me detyrë përgjegjës turni, në cilësinë e anëtarit të komisionit të ndjekjes dhe monitorimit të kontratës, lidhur me mangësitë e konstatuara në kontratën me objekt “*Blerje Shërbimi për Platformën OTT*” ku nga auditimi rezultoi se i janë paguar kontraktorit shuma prej **3,624,563.33 lekë me TVSH** për shërbime të pakryera në fakt dhe të pakonfirmuara nga ana e grupit të ndjekjes dhe monitorimit të kontratës si dhe njëkohësisht nuk i janë aplikuar penalitetet për vonesat në ofrimin e shërbimit në shumën prej **3,054,898 lekë**.

- anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, lidhur me mangësitë e konstatuara në drejtim të vlerësimit të dokumentacionit të OE fitues në procedurën me objekt “*Blerje Shërbimi për Platformën OTT*”.

F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish-drejtesit dhe ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e poshtëshënuar nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

“Lirim nga detyra” për:

1. **Th. G.**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm për periudhën 01.01.2020- 20.05.2021
2. **E. J.**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i RTSH për periudhën 03.12.2021-12.04.2023.
3. **M. L.**, me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm për periudhën 21.05.2021 deri më 02.12.2021
4. **R. N.**, me detyrë zv/drejtor i përgjithshëm për periudhën 13.04.2023 deri më 13.06.2023.

“Zgjidhje e menjëhershme e marrëdhënieve të punës”, për:

1. **E. K.**, me detyrë drejtor i shitjes dhe meanxhimit për periudhën 2020-30.06.2023.
2. **E. D.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike për periudhën 21.02.2022 deri më 30.06.2023.
3. **B. M.**, drejtor i Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike për periudhën 08.09.2022 deri më 11.07.2023.
4. **D. D.**, me detyrë ish-drejtores e drejtorisë për periudhën 26.01.2022 -03.07.2023.
5. **M. H.**, me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve për periudhën përkatëse.
6. **A. H.**, përgjegjës në sektorin e projekteve dhe administrimit të të drejtave për periudhën përkatëse.

“Vërejte me paralajmërim për pushim nga puna” për:

1. **M. A.**, me detyrë juriste në drejtorinë e planifikimit dhe prokurimeve për periudhën 23.01.2020 deri më 01.02.2022.
2. **K. B.**, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve (drejtoria juridike) për periudhën 15.11.2020 deri më 01.09.2023.

Vo: Për punonjësit e mëposhtëm nuk janë rekomanduar masa disiplinore pasi shkeljet ligjore, pavarësisht se ekzistojnë ato nuk janë materiale dhe si të tilla nuk justifikojnë dhënien e masave ndaj personave përgjegjës. Konkretisht nuk është rekomanduar për punonjësit:

1. **G. N.**, me detyrë përgjegjës departamenti i platformës tokësore dhe satelitore.
2. **S. M.**, me detyrë kryeteknik.
3. **S. B.**, me detyrë specialist IT.
4. **M. M.**, me detyrë përgjegjës sektor i transmetimeve lëvizëse dhe satelitore.

Shënim i Kryetarit: Administrimi i pronës do të auditohet me program tematik të veçantë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT